




Kosova Thërret

Konferencë ndërkombëtare për Kosovën, BE-në dhe rajonin - Promovim
i studimeve për marrëdhëniet e BE-së, disa vendeve të rajonit dhe Kosovës

Kosova Thërret

Konferencë ndërkombëtare për Kosovën, BE-në dhe rajonin
- Promovim i studimeve për marrëdhëniet e BE-së,
disa vendeve të rajonit dhe Kosovës





Përmbajtja

Spanja	7
Sllovakia	31
Rumania	51
Greqia	91
Qiproja	121
Serbia	137
Bosna dhe Hercegovina	153
Biografitë	169



Publikuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur dhe British Council
Tirazhi: 500

Parathënie

Shënim:

Opinionet e paraqitura në këto analiza janë të autorëve dhe jo të organizatave që e mbështetën këtë projekt ose të qeverive respektive.

Parathënie

4 vite pas deklarimit të pavarësisë, Kosova është e njohur si shtet nga më pak se gjysma e shteteve në botë (89 vende anëtare nga 193 vende të Kombeve të Bashkuara). Mund të themi që mos-njohjet të cilat kanë më tepër rëndësi janë ato të vendeve të rajonit, specifikisht Bosnja-Hercegovina dhe Serbia, dhe - duke pasur parasysh aspiratat e Kosovës për Bashkimin Evropian – nga pesë vendet anëtare të këtij organizmi: Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.

Në mënyrë që të kuptojmë më mirë politikat dhe historikun pas këtyre qëndrimeve, shtatë artikuj të prezantuar në këtë libër i janë komisionuar disa anëtarëve lider të fushës akademike dhe shoqërisë civile në shtetet e sipërpërmenduara. Çdo artikull paraqet një tablo të detajuar të pozicioneve të çdo shteti përpara dhe pas Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës në 2008 si dhe analizon nëse politikat drejtuar Kosovës kanë qenë të ndikuara nga Opinioni Këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, opinion i cili u bë zyrtar në Korrik 2010. Gjithashtu, autorët e artikujve kanë dhënë konkluzione dhe rekomandime mbi mënyrën se si marrëdhëniet biletarale midis Kosovës dhe këtyre shteteve mund të përmirësohen dhe thellohen.

Këto artikuj janë hartuar gjatë vitit 2011 dhe megjithëse gjatë kësaj kohe ka pasur ndryshime në politikat e brendshme të disa prej këtyre shteteve, analiza e prezantuar në këtë libër ka vlera për të gjithë ata të cilët kërkojnë të kuptojnë pengesat që qëndrojnë përpara Kosovës në rrugën e saj për të ndërtuar një marrëdhënie më të afërt dhe më konstruktive me secilin prej këtyre shteteve.

Për më tepër, është në interesin afatgjatë të Kosovës që të hapi dhe zhvillojë kanale të reja dhe mënyra komunikimi më të gjithë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe publikun e secilit prej këtyre shteteve – duke përfshirë dhe ata të cilët momentalisht nuk e njohin realitetin e ri të Kosovës – dhe jo vetëm për të pasur njohjen si fakt por dhe për të ndërtuar një bazë të qëndrueshme që krijon lidhje të forta midis Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-së, e cila është një parakusht për integrimin e suksesshëm të Kosovës në Bashkimi Evropian.

Ne shpresojmë sinqerisht se opinionistët, përfaqësuesit e zgjedhur, shoqëria civile, media dhe sidomos ata të cilët janë përgjegjës për çështjet shtetërore, do ti dedikojnë një minutë këtij libri dhe të kuptojnë se perspektiva evropiane e Kosovës dhe integrimi rajonal nuk mund të jenë një realitet i vërtetë nëse këto shtetë nuk zhvillojnë përjasje të reja. Një marrëdhënie dinamike midis Kosovës dhe këtyre vendeve do të fuqizonte perspektivën kosovare në rrugën drejt BE-së dhe do të rriste zërin e Kosovës në arenën rajonale dhe ndërkombëtare, e kjo do të ishte në të mirën e të gjithë shtetasve të Kosovës.

Spanja

Pozicioni i Spanjës në Kosovë

**Nga JORDI VAQUER I FANÉS, drejtor i CIDOB,
Qendra e Barcelonës për Studime Ndërkombëtare
Tetor 2011**

Spanja është shteti më i madh nga pesë shtetet anëtare të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Për qëndrimin e qeverisë nuk mungojnë polemikat në Spanjë, por ai mbështetet nga dy partitë politike që zotërojnë shumicën dërrmuese në Parlament dhe të vetmet që kanë ndonjë alternativë që të jenë në pushtet pas zgjedhjeve të ardhshme të 20 nëntorit. Ky punim analizon rrënjët e qëndrimit të Spanjës për mosnjohje dhe zhvillimin e tij prej shkurtit 2008. Përfundimi kryesor është se aktualisht nuk ekziston asnjë shkak i brendshëm që ta ndryshojë qëndrimin për mosnjohje, por argumenti për njohje mund të bëhet më i fuqishëm dhe qëndrimi i Spanjës mund të zhvillohet drejt praktikave më pak kundërvënëse dhe më të dobishme.

Spanja dhe Kosova, Spanja në Kosovë para pavarësisë

Spanja kurrë nuk ka qenë aktore kryesore në skenarin e Ballkanit. Marrëdhëniet ndërmjet Spanjës dhe Jugosllavisë kanë qenë relativisht të përzemërta që nga fundi i Frankos dhe në të vërtetë disa politikanë spanjollë ishin joshur të ndiqnin mosinkuadrin jugosllav, siç bënë Malta dhe Qiproja në atë kohë. Megjithatë, këto marrëdhënie të mira mbetën kryesisht në nivel diplomatik dhe Spanja zgjodhi të përqendrohej në integrimin e saj në organizatat euro-atlantike (Komuniteti Europian dhe NATO). Kur gjendja në Jugosllavi filloi të përkeqësohet, Spanja ishte e re në politikën e BE-së dhe prioriteti i saj kryesor në marrëdhëniet e jashtme të BE-së ishte balancimi i përqendrimit të papritur në Lindje me, së paku, pak përkushtim ndaj Mesdheut jugor.

Që nga fillimi i krizës jugosllave Spanja, ngurroi ta prishte unitetin europian dhe për këtë arsye pranoi zgjidhje kundër instinkteve të saj politike, siç ishte njohja e Kroacisë dhe e Sllovenisë. Spanja mori pjesë në të gjitha nismat europiane dhe e konsideroi përfshirjen e saj në Ballkan si dëshmi të statusit të saj si aktore e rëndësishme europiane. Kur filloi lufta e Kosovës më 1998, Spanja ishte bërë kontribuuese e rëndësishme në misionet ndërkombëtare në Bosnjë (1000 trupa) dhe në Shqipëri (400).

Pjesëmarrja në fushatën e Kosovës ishte vendim relativisht i lehtë, meqë të gjitha partitë në Parlament votuan për këtë, me përjashtim të së majtës radikale (23 prej 350 vendeve). Është me rëndësi të mbahet parasysh se asokohe, dy spanjollë mbanin pozita

kryesore: Javier Solana ishte Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dhe Felipe González ishte emëruar në mars 1998 Përfaqësuese Personal i Kryesuesit në detyrë për RFJ, një mandat që, në mënyrë specifike, përfshinte Kosovën. Opinioni publik nuk ishte veçanërisht i ndjeshëm ndaj kësaj çështjeje, edhe pse në Spanjë ai prirët t'i refuzojë misionet ndërkombëtare, në veçanti ato që udhëhiqen nga NATO. Qëndrimi i Spanjës diktohej në masë të madhe nga europianizimi dhe përfshirja e saj në institucionet ndërkombëtare.

Pjesëmarrja në fushatën bombarduese ishte modeste, por e qartë: Spanja jo vetëm që lejoi shfrytëzimin e tokës së saj, e cila gjendet në mënyrë strategjike ndërmjet ShBA-ve dhe vendit prej nga drejtoheshin operacionet, por kontribuoi me anije luftarake dhe aeroplanë, disa prej të cilëve (tetë F-18) morën pjesë në bombardime. Më pas, Spanja kontribuoi me një batalion në KFOR, ku deri në fund të misionit të saj 10-vjeçar mbeti kontribuuese mesatare (e pesta për nga madhësia në pjesën më të madhe të kësaj periudhe). Një spanjoll, gjeneralletenant Juan Ortuño, u bë në vitin 2000 udhëheqës i KFOR-it. Gjithsej 22.000 ushtarë spanjollë shërbyen në Kosovë (dhe nëntë humbën jetën atje) në atë kohë. Kosova ishte përvojë e formimit për një pjesë të madhe të ushtrisë spanjolle. Ndihma humanitare plotësoi rolin ushtarak të Spanjës. Gjatë atyre 10 vjetëve, në Kosovën perëndimore u shpërndanë gjithsej 1.010 tonë ndihmë ushqimore, më shumë se 10.000 ndihma sanitare dhe u kryen 120 projekte me ndikim të shpejtë (riparime të linjave rrugore dhe elektrike, tubacione uji, përmirësimi i kushteve në shkolla). Ministria e Mbrojtjes e Spanjës vlerëson se kostoja e përfshirjes së Spanjës në Kosovë arrin në 843 milionë euro.¹

Prania e gjerë ushtarake e Spanjës dhe ndihma e saj humanitare nuk u shndërrua në marrëdhënie të afërta në fushat e tjera. Në veçanti, tregtia ndërmjet Spanjës dhe Kosovës mbeti shumë e kufizuar, madje edhe para pavarësisë. Më 2006 Spanja përbënte vetëm 1% të të gjitha importeve të Kosovës dhe pjesa e saj e eksporteve në këtë vend ishte edhe më e vogël. Gjendja nuk ishte më e mirë as sa u përket investimeve.² Në shoqërinë spanjolle, në përgjithësi, aktorë me pak njohuri dhe interesim për Kosovën ishin disa gazetarë që mbuluan (dhe mbajtën gjallë pamjet e atyre kohëve), shumë pak analistë, disa punëtorë ndihmës humanitarë dhe ata që kishin lidhje me misionet ndërkombëtare.

Që nga viti 1999, Spanja ka pasur prani të vazhdueshme ushtarake në Kosovë, por nuk ishte madje as anëtare e Grupit të Kontaktit dhe gjatë të gjitha krizave të Ballkanit ishte më shumë ndjekëse se sa udhëheqëse në Bashkimin Europian. Përfshirja e saj ushtarake mori rëndësi relative meqë vendet e tjera, përfshirë Rusinë dhe Shtetet e

1 Të dhëna zyrtare nga Ministria e Mbrojtjes e Spanjës mund të gjenden në http://www.defensa.gob.es/areasTematicas/misiones/historico/misiones/mision_01.html

2 .Shih, Fonfría Mesa, Antonio 'Viabilidad económica del futuro de Kosovo' në *Documentos de Seguridad y Defensa nº2 Futuro de Kosovo. Implicaciones para España*, Madrid: CESEDEN.

Bashkuara të Amerikës, u tërhoqën nga rajoni gjithnjë e më tepër. Megjithatë, edhe pse për 10 vjet me radhë kishte 600 deri 800 ushtarë në Kosovë, qeveria spanjolle vendosi të mos ketë prani diplomatike në Prishtinë, për dallim jo vetëm nga vendet që më vonë do të mbështesnin pavarësinë e saj (Mbretëria e Bashkuar, ShBA, Franca, Gjermania), por po ashtu edhe nga ato që nuk do ta mbështesnin atë (Greqia, Rusia). Prandaj, marrëdhëniet me autoritetet kosovare ndodhën kryesisht përmes misioneve ndërkombëtare të pranishme atje, në vend që të vendoseshin drejtpërdrejt, madje edhe para pavarësisë.

Zanafilla e qëndrimit të Spanjës kundër pavarësisë së Kosovës

Përveç dhënies së disa shenjave privatisht që ishin kundër Kosovës së pavarur³, udhëheqësit dhe diplomatët spanjollë në përgjithësi u përmbajtën nga dhënia e deklaratave publike lidhur me këtë, madje edhe kur anëtarët e tjera të BE-së, si Qiproja dhe Rumania e bënë këtë. Qëndrimi zyrtar ishte që Spanja parapëlqente një zgjidhje me marrëveshje dhe nuk i pëlqente shpallja e njëanshme e pavarësisë, por që do të kontribuonte në qëndrimin e përbashkët euro-atlantik dhe, në veçanti, të BE-së ose me fjalët e ministrit të jashtëm Moratinos, 'të rrimë dhe të presim unitetin e Bashkimit Europian dhe respektimin e ligjshmërisë ndërkombëtare'⁴. Kundërshtimi i saj i qetë ndaj pavarësisë së njëanshme nuk e mbrojti Spanjën nga gafa e madhe diplomatike, që u pasqyrua në deklaratat e presidentit Putin në Moskë, në të cilat thuhej se BE-ja zbatonte standarde të dyfishta, meqë e kishte marrë parasysh njohjen e pavarësisë së njëanshme të Kosovës, ndërsa në Spanjë 'njerëzit nuk dëshirojnë të jetojnë në shtetin e njëjtë'.⁵ Një ditë më vonë, zëvendëskryetarja e qeverisë spanjolle, Maria Teresa Fernández de la Vega, u përgjigj se gjendja në Kosovë 'nuk mund të krahasohet në asnjë mënyrë me atë të Spanjës',⁶ një fjali që u shfrytëzua në deklaratat zyrtare dhe artikujt e shtypit në javën dhe, në të vërtetë, në vitet pasuese.

Kjo përmbajtje dhe profil relativisht i ulët i Spanjës përfundoi një ditë pas shpalljes së pavarësisë kur, para se të hynte në mbledhjen e ministrave të BE-së për Punë të Jashtme dhe Bashkëpunim, Miguel Angel Moratinos njoftoi se Spanja nuk do ta njihte shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës, sepse ajo nuk e respektonte të drejtën ndërkombëtare. Në takim Spanja propozoi një projektrezolutë e cila, në fund, ishte ajo që u miratua nga të 27 shtetet anëtare në mënyrë unanime. Në rezolutë⁷ u

3 *El País*, 19 nëntor 2007 dhe raporti i Ambasadës Amerikane në Madrid, që theksonte se 'Spanja do ta kundërshtojë njohjen e Kosovës në GAERC' (ID 141748, 2008-02-15 17:39:00, Ambada Madrid, konfidenciale).

4 *El País*, 12 dhjetor 2007

5 *ABC*, 15 shkurt 2008

6 *El País*, 16 shkurt 2008

7 Pjesëmarrja e Spanjës në koalicionin që pushtoi Irakun ishte argumenti kryesor për opozitën socialiste ndaj qeverisë së Aznarit dhe ishte shfrytëzuar gjerësisht para fushatës së zgjedhjeve në fillim të vitit 2004 dhe gjatë saj. Pak tema të politikës së jashtme kanë shkaktuar nivel aq të lartë të ndarjes ndërmjet dy partive më

vlerësua përkushtimi i Kosovës ndaj pakicave të saj, çështja e njohjes iu la shteteve anëtare, u rikonfirmua përkushtimi i BE-së me përpjekjet ndërkombëtare në rajon dhe perspektiva e zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, u përsërit zbatimi i parimeve të Kartës së KB-së dhe të aktit përfundimtar të Helsinkit nga ana e saj dhe, çka ishte vendimtare për Spanjën, konfirmoi që, 'duke e pasur parasysh konfliktin e të viteve nëntëdhjetë dhe periudhën e zgjatur të administrimit ndërkombëtare nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, Kosova është rast sui generis, që nuk i vë në dyshim këto parime dhe vendime'.

Po atë ditë, ministri Moratinos mohoi ndonjë ngjashmëri ndërmjet situatës spanjolle dhe Kosovës dhe e ngriti tonin kur krahasoi pavarësinë e Kosovës dhe okupimin e Irakut më 2003, një krahasim që pati konotacione të fuqishme në arenën politike spanjolle.⁸ Kështu, qeverisa spanjolle menjëherë kërceu nga roli diskret, prapa skenës, në rolin udhëheqës të klubit kundër njohjes në BE. Moratinos, megjithatë, rikonfirmoi përkushtimin e Spanjës që të jetë pjesë e pranisë ndërkombëtare në Kosovë dhe tregoi kënaqësinë e saj që ka kontribuar në 'unitetin e veprimit' të BE-së, që u shfaq simbolikisht përmes deklaratës së përbashkët.

Një muaj pas pavarësisë së Kosovës, 18 shtete anëtare njohën pavarësinë e Kosovës dhe deri në tetor 2008 numri arriti në 22 dhe mbeti kështu deri më tani. Ndërsa partnerët e BE-së njohën Kosovën dhe filluan të vendosin marrëdhënie diplomatike dhe të hapin ambasada në Prishtinë, Spanja zgjodhi Parlamentin e ri, ku socialistët do ta mbanin shumicën dhe kishin mundësi të formonin qeverinë. Profili relativisht i lartë i Spanjës në çështjen e Kosovës u dobësua ngadalë dhe pas javës fillestare të deklaratave të përhershme dhe debatit, qëndrimi i Spanjës ishte i mirënjohur dhe nuk diskutohej shumë.

Arsyet për mosnjohjen fillestare nga Spanja

Zyrtarisht, Spanja nuk e ka njohur Kosovën për arsye që zakonisht janë cituar nga ata që e kundërshtojnë atë: përmendja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë në Rezolutën 1244, statusi i Kosovës si krahinë e Serbisë (dhe jo si republikë e federuar) në Jugosllavi, mungesa e marrëveshjes ndërmjet palëve ose një rezolutë e KB-së, krijimi i një shteti 'për arsye krejtësisht etnike'⁹ kundër angazhimit të mëparshëm të bashkësisë ndërkombëtare në Ballkan dhe respektimi i tri parimeve: e drejta ndërkombëtare, stabiliteti rajonal dhe uniteti i veprimit i Bashkimit Europian.¹⁰

të mëdha politike në Spanjën demokratike. Më 2008 kjo ende kishte konotacione të fuqishme për popullin e Spanjës, i cili e kishte kundërshtuar jashtëzakonisht shumë pushtimin e Irakut.

8 Kjo referencë për Kosovën si 'shtet krejtësisht etnik' është e zakonshme në kritikën spanjolle të pavarësisë së Kosovës, pavarësisht nga dispozitat e planit të Ahtisaarit.

9 Bernardino León Gross 'La posición española sobre Kosovo' *Cinco Días*, 20 shkurt 2008

10 *The Australian*, 19 shkurt 2008; B92 faqja në internet: www.b92.net/eng, 19 shkurt 2008; *Clarín*, 19 shkurt 2008.

Në thelb, këto çështje dallojnë shumë pak nga argumentet e vendeve të tjera për këtë çështje kundër njohjes së Kosovës. Megjithatë, argumentet zyrtare nuk mjaftojnë për të sqaruar opsionet e qeverisë spanjolle. Përse qeveria socialiste spanjolle reagoi ashtu si e përshkruam? Pyetja lë mëdyshje vetëm nëse e vendosim Spanjën në kontekstin e Bashkimit Europian: mbështetja e plotë për pavarësinë e Kosovës në javët e para të shpalljes së saj nuk ishte alternativë që përkrahej nga shumica në Kombet e Bashkuara dhe as në kontekstin mesdhetar dhe të Amerikës Latine. Ne besojmë se ky reagim mund të kuptohet nëse marrin parasysh katër tipare që e dallojnë Spanjën nga shumica e shteteve anëtare të BE-së dhe në veçanti nga katër më të mëdhatë (Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar), me të cilat Spanja synon të jetë pothuajse e barabartë. Këta faktorë janë politika e brendshme, përfshirë ekzistencën e sfidave të shkëputjes, me të cilat përballet Spanja, si dhe afrimi i garës veçanërisht të ngushtë të zgjedhjeve, përkushtimi ndaj së drejtës ndërkombëtare, europianizimi dhe largësia e caktuar nga ngjarjet e përditshme në Ballkan.

Arsyet e brendshme. Pas deklaratave të Moratinos para takimit të ministrave të Jashtëm të BE-së më 18 shkurt 2008, mediat ndërkombëtare, që nga *The Australian* në Sidnej e deri te *B92* në Beograd ose *Clarín* në Buenos Aires,¹¹ ishin pothuajse të njëzëshme në përmendjen e asaj që e konsideronin si arsye kryesore të qëndrimit të Spanjës: problemet e saj me separatizmin bask dhe katalonjas. Politikanët dhe mediat spanjolle kaluan një periudhë të konsiderueshme kohore dhe hapësinore duke mohuar ndonjë lidhje të tillë. Jo vetëm zyrtarët qeveritarë; politikanët pothuajse me çdo rast deklarorin se gjendja është rrënjësisht ndryshe dhe prandaj nuk mund të krahasohej. Duke pasur parasysh të drejtën ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, pretendimi i tyre është i argumentuar mirë. Megjithatë, fakti që gjendja në Kosovë nuk është e njëjtë me atë të shtetit Bask ose të Katalonjës, nuk do të thotë se ekzistenca e problemit të nacionalizmit ndarës në shtetit Bask dhe në Katalonjë është i parëndësishëm për të kuptuar mënyrën me të cilën ka reaguar qeveria e Spanjës ndaj shpalljes së pavarësisë.

Qeveria spanjolle është gjetur në situatë të vështirë disa javë para zgjedhjeve të përgjithshme. Partia Popullore bëri të qartë para shpalljes së pavarësisë se do ta kundërshtonte çdo qëndrim tjetër përpos refuzimit të prerë të pavarësisë së Kosovës dhe udhëheqësi i tyre publikisht shprehu dyshimin që Zapatero mund të jetë në krye të detyrës¹². Privatist, shefi i stafit i ministrit Moratinos pranoi para diplomatëve amerikanë se zgjedhjet ishin faktor kryesor për mosnjohje në atë kohë dhe aludoi se qeveria, nëse do të mbetej në duar të socialistëve, mund ta shqyrtonte këtë pas zgjedhjeve.¹³ Socialistët druanin që çdo hezitim lidhur me çështjen e Kosovës

11 Shih intervistën me Mariano Rajoy, kandidat i Partisë Popullore për postin e kryeministrit, në *El País*, 17 shkurt 2008.

12 Raporti që doli nga Ambasada Amerikane në Madrid: 'Reagimi i Spanjës ndaj pavarësisë së Kosovës' (ID 142305, 2008-02-21 09:09:00, Ambasada Madrid, konfidencial)

13 Vetëm si shembull: në vitin 2007, importet e Austrisë vetëm nga Kroacia ishin më shumë se dyfishi i importeve të Spanjës nga tërë ish-republikat jugosllave, me përjashtim të shtetit anëtar të BE-së, Sllovenisë, ndërsa eksportet austriake në Kroaci ishin afërsisht katër herë më të mëdha se eksportet e Spanjës në krejt

do të shfrytëzohej nga Partia Popullore gjatë fushatës si shenjë e dobësisë para nacionalistëve katalonjas dhe baskë, të cilët nuk e fshihnin mbështetjen për pavarësinë e Kosovës. Trysnia shtesë erdhi nga ana tjetër. Qeverisa baske, e udhëhequr nga Partia Nacionaliste Demokristiane Baske (EAJ/PNV) nxori një deklaratë⁸ më 17 shkurt, ku e vlerësoi procesin e pavarësisë së Kosovës si ‘mësim për mënyrën e zgjidhjes së konfliktit të identitetit dhe të përkatësisë në mënyrë paqësore dhe demokratike’, edhe pse shumica e nacionalistëve të Katalonjës ishin më pak të prirë për të bërë krahasime dhe në të vërtetë refuzonin çdo tipar karakteristik të një procesi ku përfshihej përpjekja për gjenocid dhe përfshirja ushtarake ndërkombëtare. Shtypi u nda sipas linjave gjeografike: ndërsa gazetatat me seli në Madrid (*El País*, *El Mundo*, *ABC*, *La Razón*) u rreshtuan përkrah qeverisë në refuzimin e saj ndaj shkëputjes së Kosovës, gazetatat nga Barcelona (*La Vanguardia*, *El Periódico*, *Avui*) argumentuan se pavarësia ishte e pakthyeshme dhe theksuan pozitën e pavolitshme në të cilën po e linte qeveria Spanjën për shkak të një pozite të zhurmshme të panevojshme, duke u rreshtuar përkrah Qipros, Rosisë dhe Serbisë.

Separatizmi katalonjas dhe bask fut një element tensioni në sistemin politik të Spanjës, çka sqaron pse çdo herë kur një vend miraton pavarësinë, të gjithë aktorët politikë ndihen se janë të detyruar të reagojnë në marrëdhëniet e brendshme dhe jo vetëm në ato të jashtme. Madje edhe pavarësia e Malit të Zi, që nuk ishte kontroverse askund tjetër, tërhoqi vëmendjen e nacionalistëve të të dy palëve (katalonjas/baskë dhe spanjollë). Në kontekstin e ngarkuar rëndë të zgjedhjeve, është e kuptueshme që përmendja e Kosovës si ‘rast sui generis’ në deklaratën e Këshillit të Ministrave më 18 shkurt është parë si vendimtare nga diplomacia spanjolle. Në kontekstin më të gjerë të pakicave dhe të tensionit shkëputës kryesisht paqësor (me përjashtim të veprimeve të trishtueshme terroriste të ETA-s), është shumë e mundshme që qëndrimet e aktorëve spanjollë pak a shumë në favor të pavarësisë së Kosovës janë të ndikuara nga mënyra se si ndihen lidhur me situatën në Spanjë. Por, për dallim nga disa prej gazetarëve ndërkombëtarë, ne besojmë se vetëm ky faktor nuk mund ta sqarojë qëndrimin e Spanjës lidhur me këtë çështje dhe po ashtu duhen marrë parasysh edhe faktorët e tjerë që pasojnë.

Arsyet normative. Përmendja e Irakut nga Miguel Ángel Moratinos si një rast tjetër i veprimit të paligjshëm të bashkësisë ndërkombëtare, i cili mund të krahasohet me shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës, nuk ishte rastësi. Kundërshtimi i José María Aznar-it për të marrë pjesë në samitin e Azureve me George W. Bush dhe Tony Blair, ku u zyrtarizua pushtimi i Irakut, ishte themel i strategjisë kundërshtuese të Partisë Socialiste. Ngjitja e socialistëve në pushtet menjëherë u sinjalizua me ‘kthimin te ligjshmëria ndërkombëtare’, shprehja më e dukshme e së cilës ishte

ato pesë shtete (Bosnjë – Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi), sipas të dhënave zyrtare të ofruara nga faqja e internetit e Institutit Spanjoll për Tregti të Jashtëme – ICEX (www.icex.es) dhe nga Statistik Austria (www.statistik.at).

tërheqja e trupave të Spanjës nga Iraku. Shumanshmëria dhe mbrojtja e së drejtës ndërkombëtare do të bëheshin shenjë e identitetit të politikës së jashtme të qeverisë së Rodríguez Zapateros.

Prandaj, përmendja konstante e së drejtës ndërkombëtare nga ana e Spanjës deri në një masë të madhe nuk duhet të merret kallëp. Është e vërtetë që diplomatët spanjollë kurrë nuk e kanë dashur të drejtën për vetëvendosje jashtë kontekstit kolonial; dhe po ashtu rol mund të ketë luajtur edhe frika nga efekti domino – jo në Spanjë, por në konfliktet e tjera në Europën Juglindore. Por përkushtimi ndaj së drejtës ndërkombëtare ishte bërë shenjë e identitetit dhe ide udhëheqëse deri në atë masë sa kthimi në çështjen e Kosovës do ta kishte vënë në pikëpyetje parimin themelor të diskursit të politikës së jashtme të socialistëve.

Arsyet europiane. Mund të duket paradoksale që këtu të përfshihen prirjet europiane të qeverisë së Rodríguez Zapateros, meqë në shikim të parë qëndrimi spanjoll duket se është përçarës duke pasur parasysh që shumica dërrmuese e shteteve anëtare kanë zgjedhur njohjen. Megjithatë, europianizimi ka luajtur rol në veprimet e qeverisë spanjolle. Fillimet e kësaj prirjeje si shenjë e identitetit të qeverisë socialiste janë të ngjashme me ato të përkushtimit ndaj së drejtës ndërkombëtare. Ftohja gjithnjë e më e madhe e Aznarit nga bërthama europiane, në veçanti në boshtin Paris – Berlin dhe orientimi pro Atlantik u kritikuan rreptë nga socialistët që ishin në opozitë. Kthimi në Europë u bë temë po aq e rëndësishme në politikën e jashtme sa edhe përkrahja e së drejtës ndërkombëtare, kur erdhën në pushtet.

Ndërsa katër të mëdhenjtë (Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar) në mënyrë progresive vendosën dhe treguan gatishmërinë e tyre për mbështetjen e pavarësisë së Kosovës, krijuesit e politikave të jashtme të Spanjës panë se si dy prej parimeve të saj kryesore udhëheqëse së shpejti mund të binin ndesh: ose Spanja do të duhej ta njohte Kosovën në mënyrë që të shmangte thyerjen e zërit unik europian, ose do të duhej të qëndronte si faktor ndarës në një çështje vendimtare për BE-në. Treguesit që disa shtete si Greqia dhe Sllovakia nuk ishin të gatshme ta njihnin shtetin e ri tani për tani dhe, në veçanti, reagimi i shfaqur i Qipros dhe i Rumanisë, krijuan mundësi që Spanja, së paku me retorikë, të mbështeste europianizimin dhe të drejtën ndërkombëtare. Deri në ditën e fundit para pavarësisë, megjithatë, Spanja thjesht pohoi se do të punonte që ta ruante unitetin e veprimit.

Më 18 shkurt, Spanja shfrytëzoi kartat e veta. Në njërën anë, qëndrimi kategorik i saj parandaloi që Qiproja dhe Rumania të ziheshin ngushtë lidhur me këtë çështje dhe u krijoi mundësi vendeve të tjera, më pak kategorike, që t'i bashkoheshin një grupi që ishte aq i madh sa të tregonte se opsioni kundër pavarësisë nuk ishte vetëm i çuditshëm në Union. Në anën tjetër, teksti i konsensusit që u hartua nga diplomacia

spanjolle përfshinte të gjitha shqetësimet e qeverisë spanjolle, i shmangej çdo aluzioni të njohjes së përbashkët dhe i dhe mundësi Spanjës të pohonte se ishte ruajtur uniteti i veprimit. Kështu, përkundër të gjitha dëshmimeve për të kundërtën – shtetet anëtare madje nuk ishin në gjendje të vendosin nëse duhej ta njihnin apo të mos e njihnin pavarësinë e paralajmëruar – Spanja pohoi se Bashkimi European e kishte ruajtur unitetin e veprimit të jashtëm. Në të vërtetë, nuk ishte ruajtur besueshmëria e shkatërruar e BE-së si aktor i unifikuar ndërkombëtar, por mundësia, disa javë para zgjedhjeve të përgjithshme, për të pohuar se ende vlenin dy parimet udhëheqëse të politikës së jashtme të Rodríguez Zapateros: respektimi i së drejtës ndërkombëtare dhe kthimi në zemër të Europës.

Arsyet rajonale të Ballkanit. Karakteristika e fundit që e dallon Spanjën nga katër shtetet më të mëdha anëtare të BE-së është shtrirja e pranisë së saj në Ballkan. Para viteve nëntëdhjetë, Spanja kishte prani jashtëzakonisht të kufizuar historike në rajonin e Ballkanit dhe gjeografikisht është e ndarë prej tij. Me përjashtim të fushës ushtarake dhe të sigurisë, Spanja, në masë të madhe, ka pasur rol dytësor në arenën e Ballkanit dhe roli i saj i kufizuar tregtar, politik, diplomatik dhe social në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor paraqet një dallim të madh nga prania e një numri të madh të shteteve anëtare të BE-së.¹⁴

Spanja nuk është anëtare e Grupit të Kontaktit, ku bëjnë pjesë gjashtë vendet (Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar) që udhëhoqën nismat e mëdha diplomatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor në 15 vjetët e fundit. Diplomacisë spanjolle i mungojnë ekspertët për Ballkanin dhe ka prani të kufizuar në rajon, pjesërisht për shkak të gjendjes së përgjithshme të këtij shërbimi, që ka pak njerëz, është i financuar dobët, është zgjeruar tepër dhe nuk është fort i specializuar.¹⁴ Ka lidhje të vjetra me Jugosllavinë, që kurrë nuk janë shkëputur plotësisht, madje edhe në vitet më të këqija të Millosheviçit, si dhe që kishin vazhduar me Serbinë. Këtu bëjnë pjesë lidhjet personale të ministrit Moratinos, i cili ka shërbyer si diplomat i ri në Beograd në vitet tetëdhjetë dhe përshkruhej nga Vuk Jeremiç, ministri i jashtëm i Serbisë, si 'engjëll mbrojtës i këtij qyteti [Beogradit] dhe këtij vendi'.¹⁵ Ambasadori i Spanjës në Serbi prandaj arriti të thoshte në qershor 2009 se 'Serbia dhe Spanja e kanë ndihmuar njëra-tjetrën në 30 vitet e kaluara'.¹⁶ Për dallim, më 17 shkurt 2008, Spanja, ndryshe nga shumë partnerë të saj të BE-së, nuk kishte zyre ndërlidhëse në

14 Për një pasqyrë të të gjitha problemeve të shërbimit diplomatik spanjoll, shih Comisión para la Reforma Integral del Servicio Exterior 2005 *Informe sobre la Reforma del Servicio Exterior Español*, 20 qershor 2005 (i papublikuar, por mund të gjendet në http://www.maec.es/SiteCollectionDocuments/Documentos/informe_CRISEX.pdf).

15 Këto fjalë u thanë me rastin e nderimit të Moratinos si qytetar nderi i qytetit të Beogradit për mbështetjen dhënë Serbisë. El Mundo, 12 dhjetor 2009. Moratinos ishte po ashtu mysafir nderi në konferencën e ambasadorëve serbë në janar 2009.

16 Tanjug, 'Jeremiçi: Spanja mbështet fuqishëm Serbinë, Beograd, 25 qershor 2009.

Prishtinë dhe rrjeti i saj diplomatik në rajon ishte larg konsolidimit: ambasadat në Tiranë dhe në Shkup funksiononin për më pak se dy vjet dhe në Podgoricë nuk kishte ambasadë.

Prandaj, elementi më i rëndësishëm i pranisë spanjolle në rajon ishte pjesëmarrja e Spanjës në misionet ndërkombëtare. Në çastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Spanja kishte 637 ushtarë në KFOR-in e fuqishëm të NATO-s, që përbëhej prej 15.900 pjesëtarë. Ajo po ashtu kontribuoi në UNMIK me 8 'guardias civiles' (xhandarë), 6 zyrtarë të policisë dhe 2 vëzhgues ushtarakë. Edhe pse pjesëmarrja e saj me më pak se 5% në tërë praninë e armatosur ndërkombëtare në Kosovë mund të mos duket shumë mbresëlënëse për një vend relativisht të madh me 45 milionë banorë, për standardet spanjolle kjo nuk është pjesëmarrje e papërfillshme. Në fillim të vitit 2008 ekzistonin vetëm katër misione ushtarake spanjolle jashtë vendit dhe Kosova renditej e treta pas Libanit (1 100 trupa) dhe Afganistanit (778 trupa) dhe ishte shumë më lart se Bosnja dhe Hercegovina (316 trupa). Ushtria spanjolle ishte ajo pjesë e administratës që kishte më shumë njohuri lidhur me gjendjen në Ballkan.

Shumica e vendeve që e kanë njohur Kosovën kanë pohuar se pavarësia e saj do të kontribuojë për paqen e qëndrueshme në rajon.¹⁷ Sipas përkrahësve të pavarësisë, ekzistenca e Kosovës në njëloj harrese e ka bërë zhvillimin ekonomik praktikisht të pamundur dhe po pengon zhvillimin e tërë rajonit, përfshirë Serbinë. Pas disa muaj të tërë bisedimesh të pasuksesshme, pavarësia shihej si opsioni i vetëm me shanse për sukses dhe opsioni i vetëm real për Serbinë. Është për t'u habitur sa pak përpjekje bëri qeveria e Spanjës për zvogëlimin e argumenteve të tilla. Përgjigjja e vetme ishin referencat e përgjithshme se pavarësia është negative për stabilitetin e rajonit. Ndërsa zyrtarët spanjollë u përqendruan në mbrojtjen e ligjshmërisë ndërkombëtare për arsyet e dhëna më sipër, ata pothuajse e lanë pas dore perspektivën rajonale. Prandaj, argumenti kryesor për njohje nga Franca, Britania, Italia dhe Gjermania mungonte në masë të madhe në diskursin zyrtar të Spanjës. Spanja këmbëngul në proces (shpallja e njëanshme e paligjshme) dhe referencat kryesore për pasojat janë të rezervuara për ndikimet që ka kjo në të drejtën ndërkombëtare dhe jo në sigurinë rajonale. Kjo duhet të kuptohet kur mbahet parasysh prania dhe interesat relativisht të vogla të Spanjës në rajon në kohën e pavarësisë.

17 Shih, për shembull, deklaratat e Bernard Kouchner, ministër i Punëve të Jashtme i Francës dhe mbështetës i hapur i opsionit të pavarësisë, menjëherë pas Takimit të Këshillit European më 18 shkurt 2008 në faqen e internetit të MPJ të Francës: http://www.diplomatie.gouv.fr/fr/pays-zones-geo_833/balkans_1056/kosovo_650/france-kosovo_4601/proclamation-independance-du-kosovo-18.02.08_59650.html#sommaire_1.

Nga Osetia Jugore në Hagë: zhvillimi i qëndrimit të Spanjës

Qëndrimi i Spanjës u ngurtësua shumë shpejt në ditët pas shpalljes së pavarësisë nga Kosova, por situata në Kosovë prej atëherë ka ndryshuar, ashtu si edhe në Serbi apo dhe në kontekstin ndërkombëtar. Numri i vendeve që e njohin Kosovën si shtet të pavarur (ku bëjnë pjesë shumica e demokracive perëndimore) tani është katër herë më i madh se ç'ishte dhjetë ditë pas pavarësisë. Janë organizuar disa ngjarje, më e rëndësishmja prej tyre nisma e Serbisë për ta shpallur të paligjshme pavarësinë duke kërkuar këshillë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila në fund dështoi. Spanja nuk e ka ndryshuar qëndrimin e saj themelor kundër njohjes që nga shkurti 2008, por nuk do të thotë që ajo ka qëndruar si vëzhguese pasive e situatës. Në të vërtetë, Spanja ka ndërmarrë nisma dhe i ka bllokuar ato dhe ka mbetur aktive si dhe reaguese gjatë gjithë periudhës në tre vjet e gjysmë që kanë kaluar.

Qëndrimi i qeverisë së Spanjës mund të përshkruhet si mosnjohje konstruktive: shmangia e ndarjes në Europë, përmbajtja nga pengimi i nismave të dobishme ose nga animi në konflikt dhe mbajtja e aftësisë për të ndërmjetësuar dhe, në veçanti, për ta orientuar Serbinë drejt drejtimit 'të drejtë' (domethënë proeuropian). Megjithatë, ka indikacione të fuqishme që qëndrimi i Spanjës, në veçanti në muajt e parë, shkoi edhe përtej kësaj. Qeveria dhe shërbimi diplomatik ndërmorën një kundërshtim aktiv ndaj njohjes së pavarësisë së Kosovës me demarshe diplomatike në mënyrë që t'i shkurajonte vendet nga njohja. Për shembull, në fillim të tetorit 2008, disa medie serbe (si ditorja *Dnevnik* e Novi Sadit, agjencia zyrtare e lajmeve *Tanjug* dhe stacioni liberal televiziv *B92*)¹⁸ zbuluan se diplomatët spanjollë kishin marrë udhëzime me një listë argumentesh, në mënyrë që t'i bindnin partnerët në Afrikë, në Amerikën Latine dhe në botën arabe që të mos e njohnin Kosovën. Misioni i Spanjës në KB ishte posaçërisht aktiv dhe po ashtu ushtronte trysni të drejtpërdrejtë në qeveritë mike (dhe relativisht të varura), përfshi Andorrën dhe disa republika të Amerikës Qendrore.¹⁹

Kur Rusia vendosi të njihte Osetinë Jugore dhe Abkhazinë, në gusht 2008, shumë komentues spanjollë u ngutën të kërkonin ngjashmëri dhe të fajësonin pavarësinë e Kosovës për përkeqësimin e gjendjes në Kaukaz.²⁰ Krejt ndryshe nga disa prej partnerëve të saj të BE-së, qeveria e Spanjës heshti gjatë tërë fazës ushtarake të krizës në Osetinë Jugore dhe nxori deklaratën e saj të parë më 26 gusht, 18 ditë pas shpërthimit të gjendjes së luftës, duke u përqendruar në vendimin rus për njohjen e

18 Një përmbledhje në gjuhën angleze mund të gjendej në www.b92.net/eng më 5 tetor 2008, por pastaj është hequr.

19 Pohimet për 'trysni' në favor të njohjes kanë qenë të zakonshme gjatë tri viteve të mëparshme, më së shumti nga zyrtarët e Beogradit. Fenomeni i kundërt është publikuar më pak, por ekzistenca e udhëzimeve për diplomatët spanjollë, publikuar në shtypin serb, nuk është mohuar kurrë dhe zyrtarët nga Andorra dhe republikat e Amerikës latine privatisht i kanë pranuar përpjekjet e Spanjës, që kanë shkuar deri tek nivelet e larta në ministri.

20 Shih për shembull komentin redaktorial në *El País*, 27 gusht 2008 dhe në *ABC*, 27 gusht 2008.

Osetisë Jugore dhe të Abkhazisë si shtete të pavarura, duke e shprehur mospajtimin e saj me të dhe duke theksuar nevojën për respektimin e integritetit territorial të shteteve, në këtë rast të Gjeorgjisë, por pa përmendur as veprimet ushtarake, as praninë e trupave ruse në tokën e Gjeorgjisë, përveç përmendjes së marrëveshjes së ndërmjetësuar nga BE-ja.²¹ Ministri i Jashtëm spanjoll shprehu kënaqësinë e tij për shkallën në të cilën BE-ja ishte 'e bashkuar, e lidhur dhe e përkushtuar për të luajtur një rol të rëndësishëm politik'.

Në krizën e Kaukazit, Spanja nuk bëri ndonjë deklaratë të zëshme për të drejtën ndërkombëtare ose integritetin territorial dhe në të vërtetë ishte mes shteteve anëtare të BE-së që publikisht kritikonin më së paku veprimet e Rusisë. Kjo është e kundërta e gjetjes së kohës së përshtatshme, tonit dhe qëndrimit që kishte mbajtur Spanja një ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Papritmas, Spanja u bë e zhurmshme në kritikën ndaj partnerëve të BE-së për vendimet e tyre që të njihnin Kosovën, por ndërkaq u tregua e moderuar në kohën e dhënies së deklaratës së saj kritike për ndërhyrjen e njëanshme ushtarake të Rusisë dhe njohjen e Abkhazisë dhe të Osetisë Jugore. U deshën më shumë se dy javë që të nxirrej deklarata e parë zyrtare, që me sa dukej ishte pjesërisht rezultat i faktit që kjo kishte ndodhur në kulmin e sezonit të pushimeve, por po ashtu për shkak të pozitës së rehatshme të krijuar nga siguria që të tjerët do t'i bënin kritikën dhe do të bartnin goditjen kryesore të Rusisë së armiqësuar (një qëndrim që ishte në harmoni me qëndrimin në përgjithësi prorus të Spanjës brenda BE-së). Politikanët dhe ekspertët që ishin kundër njohjes morën një qëndrim 'a të kam thënë' në lidhje me çështjen e Kosovës dhe argumenteve të tyre kundër njohjes së Kosovës ua shtuan këto pavarësi (që i shihnin si dëshmi të efektit domino të paralajmëruar).

Kundërshtimi i njohjes zyrtare u lidh me kodin e vetimponuar, të pashprehur me fjalë, (krijuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, që kurrë nuk u bë i qartë dhe publik) për t'iu shmangur njohjes 'përmes derës së pasme'. Kjo nënkuptonte pengimin e çdo nisme të BE-së, të KB-së ose të ndonjëres nga agjencitë e tyre që mund të interpretohet si njohje e shtetësisë kosovare. Për dallim nga shumica e vendeve mosnjohëse që kanë interesa në rajon, Spanja shkëputi çdo lidhje të përfytyrueshme me autoritetet e Kosovës së pavarur dhe hoqi dorë nga çdo lloj përfaqësimi në Prishtinë, qoftë në formën e zyrës së përhershme (siç janë ato që mbajnë shtetet mosnjohëse të njohura, si Greqia, Rusia ose Kina), ose, për një periudhë të gjatë, nga vizitat diplomatike – sipas një vendimi paradoksal, madje as diplomatët nga ambasada e Spanjës në Beograd nuk mund ta vizitonin Kosovën. Parlamentarët u këshilluan që të mos e vizitonin vendin. Dokumentet zyrtare të Kosovës, siç janë pasaportat që janë pranuar nga vendet mosnjohëse, si

21 MAEC 'Declaración del MAEC sobre los últimos acontecimientos en el Cáucaso' Madrid: Njoftimi për shtyp i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Spanjës, numër 119, 26 gusht 2008.

Sllovakia, do të refuzoheshin nga Spanja. Madje prania e përfaqësuesve të shoqërisë civile nga Kosova në një ngjarje mjaftonte që të kishte për pasojë mospjesëmarrjen e përfaqësuesve zyrtarë të Spanjës, në veçanti të diplomatëve. Zbatimi më ekstrem i këtyre rregullave ishte vizita e Carmen Chacón, ministres së atëhershme të Mbrojtjes të Spanjës në Kosovë, në mars 2009. Në mënyrë që t'i shmangej madje edhe një takimi të rastësishëm me autoritetet kosovare, ministrja Chacón fluturoi me një aeroplan ushtarak në një bazë italiane prej nga udhëtoi me helikopter në bazën ushtarake spanjolle, në vend që të shkonte rrugës më të lehtë tokësore, nga aeroporti komercial në Prishtinë. E gjithë kjo ndodhi në një kohë kur kontaktet ndërmjet zyrtarëve serbë dhe qytetarëve të Kosovës ishte një ngjarje pothuajse e përditshme dhe kur zyrtarët dhe politikanët serbë udhëtonin rregullisht në Kosovë. Në shumë aspekte, doktrina e brendshme e Madridit lidhur me Kosovën e kaloi edhe atë të Beogradit.

Pjesërisht si zgjatje e kësaj doktrine erdhi edhe njëri prej vendimeve më kundërtënëse të administratës së Zapateros lidhur me Kosovën: tërheqja e njëanshme e trupave spanjolle nga KFOR-i i udhëhequr nga NATO. Vizita e ministres Chacón në mars 2009, çka u përshkrua më lart, kishte për qëllim njoftimin (së pari për medie, pastaj për trupat dhe vetëm më pas për aleatët e habitur) se Spanja do të tërhiqej nga Kosova ngase nuk mund të qëndronte në një mision, mandati i të cilit nuk korrespondonte me situatën e re dhe që nuk ishte më 'neutral ndaj statusit'. Vendimi u paraqit si rrjedhojë logjike e kundërshtimit të pavarësisë së njëanshme të Kosovës nga ana e Spanjës dhe thjesht u prezantua si 'mision i përmbushur'.²² U kritikua rreptë nga opozita e qendrës së djathtë për armiqësimin me aleatët dhe dëmtimin e besimit ndërkombëtar të Spanjës si pjesëmarrëse në misionet ndërkombëtare (qeveria e njëjtë më parë e kishte ndërprerë praninë në misionet ndërkombëtare në Irak dhe në Haiti pa këshillime paraprake), në vend së të bëhej kjo në bazë të meritave në terren.²³ Shtypi dhe komuniteti i ekspertëve kritikuan mënyrën dhe substancën e tërheqjes, por opinioni publik ishte në masë të madhe me qeverinë: 70% e spanjollëve dhanë vlerësim pozitiv për tërheqjen nga Kosova dhe vetëm 43% mendonin se kjo dëmtonte marrëdhëniet me ShBA-të (edhe pse ekzistonte një ndarje e qartë ideologjike lidhur me çështjen e dytë: 30% e atyre që e konsideronin veten të majtë mendonin se nuk e bënte këtë, krahasuar me 58% të atyre që e konsideronin veten të djathtë).²⁴ Deri në mesin e shtatorit 2009, i gjithë personeli ushtarak i Spanjës u tërhoq nga Kosova.

Qëndrimi i Spanjës kundër pavarësisë nuk ishte askund më i dukshëm se në BE. Së bashku me katër vendet e tjera mosnjohëse (Greqinë, Sllovakinë, Rumaninë dhe Qipron), Spanja u tregua e gatshme të bllokonte çdo nismë të BE-së, për të cilën mendonte se nuk është 'neutrale ndaj statusit' dhe mund të fuqizonte pavarësinë e

22 *El País*, 20 mars 2009.

23 Debati i plotë parlamentar mund të gjendet (në gjuhën spanjolle) në Diario de Sesiones del Congreso de los Diputados. Pleno y Diputación Permanente. Año 2009. IX Legislatura. Num. 71, faqe 9 deri 50.

24 Barómetro del Real Instituto Elcano, 20ª oleada, Marzo-Abril 2009

Kosovës ose të institucioneve të saj. Pas reagimit negativ të Serbisë dhe Rusisë kundër EULEX-it, ministri Moratinos sugjeroi që misioni mund të mos funksiononte më në Mitrovicë, një sugjerim që u hodh poshtë menjëherë nga Përfaqësuesi i atëhershëm i Lartë i BE-së për CFSP, Javier Solana.²⁵ Dy javë pas njoftimit për tërheqje nga KFOR-i, qeveria e Spanjës e bëri publik vendimin e saj për tërheqjen e nëntë policëve spanjollë, që ishin pjesë e EULEX-it në atë kohë, përsëri pa konsultime të mëparshme me aleatët.

Ndërsa Spanja po përgatitej për Presidencën e radhës të Këshillit të Ministrave të BE-së në gjysmën e parë të vitit 2010, zëra brenda BE-së dhe në Mision filluan ta vinin në pikëpyetje nëse mund të kryente punë të balancuar që pasqyronte konsensus, nëse jo shumicën, në BE.²⁶ Diplomacia spanjolle ishte e ndjeshme ndaj kritikave dhe bëri përpjekje të qëllimshme që të prezantonte një imazh të balancuar. Në mënyrë diskrete, ajo rivendosi kontaktet me udhëheqësit kosovarë dhe filloi një nismë të madhe, Takimin e nivelit të lartë mbi Ballkanin Perëndimor (Sarajevë, 2 qershor), që përmes një formati të dizajnuar me kujdes, u krijonte mundësi përfaqësuesve të qeverisë së Serbisë dhe të Republikës së Kosovës që të uleshin në të njëjtën tryezë – një sukses i rëndësishëm duke e pasur parasysh që një ngjarje e ngjashme e organizuar në Slloveni javë më parë ishte bojkotuar nga Serbia për shkak të pranisë së autoriteteve kosovare.

Në Kombet e Bashkuara, aktivizimi i Spanjës kundër njohjes u ekspozua haptazi për herë të parë në vendimin e saj për të votuar për propozimin e Serbisë në takimin e 63-të plenar të Asamblesë së Përgjithshme të KB-së (8 tetor 2008) për të kërkuar mendim këshillëdhënës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë mbi ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Duke bërë këtë, Spanja (dhe katër shtetet tjera mosnjohëse të BE-së) veproi ndryshe nga shumica e vendeve të BE-së, që zgjodhën të abstenonin. Për më tepër, Spanja i paraqiti në GJND komentet e saj me shkrim në korrik 2009.²⁷ Në të vërtetë, deklarata e Spanjës ishte më e gjata nga të gjitha tekstet e paraqitura në mbështetje të qëndrimit serb. Mënyra në të cilën u zhvillua pjesëmarrja e Spanjës në procedurën para GJND-së ishte e veçantë për shkak se qëndrimi ishte hartuar dhe mbrojtur nga pesë profesorë të së drejtës ndërkombëtare (njëri prej tyre ishte shefi i departamentit të së drejtës ndërkombëtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme) dhe diplomati i vetëm i karrierës i pranishëm aty ishte ambasadori i Spanjës në Holandë. Ky ishte reflektim i diskursit të brendshëm sipas të cilit e drejta ndërkombëtare dhe jo politika apo diplomacia duhej të ishin fryma me të cilën mund të shqyrtohej çështja e Kosovës, meqë ekzistonte supozimi (si në qeveri, ashtu edhe mes shumicës së studiuesve të së drejtës ndërkombëtare në Spanjë) se shpallja e pavarësisë ishte

25 *El País*, 11 mars 2008

26 Pasqyrim i shqetësimeve të tilla është artikulli 'Presidenca spanjolle rrit konfuzionin e Kosovës', më 27 janar 2010 nga Euractiv.com <http://www.euractiv.com/en/enlargement/spanish-presidency-adds-kosovo-confusion/article-189262>

27 'Pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare e shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës (kërkesë për mendim këshillëdhënës). Komentet me shkrim nga Mbretëria e Spanjës. Korrik 2009 <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15644.pdf>

qartazi akt i paligjshëm. Prandaj, mendimi këshillëdhënës i GjND-së, i dhënë më 22 korrik 2010,²⁸ ishte në kundërshtim me qëndrimin zyrtar të Spanjës. Aty theksohej se 'e drejta e përgjithshme ndërkombëtare nuk përmban asnjë ndalim të aplikueshëm të shpalljeve të pavarësisë'; mendimi këshillëdhënës i GjND-së vazhdon t'i hedhë poshtë argumentet kryesore të qëndrimit me shkrim të Spanjës. Pika e vetme kryesore e marrëveshjes në të dy tekstet është se, si Spanja ashtu edhe GjND-ja konsiderojnë se kjo e fundit ka të drejtë të japë mendim këshillëdhënës lidhur me këtë çështje. Për pjesën tjetër, GjND-ja arrin pothuajse përfundim të kundërt me atë të delegacionit spanjoll. Pjesë të rëndësishme të argumentit, në veçanti përmendja e integritetit territorial dhe rezoluta 1244 (1999), adresohen në mënyrë specifike në mendimin e GjND-së dhe interpretohen në mënyrë krejt të kundërt nga komentet e shkruara të Spanjës.

Mendimi e solli çështjen e Kosovës përsëri në debatin politik të vendit në Spanjë, ashtu siç bëri edhe në aspektin global por, ashtu siç ndodhi edhe në nivelin ndërkombëtar, ai nuk e ndryshoi mendimin e ndonjë aktori kryesor politik. Ata që ishin pro, sidomos nacionalistët e moderuar baskë dhe katalonjas, shfrytëzuan rastin të kërkonin ndryshimin e qëndrimit të Spanjës, por as qeveria, as partia kryesore e opozitës nuk treguan interesim që të nisnin një debat të ri. Qeveria nënvizoi se 'Kosova është rast i pazakontë', njoftoi se nuk do ta njihnte atë dhe vazhdimisht mohoi ndonjë ngjashmëri me Katalonjën dhe shtetin Bask: 'Ato nuk kanë fare të bëjnë me të dhe gjithkush që ka ndjenjë përgjegjësie, nuk mund ta krahasojë situatën në Kosovë (dhe në Ballkan) me normat e të jetuarit së bashku në mesin e qytetarëve spanjollë',²⁹ siç tha zëvendëspresidentja e atëhershme Maria Teresa Fernández de la Vega.

Qeveria spanjolle u qetësua kur pa që vala e njohjeve, të cilave u frikësohej, nuk u realizua në javët pas nxjerrjes së mendimit këshillëdhënës të GjND-së. Kur Serbia, në mënyrë që të kundërshtonte ndikimin negativ të mendimit të GjND-së, vendosi ta kthente çështjen në një terren që e konsideronte më të favorshëm për qëndrimin e saj, atë të takimit të Asamblesë së Përgjithshme të KB-së në shtator 2010, Spanja bashkoi forcat me pjesën tjetër të BE-së për të shmangur një konfrontim të ri të drejtpërdrejtë me shumicën e shteteve të BE-së. Trysnia e kombinuar e institucioneve të BE-së dhe e shteteve anëtare³⁰ e bindën presidentin Tadiç të miratonte një vendim të përbashkët Serbi – BE, që shtronte rrugën për bisedime të drejtpërdrejta ndërmjet Prishtinës

28 Pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare e shpalljes së njëanshme të pavarësisë në lidhje me Kosovën (Kërkesë për Mendim Këshillëdhënës), Mendimi Këshillëdhënës i GjND-së, 22 korrik 2010 <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>

29 .El País, 24 korrik 2010.

30 Është e vështirë të vërtetohen ose të refuzohen pohimet konkurruese lidhur me faktin se ndikimi i kujt ishte vendimtar për ta bindur Tadiçin ta kundërshtonte ministrin e tij të Jashtëm Vuk Jeremić dhe të ndryshonte strategjinë serbe. Diplomacia spanjolle është përpjekur të marrë meritat për këtë, por këtë e kanë bërë po ashtu ekipi i zonjës Ashton dhe ministrat e Punëve të Jashtme, së paku të Britanisë dhe Gjermanisë. Me sa duket, përgjigja është kombinimi i trysnive, por vetëm një kërkim i hollësishëm i vendimmarrjes serbe në fund të verës 2010 do të mund të na jepte përgjigje përfundimtare.

dhe Beogradit. Me këtë u përmbush thirrja që kishte bërë Spanja që nga shkurti 2008 për bisedime të mëtejshme dhe prandaj shihej nga diplomacia spanjolle si përligjeje e përpjekjeve të saj dhe plotësim i qëndrimit të 'miqësisë së posaçme' me Serbinë. Që nga shtatori 2010, as pretendimet kundër udhëheqjes kosovare, që u bënë në raportin e Martit, as dhjetëra njohje të reja që ndodhën që nga shtatori 2010, nuk kanë ndikuar shumë në ndryshimin e qëndrimit të Spanjës ose të aktorëve kryesorë politikë të Spanjës dhe çështja e Kosovës është fundosur përsëri në paqartësinë relative mes prioriteteve ndërkombëtare të Spanjës.

Perspektiva për zhvillimin e ardhshëm: aktorët dhe qëndrimet e tyre

Në kohën kur po shkruhet ky punim, Spanja është duke shkuar drejt zgjedhjeve të përgjithshme që, sipas parashikimeve të bëra nga shumica e sondazheve, do të sjellin një ndryshim në shumicën parlamentare dhe, si rrjedhojë, të partisë në pushtet, pra nga Partia Socialiste (PSOE - Partido Socialista Obrero Español) tek ajo e djathtë (PP - Partido Popular). Pavarësisht nëse do të ndodhë kështu në fund apo jo, kjo nuk do të ketë ndonjë rëndësi të madhe për çështjen e (mos) njohjes së pavarësisë së Kosovës. Bashkërenduesi për marrëdhëniet ndërkombëtare i PP, Jorge Moragas, e bëri të qartë në fund të muajit gusht 2011 kur e konfirmoi se qëndrimi i partisë së tij në atë kohë ishte që Spanja nuk duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës. 'Ne ende mendojmë se kjo pavarësi ndodhi jashtë ligjshmërisë ndërkombëtare', tha ai.³¹

Pa dyshim, aktualisht, mosnjohja duket që është instaluar fort në qeverinë e Spanjës, në veçanti në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe në shërbimin diplomatik. MPJ-ja e Spanjës nuk ka hequr dorë prej asnjërit prej argumenteve fillestare për kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës, por më pak nënvizohet Rezoluta 1244 e KB-së, integriteti territorial dhe, në përgjithësi, e drejta ndërkombëtare pas mendimit të GJND-së, ndërsa krijimi i gjoja një shteti etnik, efekti domino i dëshmuar nga njohja e Osetisë Jugore dhe Abkhazisë nga Rusia dhe nevoja për gjetjen e një zgjidhjeje me marrëveshje reciproke mbeten po aq argumente të rëndësishme kundër njohjes, kjo e fundit e përforcuar në masë të madhe nga rezoluta e KB-së, që bën thirrje për bisedime të drejtpërdrejta ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Kur u sfidua lidhur me mospajtimin me shumicën dërrmuese të aleatëve të saj në BE dhe në NATO, qeveria kundërshtoi duke thënë se shumica e shteteve anëtare të KB-së ende nuk e kanë njohur Kosovën e pavarur dhe, prandaj, Spanja nuk është e izoluar në këtë çështje.

Në të vërtetë, një argument i ri është shtuar: që mosnjohja nga Spanja i ka dhënë asaj pushtet të posaçëm mbi Serbinë, deri në atë masë sa tani, 'shumica e atyre që e

31 El País, 28 gusht 2011

kanë njohur shpalljen e njëanshme të Kosovës, si një pjesë e BE-së, kërkojnë nga ne spanjollët që të veprojmë dhe të shërbejmë si element për t'i bindur dhe tërhequr forcat e ndryshme politike të Serbisë.³² Si dëshmi janë shfrytëzuar tri ngjarje: roli i Spanjës, së bashku me socialistët ndërkombëtarë, në inkurajimin e Partisë Socialiste të Serbisë, të udhëhequr më parë nga Millosheviçi, që t'i shkëpusë lidhjet me të kaluarën dhe të hyjë në një koalicion proeuropian, që në këtë mënyrë do të mund ta merrte pushtetin në Beograd në korrik 2008;³³ pjesëmarrja e Serbisë në konferencën e nivelit të lartë në Sarajevë, e thirrur nga Spanja, që mbante presidencë e radhës në BE-së në qershor 2010; dhe vendimi i Tadiçit që të hiqte dorë nga taktikat kundërvënëse të ministrit të tij të Jashtëm në Asamblenë e Përgjithshme të KB-së në shtator 2010 dhe në vend të kësaj të paraqiste një tekst të përbashkët Serbi-BE, duke bërë thirrje për bisedime të drejtpërdrejta. Prandaj, në arsyetimin e qeverisë dhe të diplomatëve të Spanjës, ky rol i posaçëm duhej të ruhej duke vazhduar me mosnjohjen, me sa dukej deri sa Serbia të ndryshojë qëndrimin e saj ose deri sa të arrihet një marrëveshje.

Shumë pak gjëra mund të sugjerojnë që, në mungesë të zhvillimeve të mëdha në Ballkan, opsioni në favor të njohjes do të nxirrej me forcë nga opinioni publik i Spanjës. Edhe pse, në shumicën e kohës, opinioni publik është në masë të madhe indiferent ndaj politikës së jashtme, ka pasur çështje (posaçërisht, pjesëmarrja e Spanjës në koalicionin që pushtoi Irakun më 2003) që i kanë mobilizuar spanjollët në mënyrë të gjerë. Sigurisht që Kosova nuk është njëra prej tyre. Ashtu si dhe në arenën e përgjithshme politike, qëndrimi i shumicës së spanjollëve ndaj Kosovës duket se ka të bëjë me këndvështrimet e tyre lidhur me shkëputjen dhe, në veçanti, me debatin e brendshëm në Spanjë për çështjen e baskëve dhe të katalonasve.

Gjashtë javë pas shpalljes së pavarësisë, 45% e spanjollëve të pyetur në sondazh e konsideronin këtë ngjarje negative, përkundër 33%, të cilët e konsideronin pozitive (22% nuk dinin ose nuk u përgjigjën). Pjesa e votuesve të PP që mendonin se është negative (57%) ishte më e madhe se e votuesve të PSOE (45%). Sondazhi nuk jepte të dhëna sipas rajoneve, por ishin dy grupe që kishin një shumicë të lehtë të pikëpamjeve pozitive: votuesit e vetëshpallur të 'majtë' (41% pozitive, kundrejt 40% negative) dhe votuesit e rinj (18-30 vjeçarë) (41% pozitive kundrejt 38% negative). Është interesant se një shumicë e qytetarëve të pyetur në sondazh (40%) u pajtuan që 'pavarësia e Kosovës është e dëmshme për Spanjën, sepse ajo nxit kërkesat për pavarësi' (35% nuk u pajtuan), dhe shumica dërrmuese (62%) u pajtuan se 'dallimet ndërmjet vendeve europiane lidhur me Kosovën tregojnë që nuk ka politikë të përbashkët të jashtme europiane' (vetëm 15% nuk janë pajtuar). Prandaj nuk është për t'u çuditur që shumica (40%) u pajtuan me vendimin e qeverisë së Spanjës që të mos e njohë

32 Sipas fjalëve të Miguel Ángel Moratinos, ministrit të atëhershëm të Jashtëm, thënë në Parlament. Shih Diario de Sesiones del Congreso de los Diputados. Comisiones. Año 2008. IX Legislatura. Num. 27 (22/05/2008). Exteriores, faqe 30.

33 Po aty, faqe 26

(33% nuk u pajtuan). Grupi i vetëm që e refuzoi vendimin ishin përsëri votuesit e rinj nën moshën 30: 46% e tyre ishin kundër qëndrimit të qeverisë, krahasuar me 30% që u pajtuan.³⁴

Në debatin politik, dy partitë kryesore, PSOE dhe PP (që së bashku në zgjedhjet e fundit të përgjithshme përbënin 84% të votave dhe 92% anëtarë të zgjedhur të Parlamentit) kanë qenë vazhdimisht kundër njohjes. Vija e tyre e argumentit ka qenë që vazhdimisht ta mohojnë çdo ngjashmëri me gjendjen e brendshme në Spanjë dhe ta paraqesin pavarësinë si të paligjshme pa kurrfarë dyshimi (kryesisht para vendimit të GJND-së), por po ashtu edhe si të padobishme për zgjidhje paqësore, si dhe të papranueshme për shkak të karakterit të saj të njëanshëm. Kryetari Zapatero kërkoi bazë më të lartë morale në Parlament lidhur me këtë çështje: 'Kur dikush vepron për shkak të koherencës dhe parimit, ai nuk duhet të frikësohet nga pasojat'.³⁵ Ata nuk ishin të vetmuar në qëndrimin e tyre. Dy partitë e tjera 'nacionale', që ishin të përfaqësuara në Parlament me nga një deputet, mbështetën qëndrimin e tyre: kjo i përshtatej si kredencialit të fortë antiimperialist dhe antiamerikan të së Majtës së Bashkuar, ashtu dhe idealeve të fuqishme centriste të Union Progreso y Democracia - UPyD unike.

Qëndrimet në favor të njohjes së pavarësisë së Kosovës erdhën nga partitë nacionaliste baske dhe katalonase.³⁶ Një pakicë e vogël, kryesisht nacionalistë ekstremë të radikalizuar, në veçanti në shtetin Bask, u rreshtua përkrah Serbisë, por partitë kryesore kishin në përgjithësi këndvështrim të favorshëm. Për partitë që ishin për pavarësinë, si Esquerra Republicana de Catalunya, pavarësia e Kosovës ishte lajm i mirë, pasi e mbante derën hapur për shtetet e reja në Europë – një qëndrim i ngjashëm me atë që ishte marrë kur u pavarësua Mali i Zi. Kjo ishte në harmoni me reagimin fillestar të qeverisë baske në kohën e pavarësisë, kur ishte në duart e nacionalistëve të moderuar baskë (shih më lart); megjithatë, qëndrimi i partisë së tyre, PNV-EAJ, evoluoi dhe në Parlamentin spanjoll kjo parti ishte në pajtim me atë të homologut të tyre katalonas: duke argumentuar në favor të njohjes me argumente ndërkombëtare dhe jo me ato vendase. Grupi më i madh dhe më me ndikim, nacionalistët e moderuar katalonas të CiU, hedh poshtë çdo krahasim me Spanjën dhe vazhdimisht ka kërkuar njohjen e pavarësisë së Kosovës, diçka që e shohin si të pashmangshme në një afat të gjatë, në mënyrë që të mbyllet harta e Ballkanit dhe Spanja të integrohet në rrjedhën e përgjithshme europiane dhe perëndimore; duke qenë në dijeni të kundërshtimit të njohjes nga dy partitë kryesore, nacionalistët e moderuar kanë kërkuar së paku një

34 *Barómetro del Real Instituto Elcano*, 17^a oleada, Abril 2008

35 *Diario de Sesiones del Congreso de los Diputados. Pleno y Diputación Permanente. Año 2009. IX Legislatura. Num. 71 (25/03/2009)*, faqe 29

36 Në politikën e brendshme të Spanjës, parti 'nacionaliste' janë ato që përkrahin idenë se nuk ka komb unik spanjoll, por një shtet që përfshin më shumë se një komb (Baskia, Katalonia, Galicia). Disa prej këtyre partive e përkrahin pavarësinë, por të tjerat nuk e bëjnë këtë dhe janë fuqishëm proeuropiane. Nacionalizmi spanjoll në partitë në mbarë Spanjën nuk mund të quhet si 'nacionalist'; në të vërtetë mund të quhet 'antinacionalizëm' në disa raste, për shkak të kundërshtimit të kërkesave nacionaliste katalonase dhe baske.

qëndrim më pragmatik dhe më pak pengues nga diplomacia e Spanjës.³⁷

Shtypi dhe mediat në përgjithësi e kanë mbuluar çështjen e Kosovës në një masë më të madhe se vendet e tjera europiane. Ka ndodhur kështu pjesërisht për shkak të kundërshtimit të Spanjës në BE, por kryesisht edhe për arsye të ngjashmërisë së brendshme. Shumica e mediave që kanë raportuar për Kosovën janë përqendruar në reagimet politike ndaj insinuatave që kjo është e rëndësishme për çdo çështje të marrëdhënieve qendër-periferi në Spanjë, në vend që të përqendrohen në argumentet për të drejtën ndërkombëtare ose në kontekstin rajonal. Ndarja tashmë e përmendur ndërmjet shtypit (dhe mediave të tjera) me seli në Madrid dhe të atyre me seli në Katalonjë dhe në Baski (të parat kryesisht kundër njohjes, të fundit kryesisht për njohje) vlen edhe për linjën e përgjithshme redaktoriale (edhe pse gazeta kryesore e Spanjës, e cila anon nga e majta, *El País*, ka kaluar nga mbështetja e qëndrimit të qeverisë të kritika ndaj sjelljeve të saj dhe shmangia nga çështja e rëndësishme). Megjithatë, artikujt dhe raportimet me opinion në favor të njohjes kanë qenë shumë të dukshme si në *El País* ashtu edhe në *ABC* (gazeta e tretë e Spanjës, që konsiderohet si zë i së djathtës tradicionale). Në përgjithësi, mediat kanë shfaqur mendime në të dy drejtimet dhe një pjesë e vogël e spanjollëve, që i përcjell nga afër çështjet si kjo, ka qasje të lehtë në argumentet e të dy drejtimeve. Kështu, në veçanti ka qenë rasti se mendimi këshillëdhënës i GJND-së ka kundërshtuar këndvështrimin që deri atëherë ishte dominues: që pavarësia ishte e paligjshme.

Analistët dhe institutet kanë më pak ndikim në Spanjë se në Mbretërinë e Bashkuar apo në ShBA, por ata nuk zënë vend në debatin e politikës së jashtme. Veçantia e Kosovës, krahasuar me çështjet e tjera të dukshme të politikës së jashtme, është epërsia që kanë pasur në debat akademikët e së drejtës ndërkombëtare – në nivelin qeveritar, ashtu siç është sqaruar më lart, por po ashtu edhe në debatet publike. Analistët e tjerë ishin të ndarë dhe ka qenë po ashtu i qartë një fenomen i ngjashëm me atë që është vërejtur në opinionin e përgjithshëm publik: gjenerata e re e analistëve ka qenë më e zhurmshme në favor të njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Përfundime dhe rekomandime

Për disa arsye, qëndrimi i Spanjës mes vendeve mosnjohëse të BE-së ka qenë më i dukshmi dhe këtu mund të përfshihen: madhësia e saj, qëndrimin e zhurmshëm, qëndrimet brenda BE-së, kodet e rrepta të sjelljes ndaj autoriteteve kosovare, nismat ndërkombëtare të Spanjës kundër njohjes dhe tërheqja e papritur nga KFOR-i. Për këto arsye, Spanja tashmë ka qenë objektiv i disa nismave dhe është duke u vështruar si ndryshuese e mundshme e lojës në kohën e ndaljes së njohjeve, me qëllim që të mund

37 Shih në veçanti Diario de Sesiones del Congreso de los Diputados. Comisiones. Año 2008. IX Legislatura. Num. 27 (22/05/2008) Exteriores, prej faqes 18 deri në 30.

t'ua bëjë më të lehtë vendeve të tjera të BE-së dhe të Amerikës Latine ndryshimin e qëndrimit të tyre dhe njohjen.

Megjithatë, deri tani ka pak gjëra që tregojnë se trysnia e jashtme do ta ndryshojë qëndrimin e Spanjës apo se aktorët që do të mund ta ndryshonin qëndrimin e Spanjës mund të binden me argumente të mira. Nxitjet për të ndryshuar janë shumë të kufizuara. Për arsye se realiteti në terren nuk është bazë për arsyetimin e Spanjës dhe në mungesë të krizave të mëdha ose të zhvillimeve të dhunshme, ngjashmëria e gabuar me gjendjen baske dhe katalonase do të mbetet njëloj në mendjen e politikanëve, gazetarëve dhe qytetarëve. Në këtë kontekst, gjasat për ndryshimin e qëndrimit për mosnjohje janë të pakta. Por lajm i mirë është se Spanja ka shumë pak interes material për këtë çështje, e cila është relativisht e vogël krahasuar me çështjet e tjera të politikës së jashtme, si marrëdhëniet me Kubën apo Marokun. Prandaj është e mundshme që qëndrimi të ndryshojë pa ndonjë reagim të madh politik ose të opinionit publik. Me fjalë të tjera, asnjë qeveri nuk do të kishte telashe serioze për ndryshimin e qëndrimit të Spanjës për Kosovën dhe reagimi i ashpër nga shtypi dhe opozita mbase nuk do të ishte më i madh se ai me të cilin u përball Zapatero në lidhje me tërheqjen e papritur nga Kosova.

Çfarë mund të ndikonte për ndryshimin e qëndrimit? Me sa duket, këtë nuk do ta bëjë ndërrimi i ministrit (në këtë aspekt, zëvendësimi i Miguel Ángel Moratinos nga një ministër që nuk ka lidhje me serbët, Trinidad Jiménez, nuk solli praktikisht asnjë ndryshim) ose partia në pushtet (Partia Popullore duket se ka më pak mirëkuptim për pavarësinë e Kosovës). As opinionit publik nuk ka mundësi të mobilizohet në favor të njohjes, nëse gjërat qëndrojnë ashtu si janë. Të dyja (ndryshimi i qeverisë dhe mobilizimi i opinionit publik) megjithatë, mund ta shtronin rrugën drejt njohjes po të kishte ndryshime në kontekstin ndërkombëtar apo rajonal. Ndaj e bisedimeve, që do të mund t'i vishej Serbisë; shumica në BE, që do ta kushtëzonte përparimin e Serbisë në procesin e anëtarësimit me njohjen e Kosovës; rreziku i përshkallëzimit të dhunës ose ndryshimi i papritur politik drejt një qëndrimi antieuropian në Serbi - të gjithë janë shembuj të faktorëve që mund të nxisin ndryshim. Po ashtu, një valë e re e njohjeve, përfshirë disa shtete mosnjohëse të BE-së apo disa grupe të vendeve që deri tani nuk kanë qenë shumë të gatshme (Amerika Latine, vendet arabe passovjetike); një zhvillim i ri në KB (si humbja e votës nga Serbia); përtëritja e trysnisë amerikane, kur qeveria spanjolle të kërkojë marrëdhënie bilaterale ose mbështetje për një çështje vendimtare (anëtarësimi në G20, për shembull) - të gjithë këta janë shembuj të ngjarjeve të jashtme që mund të kenë si rezultat njohjen nga Spanja.

Deri sa të ndodhë kjo, çfarë strategjie do të funksiononte për të krijuar kushtet e favorshme për njohje? Më poshtë janë dhënë disa elemente për një strategji të tillë.

1. Hapja e kanaleve institucionale me Ministrinë e Jashtme dhe zyrën e kryeministrit është e rëndësishme. Në mungesë të lidhjeve të drejtpërdrejta me autoritetet kosovare, vetëm Beogradi merr vëmendjen e vazhdueshme, duke përfshirë ambasadën shumë aktive të Serbisë në Madrid. Këto kanale duhet të kenë për qëllim të jenë sa më afër ministrit dhe kryeministrit, meqë duket se, në një masë të madhe, shërbimi diplomatik pajtohet me qëndrimin për mosnjohje (edhe pse jo domosdoshmërisht me veprimet që ndërmerren në lidhje me të). Qëllimi fillestar nuk duhet të jetë që t'i bindin ata, por vetëm të sigurohet se e kuptojnë anën kosovare të tregimeve në zhvillim dhe jo vetëm atë serbe. Është e pritshme që vendimi përfundimtar do të merret në krye të sistemit (për shkak të shtrirjes së tij në politikën e brendshme), në vend të tryezës gjeografike të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
2. Çështja duhet të mbahet gjallë në Parlament me ndihmën e nacionalistëve katallanë dhe baskë, si dhe të grupeve të tjera të pakicave që tregojnë mirëkuptim (siç janë të Gjelbrit e Majtë Katallan), përmes pyetjeve parlamentare dhe në debatet e politikës së jashtme.
3. Disa aktorë kanë shumë pak ndikim në hartimin e politikës së jashtme. Ekipet për marrëdhënie ndërkombëtare në partitë politike dhe deputetët e shumicës, në parim janë të parëndësishëm për një vendim të këtillë. Vënia e tyre në objektiv mund të jetë humbje e kotë energjie me një aktor që nuk do të luajë rol në vendimin përfundimtar. Edhe afarizmi zor se mund të ketë ndikim në këtë çështje, meqë është shumë larg nga agjenda e tyre ndërkombëtare (janë të përqendruar në Amerikën Latine, në Europë dhe në Kinë).
4. Angazhimi me krijuesit e opinionit është i rëndësishëm. Edhe pse tashmë ekziston një ekuilibër i përgjithshëm i artikujve dhe kryeartikujve pro dhe kundër njohjes, është me rëndësi të sigurohet që mosnjohja nga Spanja të mbetet çështje kundërthënëse. Kjo do të thotë që të mbahen kontakte me analistët dhe gazetarët që janë haptas në favor të njohjes. Megjithatë, shumë prej veprimeve private diplomatike lidhur me këtë çështje kanë qenë predikime të të konvertuarve: një shtrirje e paramenduar tek analistët indiferentë/asnjans mund të jetë e dobishme.
5. Përveç të gjitha argumenteve që zakonisht shfrytëzohen në favor të njohjes, ekzistojnë edhe tri të tjera që janë specifike për Spanjën:
 - Armiqësia e panevojshme ndaj Kosovës. Ky argument në Spanjë funksionon më mirë kur prezantohet që Spanja është anomali në praktikën përëndimore dhe demokratike se sa kur bazohet në problemet e misioneve ndërkombëtare në Kosovë, për të cilat nuk dihet shumë.

- Kundërshtimi i pohimit se mosnjohja e Spanjës i jep asaj ndikim mbi Serbinë, çka është vështirë të provohet me fakte (përveç kontratave për firmat spanjolle në Serbi, që nuk mund të mbrohen publikisht pa e diskredituar qeverinë e Serbisë dhe diplomacinë e Spanjës).
 - Nëse zyrtarët ngulin këmbë në pohimin se kanë marrëdhënie të posaçme me serbët, atëherë argumenti i tyre mund të kthehet në drejtim të kundërt. Sipas kësaj logjike, nga Spanja duhet të kërkohet që ajo të jetë udhëheqëse e jo ndjekëse në marrëdhënien e saj me Serbinë. Madridi duhet t'i tregojë Beogradit mënyrën se si është e mundur që qytetarëve të Kosovës t'iu jepen lehtësirat maksimale dhe të kenë marrëdhënie të përzemërta me qeverinë e tyre pa njohje, në vend që të presin që Serbia të bëjë hapin e parë. Me fjalë të tjera, të jesh mik i Serbisë nuk do të thotë të rrish pas tyre, por t'i udhëheqësh ata përpara drejt marrëdhënieve më të mira me autoritetet kosovare dhe, në këtë mënyrë, drejt integritimit europian.
6. Ekzistojnë disa objektiva afatmesme që do të mund të arrihen, ndonëse ende nuk janë pjekur kushtet për njohje:
- Vendosja e kontakteve të drejtpërdrejta, të hapura dhe zyrtare ndërmjet autoriteteve spanjolle dhe atyre të Republikës së Kosovës: në fund të fundit, madje edhe Serbia tani ka bisedime të drejtpërdrejta me ta.
 - Hapja e zyrës së përhershme të Spanjës në Prishtinë ose së paku të një misioni të posaçëm, të lajmëruar publikisht, të ndonjërit nga ambasadorët rajonalë (më mirë ambasadori i Spanjës në Shkup) ose të ndonjë diplomati që punon në Madrid.
 - Ndryshimi i doktrinës së qeverisë së Spanjës: mosnjohja e shtetësisë nuk duhet të përfshijë dokumentet, pjesëmarrjen në ngjarje dhe masa të tjera që pengojnë qytetarët e Kosovës (krejt në fund, Spanja duhet t'i pranojë të gjitha lehtësirat e dhëna nga Serbia; nëse është e mundshme, duhet t'i japë shembull Serbisë duke ua lehtësuar jetën kosovarëve).
 - Autoritetet spanjolle duhet të inkurajojnë vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta ndërmjet organizatave spanjolle dhe kosovare të shoqërisë civile, por po ashtu edhe të partive politike, në vend që ta pengojnë atë.
 - Një qëndrim më neutral në BE dhe në KB në veçanti, të përmbahet nga bllokimi i zgjidhjeve të dobishme për shkak të shqetësimeve për 'njohje nga dera e pasme'.

Si përfundim, ka pak indikacione që qëndrimi i Spanjës për mosnjohje do të ndryshojë për shkak të zhvillimeve të brendshme. Ndryshimi ka mundësi të vijë nga transformimi në kontekstin rajonal ose global. Por, kur të ndodhë ndryshimi, nuk do të jetë goditje e madhe për sistemin politik të Spanjës që ta njohë Kosovën nëse është afër një alibi e mirë. Ndërkohë, kushtet për ndryshim mund të përkrahen në Spanjë përmes vendosjes së lidhjeve me zyrën e kryeministrit dhe të ministrit të Jashtëm pas zgjedhjeve të 20 nëntorit, përmes kontakteve të rregullta me analistët e politikave dhe me politikanët mbështetës, përmes nënvizimit të çështjeve që janë specifike për Spanjën dhe përmes miratimit të qëllimeve reale afatmesme, që mund të trasojnë rrugën për njohje në të ardhmen.

Slovakia

Sllovakia dhe Kosova: më afër se ç'duket

**ELIŠKA SLÁVIKOVÁ, EUROPEUM,
Pragë, shtator 2011**

Hyrje

Qëllimi i këtij dokumenti të politikave zhvillimore është që t'i kontribuojë zhvillimit të ardhshëm të marrëdhënieve ndërmjet Sllovakisë dhe Kosovës. Sllovakia, si një prej shteteve që nuk e ka pranuar pavarësinë e Kosovës deri më tani, nuk ka dhënë ndonjë indikacion që sugjeron 'ndryshim të vendimit' në këtë drejtim. Megjithatë, ky dokument i politikave zhvillimore pohon se ekzistojnë çështje tjera me shqetësime të ndërsjella e me rëndësi të njëlojtë, ku të dyja vendet do të duhej të angazhoheshin. Në njërin anë, Sllovakia ka interes strategjik për demokratizimin e Ballkanit Perëndimor dhe dëshiron të kontribuojë për materializimin e kësaj perspektive. Në anën tjetër, Kosova nuk duhet ta nënçmojë rëndësinë dhe ndikimin e të Sllovakisë në rajon, duke marrë parasysh që kjo e para është anëtare e BE-së, që po merr pjesë aktive në formësimin e politikave të BE-së që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me Ballkanin Perëndimor. Veç kësaj, përparimi në procesin e integritit në BE është prioritet strategjik për Kosovën. Prandaj, të gjithë hisedarët duhet të kenë interesim të shtuar për zhvillimin e marrëdhënieve jo vetëm me institucionet e BE-së, por edhe me shtetet anëtare individuale, meqë ato mbeten 'kyçe' për marrjen e vendimeve për çështjet e politikave të jashtme të BE-së.

Ndonëse vështirë të ndodhë ndonjë ndryshim i shpejtë i qëndrimit ndaj njohjes, mundësia për ndryshim gradual në qasje qëndron e hapur, që mund të formësohet dhe të ndikohet nga një numër faktorësh më tepër të jashtëm, siç janë zhvillimi në rajon dhe në nivelin ndërkombëtar. Akti final i njohjes nga Sllovakia mbas gjase do të realizohet vetëm pas pranimi gradual të gjendjes në terren, që kanë të bëjnë me serinë e hapave teknikë që çojnë ngadalë në njohje *faktike*. Prandaj, hapësira e hisedarëve kosovarë për të avokuar me autoritetet sllovaqe tani për tani është mjaft e kufizuar. Një përpjekje e tillë, duke marrë parasysh prapavijën politike aktuale në të dyja anët, mund të ketë ndikim kundërproduktiv dhe nuk i sjell Kosovës rezultatet e dëshiruara. Ky dokument, pra, përpaket të kërkojë hapësirë për bashkëpunim në të gjitha nivelet, duke përfshirë shkëmbimin e informatave dhe ndarjen e brengave dhe ambicieve, që përfundimisht mund të çojnë në zhvillimin e marrëdhënieve të mirëfillta dypalëshe. Paraqitja e historisë së marrëdhënieve ndërmjet Sllovakisë dhe Kosovës, së bashku me rekomandimet e dhëna në këtë dokument, mund të shërbejë si udhërrëfyes i thjeshtë për institucionet e Kosovës se si t'i qasen Sllovakisë. Gjithashtu, mund të shërbejë si

mjet për një sërë të hisedarëve joqeveritarë, instituteve dhe mediave, kur angazhohen me institucionet e Kosovës, si dhe në dizajnimin e diplomacisë qytetare dhe nismave të vetëdijesimit për Sllovakinë.

Ky dokument paraqet ambiciet e Sllovakisë për Ballkanin Perëndimorë dhe marrëdhëniet ndërmjet Sllovakisë dhe Kosovës që nga viti 1999; ky ofron një vështrim në arsyetimin që qëndron prapa vendimit të Sllovakisë për mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës dhe se si ka ndikuar kjo në marrëdhëniet ndërmjet Bratislavës dhe Prishtinës. Veç kësaj, ky dokument merr parasysh pozitën e politikëbërjes së Sllovakisë ndaj Kosovës në Bruksel. Ky dokument nxjerr përfundime duke rekomanduar trajtimin e një sërë çështjesh praktike të shqetësimeve të ndërsjella, të cilat do t'i kontribuonin ndryshimit cilësor të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Bratislavës dhe Prishtinës.

Ambiciet e Sllovakisë për Ballkanin Perëndimor

Integrimi i Ballkanit Perëndimorë në strukturat euroatlantike është formuluar si një prej prioriteteve të politikave të jashtme të Sllovakisë. Dëshira për t'i kontribuar sigurisë dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor është e natyrshme duke e pasur parasysh afërsinë e rajonit me kufirin e Sllovakisë dhe ndërkohë duke marrë parasysh që jostabiliteti në fqinjësinë më të afërt mund paraqesë rrezik serioz për sigurinë. Si një prej mbështetësve më të zëshëm të zgjerimit të BE-së, Sllovakia synon t'i kontribujë zhvillimit ekonomik dhe politik, sundimit të ligjit dhe forcimit të institucioneve demokratike në rajon përmes marrëdhënieve të saj bilaterale, si dhe në nivelin e BE-së. Për Sllovakinë, Ballkani Perëndimor është bërë njëra prej çështjeve të politikës së jashtme, në të cilën ajo ka kapacitet dhe potencial për të formësuar qasjen dhe politikat e BE-së dhe të marrë pjesë në proceset kyçe të vendimmarrjes.

Ambicia e saj për të luajtur rol të dukshëm dhe aktiv në rajon është shfaqur edhe me caktimin e disa diplomatëve sllovakë në pozitat ndërkombëtare me prestigj. Pozita më e rëndësishme është ajo e Miroslav *Lajčák*, i cili ka shërbyer si kryenegociator i BE-së për përgatitjen e referendumit malazez për pavarësinë nga Serbia (2006) dhe më vonë si përfaqësues i lartë në Bosnje e Hercegovinë (2007-2008). Në vitin 2010, *Lajčák* është emëruar drejtor për Rusinë, Partneritetin Lindor dhe Ballkanin Perëndimor në të sapokrijuarin Shërbim për Veprimin e Jashtëm European. Ndërkohë, një diplomat tjetër sllovak, ministri i mëparshëm i Punëve të Jashtme të Sllovakisë Eduard Kukan, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve për Ballkanin Perëndimorë në vitet 1999-2001, ka kryesuar delegacionin e Parlamentit European për marrëdhëniet me shtetet e Europës Juglindore që nga viti 2009.

Përvoja më e fundit e Sllovakisë në tranzicionin kompleks paskomunist, duke përfshirë reformat e thella politike, ekonomike dhe social, si dhe integrimi i suksesshëm në

BE dhe NATO është një aspekt tjetër i rëndësishëm i ambicies për të kontribuar në mënyrë aktive në proceset reformiste në rajon. Këto ndryshime thelbësore në Sllovakia janë bazuar në vizionin e një vendi ekonomikisht të fuqishëm, me institucione transparente dhe me funksionim të sistemit gjyqësorë, duke vënë në theks lirinë dhe përgjegjësinë e individit. Prandaj, nismat e shumta në nivel institucional dhe joqeveritar, duke transferuar njohuritë dhe përvojat e hisedarëve nga Sllovakia te homologët e tyre në shtetet e Ballkanit Perëndimor janë bazuar në supozimet që përvoja e përshkruar mund të shërbejë si frymëzim për ta.

Në përputhje me këto ambicie, që kur iu bashkua BE-së në vitin 2004, Sllovakia është përpjekur të forcojë praninë dhe dukshmërinë e saj në rajon. Ndërkaq, në vitin 2004, Sllovakia ka mbuluar tërë rajonin me vetëm dy ambasada, në Beograd dhe Zagreb, ndërsa sot ajo ka nga një ambasadë ose zyrë ndërlidhëse në çdo kryeqytet të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Zyrën Ndërlidhëse në Prishtinë. Kjo i ka kontribuar zhvillimit më të balancuar të qasjeve dhe politikave që janë specifike për vendin e caktuar, se sa të përqendrohen në Serbi dhe Kroaci. Ndërkohë, Kosova, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, kryesisht për shkak të kufizimeve teknike dhe politike, mbetet në rendin e fundit të përfshirjes së drejtpërdrejtë në marrëdhëniet diplomatike bilaterale, kulturore dhe afariste të Sllovakisë. Fakti që Sllovakia ka refuzuar ta pranojë realitetin politik në terren, ka shkaktuar zmbrapsje në marrëdhëniet e çdo niveli, siç vihet në dukje më vonë në këtë dokument, ka dëshmuar periudhën më produktive sa u përket kontakteve në vitet vijuese, para shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Kosova në Sllovaki dhe Sllovakia në Kosovë

Në çaste të rëndësishme të historisë së fundit të saj, Kosova ia ka dalë të jetë në qendër të vëmendjes së mediave slloake dhe madje është bërë mjet në betejat politike të vendit. Në fillim të vitit 1999, për herë të parë Parlamenti sllovak ka qenë vend i debatit të nxehtë kur përfshihej Kosova. Kjo kishte të bënte me vendimin e qeverisë për hapjen e hapësirës ajrore për fushatën e udhëhequr nga NATO-ja kundër Serbisë së Millosheviçit, vendim i ndikuar fuqimisht nga ambicia për t'iu bashkëngjitur Aleancës në të ardhmen e afërt. Partitë opozitare përshinë populistët dhe nacionalistët dhe shkuan përtej argumenteve tradicionale kundër NATO-s, të njohura nga vendet tjera europiane. Përveç të drejtës së Serbisë për të përdorur forcën në mënyrë që të parandalohet separatizmi dhe luftimi i kryengritjes së armatosur në territorin e saj, ata që e kundërshtonin intervenimin gjithashtu apeluan për solidaritet sllav dhe mbështetjen heroizmin e Serbisë në 'parandalimin e infiltrimit të islamit në Europë'. Ndonëse nuk ia dolën të tërhiqnin vëmendjen e publikut të gjerë për t'iu bashkuar demonstratave kundër bombardimit, ata në një masë të madhe shprehën mendimin e shoqërisë slloake. Në mungesë të informatave të mjaftueshme për natyrën e

konfliktit dhe kompleksitetit të historisë moderne të Ballkanit Perëndimor, shumë sllovakë prireshin ta lidhnin Kosovën me dy stereotipa tradicionalë dhe romantikë: krishterimin dhe nacionalizmin (duke pasur parasysh që agjenda natyrore e sllovakëve nacionalistë dhe populistë është ringjallje konstante e brengës për kërkimin e mundshëm të territorit nga Hungaria, përmes komunitetit hungarez të Sllovakisë Juglindore).

Lufta e Kosovës shpërtheu menjëherë pasi Sllovakia u nis në shtegun reformist, që përfundimisht e çonte drejt integritit në BE dhe NATO. Për më tepër, kjo përkoj me fundin e periudhës mjaft të zymtë për Sllovinë – ajo e viteve 1990, kur qeveria përbehej nga populistët dhe nacionalistët nën kryeministrin Vladimír Mečiar, i cili e ndryshoi orientimin e vendit kah Rusia dhe e çoi ekonominë afër rrënim. Segmentet e shoqërisë që orientoreshin nga demokracia (OJQ-të, mediat e pavarura, partitë opozitare etj) përqendroheshin në krijimin e presionit të përbashkët që do të sillte ndryshimin e vendit. Ndryshimi i qeverisë në vjeshtën e vitit 1998 hapi rrugë për një lloj ‘internacionalizimi’ për Sllovinë dhe për shoqërinë civile sllovaqe, që të fillonte të angazhohej jashtë vendit. Lufta e Kosovës ishte mundësia e parë. Shumë e shumë gazetarë dhe aktivistë udhëtuan për në kampet e refugjatëve në Maqedoni dhe gjithashtu edhe më vonë, pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s në Kosovë. Ata i mbushën mediat sllovaqe me pamje dhe tregime origjinale për mynxyrën e popullit të Kosovës dhe gjendjen e vështirë të refugjatëve që po ktheheshin dhe personave të zhvendosur brenda vendit. Duke dëshmuar realitetin, disa prej tyre ndjenë se duhej bërë diçka më shumë. Kjo tregon se si u krijua organizata e parë joqeveritare për ndihmë qytetare me seli në Sllovaki, ‘Asociacioni për njerëzit në rrezik’. Grumbullimet publike që organizoi ajo ishin fushata më e madhe për mbledhjen e fondeve në historinë e Sllovakisë së pavarur, që kishte për qëllim të ndihmonte njerëzit përtej kufijve të Sllovakisë. Kontributet nga donatorët individualë dhe nga kompanitë janë shfrytëzuar për rindërtimin e shkollës fillore në fshatin afër Pejës dhe u kanë dhënë të kthyerve furnizime themelore për t’i mbijetuar dimrit. Në vitet vijuese, organizatat e shoqërisë civile ishin hisedarët më aktivë kur ishte në pyetje Kosova.

Në dy palë zgjedhjet e para në Kosovë, të organizuara nga OSBE-ja (zgjedhjet komunale në vitin 2000 dhe ato parlamentare në vitin 2001), OJQ-të sllovaqe rekrutuan dhe kontribuuan me numrin më të madh të monitoruesve ndërkombëtarë. OJQ-të sllovaqe që merreshin me ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e konflikteve kanë qenë gjithashtu aktive në Kosovë. Që nga viti 2003, pasi Sllovakia kishte themeluar programin e saj Asistenca për Zhvillim Zyrtar (SlovakAid), që përfshinte njërin prej prioriteteve territoriale (ndoshta si pjesë e Serbisë), “Njerëzit në Rrezik” realizoi projekte së bashku me partnerët lokalë në Kosovë, që kishte për synim zhvillimin e gazetarisë së pavarur, përfshirjen e rinisë së rrezikuar dhe forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile për të marrë pjesë aktive në proceset e reformimit dhe integritit. Ndërmjet

viteve 2004 dhe 2007, “Njerëzit në Rrezik” organizoi trajnime dhe vizita studimore në Sllovaki për përfaqësues të komuniteteve të ndryshme të Kosovës, nga mediat dhe OJQ-të që merreshin me një spektër të gjerë të çështjeve të ndryshme. Në Sllovaki, ata zakonisht prezantonin punën e tyre dhe gjendjen në Kosovë para zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Shumë prej tyre janë intervistuar nga media të ndryshme sllovaqe, elektronike dhe të shkruara. Shkëmbimi i informatave ka qenë një aspekt i rëndësishëm i “Njerëzit në Rrezik” për bashkëpunimin sllovakos-kosovar. Ky organizim u ka krijuar mundësi dhjetëra gazetarëve për të trajnuar kolegët tyre në Kosovë, por në të njëjtën kohë të udhëtojnë përreth dhe të raportojnë nga vendi i tyre për përparimin e arritur të Kosovës. Ky mbulim zakonisht ka qenë i përqendruar në shembujt pozitiv të bashkëjetesës shqiptaro-serbe, meqë gjendja e vështirë e serbëve në Kosovë ka qenë njëra prej temave më kryesore, që është përdorur për ta prezantuar Kosovën negativisht. Raportet e dorës së parë nga Kosova, si dhe prania e njerëzve nga Kosova në mediat sllovaqe ka baraspeshuar në njëfarë mase raportimet e rëndomta skematike të agjencive të lajmeve, që zakonisht mbulonin vetëm incidentet skandaloze (kryesisht përfshirjen e shqiptarëve dhe serbëve) dhe ripohonin stereotipat negativë lidhur me botëkuptimet e njerëzve për shqiptarët.

Në maj të vitit 2006, “Njerëzit në Rrezik” mirëpriti 27 udhëheqës të OJQ-ve nga Kosova, si shqiptarë ashtu edhe serbë, në një tryezë të rrumbullakët diskutimi katërditor për të mësuar nga përvoja e ekspertëve të OJQ-ve sllovaqe për rolin e OJQ-ve në shoqëritë në tranzicion. Pjesë e programit ka qenë gjithashtu një konferencë gjysmëditore, ku kanë marrë pjesë rreth 100 përfaqësues të OJQ-ve, ekspertë publikë dhe media, nën titullin ‘Kosova sot - këndvështrimet nga brenda dhe nga jashtë’. Në panelin e parë, pesë folësit nga OJQ-të e Kosovës paraqitën gjendjen në Kosovë; në të dytin ekspertët e OJQ-ve sllovaqe dhe drejtori politik i Ministrisë së Jashtme në atë kohë, Miroslav Lajčák, diskutoi këndvështrimin e Sllovakisë për Kosovën. Kjo veprimtari u mbështet nga programi SlovakAid dhe u organizua nën mandatin e ministrit të Jashtëm Eduard Kukan.

Në mënyrë që të paraqitet dinamika kundërthënëse për Kosovën në Sllovaki, vlen të përmendet një konferencë tjetër që i është kushtuar vetëm Kosovës, e organizuar në janar të vitit 2008, në prag të shpalljes së pavarësisë. OJQ-ja sllovaqe ‘Conservative Institute’, e lidhur me forcat politike tradicionale dhe e krishtere, e organizuan këtë ngjarje së bashku me ‘Fondacionin Lord Byron për studime ballkanike’, *organizatë radikale nacionaliste dhe lobiste, personeli i së cilës kishte lidhje të ngushta me regjimin e Millosheviçit. Përkundër kësaj, zyrtarët e lartë nga Ministria e Jashtme dhe politikanët e shquar mbajtën fjalime gjithashtu në këtë ngjarje përkrah, për shembull, Srdja Trifkoviçit, këshilltarit të së dënuarës Biljana Plavshiq në Tribunalin e Hagës gjatë luftës në Bosnjë e Hercegovinë.*

Tani, për të kaluar në nivel zyrtar, që nga fillimi, ushtria slloake ka qenë pjesë e forcës së udhëhequr nga NATO-ja në Kosovë. Kontingjenti sllovak fillimisht ka qenë vendosur në Suharekë së bashku me austriakët dhe zviceranët e pastaj si pjesë e kontingjentit të përbashkët çek dhe sllovak, derisa sllovakët kaluan në Shajkovëc. Në pikën kulminante, trupat slloake kanë pasur më shumë se 130 ushtarë. Meqë Sllovakia nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, sllovakët nuk kanë marrë pjesë në përpjekjet e NATO-s për mbështetjen e krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kur NATO-ja vendosi ta zvogëlonte misionin, Sllovakia vendosi t'i tërhiqte forcat e veta nga Kosova, duke theksuar si arsye kryesore kufizimet buxhetore dhe përmirësimin e gjendjes së sigurisë në zonën e operimit. Sllovakia nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Misionit të BE-së në Kosovë për Politikën e Përbashkëta për Siguri dhe Mbrojtje, megjithatë, posa EULEX-i deklaroi që ka arritur 'kapacitetin e plotë veprues' në fund të vitit 2008, Sllovakia filloi të kontribuonte me numër të kufizuar zyrtarësh policorë, që ndryshonte ndërmjet gjashtë dhe tetë. Sllovakia nuk ka marrë pjesë në komponentët e gjyqësorit ose të doganave.

Është me rëndësi të vihet në dukje se, që para vitit 2008, Sllovakia nuk i ka njohur asnjëherë dokumentet e lëshuara nga administrata e UNMIK-ut, siç janë: certifikatat e lindjes, dokumentet e udhëtimit etj. Megjithatë, në mes të vitit 2004, ajo filloi të lëshonte viza në dokumentet e UNMIK-ut për udhëtim, por vetëm nën regjim të veçantë, në një letër 'shitesë' (jo vizë në faqe të pasaportës) dhe kjo gjithashtu u dha mundësi përdoruesve të pasaportave të UNMIK-ut të merrnin viza në konsullatat e tjera slloake në rajon, si dhe në Budapest dhe Vjenë, duke pasur parasysh faktin që për shumë kosovarë ishte e vështirë, nëse jo e pamundur, të udhëtonin në Beograd për të aplikuar për vizë. Është paradoksale që, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008 dhe menjëherë para lëshimit për herë të fundit të dokumenteve të udhëtimit dhe letërnjoftimeve, Sllovakia i pranoi dokumentet e UNMIK-ut, por nuk pranonte dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Prandaj, përfaqësuesit diplomatikë të Sllovakisë në Prishtinë bënë një marrëveshje me praninë tjetër të mbetur të UNMIK-ut, që të mundësohej vërtetimi i dokumenteve të Kosovës nga UNMIK-u, të cilat do t'u dorëzoheshin institucioneve slloake, si dokumentet personale të njerëzve që kanë lidhje me Slloakinë etj. Vizat, si më parë, janë lëshuar vetëm sipas regjimit të veçantë dhe nuk vireshin në faqen e pasaportës. Vizat Schengen, të lëshuara nga shtetet e tjera në pasaportat e Kosovës, mbanin vërejtjen se nuk vlenin për në Slloaki.

Kontaktet në nivel zyrtar të vizitave zyrtare kanë qenë të pakta, ndonëse kanë ndodhur. Që nga viti 1999, tre ministra të Jashtëm sllovakë kanë vizituar Kosovën, i katërti dhe i tanishmi ende nuk e ka bërë të njëjtën gjë. Më e rëndësishmja ka qenë vizita e ministrit Miroslav Lajčák, në prill 2010, pas dy viteve të Kosovës në pavarësi; ai ka qenë një prej ministrave të rrallë të Jashtëm që kanë vizituar Kosovën, madje

edhe nga shtetet që e kanë njohur Kosovën. Lajčák gjithashtu ka vizituar Kosovën në dhjetor 2005, në cilësinë e drejtorit politik të Ministrisë së Jashtme dhe përveç takimeve me politikanët kryesor të Kosovës, ai është takuar gjithashtu me një grup të madh të përfaqësuesve të shoqërisë civile të Kosovës dhe ka diskutuar për vizionin e tyre mbi zhvillimet e ardhshme. Derisa ishte ende në pozitën e drejtorit politik, në tetor të vitit 2006, ftoi në Bratislavë kryeministrin Agim Çeku dhe më pas, në fillim të vitit 2007, edhe Veton Surroin, bartësin e atëhershëm të listës së partisë opozitare Ora. Në Bratislavë, që të dy këta janë takuar me zyrtarët e Ministrisë së Jashtme, si dhe me mediat dhe shoqërinë civile.

Pas vendosjes së Misionit të Administratës së KB-ve në Kosovë, në vitin 1999, Kosova mbulohej nga Ambasada e Sllovakisë në Beograd. Megjithatë, në vitin 2006, qeveria mori vendim strategjik për hapjen e Zyrës Ndërlidhëse në Prishtinë, pjesërisht për shkak të fillimit të bisedimeve në Vjenë për statusin e Kosovës, të kryesuar nga i Dërguari Special i KB-ve për Kosovën, Martti Ahtisaari. Aktualisht, Zyra Ndërlidhëse e Sllovakisë ka tre punonjës sllovakë, duke përfshirë këtu kryesuesin e zyrës dhe konsullin. Ndonëse zyrtarisht ende bashkërendohen me ambasadën në Beograd, në vitin 2009 linja e raportimit ndryshon dhe Zyra e Prishtinës filloi komunikimin e drejtpërdrejtë me Ministrinë Jashtme. Megjithatë, sa i përket zhvillimit të marrëdhënieve me politikanët kosovarë, së paku në nivelin zyrtar, Zyra ka qenë mjaft e rezervuar ndaj qasjes së përfaqësuesve politikë të Kosovës, kryesisht në rastet jozyrtare, siç janë pritjet e organizuara nga ambasadat tjera ose zyrtarët në vizitë për të diskutuar *ad hoc* çështjet praktike që kanë të bëjnë me Sllovakinë.³⁸ Zyrtarët e Kosovës nuk janë ftuar në pritjet e organizuara nga zyra sllovaqe. Përkundrazi, diplomatët sllovakë kanë mbajtur marrëdhënie me praninë e huaj në Kosovë dhe, deri në një masë të caktuar, me shoqërinë civile ose kanë ndihmuar për zgjidhjen e çështjeve praktike lidhur me dokumente, veçanërisht kur kanë qenë të përfshirë qytetarët sllovakë. Zyra gjithashtu menaxhon skemën për grante të vogla, që ndahen për hisedarët joqeveritarë të Kosovës, të cilët mund të aplikojnë deri në shumën prej pesë mijë eurosh. Zyra gjithashtu grumbullon aplikacionet për viza, edhe pse ato dërgohen pastaj në zyrën sllovaqe në Beograd dhe kthehen në Prishtinë. Ky shembull mund të shërbejë si dëshmi se ku gjendet Kosova në hartën virtuale të sllovakëve dhe kjo mund të perceptohet si përulje nga disa kosovarë. Ndërkohë, sipas perceptimit të autoriteteve sllovaqe, hapja e mundësisë për dorëzimin e aplikacioneve për viza në

38 Kjo ka ndodhur, për shembull, në shtator të vitit 2010, kur Sllovakia organizoi Konferencën e Visegrád-it në Bratislavë dhe një drekë pune tradicionale për ministrat e Jashtëm nga Ballkani perëndimorë. Duke qenë se ishte ngjarje e Grupit Visegrád, dhe ndonëse e organizuar nga Sllovakia, nga anëtarët tjerë të grupit Visegrád pritej prania e ministrit të Jashtëm të Kosovës. Së pari, Ministria e Jashtme e Sllovakisë ka dërguar shkresë zyrtare dhe ka kërkuar nga PSSP-ja i UNMIK-ut të ftojë ministrin e Jashtëm të Kosovës, në atë kohë Skënder Hysenin. Megjithatë, kur UNMIK-u ka refuzuar ta bëjë këtë, meqë kjo ishte kundërproduktive dhe lejonte refuzimin kosovar, Zyra Diplomatie Sllovaqe iu drejtua Hysenit drejtpërsëdrejti. Në fund, për shkak të tërheqjes së papritur të ministrave të LDK-së nga qeveria, Vlora Çitaku, në kuadër të kompetencave të saj si ushtruese e detyrës së ministrit të Jashtëm mori pjesë në drekën e punës në Sllovaki, ku u mirëprit ngrohtësisht nga kryeministri Dzurinda dhe ishte aktive në diskutim.

Prishtinë do të ishte shenjë e vullnetit të mirë, meqë kjo përkitazi do ta thjeshtësonte tërë procedurën. Disa vende të BE-së, që e kanë njohur Kosovën dhe kanë ambasada në Prishtinë, ende kërkojnë nga kosovarët që të shfrytëzojnë shërbimet konsullore të ambasadave në Shkup (p.sh. ShBA dhe Republika Çeke).

Që nga pavarësimi, Kosova nuk ka pasur të drejtë për projekte ndërkufitare (të realizuara në partneritet me hisedarët sllovakë dhe kosovarë) të lejuara nga programi i ndihmës për zhvillim zyrtar. Në qershor të vitit 2011, pas vizitës së përfaqësuesve të delegacionit të shoqërisë civile nga Kosova në Bratislavë dhe takimeve me zyrtarët e Ministrisë së Jashtme të Sllovakisë (organizuar nga Klubi për Politikë të Jashtme i Kosovës dhe Komisioni atlantiko-sllovak), kjo ministri konfirmoi zyrtarisht se tani e tutje SlovakAid do të mbështesë projektin që ka për cak Kosovën. Megjithatë, Sllovakia nuk ka marrë pjesë në Konferencën e Donatorëve për Kosovën, që është mbajtur në korrik të vitit 2008 (Greqia ka qenë i vetmi shtet i BE-së që nuk e ka njohur Kosovën, por ka marr pjesë). Gjatë hulumtimit për këtë dokument të politikave zhvillimore, nuk kemi mundur të gjejmë ndonjë marrëdhënie afariste ose ndonjë marrëdhënie tjetër ekonomike që të jetë zhvilluar ndërmjet këtyre dy shteteve. Kjo tani është virtualisht e pamundur për shkak të pengesave teknike. Megjithatë, disa kompani të të dy vendeve kanë takuar zyrtarët sllovakë, në mënyrë që t'i ndihmonin për zgjidhjen e problemeve praktike që kanë dalë si rezultat i mosnjohjes së dokumenteve zyrtare të Kosovës (p.sh., fabrika e verës *Stone Castle* në Rahovec).

Nga “jo”-ja për Ahtisaari-n në “jo” për pavarësi

Në mars të vitit 2007, një gazetar opinionmbledhës i së përditshmes në Bratislavë solli para Parlamentit sllovak një hartë pa emërtime të Europës dhe kërkoj nga anëtarët e Komisionit të Punëve të Jashtme që të gjenin me saktësi pozitën gjeografike të Kosovës. Kjo ndodhi pas seancës kur anëtarët e komisionit kishin diskutuar propozimin e të dërguarit special të KB-ve për Kosovën, Martti Ahtisaarit, për pavarësi të mbikëqyrur si zgjidhje për statusin e Kosovës. Jo të gjithë arritën ta gjenin pozitën e saktë të Kosovës në hartë, ndonëse vetëm një çast më parë kishin votuar për një çështje të rëndësishme që i përkiste statusit të Kosovës, që në atë kohë ishte ende nën protektoratin ndërkombëtarë. Megjithatë, të gjithë ata ishin të patundur në pohimet e tyre se statusi i Kosovës ose, më konkretisht, rreziku i shkakuar nga pavarësia e saj, ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm për popullin e Sllovakisë.

Pas publikimit të Planit të Ahtisaari-it, në shkurt të vitit 2007, Kosova u bë një temë emocionuese për të gjithë politikanët e mediat, madje edhe për publikun e gjerë. Si rrjedhim, Parlamenti sllovak miratoi rezolutën ku kërkohej status për Kosovën, që do të respektonte ‘kërkesat legjitime’ të Serbisë, Kartën e KB-ve dhe kornizën ligjore ndërkombëtare ekzistuese. Gjithashtu, parashihej që “pavarësia absolute dhe e

pakufizuar” e Kosovës nuk ishte në interes të rajonit dhe se palët nuk i kishin shterur të gjitha mundësitë për dialog, çka do të çonte në një zgjidhje me marrëveshje. Prej 150 deputetëve, 123 votuan pro dhe 19 abstenuan. Ata që abstenuan ishin përfaqësues të partive politike që përfaqësonin hungarezët etnikë.

Ndonëse statusi i Kosovës dhe mundësia për pavarësi të mbikëqyrur kanë qenë në rendin e ditës të KB-ve dhe BE-së për më shumë se një vit, kjo nuk ka zgjuar shumë interes për partitë politike, mediat ose publikun e gjerë në Sllovaki. Si do të shpjegohet atëherë refuzimi i fuqishëm i Planit të Ahtisaari-it, shoqëruar me debate emocionale që, në mënyrë të jashtëzakonshme, hodhën poshtë mundësinë e pavarësisë së Kosovës? Në atë kohë, qeveria sllovaqe përbëhej prej tri partive që anonin fuqimisht nga populizmi dhe shpeshherë luanin me kartat e patriotizmit dhe nacionalizmit, duke përfshirë partinë ekstremiste të krahut të djathtë³⁹. Partia më fuqishme në koalicion caktoi në postin e ministrit të Jashtëm diplomatin e njohur ndërkombëtarisht, Ján Kubiš. Agjenda kryesore e tij ishte që të zbuste shqetësimet e qarqeve të BE-së, që ishin të brengosur për faktin që një parti ekstremiste e krahut të djathtë i ishte bashkuar qeverisë. Qeveria ishte përqendruar në arenën vendore dhe supozohej që ministri pak a shumë t’i përmbahej rendit të ditës, që kishte dalë nga anëtarësimi i Sllovakisë në organizatat ndërkombëtare. Ministri ishte i gatshëm, në pajtim me pjesën dërmuese të BE-së, të hapte dritën e gjelbër për njohjen e Kosovës. Por, në këtë moment, dy partitë sllovaqe opozitare të qendrës së djathtë⁴⁰ ndërhyjnë dhe e sollën çështjen në diskursin publik. Ata nuk ia dolën ta mbanin debatin në nivel teknik dhe të diskutonin për interesat strategjike dhe të sigurisë së Sllovakisë. Në vend të kësaj, u angazhuan në një diskutim verbal duke hyrë thellë në lidhjet historike të Sllovakisë me Serbinë dhe duke i paraqitur ato si diçka që ishte e pamundur të tradhtoheshin. Kjo rezultoi me një debat të nxehtë parlamentar dhe me rezolutën tanimë të njohur kundër pavarësisë⁴¹ së Kosovës. Një titull tipik i mediave gjatë atyre ditëve do të propagandonte: “Në Parlament, përplasje të fuqishme për Kosovën” dhe Sllovakia u bë i vetmi vend në botë, përveç Serbisë, që diskutoi për Kosovën si për një çështje të brendshme.

Meqë KS i KB dështoi të votonte për Planin e Ahtisaari-t, duke iu frikësuar vetos së Rusisë dhe Kinës dhe përkundër dështimit të treshes ShBA-Rusi-BE për arritjen e zgjidhjes me marrëveshje për Serbinë e Kosovën, rezoluta e miratuar nga vendimmarrësit sllovaqe praktikisht e mbylli mundësinë e qeverisë për të vepruar në pajtim me shumicën e BE-së për pavarësinë e Kosovës. Prandaj, mosnjohja nga Sllovakia ndoshta erdhi si befasi për shumicën në fillim të vitit 2008, por ishte diçka që pritej, po të merren

39 Unioni Demokristian Sllovak (SDKÚ) i Mikuláš Dzurinda-s dhe Lëvizja Demokristiane (KDH).

40 Ndoshta vlen të përmendet se fillimisht janë dorëzuar pesë projektrezoluta në Parlament. Më pas, numri i projektrezolutave është reduktuar në tri. Rezoluta që u miratua në fund doli nga ‘punëtoria’ e qeverisë dhe ishte më e moderuara e propozimeve kundër pavarësisë. Fjalja e lartpërmendur mbi nevojën për respektimin e kërkesave legjitime të Serbisë është shtuar pas votimit afirmativ për ndryshim-plotësimin e propozuar nga parlamentarët e KDK-së. Partia e hungarezëve etnikë dorëzoi të vetmen projektrezolutë që mbështeste procesin e drejtuar nga Ahtisaari.

parasysh rrethanat e atëhershme. Rezoluta e Parlamentit, ndonëse jo e detyrueshme, i dha karakter të fuqishëm rekomandues qeverisë. Ekzistenca e saj pasqyronte faktin se vendimmarrja lidhur me Kosovën u ishte marrë nga duart zyrtarëve shtetërorë teknokratë dhe pragmatikë dhe iu ishte dorëzuar përfaqësuesve të zgjedhur nga qytetarët. Kjo nënkuptonte që ndryshimi i qëndrimit do të kërkonte konsensusin e spektrit më të gjerë politik. Çdo parti politike ka beteja para vetes dhe i duhet të luftojë me kundërshtarët për çështjet e brendshme. Prandaj është tepër e vështirë që ndonjëra prej tyre ta ketë pavarësinë e Kosovës si prioritet dhe të bëjë pazarllëqe për të, në mënyrë që të mundohet për të ndryshuar qëndrimin aktual. Shihet qartë se ndryshimi kuptimplotë i mjedisit ndërkombëtar (miratimi i Rezolutës së KB-ve për Kosovën; *de facto* njohja e Kosovës nga Serbia) ose madje ngritja themelore e njohjes nga anëtarët e KB ose njohja e papritur e Kosovës nga ndonjë shtet anëtar i BE-së mund të shërbejë si nxitje për diplomacinë sllovaqe në përpjekjet për të dalë nga qorrrokaku.

Publikimet në media nga fillimi i vitit 2007, si dhe leximi i procesverbaleve nga debati parlamentar, bëjnë të qarta dy pikat kryesore të politikanëve kundër procesit që çon në pavarësinë e Kosovës. Le të merremi së pari me atë që është shenja kryesore e politikave të llogaritura, që mund të përmbledhet si më poshtë: nevoja për zgjidhje të negociuar; nevoja për parandalimin e ndryshimit në kufijtë e vendit kundër vullnetit të shtetit dhe respektimi i së drejtës ndërkombëtare. Mbështetur në parimin e paprekshmërisë së kufijve, mund të duket e natyrshme, duke marrë parasysh ekzistencën e dhjetë për qind të komunitetit etnik hungarez dhe fakti që, si qeveria e Sllovakisë ashtu edhe ajo e Hungarisë, ngrinin 'kartën hungareze' çdo herë kur u konvenon për zënkat e tyre brenda vendit. Në përgjithësi, frika nga përparësia në rast të ndarjes së njëanshme është njëri prej argumenteve të politikanëve dhe diplomatëve sllovakë, kur qëndrimi i Sllovakisë për mosnjohje qëndron mbi tryezë në rastet zyrtare dhe jozyrtare. Për shembull, Mikuláš Dzurinda, ministri aktual i Punëve të Jashtme (2011, në kohën e shkrimit të këtij dokumenti për politika zhvillimore), i cili do të kishte të drejtë të kërkonte pronësi mbi qëndrimin e mosnjohjes së Sllovakisë (meqë ai, si kryesues i Unionit Sllovak Demokristian - SDKU - doli me këtë çështje në opozitë), shpjegoi në shumë raste se "ndarja e njëanshme e ndonjë kombi nuk është në interesin e Europës". Ai e përcolli të njëjtën porosi në adresimin e tij ambasadorëve të huaj akredituar në Sllovaki, pas marrjes së postit të ministrit të Jashtëm, në verën e vitit 2010. Ai u paraqiti atyre qëndrimin e qeverisë për Kosovën si njëra prej dy çështjeve të nxehta politike, krahas atyre të brendshme (tjetri refuzonte të merrte pjesë në shpëtimin e Greqisë nga BE-ja). Megjithatë, përfaqësuesit e qeverisë aktuale sllovaqe janë distancuar nga tërheqja e paraleles ndërmjet Serbisë-Kosovës dhe Sllovakisë dhe komunitetit hungarez të saj dhe kanë theksuar në disa raste se nuk ka ngjashmëri, çfarëdo qofshin ato.

Tani duhet të kalojmë në pikën e dytë, pikën më të ndjeshme të debatit politik dhe publik në vitin 2007, që duhet të kuptohet si arsyeja kryesore për qëndrimin e Sllovakisë për mosnjohje. Këtu futen ‘pohimet dhe ankesat legjitime të Serbisë për Kosovën’ dhe ‘obligimi moral dhe historik i Sllovakisë për t’i mbrojtur ato’. Teprimi i vërejtjeve të bëra nga politikanët e të gjitha pjesëve të spektrit politik në këtë drejtim mund të ilustruhet me një deklaratë (përsëri) të ministrit të Jashtëm Dzurinda, dhënë agjencisë së lajmeve sllova në shtator 2010. Ai, në fakt, e filloi deklaratën e tij duke u shprehur: “Nuk e kam thënë kurrë që nuk do ta njohim kurrë Kosovën”. Kjo fjali ka pasur mbulueshmëri të madhe në Kosovë, megjithëse ai vazhdoi të shprehej se “ne vetëm kemi thënë që do ta marrim në konsideratë edhe interesin e Serbisë, zërin që vjen nga Beogradi. Kjo është e tëra që ka të bëjë me këtë...” Do të ishte e dobishme të vihej në pah gjithashtu origjina e qëndrimit emocional dhe pak pragmatik të Sllovakisë.

Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në korrik të vitit 2010, ku thuhej se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, nuk shkaktoi shumë ngazëllim në Sllovaki dhe ka kaloi pothuajse në heshtje. Pjesërisht, sepse kjo ishte për faktin që erdhi në kohën kur qeveria e re ishte duke u vendosur në zyra dhe politikanët, mediat dhe publiku ishin të zënë me çështje të tjera.

Për ta përmbledhur, qëndrimi i Sllovakisë për Kosovën nuk mund të konsiderohet politikë e menduar mirë, me synim dhe plan të qartë. Politikanët sllovakë kurrë nuk kanë pasur një alternativë politike ose vizion se si supozohet të zgjidhet çështja e Kosovës, nëse jo duke ia lejuar pavarësinë. Para qorrsoakut të shkakuar me rezolutën parlamentare në mars të vitit 2007, diplomatët udhëheqës, si Eduard Kukan, Miroslav Lajčák dhe Ján Kubiš, të cilët kishin njohuri për procesin për Ballkanin Perëndimor, në disa raste theksuan se nuk kishte alternativë tjetër përveç rezultateve të procesit të udhëhequr nga Ahtisaari. Megjithatë, më vonë, duke folur në cilësinë e tyre si politikanë, atyre u duhej të mbronin - ndonëse vetëm ndonjëherë dhe në mënyrë të ngathët - qëndrimin zyrtar të vendit të tyre. Ndonëse asnjëri prej tyre tani nuk është aktiv në politikën ose diplomacinë sllova, janë politikanët dhe shërbyesit e tjerë civilë, që tashmë janë të vetëdijshëm për ndikimin negativ dhe mungesën e mbështetjes së qëndrimit të tanishëm të vendit ndaj Kosovës. Prandaj, edhe pse ndryshimi i shpejtë i qëndrimit ndaj njohjes duket mjaft i vështirë, mundësia, siç shpjegohet më vonë, është e hapur për ndryshim gradual, që do të formësohet dhe do të ndikohet nga shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët do të shpjegohen më tutje në kapitullin ‘Arti i së mundshmes’.

Në Bruksel për Kosovën

Diplomatët dhe politikanët e Sllovakisë e paraqitën qëndrimin e vendit të tyre ndaj Kosovës si një qasje konstruktive, që do të thotë se në praktikë ajo e pranon “të ardhmen europiane për Kosovën” dhe nuk do t’i pengojë nismat e BE-së në këtë drejtim. Sllovakia ka ofruar mbështetje pa u nxitur nga askush (siç ka qenë rasti i Qipros) për rezolutën e përbashkët BE-Serbi, që u dorëzua në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në shtator të vitit 2010. Përkundër deklarimit të qëllimeve të mira në praktikë, megjithatë qasja e saj i ngadalëson proceset vendimmarrëse në Këshillin Europian. Në mbledhjet e grupeve punuese të Ballkanit Perëndimor - COWEB – zakonisht janë Sllovakia, Qiproja dhe Rumania, të cilat kërkojnë që UNMIK-u të përfshihet në nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Kështu ishte, për shembull, rasti i takimit për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së, në prill të vitit 2011. Në këtë rast, Sllovakia, së bashku me Qipron, kanë dorëzuar dokumente me shkrim, ku kërkonin që në tekstin e marrëveshjes, sa herë që përmendet Kosova, t’i referohen Rezolutës 1244 të KSKB dhe të përfshihet formulimi “pa e paragjykuar qëndrimin e shteteve anëtare ndaj statusit të Kosovës”. Për më shumë, Sllovakia vuri në dukje domosdoshmërinë e qartësisë ligjore dhe procedurale kur nënshkruhen marrëveshjet me Kosovën dhe, me mbështetjen e Rumanisë dhe Greqisë, kërkoi praninë e rolit të UNMIK-ut në tërë këtë proces. Prandaj, ndryshimi i qasjes së Sllovakisë në Këshillin Europian nënkupton pranim të heshtur, pranim të qasjes së vendit, që është një hap i madh përpara (Spanja, për shembull, rri në heshtje dhe zakonisht nuk u bashkëngjitet vendeve tjera mosnjohëse të pavarësisë në kërkesat e tyre për ta theksuar qëndrimin për status neutral në dokumentet e përgatitura).

Arti i së mundshmes

Do të ishte më tepër se ekzagjerim të thuhet që, nëse politikanët, ekspertët dhe shoqëria civile e Kosovës do të kishin bërë më shumë përpjekje për t’iu qasur Sllovakisë gjatë bisedimeve në Vjenë për statusin e Kosovës ose gjatë periudhës ndërmjet shpalljes së pavarësisë në mars 2008, atëherë gjërat do të kishin shkuar ndryshe me Sllovakinë. Siç është përshkruar, rruga për mosnjohje në Sllovaki ka qenë mjaft e paparashikueshme dhe nuk pritej madje as nga ata në vend, që kishin njohuri për sfondin aktual politik dhe mendimet proserbe në botëkuptimin e shumë politikanëve dhe zyrtarëve shtetërorë. Megjithatë, është me rëndësi të përmendet qasja pasive e hisedarëve të rëndësishëm të Kosovës në periudhën vendimmarrëse, kur formësohej qëndrimi i shteteve të BE-së. Mungesa e aktiviteteve të vetëdijesimit nga ana e Kosovës për ata që do të respektoheshin dhe dëgjoheshin (veçanërisht intelektualët, udhëheqësit e OJQ-ve ose gazetarët) duket të jetë paracaktuar nga dy premisa të pasakta: së pari, që shtetet më të vogla anëtare të BE-së do të ndiqnin ato të mëdhatë dhe secili do të ndiqte ShBA-të. Ndërkaq, në kohën kur ishte shumë e qartë

që Rusia planifikonte të përdorte veton në Këshillin e Sigurimit të KB-ve për rezolutën e re mbi Kosovën, e cila do ta hapte rrugën për pavarësinë e mbikëqyrur, shumica në Kosovë rrinin të qetë duke thënë se ShBA-të 'pomerren me këtë'. Një supozim tjetër i pasaktë ishte që politikanët dhe njerëzit në vendet e BE-së në njëfarë mënyrë do ta 'kuptonin' automatikisht dhe të bashkoheshin me kauzën e Kosovës. Shumë kosovarë menduan se çdokush jashtë vendit kishte njohuri për atë se ç'kishte ndodhur gjatë viteve '90 dhe fakti që shumë prej politikanëve të BE-së kanë votuar në favor të shteteve anëtare, pjesëmarrëse në fushatën e bombardimeve të NATO-s, nuk do të thotë që automatikisht (përsëri) do të 'kuptojnë' thjesht që asnjë zgjidhje tjetër nuk mund të jetë e realizueshme përveç pavarësisë. Prandaj, nuk ka pasur ose më mirë nuk ka ekzistuar asnjë aktivitet vetëdijesimi për Sllovakinë në vitet para shpalljes së pavarësisë, çka vlen edhe për shtetet e tjera të BE-së. Përsëri, pa thënë se kjo do ta kishte ndryshuar kursin e rrjedhës së ngjarjeve në Sllovakia, së paku do të kishte mundur të kontribuonte në një qasje më të baraspeshuar ose, së paku, të mundësonte një kuptim më të qartë të argumenteve të njëri-tjetrit.

Që tani, shumë e më shumë hisedarë relevantë në Kosovë e dinë se duhet të jenë më proaktivë dhe disa prej punëve duhet të bëhen prej tyre dhe nuk mund të bëhen të gjitha nga shtetet mike, si dhe është momenti i duhur të shikohet në hapësirën manovruese, kur Sllovakia është në pyetje.

Ky dokument pohon se akti përfundimtar i njohjes nga Sllovakia me siguri që do të arrijë pas pranimit gradual të gjendjes në terren, që shfaqet në një sërë hapash teknike (në marrëdhëniet bilaterale me Kosovën ose në BE). Hapa pas hapi, kjo do të çonte në njohjen *de facto* para 'po'-së zyrtare. Dinamika e këtyre hapave, si dhe kohëzgjatja e periudhës para njohjes aktuale do të vijë dhe do të varet nga disa faktorë. Vetëm disa prej këtyre mund të ndikohen drejtpërsëdrejti nga politikanët ose hisedarët e shoqërisë civile të Kosovës. Në një vështrim më të gjerë, faktorët që konsiderohen si më të rëndësishëm në Bratislavë janë zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, në veçanti marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por gjithashtu edhe me shtetet fqinje. Çdo përparim i befasishëm, por gjithashtu edhe ndonjë përkeqësim thelbësorë, natyrisht që do të ndiqet për së afërmi dhe të vlerësohet gjithashtu. Për më tepër, dinamika në Bashkimin Europian dhe në KB mund të luajë rol të rëndësishëm. Zhvillimet e brendshme në Kosovë, siç është ndonjë sukses i shënuar politik apo ekonomik ose rezultatet konkrete në përmirësimin e mjedisit ligjor, do të kishte ndikim sekondar për njohjen, megjithëse këto, me siguri, do të kontribuonin në përmirësimin e cilësisë së marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy vendeve.

Duke lënë jashtë ndonjë analizë më të thellë të asaj se çfarë me të vërtetë mund të arrihet dhe mund të ndryshohet me procesin e dialogut të udhëhequr nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duhet të pranohet që kjo mund të shihet vetëm në të

ardhmen dhe është e dobishme të dihet që politika e jashtme slloake është duke i mbajtur sytë mbyllur për këtë proces. Kjo mund të jetë shenjë që jep shumë shpresa për rezultate pozitive dhe mund të hap mundësi për Sllovakinë që të gjejë një mënyrë 'të denjë' për të dalë nga pozita aktuale jo dhe aq konstruktive. Gjenerata e re e zyrtarëve mendjehapur të nivelit të lartë në Ministrinë e Jashtme të Sllovakisë është e vetëdijshme për faktin që aktualisht Sllovakia, për shkak të qëndrimit të saj, ka mbetur jashtë procesit kryesor ndërkombëtarë të vendimmarrjes për Ballkanin Perëndimor. Dinamika e ndryshimit gradual në qasjen e Sllovakisë gjithashtu varet nga dinamika e marrëdhënieve ndërmjet Sllovakisë dhe Serbisë e sidomos mes politikanëve në të dy vendet. Prandaj, dështimi i Serbisë për të përgatitur atë çfarë pritet nga BE-ja ose Sllovakia mund t'i përshpejtojë gjithashtu prirjet dhe të çojë në qasje më konstruktive ndaj Kosovës.

Pika e kyçe, që është e fundit për t'u shtjelluar, para se të vazhdojmë me rekomandimet individuale, duke pasur parasysh kufizimet objektive dhe subjektive të përshkruara më lart në këtë dokument, është që çdo strategji për qasje ndaj Sllovakisë duhet të jetë shumë e ndjeshme, të mos jetë lobim ose avokim i drejtpërdrejtë në favor të njohjes dhe i bazuar fort në dialogun dhe hulumtimin e çështjeve me interes të përbashkët. Politikanët dhe diplomatët e Sllovakisë theksojnë në çdo rast të mundshëm para partnerëve të tyre në BE, kur pyeten nga gazetarët ose kur kanë mundësi t'u përcjellin porosi homologëve të tyre nga Kosova, se qasja e Sllovakisë ndaj Kosovës nuk është armiqësore, por mjaft konstruktive. "Ne duam të gjejmë mënyra bashkëpunimi konstruktiv, me qëllim që çështja e statusit të mos ketë ndikim negativ në jetën e përditshme të njerëzve", ka thënë ministri i mëparshëm Miroslav Lajčák gjatë vizitës së tij në Prishtinë, në prill të vitit 2010 dhe gjithashtu është në dorë të kosovarëve që t'i evidentojnë këto çështje dhe të përqendrohen në to për t'iu qasur Bratislavës. Gjithashtu, është me rëndësi të dimë që plejada aktuale politike në Bratislavë zgjedh të besojë se mund të lërë 'gjurmë pozitive të gishtit' në zhvillimin dhe transformimin e Ballkanit Perëndimor. Dhe përsëri, gjithashtu varet nga kosovarët që të dalin me ide dhe propozime për atë se si sllovakët mund të kontribuojnë për materializimin e ndryshimeve në Kosovë.

Përfundime dhe rekomandime

Për qeverinë e Kosovës:

Synimet. Të vendosë lidhje me hisedarët sllovakë dhe t'u mundësojë shkëmbim efektiv të informatave dhe ndarje të interesave dhe ambicieve në të dyja anët. Të arrihet një qasje më konstruktive e Sllovakisë ndaj Kosovës për çështje teknike, por gradualisht gjithashtu edhe në çështjet politike për marrëdhënie bilaterale dhe vendimarrjen në BE.

Veprimet e mundshme konkrete:

1. *Të angazhohet Sllovakia në asistencën praktike të institucioneve dhe agjencive të Kosovës, siç janë projektet për binjakëzim dhe ndonjë nismë tjetër për transferimin e njohurive për një sërë çështjesh, si në: drejtësi, reforma ekonomike dhe sociale; bashkërendim të përpjekjeve për integrim në BE dhe NATO, bashkëpunim rajonal, menaxhim efikas të fondeve të IPA-s, rrjetëzime në transport dhe infrastrukturë, siguri të energjisë etj.*

Vërejtje. Përfaqësuesit aktualë të Sllovakisë (2011) janë të prirë më shumë të dëgjojnë për vizionet dhe idetë se si të ndryshohen gjërat me përpjekjet e të gjithë hisedarëve përkatës në Kosovë, se sa të dëgjojnë ankesa për atë se si faktorët e jashtëm (p.sh. mungesa e unitetit në BE) po e pengojnë Kosovën për të ecur përpara. Prandaj, aftësia për të formuluar qartë vizionin për të ardhmen e Kosovës (përtej vizionit tradicional të integritetit në BE) është fillim i mbarë në qasjen ndaj politikanëve sllovakë.

2. *Diskutimi me hisedarët sllovakë, në ndonjë rast të mundshëm, për çështjet e karakterit praktik (siç është së paku pranimi faktik i dokumenteve të lëshuara nga autoritetet e Kosovës), të cilat, pasi të rregullohen, do të kenë ndikim pozitiv në jetën e përditshme të popullit të Kosovës; t'u mundësohet lëvizja e lirë dhe të shtohen mundësitë për tregti dhe marrëdhënie të tjera ndërmjet Kosovës dhe Sllovakisë.*

Vërejtje. Së pari, është me rëndësi të planifikohen dhe të evidentohen këto çështje, si dhe ndikimi negativ i realitetit aktual që ka mbi qytetarët e Kosovës ose qytetarët sllovakë në disa raste. Për shembull, një argument relevant do të ishte çdo informatë e afarizmit sllovak që dëshiron të investojë ose të eksportojë në Kosovë, si dhe fakti se nuk mund ta bëjë këtë për shkak të disa kufizimeve ekzistuese. Është paradoksale se sa më shpejtë që sllovakët e kuptojnë që gjendja aktuale po i dëmton edhe qytetarët e tyre, më i madh është shansi që ata të do të hulumtojnë për mënyrat se si të ndryshohet kjo qasje. Më tutje, në vend që të kërkohet më shumë (p.sh. njohjen e të gjitha

dokumenteve të Kosovës *en bloc*), është më e mençur që të ecet hap pas hapi, sepse do të ketë po rezultat të njëjtë.

3. *Të tregohet vullnet i mirë dhe mirëkuptim, të bëhen përpjekje që autoritetet sllovaqe të ndihmohen në çështjet me interes, nëse është e mundur. Këto çështje mund t'u përkasin sferave të ndryshme, megjithatë deri më tani këto zakonisht kanë qenë çështje të policisë dhe drejtësisë (p.sh. rasti i Baki Sadikut, i kërkuar në Sllovaki, i cili, siç besohet, është fshehur në Kosovë).*

Vërejtje. Edhe pse ndonjëherë është vështirë, madje edhe për autoritetet kosovare, të mësojnë për këto raste, meqë sllovakët priren të mos komunikojnë drejtpërsëdrejti me autoritetet kosovare, por u drejtohen misionëve të BE-së në Kosovë, ekzistojnë mënyra për të mësuar për ta. Njëra prej tyre do mbante hapur gjithashtu kanalet e rregullta të komunikimit me kryesuesin e Zyrës Ndërlidhëse të Sllovakisë në Prishtinë.

4. *Kur hyni në diskutime me përfaqësuesit sllovakë, përcilluni atyre porosi për ndikimet negative që kanë qorrsokakët në vendimmarrjen e BE-së për Kosovën dhe qytetarët e Kosovë, me synimin përfundimtar që të arrihet qasje më e moderuar e Sllovakisë në Këshillin European për Kosovën.*

Vërejtje. Planifikimi dhe kuptimi i kompleksitetit të proceseve të vendimmarrjes në Këshillin European është thelbësor para se të bëhet përpjekje të ndikohet mbi ta. Hapi i dytë mund të jetë evidentimi i agjendave ku Sllovakia mund të ndihmojë në shtyrjen drejt nivelit të BE-së.

5. *Të angazhohet Sllovakia në bashkëpunimin ekonomik, duke parashtruar mundësitë e afarizmit për investim dhe eksport.*

Vërejtje. Bashkëpunimi ekonomik është njëri prej argumenteve më konkrete për autoritetet e Sllovakisë për të qenë pragmatike në një sërë të çështjeve praktike lidhur me Kosovën.

6. *Të vendosen kontakte dhe kanale komunikimi ndërmjet partive politike për nivelin e Bashkimit European dhe atë ndërkombëtar në bazë të profilit ideologjik. Kërkoni ndihmë në programet për fuqizimin dhe ndërtimin e partive politike në Kosovë. Nëse ndonjë donator i jashtëm i dizajnon këto programe (trajnime, konferenca), siguroni që të përfshihen përfaqësuesit e partive politike nga Sllovakia.*

Vërejtje. Ka një numër të madh të shembujve, ku lidhjet ideologjike të partive politike ose politikanëve të caktuar kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në marrëdhëniet e Sllovakisë me vendet tjera në Ballkanin Perëndimor. Nuk duhet të nënvlerësohen lidhjet partiake.

7. *Mbështetja e programeve për promovimin e shkëmbimit kulturor ose sportiv dhe kontaktet popull me popull ndikojnë gradualisht për ndryshimin e imazhit të Kosovës në sytë e publikut sllovakë.*

Shënim. Të gjitha llojet e nismave për diplomaci publike, që kanë për cak hisedarët joqeveritarë në Sllovaki, duke përfshirë mediat, me qëllim që të fitohet simpatia dhe mbështetja e publikut të gjerë, janë të mirëpritura. Natyrisht, është mirë të mbështetet çdo marrëdhënie e publikut me realitetin në terren.

Për shoqërinë civile:

Synimet. Të ndërtojë partneritetet dhe rrjetëzim me të gjitha nivelet; të nxisë komunikimin, të shkëmbejë informata, të mbajë kontakte njerëzore, me qëllimin përfundimtar që ta sjellë Kosovën në hartën virtuale të sllovakëve dhe të sfidojë stereotipat tradicionale .

1. *Të plotësojë e madje të zëvendësojë qeverinë e Kosovës në ndonjë ngjarje të përshkruar më lart.*

Shënim. Të shfrytëzojë rastin e të qenit të lirë nga konotacionet negative që mund të lidhen me qeverinë e Kosovës dhe pengimin e përpjekjeve të saj. Përfaqësuesit e shoqërisë civile nga Kosova në përgjithësi mirëpritën ngrohtë në Sllovaki se ata zyrtarë, si dhe u besohet më shumë. Përfaqësuesit aktualë politikë në Sllovaki kanë marrëdhënie të ngushta me shoqërinë civile dhe i besojnë më shumë gjykimit dhe qasjes së saj.

2. *Ta angazhojë Sllovakinë në të gjitha betejat e mundshme, në të cilat po synoni për ta bërë Kosovën një vend të hapur dhe demokratik.*

Vërejtje. Jo gjithmonë është e nevojshme të paraqitet Kosova sikur të është duke folur me një zë. Ndonjëherë madje mund të duket edhe e dyshimtë nëse shoqëria civile nuk e kritikon qeverinë... kritikizmi konstruktiv dhe i mbështetur mirë është gjithmonë i mirëpritur.

3. *Në bashkëpunim me hisedarët sllovak, përgatitni dhe organizoni të gjitha llojet e aktiviteteve për diplomaci qytetare, siç janë: trajnimet, takimet, vizitat studimore si dhe ngjarjet kulturore dhe sportive në të dy drejtimet.*
4. *Bëhuni proaktivë në qasjen ndaj shoqërisë civile sllovaqe për zhvillimin e projekteve ndërkufitare, të mbështetur nga SlovakAid ose fondet e BE-së.*

Rumania

Gjendja aktuale e marrëdhënieve ndërmjet Rumanisë dhe Kosovës dhe gjasat për përparim

Oana Popescu - GlobalFocus, Bukuresht
Tetor 2011

Përmbledhje

Rumania nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe ka paraqitur një argument gjithëpërfshirës kundër saj në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Me Prishtinën nuk janë vendosur kurrfarë marrëdhëniesh diplomatike dhe nuk ka pasur ndonjë komunikim zyrtar institucional, përveç një zyre ndërlidhëse nën mandatin e KB-së. Madje edhe para pavarësisë, kur Kosova ishte krahinë nën UNMIK-un, nuk kishte marrëdhënie as zyrtare e as jozyrtare ndërmjet Rumanisë dhe subjektit autonom.

Në nivel ndërkombëtar, zyrtarët rumunë nuk kanë bërë lëshime në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare, të ngjarjeve apo organizimeve që do ta përfshinin Kosovën si shtet apo që mund të interpretoheshin si njohje e nënkuptuar dhe vazhdimisht e kanë kundërshtuar një anëtarësim/pjesëmarrje të tillë.

Megjithatë, Rumania ka mbajtur një numër të madh trupash nën mandatin e KFOR-it/ UNMIK-ut/ EULEX-it në Kosovë, por ka lënë të kuptohet se do t'i tërheqë forcat e saj duke filluar nga dhjetori 2011.

Ndërkaq, mundësitë e njohjes janë të pakta. Dy arsyt kryesore për këtë janë politika e jashtme e Rumanisë dhe mënyra e përshtatjes së çështjes së Kosovës (në perspektivën historike dhe në kontekstin aktual), si dhe situata e brendshme politike, pasi çështja lidhjet ngushtë me interesat e brendshme dhe të jashtme të administratës aktuale. Me afrimin e zgjedhjeve të përgjithshme më 2012, ndryshimi i mundshëm i kursit mbase mund të ndodhë me ndërrimin e qeverisë. Megjithatë, përmirësimi i marrëdhënieve në nivel më të ulët mund të ndodhte më herët, pavarësisht nga gjërat e thëna më sipër, duke e pasur parasysh interesimin e përhershëm të Rumanisë për të ardhmen europiane të Ballkanit Perëndimor. Po ashtu, shumë gjëra do të varen nga përparimi i Serbisë drejt anëtarësimit në BE dhe normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën, si dhe nga ndonjë ndryshim në qëndrimet e BE-së ndaj Kosovës.

Lufta në Kosovë dhe mbështetja ngurruese për fushatën bombarduese të NATO-s kundër Serbisë

Në kohën e fushatës bombarduese të Aleancës Transatlantike kundër Serbisë më 1999, Rumania ishte kandidate për anëtarësim në NATO dhe e priti me nervozizëm vendimin lidhur me këtë në samitin e Uashingtonit. Prandaj, qëllimi i vetëm më i dukshëm i politikës së jashtme të vendit ishte që t'i bindte partnerët aleatë se e meritonte ta merrte statusin e anëtarësimit. Një qëllim tjetër, ai i anëtarësimit në BE, kërkonte përpjekjen dhe përqendrim të njëjtë të pandërprerë. Në të dyja rastet, kjo njohuri shkonte paralelisht me ndjenjën e frikës se Bukureshti në të vërtetë nuk po i plotësonte të gjitha kriteret e nevojshme dhe vendimi përfundimtar për përmbushjen e tij do të ishte kryesisht politik.

Kryetari Emil Constantinescu dhe ministri i Punëve të Jashtme Andrei Plesu vendosën: në mënyrë që të ishte e besueshme, Rumania duhej të sillej si anëtare *de facto* e dy aleancave dhe të vepronte në solidaritet me to. Vendimin e mbështeti shumica parlamentare. Për rrjedhojë, pasi në tetor 1998 tashmë ia kishte lejuar NATO-s qasjen e kufizuar në hapësirën ajrore të vendit “për situata urgjente dhe të paparashikueshme”, Rumania iu dha forcave aleate qasje të pakufizuar në hapësirën e saj ajrore (çka ishte një mbështetje e rëndësishme logjistike dhe politike), pak para se delegacioni i saj të nisej për në Uashington. Samiti nuk dha rezultatet e pritura dhe Rumania mbeti jashtë Aleancës deri më 2004. Sidoqoftë, ajo mori kompensim të rëndësishëm: më 4 maj 1999, Tony Blair mbajti një fjalim të ngrohtë në Parlament në Bukuresht dhe u bë udhëheqësi i parë europian që kërkoi fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e vendit në BE. Në dhjetor të po atij viti, Këshilli Europian në Helsinki e ktheu propozimin e kryeministrit në vendim zyrtar nga Unioni.

Megjithatë, vendimi për mbështetjen e bombardimeve të NATO-s në Serbi u mor me gjysmë zemre. Rumunët gjithmonë kanë qenë proserbë qoftë për shkak të historisë së përbashkët (lufta kundër otomanëve, vetëdijesimi si mbrojtës të Perëndimit kundër okupimit dhe pastaj të braktisur nga Perëndimi kur iu leverdiste), feja (ortodokse), ose për shkak të admirimit të Serbisë si zemër e Jugosllavisë komuniste, megjithatë perëndimore dhe përparimtare në kohën e Titos (farefis i pasur, që shikohej me lakmi). Inteligjencia kulturore, shumë prej elitës politike dhe mediat nuk ishin në favor të ndonjë veprimi që konsiderohej si veprim kundër serbëve krenarë dhe guximtarë, po aq sa edhe kundër regjimit të Millosheviçit.

Sipas ministrit të Punëve të Jashtme të asaj kohe, Andrei Plesu, zyrtarët në Bukuresht ua bënë të qartë Madeleine Albright-it, Strobe Talbott-it dhe Javier Solana-s se, sipas mendimit të tyre, asnjëra palë nuk ishte krejt fajtores apo krejt e pafajshme dhe se gjykimi i situatës krejt bardhë e zi do të ishte gabim. Ky këndvështrim i konflikteve në

Ballkan, që tregon se historia e gjatë dhe e komplikuar i bën të gjithë aktorët përgjegjës për gjendjen aktuale të tendosjes në rajon, është ruajtur deri më sot.

Po ashtu, diplomacia rumune e ka si traditë mbështetjen e parësisë së të drejtës ndërkombëtare duke u bazuar në parimet morale dhe në Bukuresht pranohej se veprimi kundër Millosheviçit bazohej në faktin se në Kosovë po kryheshin krime të tmerrshme kundër njerëzimit, se po zhvendosej një numër i madh shqiptarësh etnikë dhe civilët po terrorizoheshin nga regjimi.

Sidoqoftë, vetëm tre muaj pas fushatës, ndjenjat e përziera ndaj Perëndimit u përforcuan nga ndryshimi i mendimit të kryetarit Constantinescu dhe shprehja e zhgënjimit të tij lidhur me mënyrën se si NATO dhe BE vendosën ta shpërblenin vendin për mbështetjen e tij gjatë luftës. Kryetari tha se ishte i irrituar nga “standardet e tyre të dyfishta”, për shkak se nuk i ofruan Rumanisë garanci sigurie përmes anëtarësimit në NATO dhe sepse nuk kishin ndërmarrë ndonjë veprim për zvogëlimin e humbjeve ekonomike të vendit, që u shkaktuan për shkak të embargos së shitjes së naftës Serbisë.

Duhet vënë re, në anën tjetër, se pati përfitime të mëdha nga shkelja e embargos si nga vendasit në anën rumune të kufirit, ashtu dhe nga zyrtarët në Bukuresht, që i miratuan veprimet e tyre. Miqësia serbo-rumune u konsolidua në atë kohë, deri sa autoritetet qendrore mbështesnin veprimin e Perëndimit kundër administratës së Millosheviçit në Beograd, por po ashtu kërkonin ndihmën e popullsisë së prekur nga sanksionet, ndërsa individët që kishin bërë tregti përtej kufirit për vite të tëra po bënë në njëjtën gjë – kryenin biznes të errët, por në të njëjtën kohë tregonin solidaritet ndaj serbëve të zakonshëm, të cilët po vuanin në luftë.

Në tërësi, në fund të fushatës, zemërimi kundër Perëndimit ishte në rritje dhe popullsia e viktimizuar serbe përfitoi nga simpatia e përtërirë e rumunëve të zakonshëm dhe elitave të zhurmshme dhe mediave po ashtu.

Pas luftës: Rumania, njëra prej kontribuueseve kryesore në misionet ndërkombëtare

Rumania ka marrë pjesë në misionet ndërkombëtare në Kosovë si njëra prej kontribuueseve kryesore europiane. Arsyet për këtë gjithmonë ka qenë aftësimi i personelit të saj dhe zhvillimi i ndërveprimit me NATO-n dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë. Interesat e politikës së jashtme të Rumanisë gjithmonë kanë qenë njëra prej arsyeve për pjesëmarrjen e tillë konsekuente.

Që nga qershori 1999, ishin dërguar dy oficerë në njësinë policore në UNMIK, të cilëve më vonë iu bashkuan edhe 24 të tjerë në korrik 1999. Deri në përfundim të luftës, pas dy kërkesave të njëpasnjëshme nga KB (në gusht dhe në nëntor), kontingjenti rumun në Kosovë kishte arritur në 70 vetë, si dhe një oficer ndërlidhës ushtarak me misionin e KFOR-it – OSBE-së në terren. Kështu, ky vend ishte nga të parët që iu përgjigj kërkesës së KB-së për kontribut në misionin policor. Me kalimin e viteve, personeli i dërguar ka ndihmuar në krijimin e SHPK-së (Shërbimit Policor të Kosovës) dhe ka aftësuar stafin e tij. Aktualisht, Rumania ende mban dy vëzhgues ushtarakë në UNMIK.

Kur tranzicioni në një mision nën BE-në u konkretizua me krijimin e EUPT (misionit planifikues të BE-së), në janar 2007, policia rumune ishte përsëri nga të parat që mori pjesë. Kur EULEX-i u bë funksional, në dhjetor 2010, 60 oficerë policorë rumunë dhe 115 xhandarë e ndërruan kapelën e UNMIK-ut me atë të EULEX-it. Kjo pjesëmarrje bazohej në argumentet që kanë të bëjnë me “mbajtjen e përkushtimeve dhe vëmendjes ndërkombëtare në strategjinë nacionale të sigurisë lidhur me rajonin”, siç shihet nga qëndrimi zyrtar i Ministrisë së Brendshme.

Krejt papritmas, duke i pasur parasysh gjërat e thëna më lart, më 26 shtator 2011, Këshilli Suprem i Mbrojtjes (CSAT) vendosi të bënte tërheqjen e plotë të trupave të policisë dhe të xhandarëve në fund të periudhës së tyre të detyrës. Mbase arsyeja kryesore (përveç asaj të mosnjohjes në përgjithësi) mund të jetë reagimi lidhur me mungesën e unitetit të BE-së për pranimin e Rumanisë dhe Bullgarisë në zonën Schengen. Mund të spekulohet se kjo lidhej me nevojën për ridërgimin e disa prej këtyre trupave në vende si Libia, si edhe, çka është më e rëndësishme, ngritja e tensioneve në Kosovën veriore të dominuar nga serbët, ku xhandarët rumunë ishin bashkë me pak trupa policore europiane të pranishme atje dhe bënë punë të rëndë në rrethana të vështira.

Pavarësisht nëse kishte ndonjë peshë argumenti i fundit apo jo, në rast se xhandarët rumunë do të gjendeshin në situatën e ndërhyrjes me forcë në përplasjet ndërmjet civilëve serbë dhe shqiptarë, kjo vërtet do të krijonte problem për trupat, për shkak të një incidenti kontrovers disa vite më parë.

Në shkurt 2007, për të kthyer rendin gjatë protestave në rrugët e Prishtinës, që me sa dukej po dilnin jashtë kontrollit, xhandarët rumunë përdorën armët kundër pjesëmarrësve në trazira. Meqë përdorën plumba gome, afati i të cilëve kishte skaduar më 1994 (sipas raporteve të tjera, plumba gome me pjesën qendrore të posaçme me hekur), u vranë dy shqiptarë etnikë anëtarë të lëvizjes Vetëvendosje. Sipas hetimeve të KB-së, ata nuk paraqisnin kërcënim të pashmangshëm. Xhandarët rumunë argumentuan se përdorimi i armëve ishte i justifikueshëm, i arsyeshëm dhe sipas procedurave. Ata u tërhoqën nga vendi përkundër kërkesës së KB-së që ata

duhej të rrinin në Kosovë, në dispozicion të ekipit të KB-së, deri sa të sqarohej situata. Rezultatet përfundimtare të hetimit kurrë nuk u bënë publike.

Imazhi i kontingjentit rumun në Kosovë pësoi një goditje të rëndë me atë rast dhe shqiptarët etnikë akuzuan se vrasjet ishin bërë me qëllim dhe kjo ishte shprehje e paragjykitimit antishqiptar. Në anën tjetër, zyrtarët në Bukuresht, si dhe përfaqësuesit rumunë në Prishtinë, vazhdimisht e kanë akuzuar administratën dhe diplomacinë kosovare se po ushqen ndjenja antirumune duke e ngritur çështjen e incidentit të vitit 2007 çdo herë, në çdo rast, si dhe duke i lidhur me atë ngjarje të izoluar të gjitha marrëdhëniet me vendin mosnjohës. Me këtë arsyetim, për shembull, në Prishtinë ka pasur protesta kur koloneli i xhandarmërisë rumune, Marian Petre, u emërua shef i Policisë Speciale të EULEX-it më 2011.

Në të njëjtën kohë, një incident tjetër më i vonshëm e shtoi më tej perceptimin negativ për trupat rumune. Oficerët policorë të EULEX-it nga Rumania ishin të përfshirë gjoja në kontrabandë dhe u zunë në flagrancë nga zyrtarët doganorë maqedonas në kufirin me Kosovën, më 2010, ndërsa po përpiqeshin të transportonin cigare dhe alkool në mënyrë të paligjshme në autobusin zyrtar të EULEX-it.

Duke i anashkaluar këto raste fatkeqe, aktiviteti i kontingjentit rumun ka fituar mirënjohje të gjerë si nga kolegët e tyre vendas, ashtu dhe nga forcat ndërkombëtare. Ata kanë ndërmarrë misione në situata të rrezikshme (vizitat e nivelit të lartë, etj.) dhe në vende veçanërisht të rrezikshme, siç është Veriu i Kosovës - së fundi gjatë trazirave të shkaktuara nga serbët që protestonin për marrjen e kontrollit në vendkalimet kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak nga Policia e Kosovës në korrik të këtij viti. Me sa duket, largimi i trupave nga ana e qeverisë në Bukuresht do të vlerësohet si humbje nga autoritetet kosovare dhe partnerët e BE-së, por do t'i kushtojë po ashtu edhe Rumanisë – në kuptimin e humbjes së rastit për të marrë pjesë në stabilizimin dhe arkitekturën pas konfliktit në Ballkan dhe të përfitimeve nga dobitë, nga ekspertiza dhe reputacioni.

Trupat rumune në KFOR (59) do të rrinë, meqë ata funksionojnë sipas mandatit të NATO-s e jo të BE-së, që mbështet Rezolutën 1244 dhe nuk bie ndesh me mosnjohjen e shtetësisë së Kosovës nga ana e Rumanisë.

Marrëdhëniet e dyanshme nuk ekzistojnë në asnjë nivel

Komunikimi institucional. Përveç pjesëmarrjes së Rumanisë në misionet ndërkombëtare, nuk ka pasur pothuajse kurrfarë komunikimi institucional ndërmjet vendit dhe Kosovës, madje as para pavarësisë. Duke pasur parasysh marrëdhëniet e afërta ndërmjet Bukureshtit dhe Beogradit, si dhe mbështetjen e vazhdueshme të Rumanisë për Serbinë, kur Kosova ishte krahinë autonome nën mandatin e KB-

së, i gjithë dialogu ishte zhvilluar ekskluzivisht me Beogradin dhe përmes tij. Pas pavarësisë, duke pasur parasysh mosnjohjen nga Rumania, komunikimi ishte edhe më pak i mundur. Për dallim nga vendet tjera të BE-së që nuk e njohin Kosovën, siç është Greqia, Rumania vendosi t'i shmangej çdo kontakti zyrtar që mund të interpretohej si njohje e nënkuptuar, si dhe të refuzonte gjithë bashkëpunimin me Prishtinën në kuadër të kornizës së ndonjë organi dhe/ose ngjarjeje ndërkombëtare. Megjithatë, Bukureshti mban një zyrë ndërlidhëse në Prishtinë, nën mandatin e KB-së.

Shoqëria civile. Bashkëpunimi i shoqërisë civile ka mbetur vetëm në projekte sporadike, shumica prej tyre të shumanshme, rajonale, që kanë bashkuar organizatat dhe pjesëmarrësit individualë rumunë dhe kosovarë. OJQ-të, si Rrjeti Rumun për Zvogëlimin e Dëmtimit, PATRIR (Veprimi për Paqe, Instituti për Aftësim dhe Kërkime i Rumanisë) apo Instituti i Aspenit, kanë bashkëpunuar me institucionet kosovare dhe OJQ-të në projekte jopolitike. Shoqata 'Për Demokraci' ka marrë pjesë në monitorimin e zgjedhjeve të vitit 2010 në Kosovë, nën ombrellën e ENEMO-s (Rrjeti European i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve).

Më sipër janë dhënë vetëm disa shembuj – bashkëpunim ndërmjet organizatave joqeveritare kosovare dhe rumune mund të ketë pasur në më shumë projekte, por duket që asnjëri nuk ka pasur elementë të dyanshëm. Po ashtu, nuk ka ndonjë shënim të qendëruar në asnjë bazë të të dhënave, ngaqë Kosova nuk njihet si shtet dhe, për rrjedhojë, as si partner ndërkombëtar në ndonjë projekt të caktuar.

Tregtia. Në lidhje me marrëdhëniet ekonomike, përsëri çështja e statusit pengon që ndonjë kapitull i posaçëm në ndonjë bazë zyrtare të të dhënave t'i kushtohet bashkëpunimit tregtar dhe investimeve Kosovë-Rumani. Në faqen e internetit të Ministrisë rumune të Ekonomisë dhe Tregtisë gjenden hollësi lidhur me mjedisin ekonomik në Serbi dhe marrëdhëniet tregtare ndërmjet dy vendeve, si dhe përvijohen informatat specifike për rajonet në Serbi, të cilat konsiderohen të jenë posaçërisht të rëndësishme për investorët dhe afaristët rumunë. Megjithatë, Kosova nuk është njëri prej tyre dhe nuk përmendet kurrfarë dallimi ndërmjet të bërit biznes në Kosovë dhe në ndonjë pjesë tjetër të Serbisë. Po ashtu, madje edhe gjatë periudhës së këmbimeve intensive tregtare gjatë ish-Jugosllavisë, biznesi me bazë në Kosovë rrallë ka qenë pjesë e kësaj, nëse ka qenë ndonjëherë.

Zyra përfaqësuese rumune në Prishtinë, që e zhvillon aktivitetin e saj nën mandatin e KB-së, po ashtu shërben si pikë kontaktuese për biznesin e mundshëm rumun në Kosovë – por nuk jepet kurrfarë indikacioni në këtë aspekt përmes ndonjë kanali publik (faqja e internetit e MPJ-së apo ngjashëm). Kompanitë rumune në të vërtetë janë të pranishme në Kosovë, shumica prej të cilave veprojnë në sektorin e ndërtimit. Megjithatë, është e vështirë të sigurohen emrat dhe aktiviteti i tyre i saktë, meqë ato funksionojnë atje në cilësi krejtësisht private dhe nuk kanë nevojë t'u

raportojnë zyrtarëve rumunë për praninë e tyre. Disa prej tyre janë bërë të njohura për autoritetet rumune ngaqë kishin nevojë për to në rastet kur ishin bërë viktime të hajdutëve kosovarë dhe kishin pësuar humbje për shkak të mashtrimit ose veprimeve keqdashëse. Rekomandimi i përgjithshëm i autoriteteve rumune për ta është që të kenë kujdes të shtuar kur bëjnë biznes në Kosovë, ngase konsiderohet se aty ka mjedis investues dhe politik të paqëndrueshëm dhe të korruptuar. Së fundi, megjithatë, ka pasur një shprehje të rritur të interesimit të qeverisë në Bukuresht, ndonëse ende vetëm kërkimor, për të identifikuar nëse është i mundur bashkëpunimi në fushën e biznesit me Prishtinën, madje edhe në rrethanat e mosnjohjes.

Pavarësia dhe vendosmëria për mosnjohje

Në shkurt 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë, Rumania refuzoi që në fillim të mos e njohte atë si shtet. Arsyet janë të shumta; disa bazohen në rrethana objektive, çka pasqyrojnë faktorë të interesit nacional të vendit, të tjerat lidhen fort me situatën e brendshme politike.

E drejta ndërkombëtare. Së pari, Rumania konsideronte se shpallja e njëanshme e pavarësisë shkelte të drejtën ndërkombëtare – dhe duke e përkrahur parësinë e së drejtës ndërkombëtare në kontekst global, ku shkeljet dhe interpretimet e sërishme po shumohen, nuk do të ishte vetëm e moralshme, por po ashtu do t'u shërbente interesave të një vendi me madhësi mesatare si Rumania.

Para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në vitin 2009, sekretari i Shtetit i MPJ Bogdan Aurescu paraqiti argumentin që, ndonëse Serbia vërtet kishte shkelur të drejtat njerëzore të popullit të Kosovës gjatë kohës së Millosheviçit, kjo nuk po ndodhte më me shpalljen e pavarësisë. Vetë Serbia në vitin 2008 ishte vend krejtësisht ndryshe prej vitit 1999 dhe shpallja e pavarësisë nuk mund të bazohej në rrethanat që kishin ekzistuar 10 vjet më parë. Po ashtu, sipas mendimit të Rumanisë, shpërbërja e ish-Jugosllavisë kishte përfunduar në vitin 1992 dhe Kosova mbeti pjesë përbërëse e Serbisë, jo subjekt me të drejtë për vetëvendosje, gjë kjo që do të arsyetonte shkeljet. Statusi i saj specifik në RF të Jugosllavisë nuk ishte i rëndësishëm më 2008, kur Republika Federative nuk ekzistonte më.

Edhe pas nxjerrjes së vendimit nga GjND-ja, Rumania përkrahu mendimin se Kosova nuk kishte të drejtë të shkelte, me arsyetimin se kjo nuk ishte në kundërshtim me qëndrimin fillestar të Bukureshtit, meqë pyetja që Serbia ia kishte drejtuar gjykatës nuk i prekte drejtpërdrejt argumentet e paraqitura më sipër.

Rreziqet nga paqëndrueshmëria dhe ndërhyrja e jashtme. Miqësia me Serbinë. Nëse anashkalojmë çështjet teknike, Rumania nuk dëshironte të shihte ndryshime territoriale, konflikte kufitare dhe tension të përtërirë dhe copëzim në afërsi të vet – aq më pak përmes asaj që ajo e konsideronte si ndërhyrje joparimore nga fuqitë e huaja dhe imponim me forcë. Interesat e saj nacionale gjithmonë kanë qenë që ta shohë Ballkanin duke u zhvilluar në mënyrë paqësore drejt stabilitetit, përparimit dhe një të ardhmeje evropiane, si dhe të lihen pas konfliktet etnike.

Të mos harrojmë në të njëjtën kohë se mbështetja e fushatës së NATO kundër Serbisë më 1999 kishte lënë pendim të vazhdueshëm, ndjenja fajësie ndaj serbëve dhe një lloj zemërimi ndaj Perëndimit. Një “sulm” ndaj integritetit territorial të Serbisë, i farkëtuar nga Perëndimi, ishte diçka që popullsia rumune, ashtu dhe udhëheqja e saj, nuk mund ta përkrahnin. Bukureshti kishte punuar rregullisht me Beogradin si avokat brenda BE-së duke i mbështetur të moderuarit, duke shpresuar që në këtë mënyrë ta forconte orientimin proeuropian të Serbisë dhe gradualisht t’i shkurajonte përçarjet dhe prirjet nacionaliste.

Duke besuar fuqishëm se një qasje e tillë pozitive në fund do të shpaguhej dhe do ta çonte vendin (të cilin e konsideron si çelës për stabilitetin rajonal) në drejtimin e duhur, diplomacia rumune (gjatë administratave të njëpasnjëshme) shpesh i jepte Tadiçit çeqe të zbrazëta. Kjo shpesh shpërfillte edhe mungesën e plotë të përparimit lidhur me kërkesat rumune për të drejtat e pakicës së konsiderueshme rumune në Vojvodinë dhe në luginën Timok. Serbia bën dallimin ndërmjet pakicës së ashtuquajtur “vllahe” dhe asaj rumune, që në të vërtetë kanë identitet të njëjtë. Beogradi nuk ua jep rumunëve etnikë të drejtën për shkollim në gjuhën e tyre amtare dhe e pengon me çdo mënyrë ruajtjen e kulturës së tyre. Vetëm së fundi, ekipet serbe për regjistrimin e popullsisë në rajonet e banuara me rumunë kanë ushtruar trysni në qytetarët pakicë që të deklarohen shtetas serbë.

Përkundër këtyre problemeve të vjetra, qeveria rumune ka ngurruar ta nxitë Beogradin më shumë. Edhe pasi Rumania i dha Serbisë mbështetje të çmuar duke mos e njohur Kosovën, nuk duket që ky favorizim ta lëvizë fqinjin e saj jugperëndimor drejt ndonjë lëshimi për çështjet e rëndësishme dypalëshe. Në të vërtetë, Rumania nuk duket se ka arritur ndonjë fitim të dukshëm në marrëdhëniet me Serbinë si rrjedhojë e qëndrimit të saj për Kosovën.

Përveç kalkulimeve të politikës së jashtme të përmendura më sipër, simpatia tradicionale rumune për serbët është diçka që as ish ministri i Jashtëm dhe këshilltari i Kryetarit Andrei Plesu, një intelektual i shquar, shkrimtar dhe njohës i shpirtit rumun, nuk mund ta shpjegojë me përpikëri. Kur e pyetën për këtë në një intervistë, ai përmendi befasinë e shkrimtarit rumun Octavian Goga, shprehur në vitet 1930

lidhur me prirjen proserbe të rumunëve, të cilët madje ishin të gatshëm t'i harronin kërkesat e përsëritura serbe për Banatin (rajoni perëndimor i Rumanisë, që kufizohet me Serbinë). Plesu hedh poshtë njërin prej sqarimeve më të përhapura, atë të fesë së përbashkët ortodokse, si dhe favorizon argumentin që simpatia aktuale buron nga vitet komuniste, kur rumunët e shikonin Jugosllavinë e Titos dhe shoqërinë e saj relativisht të hapur si pishtar të përparimit.

Arsye tjetër mund të jetë historia e përbashkët e rezistencës kundër pushtuesve (kryesisht otomanë), si mbrojtës të krishterimit dhe të Perëndimit – dhe vetëperceptimi si viktimë të kësaj historie që ngadalësoi zhvillimin e dy popujve, ndërsa Europa Perëndimore po e shfrytëzonte pushimin për të ecur me hapa të mëdha drejt përparimit. Më vonë, po kjo Europë i braktisi të dyja vendet gjatë komunizmit, diçka që mund të kompensohet vetëm përmes anëtarësimit në BE – për çka Serbia gëzon përkrahjen e fortë të Rumanisë.

Kësaj mund t'i shtohet edhe fakti se, duke pasur parasysh copat e mëdha të territorit të saj që u aneksuan nga ish-BRSS (në Ukrainën dhe Moldavinë e sotme) dhe Bullgaria (jugu i Dobroudja), si dhe kërkesat e përhershme të Hungarisë për Transilvaninë, kufiri me Serbinë ka mbetur më miqësori për Rumaninë.

Pavarësisht nga arsyet, kjo afri është shndërruar në mbështetje të përhershme për Serbinë, përkundër përgjigjes së përzier që ka marrë. Po ashtu, meqë kështu ndihen shumica dërrmuese e popullsisë, të kuptuarit që njohja e Kosovës do ta lëndonte Serbinë është diçka për të cilën do të reagonin shumica e njerëzve. Prandaj, mosnjohja nuk është vendim ekskluzivisht politik i marrë në një kontekst të caktuar, por është një vendim që ka mbështetjen e gjerë të popullit, nëse prezantohet si diçka që mbron interesat e Serbisë.

Precedent i rrezikshëm për separatizmin në vetë Rumaninë ose në Republikën e Moldavisë. Një këndvështrim më politik është ai që e konsideron Kosovën si precedent të rrezikshëm për integritetin territorial të vetë Rumanisë – ose atë të Republikës së Moldavisë, që dikur ishte krahinë e Rumanisë.

Përkundër këmbënguljes së Kosovës që rrethanat e saj ishin të pazakonta dhe veprimi i saj i njëanshëm nuk mund të shërbejë si precedent për krahinat e tjera që dëshirojnë të shkëputen, presidenca rumune dhe një pjesë e diplomacisë mendojnë se kjo është më tepër çështje e interpretimit politik se sa fakt objektiv. Në bazë të ngjashmërive me shkëputjen e Kosovës, territoret e tjera në rajon, si Abkhazia, Osetia Jugore ose Nagorno-Karabakh, dhe çka është më e rëndësishmja, Transnistria, do të mund të bënin të njëjtën gjë. Rumania gjithmonë e ka dënuar ndërkombëtarisht regjimin separatist në Tiraspol dhe ka theksuar se çdo rezolutë e këtij konflikti të ngrirë afër kufirit të saj duhet të respektojë integritetin territorial të Moldavisë.

E vërteta është se shumica në Rumani, politikanë ose diplomatë, besojnë në faktin që Moldavia do të ishte më mirë pa Transnistria dhe anëtarësimi i saj në BE do të ishte po ashtu më i lehtë. Shumica e popullsisë në Transnistria janë rusë etnikë, ekonomia është në pronësi të rusëve dhe, ndonëse në rajon gjenden pjesa më e madhe e kapaciteteve kryesore të Moldavisë për prodhimin e energjisë, ai vepron në të njëjtën kohë si “kali i Trojës” i Moskës brenda vendit. Duke mos pasur ndonjë zgjidhje të pranueshme dhe duke marrë parasysh kundërshtimin e Rosisë, duket që ndarja nga Republika e Moldavisë së paku mund të siguronte zgjidhjen e kontestit kufitar, çka është e domosdoshme për anëtarësimin e kësaj të fundit në BE.

Megjithatë, asnjë politikan rumun nuk mund t’ia lejojë vetes ta mbështesë publikisht këtë drejtim të veprimit, së paku tani për tani, pa iu ekspozuar përcmimit publik. Rumunët priren të jenë shumë të ndjeshëm ndaj temës së Republikës së Moldavisë – dhe është pikërisht fija e ndjeshme që Kryetari rumun Traian Basescu u përpoq ta godasë kur e përmendi rrezikun nga sëmundja ngjitëse rajonale pas shkëputjes së njëanshme të Kosovës.

Kur Kosova diskutohet si precedent i mundshëm për shkëputje mu në territorin e Rumanisë, ndjenjat nacionaliste janë edhe më të theksuara. Edhe pse kjo nuk është përmendur në mënyrë të qartë në fillim, gjithnjë e më tepër theksi vihet në mundësinë që hungarezët etnikë të kopjojnë shembullin e shqiptarëve. Pakica hungareze përbën 7% të popullsisë së përgjithshme dhe është përqendruar në disa qarqe ku ata janë shumicë dhe po ashtu shtrihen nëpër Transilvani. Përmendet argumenti që, ose hungarezët do ta shfrytëzojnë shembullin e Kosovës për të kërkuar autonomi për tërë Transilvaninë dhe më shpesh argumenti që ata do të bëjnë thirrje për shkëputjen e Szeklers Land – grupit të qarqeve (Harghita, Covasna, që iu shtohet edhe Mures) ku ata përbëjnë shumicën dërrmuese etnike. Pakica hungareze vazhdimisht ka bërë kërkesa për autonomi, që sillen prej kërkesave më të moderuara për kompetenca më të mëdha administrative dhe më shumë kushte për shkollim në gjuhën e tyre amtare etj., deri te kërkesat radikale për njohje të së drejtës për vetëvendosje.

Muajt e fundit është bërë më shpesh analogji ndërmjet rastit të Kosovës dhe lëvizjes së mundshme të radikalëve hungarezë që të kopjojnë shpalljen e njëanshme të pavarësisë. Në hapësirën publike janë shuar argumentet lidhur me të drejtën ndërkombëtare dhe kontekstin e politikës së jashtme. Kjo nuk nënkupton aspak që ato janë hequr nga arsyetimi zyrtar i qëndrimit të Rumanisë. Më saktë, diskursi publik, i ndihmuar nga konteksti i brendshëm i favorshëm për ndjeshmërinë e shtuar të popullit për këtë temë, është bërë më i politizuar.

Vendimet për politikën e jashtme në Rumani janë përqendruar pothuajse vetëm në Presidencë, ndërsa ministri për Punët e Jashtme Teodor Baconschi, ndjekës besnik i

Kryetari Traian Basescu dhe që ka synime të mëdha për poste në shoqatën politike të Kryetarit, shpesh herë është vetëm ekzekutues. Meqë qëndrimi i Rumanisë për Kosovën që nga fillimi ka qenë kryesisht rezultat i qëndrimit personal të Kryetarit Basescu (edhe pse, pa dyshim, jo vetëm i tij), qëndrimi i personave të tjerë relevantë publikë në lidhje me këtë temë është varur shumë nga qëndrimi i tyre pro ose kundër Kryetarit. Në kuadër të kornizës së debateve të brendshme politike tepër të radikalizuara, që shpesh u kanë munguar tonet e hirta dhe nuancat, kundërshtimi ndaj politikave të Kryetarit në përgjithësi pothuajse automatikisht është shndërruar në kundërshtim të qëndrimit të tij ndaj temës së Kosovës. Anasjelltas, mbështetja për Kryetarin ka nxitur mbështetjen për mosnjohje nga Rumania.

Afrimi i zgjedhjeve lokale dhe atyre të përgjithshme më 2012 dhe përkeqësimi i kontekstit ekonomik, që e ka vënë nën zjarr qeverinë aktuale të mbështetur nga Basescu, kanë kontribuar për krijimin e një klime të prirë për qasje emocionale në vend të argumentit racional.

Këto rrethana janë përkeqësuar dhe problemi hungarez është ndezur sërish prej planeve të shpallura së fundi nga qeveria për ta riorganizuar vendin në aspektin administrativ për të krijuar 8 rajone në vend të 41 qarqeve aktuale ("judete"). Pakica hungareze ka reaguar me shumë zhurmë ndaj këtij propozimi, e pakënaqur që Szeklers Land do të duhej të "shpërbëhej" në njësi territoriale që përbën qarqet e tjera me shumicë rumune dhe kështu hungarezët do ta humbnin statusin e shumicës së koncentruar gjeografikisht, çka e gëzojnë aktualisht.

Zemërimi hungarez po ashtu u shkaktua nga fakti që UDMR, parti politike hungareze, e cila është partnere në qeveri me partinë PD-L (Partinë Liberal-Demokrate) e cila është pro Kryetarit, nuk ishte konsultuar para se këto plane të shpallehin publikisht. Janë bërë spekulime që nisma dhe kjo mënyrë e posaçme e prezantimit në të vërtetë ishin gjest i qëllimshëm nga ana e PD-L për ta nxjerrë UDMR-në jashtë qeverisë ose për ta këmbyer këtë kartë për koncesione më të vogla ndaj kërkesave të pakicës hungareze në bisedimet e mëvonshme. Përkundrazi, të tjerët e kanë akuzuar Presidentin - i cili në fund i bëri një ofertë alternative UDMR-së që t'i mbajë jashtë riorganizimit territorial dy qarqe të dominuara nga hungarezët - se po bën komplot të fshehtë që t'ua japë atyre autonominë e lakmuar gjatë ose të krijojë kushte për këtë, si këmbim për mbështetje politike.

Sidoqoftë, UDMR kërcënoi me mosbindje qytetare, por nuk e braktisi qeverinë. Në fund, vendimi përfundimtar për riorganizimin territorial u shty, por vetëm pasi shkaktoi grindje diplomatike me Budapestin, i cili u hodh në mbrojtje të etnikëve të tij në Rumani. Ministria e Jashtme në Hungari dhe zëvendëskryeministri Zsolt Semjen (i partisë nacionaliste të Viktor Orbanit, FIDESZ) lëshoi një deklaratë zyrtare lidhur

me këtë temë dhe e dënoi atë që ata e quajtën përpjekje të qëllimshme të autoriteteve rumune për të ndryshuar ekuilibrin etnik. Këto komente kanë shkaktuar reagimin e Ministrisë së Jashtme në Bukuresht, që e akuzoi Budapestin se po përzihet në punët e brendshme të Rumanisë.

Në sfond të këmbimit të këtyre akuzave në nivel të lartë, u riaktivizua diskutimi publik për çështjen hungareze dhe hapësira mediatike u pushtua nga reagime tepër emocionale nga të dyja palët.

Marrëdhëniet ndërmjet shumicës rumune dhe pakicës hungareze gjithmonë kanë qenë të komplikuar, po të kemi parasysh pohimin hungarez që historikisht Transilvania i takon Hungarisë. Megjithatë, incidentet e vërteta ndëretnike kanë qenë të rralla dhe shpesh kanë qenë manifestime të elementëve të izoluar radikalë. Në të vërtetë, integrimi i komunitetit hungarez mund të konsiderohet si i suksesshëm, që Rumania nuk e ka publikuar në mënyrë të mjaftueshme në nivel ndërkombëtar, integrim që do të mund të shërbente si model për vendet fqinje që ende po merren me konflikte etnike. Që nga incidentet e përgjakshme në fillim të viteve nëntëdhjetë në Targu Mures dhe në vendet e tjera në Transilvani e deri te gjendja aktuale e pakicës hungareze është bërë përparim i madh: pjesëmarrja në qeveri përmes UDMR për 20 vjet radhazi, strukturat lokale të dominuara nga hungarezët në të gjitha nivelet, në qarqet Harghita dhe Covasna, qasja në shkollim dhe përfaqësimi në gjykatë dhe në administratë publike në gjuhën e tyre amtare etj.

Kjo është saktësisht arsyeja pse në fillim argumenti kundër njohjes së Kosovës, bazuar në analogji me separatizmin e mundshëm hungarez, nuk është marrë shumë seriozisht. Në anën tjetër, ende ka ndjeshmëri dhe armiqësitë mund të ringjallen lehtë. Debati i nxitur politikisht, siç është ai për ndarjen në regjione, ka hasur në reagime historike dhe përmendja e Kosovës në këto rrethana priret ta zhdukë çdo gjykim racional ose fakt të kontekstit historik.

Është me rëndësi të thuhet që shumë vetë kanë vërejtur – dhe mes tyre zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe diplomatë – se këmbëngulja për tërheqjen e paraleles ndërmjet pakicës hungareze dhe shqiptarëve të Kosovës në Serbi në të vërtetë krijon një problem në vendin ku nuk ka ekzistuar. Kur Rumania sulmohet për shkak të problemeve të saj me romët, për shembull, si edhe për shumë arsye të tjera, në vend që “t’i shesë” arritje për të drejtat e pakicave në nivel evropian si sukses, ajo zgjedh t’i theksojë në mënyrë të tepruar problemet e mundshme. Për më tepër, ajo po krijon përshtypjen se ekzistojnë ngjashmëri ndërmjet llojit të tendosjeve etnike në Ballkan dhe marrëdhënieve të saj me pakicën hungareze. Përmes deklaratave të tilla ekziston rreziku i sigurisë kombëtare dhe humbje e mëtejshme e autoritetit në aspektin ndërkombëtar.

Debati i brendshëm për Kosovën – gati inekzistent dhe kryesisht i politizuar

Siç u theksua në kapitullin e mësipërm, debati i brendshëm për Kosovën është reflektim i kontekstit politik para zgjedhjeve. Të paktë janë ata që mund ta diskutojnë apo e kanë diskutuar këtë çështje duke iu referuar vetëm argumenteve historike dhe juridike. Në të vërtetë, duke pasur parasysh afërsinë e Kosovës me Rumaninë, por jo vetëm këtë, tema nuk mund të ndahet nga elementet e saj subjektive dhe emocionale.

Argumentet e ngritura kundër njohjes nga zyrtarët në Bukuresht kanë pasur përkrahje të gjerë nga popullsia, sepse ato përmbajnë në vetvete besime që janë gjerësisht të përhapura. Duhet të thuhet megjithatë se ky pajtim ishte kryesisht i heshtur dhe ngjarja e pavarësisë së Kosovës, si dhe qëndrimi i Rumanisë, nuk shkaktuan shumë interesim në Rumanë. Nuk është mbajtur kurrfarë debati i hollësishëm mes elitave ose opinionit të përgjithshëm. Përkundër pohimit të vazhdueshëm të Rumanisë për interesimin e fuqishëm lidhur me zhvillimin europian të fqinjëve të saj, përfshirja aktive e Bukureshtit në Ballkan apo përmes marrëdhënieve tregtare, shoqërisë civile apo diplomacisë, është zvogëluar me kalimin e viteve dhe aktualisht është mjaft e dobët. Rastësisht apo jo, kjo përfshirje është zvogëluar pas vitit 2004, kur administrata aktuale erdhi në pushtet. Prandaj, interesimi i vërtetë për temën e Kosovës mungon shumë dhe kur është fjala për fqinjët e Rumanisë, si opinioni publik ashtu dhe vendimet e politikës së jashtme përqendrohen më shumë në Moldavi, Ukrainë dhe Rusi.

Në mungesë të debatit konsekuent publik, shumë mendime krijohen në bazë të reagimeve sipërfaqësore ndaj kontekstit politik ose ndjeshmërive historike (shpesh të keqkuptuara). Mënyra e prezantimit të çështjes shpesh ndikon në mënyrën e reagimit të njerëzve. Nëse prezantohet në kontekstin siç u përshkrua më lart, lidhur me temën tepër emocionale të separatizmit hungarez, do të ishte krejtësisht e pamundur të bëhej diskutim i balancuar për elementet themelore të pavarësisë së Kosovës dhe kjo do të ishte një kauzë e humbur që në fillim.

Shumica e reagimeve gjatë tërë kohës nuk e kanë kundërshtuar reagimin zyrtar të Rumanisë. Sërish, kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të argumenteve që janë prezantuar si bazë e këtij qëndrimi dhe pjesërisht për shkak të shkallës së indiferencës ndaj kësaj teme dhe, për rrjedhojë, mungesës së motivimit për të diskutuar lidhur me këto arsye.

Një indiferencë e njëjtë relative ka përcaktuar përqendrimin e përgjithshëm të mediave në ngjarjet sensacionale në Kosovë, të cilat vlenin të përmendeshin në lajme para dhe pas pavarësisë. Siç ndodh zakonisht në gazetarinë e popullarizuar, kjo shpesh ka qenë

e kufizuar në shembujt e rindezjes së konfliktit, trazirat në rrugë, ngjarjet (negative në përmbajtje) ku janë përfshirë forcat rumune atje, pretendimet për trafik organesh nga kryeministrit Hashim Thaçi dhe gjëra të tjera të ngjashme. Sipas praktikës aktuale mediatike, lajmi i mirë nuk është lajm. Prandaj, para dhe pas pavarësisë është forcuar perceptimi për Kosovën si një vend ku zotëron konflikti, trafikimi i qenieve njerëzore, korrupsioni, paqëndrueshmëria politike dhe varfëria.

Duhet thënë gjithashtu se këto perceptime janë formuar po ashtu për shkak të injorancës së përhapur mes popullsisë së përgjithshme lidhur me rrethanat e konfliktit në Kosovë, para dhe pas Millosheviçit. Konfliktet e përgjakshme në Ballkan, shumica kanë njohuri vetëm për Millosheviçin si kriminel, ndoshta përmes lidhjes me Çausheksun, si dhe për historinë e vëllavrasjes së secilit kundër secilit. Me sa duket, Bosnja është më e njohur se Kosova dhe është e sigurt që, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, vëmendja është përqendruar në vendet që kanë qenë më afër anëtarësimit në strukturat transatlantike: Serbi, Kroaci dhe Maqedoni, ndërsa ka të ngjarë që shumë të harrojnë madje edhe të mendojnë për Slloveninë në kontekstin e njëjtë, pasi zhvillimi i saj ka qenë aq ndryshëm nga ai i të tjerëve. Për Kosovën dihet pak dhe dihet vetëm përmes asaj që Rumania i frikësohet më së shumti në fqinjësi: mungesës së stabilitetit.

Megjithatë, duhet të bëhet dallimi ndërmjet elitave dhe publikut të gjerë. Shkëputja aktuale intelektuale e Rumanisë nga Ballkani ka ndodhur vetëm rishtazi. Kjo është me sa duket rezultat i shqetësimeve të veçanta për anëtarësimin në BE dhe në NATO, që i ka thithur të gjitha përpjekjet e politikës së jashtme gjatë viteve të fundit, ndërsa në rajon vëmendja ka mbetur e përqendruar në kufirin shqetësues në lindje, me ish-hapësirën sovjetike dhe ku Rumania ka disa prej territoreve të saj të mëparshme. Intelektualët dhe diplomatët kanë njohuri të gjera për Ballkanin. Që të dyja, edhe periudha para komunizmit, edhe ajo kur Titoja ishte model i Çausheksut, si udhëheqës i lëvizjes së të painkuadruarve dhe përkrahës i agjendës nacionale të pavarur edhe nga Moska, edhe nga Perëndimi, kanë nxitur interesimin e historianëve, shkrimtarëve dhe të politikëbërësve.

Ndërsa mediat e popullarizuara priren të përqendrohen në debatin e lehtë sensacional mes qarqeve me njohuri më të mëdha, në revistat si “Dilema Veche”, “22”, “Foreign Policy” etj. Rumania ka qenë më e informuar dhe konsekuente. Është vështirë të thuhet nëse qëndrimi ka qenë më shumë në favor të pavarësisë së Kosovës apo kundër saj. Shumica e elitës intelektuale rumune anon nga e djathta e qendrës, prandaj priret të ketë favorizime disi nationalist, shpesh të lidhura me ndjenjën vëllazërore proserbe, çka u përshkrua më parë. Udhëheqësit e opinionit me rol më aktiv ose lidhje më të ngushta me diplomacinë ose me vendimet aktuale të politikës së jashtme janë përpjekur të kenë qasje më pragmatike dhe ta kundërshtojnë qëndrimin zyrtar të

Rumanisë. Prapë se prapë, madje as në këtë rast nuk mund të thuhet se tema e Kosovës është trajtuar si temë kryesore.

Kjo ka ndodhur për arsye se, mes analistëve dhe inteligjencës në përgjithësi, qëndrimet formohen në bazë të argumenteve dhe prioriteteve vetjake, pavarësisht nga konteksti politik dhe nuancat e ndryshme, si dhe duke pasur parasysh kompleksitetin e këtij problemi me shumë aspekte. Për shembull, qëndrimi proserb nuk shihet domosdoshmërisht si antikosovar dhe mbështetja e argumenteve të Kryetarit Basescu lidhur me të drejtën ndërkombëtare mund të balancohet me kritikën për pasojat që mund t'i vijnë politikës së jashtme për shkak të qëndrimit të njëjtë.

Gjërat janë shumë më të qarta në rastin e politikanëve, gazetarëve ose komentuesve të tjerë, të cilët janë aleatë ose kundërshtarë të patundur të qeverisë dhe të Kryetarit (dhe pjesa më e madhe e debatit publik është kontribut për rreshtimin politik për shkak të pronësisë politike të medias ose për shkak të politizimit të përgjithshëm të diskursit). Përkrahësit e Basescut do të mbrojnë qëndrimin se mosnjohja është e drejtë dhe në pajtim të plotë me interesat nacionale të Rumanisë, ndërsa kundërshtarët menjëherë do ta kritikojnë vendimin si vetëmundësi dhe të dëmshëm për pozitën ndërkombëtare të Rumanisë.

Duke pasur parasysh që çështja e Kosovës nuk është në qendër, hera e vetme kur është kundërshtuar posaçërisht fuqishëm në media qëndrimi i Kryetarit ka qenë kur ai u shndërrua në të vërtetë në diskutim për marrëdhëniet e Rumanisë me aleatët e saj të BE-së dhe ata amerikanë. Kur Traian Basescu vendosi të bojkotonte samitin e shefave të shteteve të Europës Qendrore dhe Lindore, mbajtur më maj 2011 në Varshavë, për shkak se ishte ftuar Kosova, shumë njerëz në Rumanë menduan se gjërat kishin shkuar tepër larg. Edhe ata që nuk ishin prokosovarë tërhoqën vëmendjen për faktin që Rumania po bëhej vazhdimisht obstruktive kur presidenti vendosi që, për arsye që kishin të bënin me vendimin e politikës së jashtme, të humbte një takim me Presidentin e ShBA-ve, Barack Obama, i cili po merrte pjesë në samit; pjesa dërrmuese nuk mendonin se këto arsye ishin aq të rëndësishme sa të rrezikohej prishja e marrëdhënieve me aleatët. Gazetarët dhe analistët thanë se ndoshta kishte ardhur koha të rishqyrtoheshin përfitimet dhe humbjet që buronin nga qëndrimi i Rumanisë.

Kjo temë u bë më e rëndësishme kur u shqyrtua në lidhje me marrëdhëniet me ShBA dhe BE, që çmohen shumë në vend. Basescu akuzohej gjithnjë e më shumë që kishte kundërshtuar qëndrimin e shumicës në BE, në mënyrë që të fitonte popullaritet në vend duke e luajtur të fuqishmin, i cili nuk do të sillej si “marionetë amerikane”, si dhe për t'u hakmarrë për izolimin e tij të perceptuar brenda BE-së nga shumica e shefave të tjerë të shteteve. Po ashtu u tha se vendimi po e shtynte Rumaninë drejt mungesës së lidhjeve në rajon, si dhe po e vendoste atë në një grup me Rusinë dhe Kinën, ndërsa

argumentet dhe rrethanat e brendshme politike të vendeve të tjera mosnjohëse të BE-së janë shumë më serioze se të Rumanisë.

Perspektiva për të ardhmen: vendosja e marrëdhënieve në nivel më të ulët para njohjes

Tani për tani, njohja është e lidhur ngushtë me ndryshimin e mendimit personal të presidentit Basescu – nëse është e mundur. Shumë vështirë se do të ndodhë kjo, duke e pasur parasysh vendosmërinë e tij lidhur me këtë temë. Ndryshimi i qeverisë më 2012 (tani ende krejt e paparashikueshme, edhe pse shumë e mundur) mund të shtojë trysninë, ndonëse, në fund të fundit, vendimi i politikës së jashtme i takon presidentit.

Një aspekt tjetër që mund ta lakonte ekuilibrin është lëvizja e mundshme e vendeve të tjera mosnjohëse të BE-së për ta ndryshuar qëndrimin e tyre. Natyrisht, nëse vetë Serbia arrin një marrëveshje të pajtueshme me Kosovën, kjo automatikisht do t'i mënjanonte të gjitha pengesat për njohje nga Rumania.

Me sa duket, në nivelet poshtë presidencës qëndrimet janë më pak të polarizuara se ç'mund të duken.

Për këtë arsye, shumë diplomatë dhe vendimmarrës politikë priren të jenë pragmatikë dhe e kuptojnë se “të fortët bëjnë çka dëshirojnë, të dobët atë që duhet të bëjnë”. Në kuptimin e ngushtë të interesave të politikës së jashtme, zyrtarët në Ministrinë e Punëve të Jashtme pranojnë jozyrtarisht se ndonjëherë qëndrimi i vendit e bën jetën jashtëzakonisht të vështirë, meqë ata janë përpjekur të gjejnë argumente dhe të shpikin strategji për kundërshtimin në çdo nivel të anëtarësimit të Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare (madje edhe në ato relativisht të vogla, që merren me mjedisin apo me tregtinë). Nëse anashkalojmë përpjekjen “logjistike”, ata pranojnë se një pengesë e tillë e përhershme e ka lënë në hije jo vetëm një herë imazhin e Rumanisë, meqë vendi nuk e ka plotësuar këtë kundërshtim me shumë propozime konstruktive dhe përfshirje në rajon.

Po ashtu, meqë Rumania dhe Bullgaria gjithmonë kanë dalë si shembuj negativ në bisedimet e BE-së me Kroacinë për anëtarësim, të cilat janë vonuar pjesërisht për t'iu shmangur përsëritjes së gabimeve të bëra në rastin e dy anëtarëve më të rinj të BE-së, reputacioni i Rumanisë në Ballkan nuk është përmirësuar. Sa i përket Serbisë, përsëri shumëkush do të pranonte se mbështetja e Rumanisë nuk ka sjellë ndonjë përfitim të dukshëm dhe Beogradi nuk e ka kthyer nderin në ndonjë formë – qoftë

përmbes bashkëpunimit të shtuar për çështjen e pakicës rumune, qoftë për përfitime të tjera. Në të vërtetë, Rumania po humb rastin për të qenë e pranishme në rindërtimin e Ballkanit pas konfliktit në nivel të shoqërisë civile ose në atë politik e jo vetëm të angazhohet me trupa nën mandatin e NATO-s ose të BE-së. Si pjesëmarrëse më e përfshirë, ajo mund ta përmbësonte imazhin e saj dhe ta shndërronte disavantazhin në avantazh përmbes këmbimit të mësimëve të nxëna, madje edhe nga gabimet e veta, si vend që ka kaluar përmbes një procesi analog demokratizimit dhe të anëtarësimit në BE. Po ashtu, Rumania po e humb rastin për mundësi tregtare dhe investime, ndërsa paratë po derdhen në infrastrukturën dhe në (ri)ndërtimin e ekonomisë së Kosovës. Në përgjithësi, vendi thjesht nuk mund të jetë aktor kryesor në rajon (ku në të vërtetë Polonia dhe Hungaria po kërkojnë gjithnjë e më tepër ndikim, pasi Greqia po merret vetëm me veten e saj për shkak të problemeve të brendshme dhe nuk mund të vazhdojë të jetë agjent i ndikimit, ashtu siç ka qenë gjithmonë në Ballkan) duke refuzuar të bashkëpunojë në ndonjë mënyrë apo formë me njërin nga komponentët e rajonit – pavarësisht nëse e quan atë shtet apo diçka tjetër.

Shumë vendimmarrës në Rumani do të donin ta shihnin atë në rrugën e Greqisë, e cila ka bashkëpunuar me Kosovën, ka pasur kontakte të nivelit të lartë me Prishtinën dhe nuk e ka kundërshtuar anëtarësimin e Kosovës në disa organizata ndërkombëtare, edhe pse kurrë nuk e ka njohur atë si shtet. Në disa nivele të caktuara ekziston dëshira që së paku të punohet me Kosovën deri sa çështja e statusit të saj të sqarohet ndërkombëtarisht. Qëndrime të tilla, ndonëse shprehen në mënyrë liberale nga politikanët opozitarë, nuk mund të thuhet publikisht nga diplomatët ose politikanët e partisë në pushtet, ndërkohë që linja presidenciale mbetet e pandryshuar.

Si të bëhet kjo?

Me sa duket, gjëja më e rëndësishme që duhet shmangur kur diskutohet Kosova në përgjithësi do të jetë rënia në kurthin e lidhjes së kësaj çështjeje me çështjet emocionale dhe të ndjeshme ndaj të cilave rumunët priren të reagojnë në mënyrë të pafavorshme dhe t'i bllokojnë të gjitha argumentet. Kontekstet ose temat që do të mund të nxitnin referenca me Moldavinë, me separatizmin hungarez ose me vëllazërinë rumuno-serbe do të godisnin vetëm çështje të ndjeshme dhe do ta bënin praktikisht të pamundur hapjen ndaj kompromisit. Argumentet morale lidhur me vuajtjet e shqiptarëve pjesërisht mund të hasin në veshë të shurdhër, meqë shumica e rumunëve ndoshta do të pajtoheshin instinktivisht me ta, me përjashtim të implikimeve të fundit nga kjo e që do të ishte veshja e fajit serbëve - prandaj ata nuk janë të gatshëm ta bartin argumentin te pasojat e tij të fundit. Po ashtu, ekziston mundësia që shumica do të arsyetohen se UÇK-ja po ashtu ka kryer krime të tmerrshme.

Përkundrazi, nëse i qasen kësaj çështjeje përmes prizmit të interesave të përbashkëta në marrëdhëniet transatlantike, aspiratave europiane, përkushtimit të Rumanisë për anëtarësimin e Ballkanit Perëndimor, lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët europianë etj., pranimi i vetë debatit mund të ketë më shumë gjasa për sukses. Përderisa nuk theksohen dallimet dhe nuk bëhen linja të tjera ndarëse dhe nëse shmanget paradigma reciprokisht e veçantë 'Kosovë apo Serbi', mund të ndodhte një ndryshim i pjesshëm i perceptimeve negative.

Mund të jetë më efikase nëse bëhen përpjekje që opinionit publik t'i prezantohen aspektet e realitetit kosovar për të cilat nuk ka njohuri, në vend që të bëhen përpjekje për kundërshtimin e opinioneve tashmë të formuara. Përveç kësaj, duhet pasur parasysh që shpesh, gjatë vizitave studimore ose projekteve të ngjashme komunikuese, njerëzit parapëlqejnë që, në mënyrë përzgjedhëse, të shohin vetëm ato aspekte që i përforcojnë perceptimet e tyre të mëparshme duke u kënaqur në rehatinë e sigurisë në vend që ta pranojnë kundërshtimin e ideve të formuara që më parë.

Kur diskutohet injorimi i realitetit kosovar, kjo ka të bëjë me kohën e tashme dhe me historinë. Përderisa shumë rumunë janë në dijeni të plotë të lidhjes së tyre me serbët përmes fesë, traditës dhe historisë, dituria e tyre lidhur me marrëdhëniet rumuno-shqiptare në përgjithësi është e kufizuar vetëm tek intelektualët e informuar. Perceptimet për shqiptarët janë formuar vetëm në vitet e fundit, kryesisht përmes krimeve të dhunshme që komuniteti shqiptar ka kryer në Itali, por që krahasohen me nivelin e krimit brenda komunitetit rumun (!). Po ashtu, para anëtarësimit të Rumanisë në BE (dhe jo vetëm atëherë), Shqipëria ishte vendi i vetëm që renditej më poshtë se Rumania në raportet e Komisionit në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me standardet e jetesës, sundimin e ligjit, etj. Nuk është çudi që perceptimet për shqiptarët janë shpesh negative.

Ekziston paragjykim relativisht i ulët kundër shqiptarëve lidhur me fenë. Kosova lidhet me islamin dhe me siguri që ekziston një rezistencë ndaj përfytyrimit të "tjetrit", por ndoshta më shumë në aspektin kulturor se sa vetëm në atë fetar, së paku duke gjykuar në bazë të dimensionit evropian të problemit. Edhe pse tepër ortodoksë, rumunët priren të jenë relativisht tolerantë (ose së paku nuk janë jotolerantë radikalë), ndoshta për shkak të ndërveprimit të tyre të vazhdueshëm me otomanët ndër shekuj dhe pranisë së komunitetit mysliman në Rumaninë jugore/jug-lindore (Dobroudja). Një portretizim i thjeshtëzuar i islamit në media ka shtyrë shumë njerëz ta identifikojnë islamin me konflikt dhe me arabë, prandaj është e pritshme që shumica do të presin që Kosova të jetë shumë më e radikalizuar se ç'është në të vërtetë dhe shumë më e ngjashme me vendet e Lindjes së Mesme – që janë të prira ndaj konfliktit dhe ekstremizmit fetar.

Ndoshta do t'ia vlente të merrej parasysh vetëdijesimi lidhur me strukturën shtetërore laike dhe qasjen tolerante dhe të hapur ndaj fesë (po ashtu edhe ndaj feve të tjera) dhe dhënien e të drejtave grave (duke publikuar, për shembull, numrin e madh të grave deputete, ministre e madje edhe presidentes së vendit). Po ashtu mund të ndihmojë edhe paraqitja e fakteve që janë në kundërshtim me perceptimin publik të krijuar gjatë dhe pas luftës së vitit '99, që UÇK ishte mbështetur dhe financuar nga al-Qaeda, dhe për këtë arsye interesat e huaja fundamentaliste dhe të paligjshme të disa shteteve fundamentaliste arabe (siç është Arabia Saudite) ende po e pllakosin Kosovën në mënyrë strukturore.

Fatkeqësisht, ndonëse shumë njerëz në Kosovë e pranojnë me gatishmëri Rumaninë si vend mik (çka mund të jetë tmerrësisht befasisëse për rumunin që është njohur kryesisht lidhur me marrëdhëniet e fundit ndërmjet dy vendeve!) dhe tregojnë shumëçka për rolin vendimtar që ka luajtur Bukureshti gjatë shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe strehimit të mëpastajmë në Rumani, në fillim të shekullit të njëzetë, shumë pak rumunë kanë mësuar lidhur me marrëdhëniet e forta tradicionale ndërmjet rumunëve dhe shqiptarëve.

Vetëm një grusht intelektualësh do të mbajë mend se shqiptarët dhe rumunët kanë disa qindra fjalë të përbashkëta, të cilat nuk gjenden në asnjë gjuhë tjetër (mes tyre janë fjalët e popullarizuara dake: vizione, barza, murg etj), çka mbështeten nga teoria e origjinës së përbashkët trakase. Ose teorinë që mbreti i famshëm moldav, Vasile Lupu, ishte shqiptar etnik. Ose që shqiptarët në të vërtetë kanë luftuar gjatë përkrah rumunëve në mënyrë që ta mbrojnë ortodoksinë e tyre kundër pushtuesve osmanë. Ose që himni kombëtar shqiptar, Hymni i Flamurit, këndohet sipas melodisë Pe-al nostru steag e scris unire të kompozitorit rumun Ciprian Porumbescu, ndërsa teksti i tij ishte shkruar nga një banor i Bukureshtit, Aleksandër Stavre Drenova. Drenova po ashtu mori pjesë në takimin e qeverisë shqiptar në ekzil në vitin 1912 në Bukuresht, ku u miratua rezoluta e parë lidhur me pavarësinë e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, pak e dinë që figurat e shquara rumune, siç është poeti Victor Eftimiu ose familja e famshme Ghica, kanë origjinë shqiptare. Ose që në ditët e sotme në Kosovë jetojnë rumunë etnikë, të cilët kanë krijuar jetë atje, si dhe shqiptarë të Kosovës që kanë studiuar në Rumani dhe e flasin gjuhën rumune rrjedhshëm. Mes rasteve të tilla është drejtori aktual në Ministrinë e Integritetit Europain, Pleurat Sejdiu, i afërt i ish-presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu, ose drejtori i Bibliotekës Kombëtare në Prishtinë, i cili ka përkthyer gjerësisht nga letërsia rumune, si dhe të tjerë, që nga kirurgë të famshëm e deri te zëdhënësit vendas për KFOR-in.

Bashkëpunimi për vetëdijesimin reciprok lidhur me marrëdhëniet historike dhe të mira fqinjësore mund të ndihmojë krijimin e ndjenjës së afërsisë ndërmjet Rumanisë dhe Kosovës, që aktualisht mungon nga ana rumune, si dhe krijon një ndjenjë që duhet të bëhet zgjedhja ndërmjet Serbisë me të cilën ka lidhje, si dhe Kosovës së huaj, me të cilën nuk ka kurrfarë lidhjeje e me të cilën Bukureshti nuk ka asgjë të përbashkët.

Përveç rrëfimit për marrëdhëniet tradicionale, mund të jetë e përshtatshme që të tregohet fytyra aktuale e Kosovës në elementet e saj më së paku të reklamuar: një komunitet i moshës së re që flet anglisht, që ka shumë profesionistë të shkolluar mirë, të cilët janë kthyer nga diaspora pas ekzilit të imponuar nga pastrimi etnik për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie europiane dhe që ka aspirata të njëjta me ato që i nxitën rumunët të bënin përpjekje të ngjashme për t'iu bashkuar BE-së.

E drejta për të udhëtuar lirshëm, për t'u shkolluar dhe për të punuar jashtë vendit, një shoqëri më përparimtare demokratike – të gjitha këto kumbuese për rumunët, të cilët rishtazi kanë kaluar nëpër faza të njëjta dhe ende ballafaqohen me raste të ngjashme të refuzimit nga partnerët europianë perëndimorë, kur është fjala për lëvizjen e lirë (shih grindjen e fundit lidhur me pranimin e Rumanisë dhe të Bullgarisë në zonën Schengen), të drejtat e punës (në disa vende ende ekzistojnë kufizimet e vëna kundër punëtorëve rumunë) ose diskriminimin (kundër rumunëve dhe romëve me origjinë rumune në mbarë Europën).

Ndoshta duhet nënvizuar se amullia politike në nivel të BE-së, që po i kontribuon edhe Rumania, de facto po e pengon zhvillimin e Kosovës dhe qytetarëve të saj po ua mohon të drejtat për të cilat rumunët kanë luftuar, të cilat i kanë fituar dhe nga të cilat nuk do të heqin dorë përsëri. Nëse bëhet një sondazh i opinionit mes qytetarëve të zakonshëm, me siguri do të tregonte se përfitimi më i dukshëm nga anëtarësimi në BE, të cilin mund ta përmendë çdo rumun, është udhëtimi pa viza, diçka për të cilën kosovarët madje nuk kanë as perspektivë, meqë procesi është ndaluar nga dallimet e njëjta politike në BE. Në botën e sotme, të lidhur ndoshta shumë më tepër se para dhjetë vjetëve, t'ia mohosh këtë një të riu që flet anglisht dhe është i shkolluar duket sikur i ke marrë një të drejtë të natyrshme dhe jo si refuzim për t'ia dhënë një të drejtë të tillë. Pa dyshim, kurrë nuk ka qenë pjesë e qëllimeve të politikës së jashtme të Rumanisë që t'ia mohojë një mundësi të tillë për jetë më të mirë ndonjë personi në Ballkan apo gjetkë. As të nxisë destabilitet në rajon, duke kontribuar në atë që aktualisht është moszbatim i sundimit të vërtetë të ligjit nga EULEX-i, për arsye të njëjta që kanë të bëjnë me situatën politike në BE.

Sigurisht, nuk mund të mohohet se kritikën e BE-së lidhur me korrupsionin, trafikimin e qenieve njerëzore në Kosovë, konsideratat për valë të mundshme të imigrimit me t'u hapur kufijtë, etj, janë të bazuara në argumente. Megjithatë, Rumania duhet të jetë

njëri prej vendeve që e kupton më së miri kontekstin rajonal dhe, pa i mbyllur sytë për asnjërën nga gjërat e thëna më sipër, të punojë me fqinjët e saj dhe të ndajë përvojën për tejkalimin e këtyre pengesave, ndoshta nga pozita e “vëllait më të madh” dhe më të kuptueshëm se disa nga popujt e Europës Perëndimore. I realizuar brenda kornizës së përkushtimit të Rumanisë ndaj integritetit të Ballkanit Perëndimore në BE, diskutimi mund të jetë konstruktiv dhe i dobishëm në mënyrë reciproke.

Rumania do të kishte rast t’i jepte shtytje profilit të saj ndërkombëtar, të shihet si aktore konstruktive dhe jo obstruktive dhe si aleate e mirë për mbështetësit e Kosovës, siç janë ShBA, MB, Gjermania ose Franca, përkundër qëndrimit të saj për mosnjohjen e Kosovës, si dhe do të ishte një aktore e vërtetë në rajon, që do të kishte mundësi të bënte ndërtimin e brendshëm të kapaciteteve gjatë këtij procesi. Sidomos pasi BE-ja po përballlet me sfida të tmerrshme të brendshme dhe zgjerimi duket se do të ngadalësohet edhe më, çdo bashkëpunim në afërsi të BE-së do të çmohej si diçka që është me rëndësi fundamentale për forcimin e lidhjeve me Bashkimin Europian, ndërsa ky i fundit nuk mund të ofrojë më shumë se kaq.

Obligim moral i Rumanisë ndaj fqinjësisë së saj dikur komuniste dhe interesi i saj pragmatik duhet të jenë pjesë e themelit të të gjitha komunikimeve të Kosovës me Rumaninë. A do të kthehet rryma në mënyrë radikale sa i përket opinionit publik dhe vendimit politik apo jo, kjo është vështirë të thuhet. Megjithatë, ndërtimi i marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në zonë të pashkelur – duke pasur parasysh mungesën e përpjekjeve të tilla për këtë qëllim – në nivel njerëzor dhe madje edhe institucional, kurdo që është e mundur në këto rrethana, nuk duhet të ballafaqohet me pengesa të pakalueshme. Nxitja e bashkëpunimit më të mirë të shoqërisë civile dhe asaj akademike për të krijuar kushte për tregti dhe afarizëm (gjëra që mund t’i shmangen lehtë ngecjes në çështjen e shtetësisë) dhe mbështetja e një pasqyrimi të realitetit në anën tjetër në mënyrë më të balancuar, korrekte dhe më pak emocionale në media, mund të mos jetë pikënisje e keqe.

Qëndrimi i Rumanisë ndaj Kosovës: Një pikëvështrim historik dhe kulturor

George-Vadim Tiugea,
Instituti "Ovidiu Sincai", Bukuresht, Rumania
Tetor 2011

Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia. Kjo ngjarje u pasua nga një valë njohjesh nga vendet e Bashkimit Europian dhe nga Amerika Veriore. Megjithatë, pesë shtete anëtare të BE-së nuk pranuan ta njohnin atë: Qiproja, Greqia, Rumania, Spanja dhe Sllovakia. Si rrjedhim, ato u pozicionuan në favor të qeverisë serbe, që e konsideron Kosovën të jetë rajon autonom dhe i ligjshëm i saj (sipas Kushtetutës së re të Serbisë, të vitit 2006), një pozitë që mbështetet, ndër të tjera, edhe nga dy shtetet e përherëshme anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Rusia dhe Kina. Në vijim të këtij artikulli do të përpiqemi të sqarojmë disa arsye historike dhe kulturore që shërbyen si bazë për vendimin dhe qëndrimin e Rumanisë ndaj Kosovës.

Rumania dhe Serbia – rikujtim i shkurtër i marrëdhënieve të gjata dhe të qëndrueshme

Marrëdhëniet e Rumanisë me Serbinë luajnë rol vendimtar për qëndrimin e saj të tanishëm ndaj Kosovës. Një gjë duhet të veçohet që nga fillimi: të dyja vendet kanë vazhduar të afrohen me njëra-tjetrën historikisht aq sa, në kohërat e luftës, një diplomat i njohur rumun, Nicolae Titulescu, pati thënë se *Jugosllavia [Serbia] dhe Deti i Zi ishin fqinjët e vetëm miqësorë të Rumanisë*⁴¹.

Marrëdhëniet e mira mes dy vendeve kanë qenë ndërtuar përmes raporteve historike të të dy popujve fqinjë. Duhet të theksohet se të dyja këto vende janë ndikuar nga tiparet e krishterimit bizantin sllavo-ortodoks, që u paraqit gjatë sundimit të Perandorisë së Parë Bullgare gjatë shekujve 9-11 para Krishtit⁴². Bashkëpunimi i parë politik dhe ushtarak u zhvillua në vitin 1389, në rastin e Betejës së (Fushë)Kosovës, kur një grup i vogël luftëtarësh u dërgua nga princi i Vllahisë, Mircea i Madh (1386-1418) për t'u bashkuar me koalicionin e krishterë të serbëve, bullgarëve, boshnjakëve, shqiptarëve dhe hungarezëve kundër turqve osmanë. Deri sa u pushtuan të gjitha tokat serbe nga osmanët, Principata e Vllahisë ishte një aleat i princave serbë⁴³.

41 Sabina Fati, "România, prizonieră între Serbia și Marea Neagră" ("Rumania, e zënë ndërmjet Serbisë dhe Detit të Zi") në *România liberă*, joi, 28 maj 2009, <http://www.romanialibera.ro/editorial/a155212-romania-prizoniera-intre-serbia-si-marea-neagra.html>, e qasur më 24 janar 2010

42 Vlad Georgescu, *Istoria românilor de la origini până în zilele noastre (Historia e romakëve nga origjin deri në ditët sotme)*, Editura Humanitas, București, 1995, fq. 52

43 Georgescu, vepra e cit., fq. 69

Momenti i dytë i rëndësishëm i bashkëpunimit zuri vend gjatë Betejës së Dytë të (Fushë) Kosovës (1448), kur mbreti hungarez Xhon Huniadi udhëhoqi koalicionin e krishterë që përbëhej nga hungarezët, vllahët dhe serbët, sërish kundër osmanëve. Fakti që mbreti hungarez kishte një lloj prejardhje rumune nga ana e babit të tij, i cili njihet në historinë rumune si Janku de Hunedoara, princ i Transilvanisë (1441-1456), dhe se ai udhëhoqi një ushtri me pjesëmarrje edhe nga Transilvania dhe Vllahia, mund të merret si një lidhje e mirë me serbët⁴⁴. Më vonë, kur serbët ishin nën sundimin osman dhe principatat rumune kishin një shkallë më të lartë autonomie, shumë fisnik serbë dhe klerikë gjetën strehim në Transilvani dhe Vllahi.

Bashkëjetesa mes dy popujve, në rastin më të mirë ishte brenda rajonit të Banatit, të formuar nga turqit nën emrin e *Ezaleti i Temishvarit*, në vitin 1552, pasi ky i fundit kishte pushtuar pjesën më të madhe të Hungarisë. Ky rajon dominohej etnikisht nga serbët rasië dhe vllahët (rumunët). Ajo ishte kolonizuar me popullsi gjermane pas vendosjes së sundimit austriak në vitin 1718, por të dyja grupet dominuese, deri në fund të shekullit 19, mbetën rumune dhe serbe. Gjatë Revolucionit të vitit 1848, të dyja grupet u bënë aleatë për të luftuar kundër ushtrisë hungareze revolucionare, sipas premtimeve të gënjeshtërtë për autonomi nga administrata e Perandorisë Austriake. Ky rezultoi të ishte një gabim strategjik, meqë revolucioni u shua dhe të dyja grupet ranë nën sundimin e ashpër hungarez pas formimit të monarkisë dualiste austro-hungareze në vitin 1867⁴⁵.

Në fillim të shekullit 19, ekzistonte madje edhe projekti i bashkimit të principatave rumune të Moldavisë, Vllahisë dhe Serbisë. Pas Paqes së Adrianopojës, në vitin 1829, turqit u dobësuan dhe kishte filluar të dominonte ndikimi rus mbi dy principatat rumune. Kjo çoi në përtëritjen e klerit fetar ortodoks, që nisi të ndërmernte projekte politike për bashkimin e popujve ortodoksë kundër pushtetit feudal turk. Nga ana tjetër, Serbia fitoi autonominë e saj nën sundimin osman në vitin 1817, e udhëhequr nga familja Obrenoviç. Ishte në këtë kohë (1839) që Lonte Radu nga Moldavia hartoi planin e tij për të krijuar një shtet tampon konfederativ ortodoks mes të turqve dhe rusëve e që përbëhej nga tri principata. Megjithatë, projekti nuk u mbështet nga fisnikëria në pushtet në të tria subjektet⁴⁶.

Më 19 prill 1841, principata serbe vendosi marrëdhënie zyrtare diplomatike me Principatën e Vllahisë⁴⁷. Kjo erdhi si rezultat i marrëdhënieve të mira mes dy vendeve gjatë protektoratit rus (1829-1856), pavarësisht nga vazhdimi i pushtetit feudal turk.

44 Po aty, fq. 136-139

45 Maria Bulgaru, *Gândirea iluministă în Moldova: opinii și realități (Mendimi lumnist në Moldavi: Opinione dhe Realitetet)*, Centrul Editorial al Universității de Stat din Moldova, Chișinău, 2001, fq. 147

46 Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë, "Serbi-Rumani, marrëdhëniet bilaterale politike" në http://www.mfa.gov.rs/Policy/Bilaterala/Romania/basic_e.html, e qasur më 24 janar 2010.

47 Vasile Petrișor, Vasile Niculae, *Românii în lupta pentru cucerirea independenței de stat (Romakët në luftën për pushtimin e plotë të pavarësisë shtetërore)*, Editura Politică, București, 1987, fq. 14, 18-19, 198

Marrëdhëniet diplomatike u konfirmuan pas bashkimit të Vllahisë dhe Moldavisë në vitin 1859 dhe themelimit të shtetit modern rumun (1862).

Gjatë Luftës Ruso-Turke të viteve 1875-1878, këto dy vende ishin përsëri aleatë, së bashku me rusët, në mënyrë që të fitonin pavarësinë e tyre të plotë nga Pernadoria Osmane. Kjo u arrit përfundimisht me Traktatin e Shën Stefanit dhe Konferencës së Berlinit (1878), që ua dha atyre këtë status⁴⁸. Nga ky çast, Serbia u bë aleat zyrtar i Rusisë në Ballkan, ndërsa Rumania nënshkroi aleancën me Fuqitë Qendrore (Austro-Hungaria, Gjermania dhe Italia).

Në vitin 1914, kur Serbia u sulmua nga Austro-Hungaria dhe filloi Lufta e Parë Botërore, Rumania, përkundër aleancës së saj me Fuqitë Qendrore, mbajti qëndrim neutral, siç bëri edhe Italia. Në vitin 1916, si rezultat i përpjekjeve diplomatike të marrëveshjes së mirëkuptimit, që premtonte mbështetjen e bashkimit të Transilvanisë me Rumaninë, trupat rumune hynë në luftë kundër Austro-Hungarisë, Gjermanisë dhe aleatëve të tyre⁴⁹. Serbia tanimë ishte pushtuar dhe mposhtur në këtë pikë. Pas një humbjeje me jehonë të ngjashme në vitet 1916-1917, në vitin 1918 Rumania u gjet së bashku me Serbinë në anën fituese, për shkak të rënies së Fuqive Qendrore në kuadrin e përpjekjeve të përbashkëta të Francës, Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara, Italisë dhe aleatëve të tyre. Pas këtyre ngjarjeve, trupat serbe dhe rumune u mobilizuan sërish dhe pushtuan Transilvaninë dhe Banatin. Në vitin 1919, së bashku me trupat frënge dhe çeko-slllovaqe, ata kontribuan thelbësisht për rrëzimin e Republikës sovjetike Hungareze të Bela Kun-it⁵⁰.

Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë ndërmjet Rumanisë dhe Mbretërisë së sapokrijuar të serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, u vërtetuan në vitin 1921 me arritjen e marrëveshjes së përbashkët për caktimin e kufirit ndërmjet dy vendeve në Banat. Marrëveshja, e nënshkruar nga kryeministri rumun Take Ionescu dhe kryeministri serb Nikola Pashiç, gjithashtu përfshiu edhe marrëveshjen e parë, të asaj që u bë një Aleancë e Vogël, një organizatë politike e përbërë nga Rumania, Jugosllavia dhe Çekosllovakia, për të frenuar rishikimin hungarez⁵¹. Ky subjekt i ri politik u mbështet gjithashtu edhe nga Franca, që u përpoq të krijonte aleancë ndërmjet vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore kundër rishikimit gjerman.

48 Comisia Română de Istorie Militară (Romanian Commission for Military History), *Istoria militară a poporului român* (Historia ushtarake e popullit romak), vëll. V, Editura Militară, București, 1988, fq. 347

49 Valeriu-Florin Dobrinescu, "Tratatul de la Trianon" ("Traktati i Trianonit"), në Gheorghe Nicolescu (koord.), *România în ecuația păcii și dictatului* (Rumania në ekuacionin e paqes dhe diktateve), Editura Paralela 45, Pitești, 2001, fq. 133-134, 142-148.

50 Eliza Campus, *Mica Înțelegere* (The Little Entente), Editura Academiei Române, București, 1997, fq. 55-59, 64-65

51 *Po aty*, fq. 190, 192

Një tjetër shenjë e marrëdhënieve të mira mes dy vendeve në periudhën e luftërave ishte themelimi i Bllokut Ballkanik në vitin 1924. Kjo nismë, përveç Rumanisë dhe Jugosllavisë, mbledhi po ashtu edhe Greqinë e Turqinë. Në vitin 1934, kjo u zhvillua në Paktin e Ballkanit, që kishte për synim ruajtjen e stabilitetit rajonal, si dhe përfshirjen e vendeve rishikuese, siç ishin Bullgaria dhe Shqipëria. Megjithatë, nuk ia doli t'i bënte të gjitha këto dhe në vitin 1940 ajo u shpërbë, pas dështimit për të vepruar pas shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore⁵². Megjithatë, pas pushtimit të Jugosllavisë nga trupat gjermane, Rumania nuk pranoi që Banati t'u jepej serbëve. Duhet thënë se pas demarkacionit të kufirit në vitin 1921, 37.000 serbë etnikë mbetën në Rumani dhe 66.000 rumunë etnikë mbetën në Serbi⁵³.

Pas vitit 1948, marrëdhëniet midis Rumanisë dhe Jugosllavisë u përmirësuan përsëri, meqë të dy vendet udhëhiqeshin nga regjimet komuniste. Në të njëjtën kohë, të dy vendet kishin raporte të ftohta me Bashkimin Sovjetik dhe epërsinë e tij brenda kampit komunist: Jugosllavia e Titos synonte të bëhej udhëheqëse e lëvizjes së të painkuadruarve dhe Rumania nuk e përballonte humbjen e Besarabisë dhe pushtimin sovjetik⁵⁴. Si rrjedhim kemi përmirësimin e qëndrueshëm të marrëdhënieve bilaterale gjatë viteve '50, '60 dhe '70. Gjatë viteve '80 pasoi një periudhë marrëdhëniesh të ftohta mes dy vendeve për shkak të regjimit të diktaturës komuniste që i priu Rumanisë dhe rritjes së emigracionit në Perëndim, duke shfrytëzuar Jugosllavinë si një vend tranzit. Marrëdhëniet e mira të Beogradit me Perëndimin u panë me shumë zili nga Bukureshti, po ashtu edhe gjendja e mirë ekonomike e komunizmit ndryshe, më liberal dhe i orientuar nga tregu.

Pas rënies së komunizmit në Europën Qendrore dhe Lindore në vitin 1989, marrëdhëniet ndërmjet Bukureshtit dhe Beogradit sërish u përmirësuan, pavarësisht luftërave të Ballkanit dhe pasojave të tyre (duke përfshirë bllokimin e Danubit si linjë qendrore e transportit drejt Perëndimit). Qeveria e krahut të majtë e Rumanisë mbështeti Slllobodan Millosheviçin deri më 1996; edhe pse ka pasur embargo ekonomike të vendosur kundër Jugosllavisë, trenat rumunë të ngarkuar me karburante i transportonin ato fshehurazi në Serbi, çka u quajt 'afëra Jimbolia' (sipas emrit të qytetit kufitar rumun, ku trenat e lënë vendin) e që nuk është qartësuar as në ditët e sotme⁵⁵.

Pas ndryshimit të qeverisë rumune në vitin 1996 dhe ngritjes së një koalicioni të qendrës së djathtë në Bukuresht, Slllobodan Millosheviçi filloi të shihej si diktator

52 Muntean, vep. cit., fq. 234

53 Jean-Francois Soulet, *Istoria comparatë a statelor comuniste: din 1945 până în zilele noastre (Historia krahasimtare e shteteve komuniste nga 1945 deri në ditët e sotme)*, Polirom. Iași, 1998, fq. 80-81

54 Marius Oprea, „Operațiunea Banat” (“The Banat Operation”) in *Ziua*, joi, 3 martie 2005, <http://www.ziua.net/prt.php?id=170836&data=2005-03-03>, e qasur më 24 janar 2010

55 John Cherian, “Aarrestimi i Millosheviqit” në linjën e parë të frontit, Vëllimi 18 – Çështja 08, prill. 14 - 27, 2001, Nju Delhi, <http://www.hinduonnet.com/fline/fl1808/18080520.htm>, e qasur më 24 janar 2010

dhe opozita serbe mbështetej për të marrë pushtetin. Pas lejimit të trupave të NATO-s për shfrytëzimin e objekteve ushtarake në mënyrë që të bombardohet Jugosllavia e Millosheviçit në vitin 1999 (në përpjekje për të marrë anëtarësimin në NATO dhe për t'iu shmangur izolimit si aleate e Rusisë), përpjekjet e Rumanisë për të fuqizuar opozitën serbe u shtuan dhe nga viti 2000 ajo u ndodh mes trysnisë së madhe ndërkombëtar⁵⁶. Pas këtij momenti, Rumania u bë mbështetëse e vazhdueshme e integritetit të Serbisë dhe kandidaturës së saj për pranim në BE.

Rumania dhe Kosova – momente dhe qëndrime historike

Rumania nuk ka pasur ndonjë qëndrim zyrtar ndaj Kosovës deri në vitin 1998. Gjithmonë e ka konsideruar atë si çështje shqetësuese e brendshme për Serbinë dhe nuk ka ndërhyrë kurrë. Megjithatë, në vitin 1998, si rezultat i zhvillimeve në lidhje me konfliktin që u dënua nga komuniteti ndërkombëtarë, Rumania iu bashkua korit të përgjithshëm të kritikëve ndaj regjimit të Slllobodan Millosheviçit. U tha se qeveria serbe e kishte abuzuar pushtetin e saj në trajtimin e pakicës shqiptare dhe u kërkua trajtim i drejtë.

Në mars të vitit 1999, Rumania përballej me një vendim të vështirë: ta mbështeste fushatën e bombardimeve të NATO-s në Jugosllavi apo jo? Administrata rumune ishte e vetëdijshme se ndërhyrja ushtarake nuk do të ishte pa rreziqe dhe se popullata civile gjendej në rrezik të madh. Në të njëjtën kohë, si një fqinj i mirë, ajo nuk mund të merrte pjesë në një akt agresioni kundër Serbisë. Megjithatë, që nga viti 1997, Rumania ka qenë vend kandidat për anëtarësim në NATO. Të gjitha forcat politike të vendit (madje edhe nacionalistët) në vitin 1995 kishin nënshkruar Deklaratën e ashtuquajtur *Snagov*, që kishte përcaktuar objektivat strategjike të vendit: integrimin në NATO dhe BE. Në vitin 1997, administrata e sapothemeluar e Bukureshtit kishte shpresuar se, në çastet e fundit, ajo do të përfshihej në valën e parë të zgjerimit të NATO-s. Për këtë qëllim, në fillim të vitit u krijua një partneritet strategjik me Francën, e cila u bë një përkrahëse e fuqishme e këtij rasti. Megjithatë, Shtetet e Bashkuara mendonin se vetëm tri shtete të Europës Qendrore dhe Lindore ishin të përgatitura për t'iu bashkuar NATO-s (Polonia, Republika Çeke dhe Hungaria), ndërsa Konferenca e Madridit e vulosi këtë vendim⁵⁷.

Prandaj, në vitin 1999, Rumania ishte në procesin e pranimit të saj nga administrata e ShBA-ve për valën e ardhshme të zgjerimit. Për këtë qëllim ajo kishte përkrahur të gjitha veprimet e ShBA-ve në Ballkan dhe në zonat e Detit të Zi; ky ishte rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes për Partneritet Strategjik me ShBA-të në fund të vitit 1997. Në vitin 2000, duke ndjekur modelin e Grupit të Vishegradit, Rumania, së

56 NATO, "Korrik 1997", Azhurnimi i NATO-s në <http://www.nato.int/docu/update/1997/9707e.htm>, e qasur më 25 janar 2010

57 Ministria e Punëve të Jashtme e Letonisë, "Grupi Vilnius" në <http://www.am.gov.lv/en/security/4494/4509/>, qasur më 25 janar 2010.

bashku me shtetet tjera në Europën Lindore dhe Qendrore (Shqipërinë, Bullgarinë, Kroacinë, Estoninë, Letoninë, Lituaninë, Maqedoninë, Sllovakinë dhe Slloveninë) themeluan Grupin Vilnius. Kjo kishte për qëllim krijimin e platformës së përbashkët për integrimin e këtyre shteteve në NATO⁵⁸.

Në këtë kontekst, kur NATO-ja ndërhyri në Jugosllavi, në mars të vitit 1999, administrata rumune vendosi të ofronte hapësirën ajrore të aeroportit të saj për trupat e NATO-s. Kërkesa e njëjtë nga Rusia, si kundërpeshë në favor të regjimit të Millosheviçit, u mohua. Në të njëjtën kohë, aeroporti i Temishvarit iu ofrua kompanive ajrore civile të Jugosllavisë për të shoqëruar aeroplanët e tjerë gjatë sulmeve ajrore⁵⁹. Pavarësisht nga akuzat e Beogradit se Rumania në fakt po mbështeste një sulm ndaj territorit të saj, disa aeroplanë të JAT-it (kompania ajrore kombëtare jugosllave) ateronin në Timisoara, ku e ndanin pistën me aeroplanët ushtarak të NATO-s. Njëkohësisht, qeveria rumune pranoi të priste 100 refugjatë shqiptarë të Kosovës, të ardhur nga kampet e refugjatëve në Maqedoni. Të gjithë, përveç një refugjati të vetëm, janë kthyer në Kosovë⁶⁰. Ishte e kufizuar edhe ndihma humanitare me anë të asistencës private nga një projekt *World Vision Rumania* dhe 12 firmave rumune dhe US Aid-it në Mitrovicë. Kjo nismë u përpoq pa sukses edhe për fillimin e marrëdhënieve tregtare mes Rumanisë dhe të Kosovës, por nuk arriti ta bënte këtë në mënyrë të mirëfilltë.

Vendimi i qeverisë rumune për të mbështetur ndërhyrjen e NATO-s në Jugosllavi nuk ishte shumë i mirëpritur mes qytetarëve rumunë. Botëkuptimi i përbashkët ishte që Jugosllavia kishte qenë për një kohë të gjatë një mik i ngushtë i Rumanisë dhe nuk do të duhej ta sulmonte në asnjë rrethanë. Sidomos në Banat, ku jeton pakica serbe, ndjenjat kundër NATO-s vetëm se shtoheshin. Më së shumti për të inkurajuar pikëpamjet e të dy palëve në media, operatorët televizivë kabllorë në Rumani, në kanalet e rregullta si CNN dhe EuroNews, futën kanalin televiziv publik serb, RTS-në. Një fakt tjetër negativ ishte se urat mbi lumin Danub u bombarduan në Serbi dhe trafiku u bllokua përsëri, duke shkaktuar probleme tregtare në Rumani. Mediat rumune e pasqyruan shumë negativisht këtë lajm, që filloi të shihej si më i rëndësishëm se represioni kundër shqiptarëve etnikë në Kosovë⁶¹.

58 Tom Gallagher, "Rumania, NATO dhe Kosova: Instiktet e dhura, taktikat e gabuara" në *Politica Externă*, 3(7-8) 1999-2000, fq. 84-95

59 Enciklopedia e kombeve, "Rumania - Migrimi" në <http://www.nationsencyclopedia.com/Europe/Romania-MIGRATION.html>, e qasur më 26 shtator 2011.

60 Euractiv, „Jandarmii romani - suspectati ca au ucis doi albanezi in Kosovo” ("Xhandarët rumunë dyshohet të kenë vrrarë dy shqiptarë të Kosovës"), 15 shkurt 2007 në http://www.euractiv.ro/uniunea-europeana/articles%7CdisplayArticle/articleID_9438/jandarmii-romani-suspectati-ca-au-ucis-doi-albanezi-in-Kosovo.html.

61 Dănuț-Radu Săgeată, Dragoș-Mihail Baroiu, *Granițele de stat ale României - între tratatele internaționale și dictatele de forță* (Kufinjët shtetërorë të Rumanisë - ndërmjet traktateve ndërkombëtare dhe diktateve të detyruara), Iași, Princeps Edit, 2004, fq. 98.

Duke iu shtuar problemeve tjera ekonomike dhe sociale në vend gjatë vitit 1999, mund të thuhet se vendimi i qeverisë rumune për mbështetjen e sulmeve ajrore të NATO-s mbi Jugosllavinë, ndihmoi në një masë të konsiderueshme që të binte koalicioni i qendrës së djathtë në pushtet në Rumani dhe të ngjiteshin nacionalistët. Në fakt, midis forcave kryesore politike ishte Partia e Rumanisë së Madhe, nacionaliste, që kishte pozitë më të shumtë proserbe. Gjatë vitit 2000, zgjedhjet legislative e trefishuan përqindjen e saj (nga 7% në 21%) dhe kandidati i saj, Corneliu Vadim Tudor, shkoi në raundin e dytë të zgjedhjeve kundër kandidatit të opozitës socialdemokrate, Ion Iliescu. Për socialdemokratët, pozicioni i tyre ishte neutral: dënuan sulmet ajrore të NATO-s, por edhe kundërshtuan krimet serbe në Kosovë. Është për t'u habitur se asnjë nga forcat mbështetëse të goditjeve ajrore të NATO-s nuk arritën të merrnin ndonjë rezultat përmbajtësor në zgjedhje: Partia Demokratike mori gjysmën e rezultatit të vitit 1996 (vetëm 8%), Partia Kombëtare Liberale mori vetëm 7% dhe Konventa Demokratike Rumune, forca kryesore qeveritare, pësoi rënie të gjashtëfishit në përqindjen e saj (në vetëm 5%) dhe mbeti jashtë Parlamentit (ajo kishte nevojë për 10%, duke qenë një aleancë). Kryesuesi i radhës refuzoi të qëndronte për një mandat të dytë, duke e marrë parasysh që popullariteti i tij ishte tmerrësisht i ulët (nën 10%).

Pas ndërhyrjes në vitin 1999, Rumania dërgoi trupa paqeruajtëse në Kosovë (78 policë dhe pastaj 115 pjesëtarë të xhandarmërisë) - pothuajse si në rastin e Bosnjës gjatë viteve të hershme '90, nën patronazhin e administratës së Kombeve të Bashkuara - Misioni i Përkohshëm në Kosovë (UNMIK), e pastaj i integruar në EULEX. Mbështetja e tyre erdhi kryesisht në zonat e banuara nga serbët, ku ata ishin pranuar si mbrojtës. Kurse popullata shqiptare i konsideronte ata forca pushtuese, besnike ndaj autoriteteve serbe. Gjatë disa demonstratave të dhunshme në vitin 2006, disa shqiptarë u lënduan dhe dy u vranë pas ndërhyrjes së policisë rumune⁶².

Madje edhe sot, pjesa dërmuese e opinionit publik në Rumani është kundër pavarësisë së Kosovës. Ky qëndrim u vërtetua nga qëndrimi i fuqishëm i presidentit dhe i Parlamentit kundër këtij akti në vitin 2008; vetëm Bashkimi Demokratik Hungarez ka qenë në favor. Për më tepër, autoritetet rumune ndërmorën veprime ligjore kundër vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë⁶³. Megjithatë, kjo çështje nuk renditet në prioritetet e agjendës së qytetarëve rumunë edhe për shkak të krizës ekonomike të viteve të fundit.

Megjithatë, përveç argumenteve ligjore duhet të marrim parasysh disa arsye të thella historike për këtë qëndrim. Njëra prej arsyeve, që kujtohet aktualisht, është

62 Grigore Gafencu, Hyrja në fushatën ruse: nga Pakti i Moskës (21 gusht 1939) deri në fillimin e armiqësisë në Rusi (22 qershor 1941), Frederick Muller, Londër, 1945, fq. 268-269, 28.

63 Gheorghe Zaharia, Constantin Botoran, *Politica de apărare națională a Românie în contextul european interbelic (1919-1939)* (Politikat për mbrojtje kombëtare e Rumanisë në kontekstin politik ndërmjet luftërave, 1919-1939), Editura Militară, București, 1981, fq. 277.

ekzistenca e një pakice së konsiderueshme hungareze në Transilvani. Historikisht, ajo ka qenë pjesë e Rumanisë pas shpërbërjes së Austro-Hungarisë në vitin 1918. Para kësaj, për dhjetë shekuj, hungarezët ishin popullsia dominuese në atë rajon dhe pjesë e mbretërisë historike hungareze. Nga viti 1948 deri në vitin 1968, hungarezët nga Transilvania Lindore, të quajtur seklerë, kanë përfituar nga autonomia në atë që quhej Rajoni Autonom Mures Hungarez⁶⁴. Kjo ishte një masë paraprake e autoriteteve komuniste për të parandaluar ngjarje të tilla si ato që u shfaqën gjatë Luftës së Dytë Botërore, kryesisht në vitin 1940.

Viti 1940, është vit simbolikisht shkatërrimtar për Rumaninë. Ishte pas një periudhe kur shteti rumun kishte arritur shtrirjen e tij territoriale maksimale, si pasojë e Luftës së Parë Botërore. Në vitin 1919, Rumania dyfishoi sipërfaqen e saj duke fituar Transilvaninë dhe Banatin nga Hungaria, Bukovinën nga Austria dhe Besarabinë nga një luftë civile e Rusisë. Ajo gjithashtu kishte marrë Dobrujën Jugore nga Bullgaria në vitin 1913. Në të gjitha këto rajone, rumunët u bënë popullsia më e favorizuar nën ndikimin dominues të nacionalistëve të asaj kohe, kurse ish pakicat, të tilla si hungarezët, ukrainasit, bullgarët dhe hebrenjtë e humbën nderin. Megjithatë, lëvizja u mbështet nga Franca dhe Britania e Madhe, dy nga fuqitë fituese së të ashtuquajturës “Lufta e Madhe”.

Në vitin 1940, si rezultat i epërsisë gjermane, italiane dhe sovjetike në kontinent, si dhe mposhtjes së francezëve dhe tërheqjes britanike, situata ndryshoi në mënyrë dramatike për Rumaninë. Kur Pakti Ribbentrop-Molotov u nënshkrua në vitin 1939, pak para shpërthimit të luftës, Bashkimi Sovjetik i ishte atribuuar Besarabisë, ndërsa pjesa tjetër e Rumanisë mbeti në sferën e influencës gjermane ⁶⁵. Kështu, më 26 qershor 1940, Bashkimi Sovjetik i adresoi një ultimatum Rumanisë për të dorëzuar këtë territor si dhe veriun e Bukovinës, duke kërcënuar me ndërhyrje ushtarake. Duke qenë të izoluar nga ish-aleatët e tyre, autoritetet rumune vendosën të pranonin fatin e tyre dhe t’ia dorëzonin territorin Bashkimit Sovjetik. Në këtë proces të shpejtë, 356 policë rumunë dhe 42.876 ushtarë janë vrarë nga Ushtria e Kuqe, të ndihmuar nga popullsia vendase ukrainase dhe hebraike ⁶⁶. Në vitin 1941, trupat rumune u kthyen si aleatë gjermanë kundër Bashkimit Sovjetik dhe u hakmorën te grupet e pakicave përkatëse. Megjithatë, pas viti 1944, Rumanisë iu desh të tërhiqej sërish dhe për herë të fundit, pasi sovjetikët e fituan luftën. Megjithatë, rumunët asnjëherë nuk kanë harruar se rusët i detyruan të largoheshin nga një ish-krahinë ku ata ishin (dhe disa e konsiderojnë se ende janë) popullsi në shumicë.

Ndërkohë, qeveria hungareze zhvilloi marrëdhënie të ngushta me Gjermaninë naziste dhe Italinë fashiste. Në vitin 1939, Budapesti mori pjesë në ndarjen e Çekosllovakisë, duke marrë pjesën jugore të Sllovakisë dhe rajonin e përtej Karpateve. Rumania refuzoi të merrte pjesë në këtë, sepse ajo ishte aleat i ngushtë i Çekosllovakisë ⁶⁷. Më 30 gusht

64 Gheorghe I. Bodea, Vasile T. Suci, Ilie I. Pușcaș, *Administrația militară horthystă în nord-vestul României (Administrata ushtarake horthiste në Rumaninë Veriperëndimore)*, Editura Dacia, Cluj-Napoca, 1988, fq. 65.
65 Po aty, fq. 138.

1940, u organizua Çmimi i dytë i Vjenës nga gjermanët dhe italianët për të zgjidhur çështjet mes dy aleatëve të tyre: Rumanisë dhe Hungarisë. Me këtë rast, hungarezët morën pjesën veriore të Transilvanisë, ku jetonin shumica e pakicës hungareze (1 milion banorë), por duke përfshirë 1.2 milion rumunë⁶⁶. Pas kësaj ngjarjeje, rreth 200.000 rumunë u detyruan të strehoheshin në pjesën tjetër të Rumanisë dhe 300.000 hungarezë ishin kolonizuar për t'i zëvendësuar ata⁶⁷. Rumania u detyrua ta pranonte këtë situatë deri në vitin 1944. Pasi trupat sovjetike përparuan deri në verilindje të vendit, Rumania u dorëzua dhe, së bashku me Ushtrinë e Kuqe, rimori pjesën veriore të Transilvanisë. Situata e këtij rajoni që para vitit 1940 u rikonfirmua nga traktatet e paqes së vitit 1947. Megjithatë, kujtimi i këtyre ngjarjeve ka ndikuar për dekadën e fundit në marrëdhëniet ndërmjet rumunëve dhe hungarezëve në Transilvani.

Por fundi i vitit 1940 nuk ishte vetëm me Çmimin e Vjenës. Më 7 shtator 1940, Bullgaria dhe Rumania u detyruan nga Gjermania që të nënshkruanin një traktat kufitar në Kraiovë. Rumania ktheu Dobrujën Jugore dhe 110.000 rumunë etnikë dhe vllahë, të cilët kishin qenë të kolonizuar atje që nga viti 1913 dhe u larguan nga shtëpitë e tyre. Në të njëjtën kohë, 77.000 bullgarë etnikë nga pjesa veriore e Dobrujës u zhvendosën në anën bullgare të provincës⁶⁸. Situata ishte e njohur pas traktateve të luftës. Megjithatë, kujtimi i 1940-ës dhe humbjet territoriale rikujtohen gjithnjë në Rumani.

Ashtu si Rumania në vitin 1940, edhe Serbia u përball me një proces të ngjashëm, por gradual, pas themelimit të saj më 1919. Dallimi kryesor ishte se, pas vitit 1945, ajo ishte bërë një shtet federal, ku shumë kombësi jetonin krah për krah. Megjithatë, pas vitit 1989 dhe pas rënies së komunizmit, u rishfaqën ndjenjat nacionaliste brenda Jugosllavisë dhe rifilloi lufta. Beogradi vuri në dukje rëniet në territorin e saj për çdo vit: në vitin 1991, Kroacia dhe Sllovenia deklaruan pavarësinë e tyre dhe u njohën nga Perëndimi. Në vitin 1992, Bosnja dhe Hercegovina shpalli pavarësinë dhe lufta në mes myslimanëve, serbëve dhe kroatëve zgjati për tre vjet. Pas Marrëveshjes së Dejtonit të vitit 1995, Beogradi tërhoqi trupat dhe u detyrua të pranonte situatën e dominuar nga ndërhyrja amerikane dhe vendosjen e trupave të NATO-s. Ndërkohë, në vitin 1993, Maqedonia u nda në mënyrë paqësore nga federata dhe u bë shtet i pavarur.

Pasi që u vendosën trupat e NATO-s në Kosovë, pas ndërhyrjes ushtarake të vitit 1999, serbët e panë territorin e tyre duke u zvogëluar edhe më shumë me pavarësinë e Malit të Zi në vitin 2006. Në një periudhë prej 15 vjetësh, federata jugosllave u shpërbë tërësisht, gjë që, tre dekada më parë, dukej pothuajse e pamundur për shumicën e njerëzve. Ky ishte rezultat i një politike të mangët nacionaliste të zbatuar nga autoritetet e ish Jugosllavisë pas vdekjes së Titos. Ajo kishte dominim serb (si më i madhi midis kombeve përbërëse), duke nxitur një proces veprimesh reaktive

66 Theodore I. Geshkoff, *Balkan Union: A Road to Peace in Southeastern Europe*, Columbia University Press, New York, 1940, fq. 57.

nga kombet e tjera. Ky gabim është paguar plotësisht nga serbët, të cilët u reduktuan në një territor minimal, me shumë pakica të konsiderueshme serbe të mbetura në shtetet e reja të pavarura. Ky është një shembull se si politikanët nuk duhet të sillen, në mënyrë që të mos humbasin çdo gjë (Millosheviçi përfundimisht vdiq në burg në Hagë, më 11 mars 2006).

Në këto kohë të vështira, Rumania kuptoi (nga përvoja e saj) se Serbia duhej të mbështetej të paktën nga aleatët e saj të mëparshëm dhe nuk zgjodhi ta njihte Kosovën si një shtet të pavarur, si dhe mbrojti integritetin territorial të Serbisë. Edhe në qoftë se gjatë 20 viteve të fundit kishte zgjedhur një qasje të ndryshme ndaj pakicave etnike, Rumania nuk e mbështeti ndarjen mbi baza etnike. Modelin e vet të bashkëjetesës etnike e kishte bazuar në dhënien e të drejtave të plota pakicave kombëtare në shtetin e origjinës, të paktën pas vitit 1996. Kështu, në Parlamentin rumun, në kuadër të Dhomës së Deputetëve, 18 vende janë të ndara për përfaqësuesit e pakicave kombëtare. Për më tepër, që nga viti 1996, Bashkimi Demokratik Hungarez ka marrë pjesë ose ka përkrahur pothuajse të gjitha qeveritë. Ajo arriti të merrte poste udhëheqëse në qeveri (deri në nivelin e ministrisë dhe postin e zëvendëskryeministrit), si dhe në nivel të administratës lokale, ku popullsia hungareze është e përfaqësuar nga hungarezë etnikë dhe mund ta përdorin gjuhën e tyre amtare në të gjitha nivelet.

Po kështu edhe në Serbisë, me përjashtim të Vojvodinës, çështje kjo ku nevojitet përmirësim i domosdoshëm. Kjo po ashtu ka të bëjë me 40.000 vllahët që jetojnë në Luginën e Timokut, të cilët që vuajnë nga një proces i asimilimit të dhunshëm nga serbët ⁶⁷. Në Kosovë, situata është përmirësuar, ndonëse serbët nuk marrin pjesë në praktikë për vendosjen e rendit kushtetues. Kushtetuta e re serbe ishte një hap përpara, por ajo po ashtu erdhi shumë vonë, kur ndoshta momenti pa kthim tashmë vetëm kishte kaluar nga të dy palët: serbët dhe shqiptarët e Kosovës.

Qëndrimi aktual i Rumanisë ndaj Kosovës

Pavarësisht nga statusi i saj si anëtare e BE-së dhe NATO-s, Rumania zgjodhi të mos e njihte Kosovën, edhe në qoftë se pozicioni i saj mbështetet vetëm nga një pakicë e shteteve anëtare të BE-së. Megjithatë, ndryshe nga shtetet e tjera që nuk e njohin Kosovën (të tilla si Rusia apo Kina), Rumania ka një zyrë ndërlidhëse në Prishtinë, e cila ndërlidhet ngushtë me pjesëmarrjen e saj në EULEX.

Rumania ka zgjedhur ta mbrojë një pozicion që është në përputhje me politikën e saj kombëtare si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Brenda vendit, Rumania kundërshton

67 9 AM, „Vlahii din Timoc refuză să renunțe la graiul românesc” („The Timok Vlachs refuse to give up their Romanian mother tongue”) in 9AM, 17 martie 2007, <http://www.9am.ro/stiri-revista-presei/2007-03-27/vlahii-din-timoc-refuza-sa-renunte-la-graiul-romanesc.html>, e qasur më 25 janar 2010.

formimin e shteteve etnike duke promovuar një lloj të nacionalitetit qytetar, duke përfshirë të gjitha pakicat etnike. Kjo parashikon që, të gjithë njerëzit që jetojnë në një shtet, të kenë të drejta të barabarta, pavarësisht nga origjina etnike dhe se çdo zhvillim i veçantë i një grupi pengon zhvillimin koherent të shtetit si tërësi. Për këtë qëllim, autoritetet rumune vazhdojnë të refuzojnë autonomi territoriale sipas parimit etnik, vendim që po ashtu mbështetet nga disa liderë radikalë të Bashkimit Demokratik Hungarez.

Jashtë vendit, që nga viti 1955 dhe pas pranimit të saj në Kombet e Bashkuara, Rumania ka mbështetur parimin e paprekshmërisë së kufijve që u krijuan pas vitit 1945. Ky parim u forcua në nivel evropian me miratimin e Aktit Final të Helsinkit në vitin 1975 dhe është parë si e vetmja mënyrë për të parandaluar çdo dukuri të luftërave ndërshtetërore në kontinentin evropian. Ajo gjithashtu përfshiu disa nga vendimet e marra me rastin e Traktatit të Versajës (1919-1920), që ishte bazë e ekzistencës së shtetit rumun aktual brenda kufijve të vet, të pranuar dhe të mbështetur bashkërisht për një kohë të gjatë nga Bukureshti dhe Beogradi (përkundër me Sofjen, Tiranën dhe Budapestin, që ishin kryeqytete revizioniste në periudhën e luftërave). Një përjashtim nga kjo ishte pranimi i ndarjes në mes të shteteve që përbënin federatë, të tilla si Bashkimi Sovjetik, Çekosllovakia dhe Jugosllavia (ndërmjet republikave përbërëse). Në rastin e Kosovës, statusi zyrtar maksimal gjatë ekzistencës së saj kishte qenë në nivelin e rajonit autonom brenda Serbisë. Prandaj, ndërkombëtarisht, Rumania nuk mund ta mbështesë këtë status dhe u mbetet besnike parimeve që ka miratuar më parë.

Mund të argumentohet se çdo popull ka të drejtë për vetëvendosje, sipas nenit 1 (2) të Kartës së OKB-së³³. Megjithatë, ky artikull nuk mund të interpretohet, por duke marrë parasysh që neni 2 (7), i cili siguron se *asgjë që përmban kjo Kartë nuk autorizon Kombet e Bashkuara për të ndërhyrë në çështjet që janë, në thelb, nën juridiksionin e brendshëm të çdo shteti ose anëtarët do të kërkojnë të paraqesin çështje të tilla për zgjidhje në bazë të kësaj Karte dhe përbën një bazë për të drejtën ndërkombëtare midis vendeve. Rumania konsideron se çdo shkelje (ose interpretimi sui generis) për sovranitetin e vendeve demokratike mund të kërcënojë tërë vendosjen paqësore aktualisht ekzistuese në të gjithë botën, duke krijuar bazën për ndërhyrje arbitrare nga shtetet më të forta mbi ato të dobëta dhe anulimin e të gjitha zhvillimeve pozitive që nga viti 1945 . Në fakt, kanë ndodhur ngjarje të tilla në formën e ndërhyrjes së paligjshme të Rusisë mbi pjesët sovrane të Gjeorgjisë, duke përdorur rastin e Kosovës si precedent. Në raste të tilla, interesi kombëtar i Rumanisë është përcaktuesi i fundit i qëndrimit të vendit drejt subjekteve të tjera ndërkombëtare. Nga frika e një kërcënimi për sovranitetin e vet, Rumania ka zgjedhur të mos e njohë Kosovën dhe në vend të kësaj favorizon një ruajtje të *status-quo ante*. Vetëm historia do të tregojë nëse ky ishte vendim i drejtë, por në çdo rast, duke marrë parasysh përvojat e kaluara, mund të arrihet në përfundimin se ishte vendim logjik.*

Rekomandime

Rekomandimi zyrtar i shtetit rumun lidhur me shtetin e Kosovës është se çështja duhet të zgjidhet nga bisedimet e drejtpërdrejta me Beogradin. Meqë është një çështje shumë komplekse, këtë rekomandim është e vështirë për ta ndjekur në praktikë. Megjithatë, ka edhe mjete të tjera për të tejkaluar hapësirën e komunikimit dhe këto mund të gjenden në nivelin e shoqërisë civile.

Një nga mjetet e komunikimit në nivel të shoqërisë civile është përfshirja e përfaqësuesve nga Rumania dhe Kosova në grupe të përbashkëta rajonale. Gjatë viteve të fundit, ka pasur disa nisma të tilla të nxitura nga organizata të ndryshme ndërkombëtare. Ne mund të përmendim këtu Qendrën e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), iniciativën e quajtur *Rrjeti i Fytyrave të Reja*, që u zhvillua në periudhën 2005-2010. Një tjetër iniciativë në vitin 2006 ishin seritë *Mozaiku i Ballkanit*, seminare në lidhje me strategjinë rajonale të sigurimit, që u mbështet nga Shoqata e Traktatit të Atlantikut (ATA) dhe Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme. Ka pasur gjithashtu një program rajonal të Shkollës Politike Bullgare, të quajtur *Debat i Politik në Europën Juglindore*, që përfshinte në periudhën 2006-2007 pjesëmarrës nga Rumania, së bashku me pjesëmarrës nga të gjitha zonat e Ballkanit (duke përfshirë Kosovën).

Dialogu në nivelin e shoqërisë civile është ndihmuar edhe nga anëtarësimi i Shkollës Europiane “Ovidiu Sincai” dhe Instituti për Studime Politike i Prishtinës (PIPS), në Shoqatën Europiane të Shkollave të Studimeve Politike, një iniciativë e mbështetur nga Këshilli i Europës. Në kuadër të këtij rrjeti, në nëntor të vitit 2009, një delegacion prej katër përfaqësuesve të shkollave rumune morën pjesë në konferencën *Sfidat dhe mundësitë e rajonit të Ballkanit*, që u organizua nga PIPS në Prishtinë.

Një tjetër mundësi komunikimi mes të Kosovës dhe Rumanisë është prania e rëndësishme e pakicës shqiptare dhe studentëve shqiptarë në Rumani. Pakica shqiptare në Rumani përfshin 4.670 banorë, që kryesisht jetojnë në Bukuresht dhe në pjesën jugore të vendit. Ata janë të përfaqësuar në Dhomën e Deputetëve Rumunë nga një anëtar i Lidhjes së Shoqatës së Shqiptarëve të Rumanisë. Qeveria Rumune, gjithashtu çdo vit ofron bursa për shtetasit shqiptarë që vijnë ose kanë paraardhës nga komuniteti vllah i Shqipërisë. Disa prej tyre zgjedhën të qëndronin në Rumani dhe të zhvillojnë lidhje të ngushta me vendin e tyre të origjinës.

Megjithatë, një pikë e rëndësishme e të gjitha diskutimeve vjen në një vështirësi të madhe: pozicionin e Serbisë. Kjo është arsyeja pse, pa iu adresuar lidhjes me Beogradin, çdo përparim i konsiderueshëm në lidhje me Rumaninë do të parandalohet në afat të gjatë. Faji kryesor i të gjitha strategjive të zbatuara deri më tani nga Beogradi dhe

Prishtina ka qenë qasja “shuma-zero”, në të cilën çdo anë dëshiron të arrijë qëllimin e saj mbi anën tjetër. Megjithatë, nuk janë vënë në dukje çështjet që i bashkojnë të dy palët, të tilla si: aspirata për t’u bërë anëtare të BE-së, prosperiteti ekonomik.

Kjo është arsyeja pse një rekomandim i madh, për nga ana e Kosovës, do jetë organizimi i një fushate bashkëpunimi të shoqërisë civile, së bashku me OJQ-të serbe, në mënyrë që të tregojnë se, pavarësisht nga pozicionet shtetërore, njerëzit e zakonshëm të të dyja palëve nuk janë të lindur si armiq dhe se ky imazh jo i plotë është krijuar vetëm nga një qasje historike e njëanshme e realiteteve.

Një tjetër rekomandim do të jetë që asnjë fushatë nuk do të shpalolet nga njëri krah apo një tjetër që përpiqet të injorojnë ekzistencën dhe pozitën e të tjerëve. Duke e pranuar njëri-tjetrin si palë të merituar për diskutim, të dyja palët mund të kapërcejnë pengesat e dialogut dhe të identifikojnë çështjet kryesore kontestuese; pas kësaj ata do të vendosin së bashku nëse këto janë me të vërtetë dallime kontradiktore apo nëse mund të tejkalohen me një kompromis të dobishëm për të dyja palët, në frymën e diplomacisë moderne dhe bashkëkohore.

Së fundi, promovimi agresiv i pozitës së njëres palë kundër tjetrës mund të bëhet një pengesë e madhe për komunikimin e duhur mes të shoqërive civile të të dyja palëve. Duhet të pranojnë se institucionet politike nuk janë instrumente vetëm për komunikim ndypalësh dhe se iniciativat e shoqërisë civile mund të ndihmojnë për tejkalimin e dallimeve. Kur një lidhje pozitive themelohet në nivelin e shoqërisë civile, mund të ketë një të ardhme më të mirë për njohjen e ndërsjellë, të paktën sa u përket pjesëve nga parimet e tjetrit.

Bibliografia

a. Libra

Bodea, Gheorghe I., Suciu, Vasile T., Pușcaș, Ilie I., *Administrația militară horthystă în nord-vestul României (The Horthyst Military Administration in North-West Romania)*, Editura Dacia, Cluj-Napoca, 1988

Bulgaru, Maria, *Gândirea iluministă în Moldova: opinii și realități (Enlightenment Thought in Moldova: Opinions and Realities)*, Centrul Editorial al Universității de Stat din Moldova, Chișinău, 2001

Campus, Eliza, *Mica Înțelegere (The Little Entente)*, Editura Academiei Române, București, 1997

Română de Istorie Militară (Romanian Commission for Military History), *Istoria militară a poporului român (The Military History of the Romanian People)*, vol. V, Editura Militară, București, 1988

Gafencu, Grigore, *Prelude to the Russian campaign: from the Moscow Pact (august 21st 1939) to the opening of hostilities in Russia (June 22nd 1941)*, Frederick Muller, London, 1945

Georgescu, Vlad, *Istoria românilor de la origini până în zilele noastre (History of Romanians from Origins until Our Days)*, Editura Humanitas, București, 1995

Geshkoff, Theodore I., *Balkan Union: A Road to Peace in Southeastern Europe*, Columbia University Press, New York, 1940

Judah, Tim, *The Serbs: history, myth, and the destruction of Yugoslavia*, Yale University Press, London, 2000

Muntean, Vasile V., *Contribuții la istoria Banatului (Contributions to the History of Banat)*, Editura Mitropoliei Banatului, Timișoara, 1990

Nicolescu, Gheorghe (coord.), *România în ecuația păcii și dictatului (Romania in the Equation of Peace and Dictates)*, Editura Paralela 45, Pitești, 2001

Petrișor, Vasile, Niculae, Vasile, *Românii în lupta pentru cucerirea independenței deplină de stat (Romanians in the Fight for Conquering Full State Independence)*, Editura Politică, București, 1987

Săgeată, Dănuț-Radu, Baroiu, Dragoș-Mihail, *Granițele de stat ale României – între tratatele internaționale și dictatele de forță (Romania's State Borders – between International Treaties and Forced Dictates)*, Iași, Princeps Edit, 2004

Soulet, Jean-Francois, *Istoria comparată a statelor comuniste: din 1945 până în zilele noastre* (*The Comparative History of the Communist States from 1945 till Our Days*), Polirom, Iași, 1998

Zaharia, Gheorghe, Botoran, Constantin, *Politica de apărare națională a Românie în contextul european interbelic (1919-1939)* (*Romania's National Defence Policy in the Interwar Political Context, 1919-1939*), Editura Militară, București, 1981

b. Artikuj

Fati, Sabina, „Kosovo: interesul național și propaganda anti-occidentală” (“Kosovo: the national interest and anti-Western propaganda”) in *Sfera Politicii*, 70, 1999, pp. 23-28

Gallagher, Tom, “Romania, NATO and Kosovo: Right Instincts, Wrong Tactics” in *Politica Externă*, 3(7-8) 1999-2000, pp. 84-95

c. Faqe internetit

<http://www.am.gov.lv/>

<http://www.9am.ro/>

<http://www.euractiv.ro/>

<http://www.financiarul.ro/>

<http://www.hinduonnet.com/>

<http://www.mfa.gov.rs/>

<http://www.nationsencyclopedia.com/>

<http://www.nato.int/>

<http://www.romanialibera.ro/>

<http://www.un.org/>

<http://www.ziua.net/>

Greqia

Greqia – Kosova - Një marrëdhënie e ndërlikuar

Autorë⁶⁸:

Dr. Ioannis Armakolas, studiues i lartë në 'Stavros Costopoulos', Fondacioni Helen për Politikë Europiane & të Jashtme (ELIAMEP) & ligjërues, Departamenti i studimeve ballkanike, sllave dhe orientale, Universiteti i Maqedonisë

**Apostolis Karabairis, studiues i ri, Fondacioni Helen për Politikë Europiane & të Jashtme (ELIAMEP)
Tetor 2011**

Hyrje

Që nga kriza e viteve nëntëdhjetë në ish-Federatën Jugosllave dhe si rezultat i fushatës gjithnjë e më kategorike dhe të suksesshme të shqiptarëve të Kosovës për struktura të ndara shoqërore, Kosova është bërë aktore në skenën ndërkombëtare. Në fillim si lëvizje për pavarësi, që fitoi simpatinë dhe mbështetjen ndërkombëtare, më vonë si entitet i administruar nga Kombet e Bashkuara dhe sot si shtet i pavarur, i njohur pjesërisht, Kosova, në secilën prej formave të mësipërme, ka pasur zë në arenën ndërkombëtare.

Edhe Greqia, ndonëse nuk e ka njohur atë, në pajtim me rolin udhëheqës që synon të luajë në rajon, ka zhvilluar marrëdhënie të pavarura me Kosovën. Këto marrëdhënie, që zakonisht lihen në hije nga marrëdhëniet e posaçme greko-serbe, shpesh përshkruhen si të kujdesshme ose marginale. Megjithatë, shqyrtimi nga afër, ashtu siç bëhen përpjeke në këtë punim, hedh dritë në këtë marrëdhënie për të cilën nuk dihet shumë dhe sugjeron se Greqia është e interesuar t'u japë shtysë lidhjeve me Kosovën, së paku po aq sa edhe me pjesën tjetër të fqinjëve ballkanikë.

Ky punim ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të shkurtë të historisë së fundit dhe të gjendjes aktuale në marrëdhëniet ndërmjet Athinës dhe Prishtinës. Ai synon të japë informata lidhur me themelet e kompleksitetit të këtyre marrëdhënieve, si dhe disa informata themelore lidhur me karakteristikat e tyre të ndryshme (politike, institucionale, ekonomike, shoqërore). Punimi është dokument i gjallë dhe u drejtohet komuniteteve dhe studiuesve të politikave, me qëllim që të investojnë më shumë kohë dhe burime për studimin e marrëdhënieve ndërmjet Greqisë dhe Kosovës, të cilat,

68 Autorët dëshirojnë të falënderojnë Theodore Couloubis, Thanos Dokos, Evangelos Kofos dhe Alexandros Mallias për komentet e çmueshme lidhur me draftet e mëparshme të këtij punimi dhe Drejtorinë A3 për çështje ballkanike të Ministrisë greke të Punëve të Jashtme për informatat e dobishme. Është e panevojshme të thuhet se përgjegjës për ndonjë gabim janë vetëm autorët.

përkundër afërsisë gjeografike, ende kanë nevojë të mësojnë për njëra-tjetrën.⁶⁹

PJESA I: Greqia dhe lufta e Kosovës

Greqia, në pajtueshmëri të plotë me politikën fillestare të politikës perëndimore, u përpoq ta parandalonte shkatërrimin e Federatës Jugosllave. Kur, përkundër përpjekjeve ndërkombëtare, vendi filloi të shpërbëhej dhunshëm, zhvillimet ishin një përvojë tronditëse për Greqinë. Shembja e Jugosllavisë ndryshoi ekuilibrin e forcave në Ballkan. Përveç kësaj, gara e elitave për kufijtë nacionalë dhe shfaqja e një shteti të ri që kishte emrin e njëjtë me krahinën e afërt greke, shkaktoi frikë në Greqi, ngaqë edhe ajo do të mund të ndikohej nga vala e rishikimeve. Perceptimet e grekëve lidhur me krizën ballkanike që po zhvillohej në atë kohë, u prishën nga ajo që në atë kohë konsiderohej si përpjekje e diplomacisë turke për të krijuar një hark islamik në Ballkanin e ri. Elitat politike greke morën menjëherë një qëndrim mbrojtës, çka e ngadalësoi përshtatjen me realitetin e ri në Ballkan. Në këtë frymë, Greqia e konsideronte shkatërrimin e Jugosllavisë si kërcënim për stabilitet dhe, si rrjedhojë, në fillim u rreshtua me Beogradin, që në fillim perceptohej si forcë status quo. Me këtë u shtruan themelet për krijimin e mirëkuptimit greko-serb, që në aspektin ndërkombëtar shpesh është perceptuar si aleancë; ky i fundit nuk ishte supozim i paarsyeshëm, edhe pse para së gjithash ishte ekzagjerim, meqë Greqia kurrë nuk i ka kundërshtuar me të vërtetë politikat perëndimore, të krijuara si përgjigje ndaj luftërave në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë.

69 Përveç periudhës së menjëhershme pas luftës më 1999, kur u botuan disa libra për konfliktin e Kosovës, ka një numër studimesh të bëra nga akademikët grekë, të cilët përpiqen të hedhin dritë në fqinjin shumë të panjohur dhe në krizën e Kosovës në tërësi. Shih, për shembull, mes të tjerash, Ιωάννης Αρμακόλας: "Ισλάμ, μειονότητες και πολιτική αστάθεια στην πρώην Γιουγκοσλαβία (Ισλαμιστική τρομοκρατία, καθεστώς Κοσόβου, Σερβία)", **Instituti për Analizë të Mbrojtjes**, raport i pabotuar, 2007; Ιωάννης Αρμακόλας & Θάνος Ντόκος "Εισαγωγή-1999-2009: Τα Βαλκάνια μεταξύ ρευστότητας και σταθεροποίησης" in Ιωάννης Αρμακόλας & Θάνος Ντόκος (eds.), **Από τα Βαλκάνια στη Νοτιοανατολική Ευρώπη: Προκλήσεις και προοπτικές στον 21^ο αιώνα**, Σιδέρης, 2010; Alexis Heraclides: "Konflikti i Kosovës dhe zgjidhja e tij: duke ndjekur fillin e Ariadne", **Dialogu për sigurinë**, Vëll.28, Nr.3, 1997, faqe 317-331; Alexandros Mallias: "Kosova pas Hagës", **ELIAMEP** Thesis 6/2010, nëntor 2010; Παντελής Σκλιας & Φώτης Βλάχος, "Η πρόκληση της επιστροφής: Η επανεγκατάσταση των προσφύγων στο Κόσοβο" in Νικόλαος Τζιφάκης & Αστέρης Χουλιάρας (eds.), **Η διεθνής αναπτυξιακή βοήθεια στα Βαλκάνια - Οι αντιφάσεις της γενναιοδωρίας**, Παπαζήσης, 2007; Δημήτρης Σωτηρόπουλος: "Κόσοβο, 1999-2005: Αδιέξοδα και εναλλακτικές λύσεις", **Αγορά Χωρίς Σύνορα**, Vëll.11, Nr.3, 2006, faqe 243-258; Dimitrios Triantapfyllou (ed.), **Çfarë statusi për Kosovën?**, Chaillot Papers Nr. 50, Instituti për Studime të Sigurisë, 2001; Aristotle Tziampiris, **Faza e fundit e luftës së Kosovës: Sovraniteti dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor**, Instituti për Analizë të Mbrojtjes, 2006; Aristotle Tziampiris: "Sovraniteti i ardhshëm i Kosovës: Një rol për Bashkimin Europian", **Studime të Europës Juglindore dhe të Detit të Zi**, Vëll.5, Nr.2, 2005, faqe 285-299; Νικόλαος Τζιφάκης & Ευστάθιος Φακιολλάς: "Κυριαρχία, ανθρώπινη ασφάλεια και ανθρώπινη ανάπτυξη: Μια εναλλακτική προβληματική για την διευθέτηση του τελικού καθεστώτος του Κοσόβου", **Αγορά Χωρίς Σύνορα**, Vëll. 12, Nr.1, 2006, faqe .3-25; Thanos Veremis & Dimitrios Triantaphyllou (eds.), **Kosova dhe dimensionit shqiptar në Europën Juglindore: Nevoja për siguri rajonale dhe parandalim të konfliktit**, ELIAMEP, 1999; Thanos Veremis & Evangelos Kofos (eds.), **Kosova: Shmangia e një lufte tjetër ballkanike**, ELIAMEP & Universiteti i Athinës, 1998

Kur kriza e Kosovës u përshkallëzua gjatë asaj dekade, politika e jashtme e Greqisë për Ballkanin kishte ndryshuar rrënjësisht. Tashmë, prej viteve 1994-95 dhe posaçërisht pasi kontesti me IRJM-në për shfrytëzimin e emrit 'Maqedoni' arriti kulmin, politika e Greqisë për Ballkanin filloi të ndryshonte dhe menjëherë pas kësaj, një lloj i ri i politikanësh në pozita të larta qeveritare paraqitën një politikë të jashtme pragmatike dhe të hapur. Megjithatë, ky ndryshim duhet të transferohej te shoqëria, si dhe te pjesë të mëdha të politikës intelektuale dhe politike, të cilat vazhdonin ta shfrytëzonin të njëjtën kornizë analitike për shqyrtimin e krizës së përtëritur jugosllave.

Opinionit publik grek dhe lufta e Kosovës

Tabela e hollësishme lidhur me stereotipat negativë dhe pozitivë u paraqit në 4 gazeta ditore greke

	22-26/3/'99		15-18/4/'99		16-19/5/'99		Total	
	-	+	-	+	-	+	-	+
NATO	19	0	60	2	48	2	127	4
ShBA	22	0	43	0	34	0	99	0
Klinton	19	0	21	0	5	0	45	0
Milloseviç	9	0	55	0	41	2	105	2
BE	13	0	15	0	14	0	42	0
Lufta	53	1	158	1	78	1	289	3
Shqiptarët	6	2	20	29	14	15	40	60
Sserbët	0	9	0	16	0	9	0	34

Në fund të viteve nëntëdhjetë, mobilizimi ndërkombëtar ndali vendosmërisht një rënie të re në luftën e zgjatur në Ballkan duke ndërhyrë në konfliktin ndërmjet regjimit të Milloseviçit dhe rebelimit të shqiptarëve të Kosovës. Për dallim nga situata në vendet e tjera perëndimore, shoqëria greke reagoi tejet negativisht ndaj ndërhyrjes ushtarake të Perëndimit. Vendimi i NATO-s pa autorizimin e qartë të OKB-së për të nisur ofensivën ajrore për ndaljen e dhunën në Kosovë hasi në mospranim të fuqishëm nga opinionit publik grek. Sondazhet e opinionit gjatë tërë fushatës së NATO-s tregonin se dënimi që i bënte popullata greke ndërhyrjes ndërkombëtare sillej ndërmjet 92-97%.⁷⁰ Për më tepër, kundërshtimi publik ishte aktiv në formën e demonstratave të shpeshta masive në qytetet e mëdha greke.⁷¹

Mediat, shpesh duke përdorur gjuhë nxitëse, luajtën rol vendimtar për formimin e opinionit publik negativ.⁷² Ky qëndrim ishte krejt ndryshe nga qëndrimet e opinionit

70 Σωτήρης Ντάλης, *Η Κρίση στο Κόσσοβο: η Ελλάδα, η Διεθνής Κοινότητα και τα ΜΜΕ*, Εκδ. Παπαζήση, 1999, f. 194

71 Carol Migdalovitz: "Kosova: Perspektivat greke dhe turke", *Raport i CRS për Kongresin*, 27 maj 1999, f.3

72 Margarita Kondopoulou: "Mediet greke dhe kriza e Kosovës", *Konflikti & Komunikimi nëpërmjet internetit*, Vëll. 1, Nr.2, 2002, f.2

publik në vendet e tjera të NATO-s dhe nga linja zyrtare e qeverisë greke, siç do ta shohim më poshtë. Duke e shfrytëzuar materialin e ofruar nga burimet serbe, disa medie greke e trajtuan regjimin e Millosheviçit në mënyrë të favorshme; por madje edhe ato që nuk e bënë këtë, prapë se prapë erdhën në përfundimin se bombardimi nuk ishte përgjigjja e përshtatshme ndaj politikave të Millosheviçit.⁷³ Ajo çka dominonte ishte viktimizimi i serbëve nga NATO-ja dhe udhëheqja e saj politike dhe ushtarake, pamjet e të cilave paraqiteshin në mënyrën më negative. Është interesant se imazhi i shqiptarëve vetëm në disa raste ishte negativ, sidomos në shtypin e krahut të djathtë, që ngriti fantazmën e fluksit të ndërlikuar të refugjatëve.⁷⁴ Sipas analizave të shumta në shtypin grek përballë krizës së Kosovës, në fillim, në mes dhe nga fundi i fushatës së bombardimit, stereotipet pothuajse vetëm negative iu veshën luftës, NATO-s, Slllobodan Millosheviçit, ShBA-ve, presidentit amerikan Bill Clinton dhe BE-së, ndërsa serbëve vetëm ato pozitive. Është interesante se, me kalimin e kohës ranë referencat negative ndaj Clintonit, ndërsa referencat e ngjashme për Millosheviçin u shumëfishuan (shih tabelën).⁷⁵ Një temë tjetër e preferuar në mediat greke në atë kohë ishin akuzat për raportim të njëanshëm, drejtuar kundër mediave perëndimore, ndërsa vetëkritika në mediat greke ishte e papërfillshme.⁷⁶

Individët dhe institucionet me ndikim ndihmuan gjithashtu në formimin e qëndrimit specifik të opinionit publik grek, përfshirë elementë të caktuar brenda Kishës Ortodokse dhe Akademisë. Madje edhe Kryetari i Republikës, që në Greqi ka kryesisht rol ceremonial dhe pa funksione ekzekutive, tha: “I gjithë populli serb, që po lufton me trimëri dhe krenari për të drejtat e tij, ka simpatinë tonë”.⁷⁷ E rëndësishme në përcaktimin e këtij fronti të ‘unitetit popullor’ është se të gjitha anët politike në spektrin ideologjik gjetën arsye dhe argumente për t’iu bashkuar atij. Për të djathtën e ndikuar nga feja, kjo kishte të bënte me vuajtjet e shokëve ortodoksë serbë; për qendrën liberale, arsyeja ishte kërcënimi i drejtpërdrejtë ndaj stabilitetit dhe prosperitetit në një rajon më të gjerë; dhe për të majtën arsyeja ishte ushtrimi i qartë i fuqisë neoimperialiste të ‘Rendit të Ri Botëror’.⁷⁸

Opinionistët grekë hodhën poshtë arsyet humanitare të intervenimit dhe në vend të kësaj sugjeruan se humaniteti ishte preteksti për planet perëndimore për ndarjen e

73 Po aty., f.4, 6

74 Po aty., f.6-7, 9

75 Χριστόδουλος Γιαλλουρίδης, Βιβή Κεφαλά, *Κόσσοβο: η εικόνα του πολέμου – όψεις σύγχρονου милитаристικού ανθρωπισμού*, Ι. Σιδέρης, 2001, p.142

76 Γιάννης Παντελάκης: “Η μάχη της «πληροφόρησης»”, Σωτήρης Ντάλης, op. cit., p.128-131; Τραϊανός Χατζηδημητρίου: “Ο πόλεμος, η γεωοικονομία και η Θεσσαλονίκη”, Σωτήρης Ντάλης, op. cit., p.186-187

77 Carol Migdalovitz, op. cit.

78 Margarita Kondopoulou, op. cit., p.2-3, 7, 10; Λεωνίδας Κύρκος: “Ο ρόλος της Αριστεράς” in Σωτήρης Ντάλης, op. cit., p.85-87; Δημήτρης Σωτηρόπουλος: “Η κοινωνία πολιτών και ο πόλεμος” in Σωτήρης Ντάλης, op. cit., p.17

mëtejshme të Jugosllavisë.⁷⁹ Ndjenja antiamerikane, kryesisht te grupet majtiste, e ushqyer nga kujtimet e përqafimit të diktaturës ushtarake greke nga ana e amerikanëve (1967-'74) ishte e madhe. Për më tepër, disa opinionistë frikësoheshin se modeli i shkëputjes së Kosovës mund të zbatohej në të ardhmen në rastin e Qipros.⁸⁰

Për më tepër, këtu mund të përmenden edhe frika dhe shqetësime të tjera të ekzagjeruara, që u ngritën nga mediat dhe opinionistët grekë. Për shembull, për shkak të afërsisë gjeografike të Greqisë me fushën e betejës në arenën e luftës, disa shqetësoheshin lidhur me ndikimin në ndotjen e mjedisit, ndërsa më vonë u shtuan edhe shqetësimet lidhur me ndikimin e uraniumit të varfëruar të përdorur në armët e NATO-s.⁸¹ Sipas disa interpretimeve, lufta e Kosovës konsiderohej si përpjekje amerikane për minimin e shfaqjes së Bashkimit European si aktor i fuqishëm në politikën botërore, për të shkëputur vëmendjen e publikut amerikan nga çështja Lewinski ose për të realizuar planet për Shqipërinë e Madhe.⁸² Në fund, pak më rrallë, dëgjoheshin shqetësime lidhur me rivendosjen e mundshme të refugjatëve kosovarë në Shqipërinë e Jugut e që, për pasojë, do të sillte ndryshimin e ekuilibrit demografik në territoret e banuara nga pakica greke.⁸³

Qeveria greke: vendime të ashpra në rrethana të vështira

Qeveria greke, që në atë kohë drejtohej nga Costas Simitis, funksiononte duke u ballafaquar me kufizime serioze. Në njërën anë, kishte disa arsye që të shqetësohej për luftën dhe ndikimin e saj. Përveç kundërshtimit të luftës nga ana e opinionit publik, qeveria po ashtu frikësohej se përshkallëzimi i dhunës në rajon mund të shkaktonte rënie të madhe të investimeve të huaja, turizmit dhe të hyrave të ekonomisë greke nga eksporti, si dhe do të sillte për pasojë pengimin e kërkesës nacionale për anëtarësim në Unionin Monetar European.⁸⁴ Përveç kësaj, qeveria frikësohej se një luftë në shkallë të gjerë dhe ndryshimi i mundshëm i kufijve mund të nxiste efektin domino në rajon. Prandaj, diplomacia greke ishte kategorikisht kundër çfarëdo ndryshimi të kufijve

- 79 Margarita Kondopoulou, op. cit., p.2, Costis Hadjimichalis: "Kosova, 82 Ditë të një Luftë të Padeklaruar dhe të Padrejtë: Koment Gjeopolitik", **Studimet Europiane Urbane dhe Rajonale**, 2000, f.177; Keith Brown, Dimitrios Theodossopoulos: "Përmbushja e ankthit: tregimet greke për luftën në Kosovë", **Anthropology Today**, Vëll.16 Nr.1, shkurt 2000, f.5. Për të marrë përgjigje në këto argumente kundër intervenimit nga këndvështrimi i intervenimit humanitar dhe 'përgjegjësia për të mbrojtur', shih Αλέξης Ηρακλείδης: "Από τη Ναυμαχία του Ναυαρίνου στην επέμβαση στο Κόσοβο", **Newstime.gr**, 24 mars 2010, (<http://www.newstime.gr/?i=nt.el.article&id=37413>); Αλέξης Ηρακλείδης: "Απολογισμός για το Κόσοβο", **Τα Νέα**, 14 prill 2010, mund ta gjeni në (<http://www.ananeotiki.gr/el/readRelated.asp?intThemeID=58&textID=4521>)
- 80 Georgios Kostakos: "Krahu Jugor: Italia, Greqia, Turqia", Albrecht Schnabel, Ramesh Thakur (ed.), **Kosova dhe Sfida e Intervenimit Humanitar: Zemërimi Selektiv, Veprimi Kolektiv dhe Shtetësia Ndërkombëtare**, Shtypi Universitar i Kombeve të Bashkuara, 2000, f.171
- 81 Po aty, f. 175-176; Margarita Kondopoulou, op. cit., p.5
- 82 Keith Brown, Dimitrios Theodossopoulos, op. cit.; Costis Hadjimichalis, op. cit., p.179-180
- 83 Margarita Kondopoulou, op. cit., p.6
- 84 Carol Migdalovitz, op. cit., p.2-3

dhe mbeti kryesisht për status quo.⁸⁵ Në këtë frymë, Greqia u angazhua në aktivitete intensive diplomatik para intervenimit ushtarak dhe nga fundi i tij, në mënyrë që të shtoheshin mundësitë për një zgjidhje paqësore.⁸⁶

Në anën tjetër, qeveria nuk dëshironte të kishte mosmarrëveshje me aleatët e saj të NATO-s. Kryeministri Costas Simitis i Partisë Socialiste (PASOK) mendonte se vënia e vetos ndaj vendimit të NATO-s për ndërhyrjen në Jugosllavi sigurisht që do ta marginalizonte Greqinë, diçka që ai ishte përpjekur ta shmangte gjatë tërë mandatit të tij.⁸⁷ Sidomos në kontekst të kohës, politikanët grekë kuptuan se, nëse Greqia do të lidhej me Serbinë, ajo do ta humbte mbështetjen ndërkombëtare për çështjet e saj thelbësore të politikës së jashtme.⁸⁸ Në fjalimet e tij, kryeministri Simitis bëri të qartë shpjegimin e arsyes që shfrytëzonte politika e tij e jashtme: “Në mënyrë që të merremi me rreziqet në rajon, ne duhet të bashkëpunojmë me vendet e BE-së, por po ashtu duhet ta ruajmë rolin tonë në NATO. Ne nuk jemi vetëm në botë. Në funksionojmë në rrethana specifike, shpesh të krijuara nga të tjerët. Ne duhet t'i vëzhgojmë me kujdes interesat kombëtare. Turqia përpiket të plotësojë boshllëkun që do të linte shkëputja e mundshme e Greqisë nga zhvillimet. Nuk do ta lejojmë këtë”.⁸⁹

Megjithatë, nuk ishte detyrë e lehtë që t'i bindte bashkëqytetarët e tij që të pajtoheshin me fushatën ushtarake.⁹⁰ Qeveria e Simitis tashmë ishte dobësuar nga marrja mbi supe e shpenzimeve politike të masave të rrepta dhe trajtimi i pakujdesshëm i krizës së Abdullah Öcalan, gjatë së cilës udhëheqësi i Partisë militante të Punës të Kurdistanit, i cili kërkohej nga Turqia, gjeti strehim në Ambasadën e Greqisë në Najrobi pak para se të kapej nga shërbimet sekrete turke. Ndërkaq, përveç rizgjedhjes së Simitis në krye të partisë, ndonëse rivalët e tij brenda saj, disa prej të cilëve ishin pjesë e një fraksioni të paepur për çështjet e politikës së jashtme, ai kishte mbajtur një pjesë të konsiderueshme të pushtetit dhe ndikimit brenda PASOK-ut dhe qeverisë.⁹¹

Përballë këtyre vështirësive të brendshme, qeveria dha pëlqimin e saj për ndërhyrjen ushtarake të NATO-s kundër Jugosllavisë. Ajo madje u përmbajt nga vendosja e një fusnote joblokuese kundër në poshtëshënimin e saj, duke u distancuar nga e ashtuquajtura ‘politikë e yllit’ e kryeministrit të mëparshëm socialist Andreas Papandreu.⁹² Por, në të njëjtën kohë, qeveria vendosi që asnjë trupë greke të mos

85 Margarita Kondopoulou, op. cit., p.2; Georgios Kostakos, op. cit., p.168

86 Carol Migdalovitz, op. cit., p.2, 6

87 Κώστας Σημίτης: “Εξωτερική Πολιτική της Ελλάδας: Εξελίξεις και Προοπτικές”, Θ. Κουλουμπής, Δ. Τριανταφύλλου, *Ανασκόπηση Αμυντικής και Εξωτερικής Πολιτικής '99 - Η Ελλάδα και ο κόσμος 1998-99*, Παρατηρητής - ΕΛΙΑΜΕΠ, 1999, p.23-28

88 Po aty.; Margarita Kondopoulou, op. cit.

89 “Κ. Σημίτης: Διάγγελμα υποτέλειας σε NATO - ΕΕ”, *Ριζοσπάστης*, 6 April 1999, p.6

90 Georgios Kostakos, op. cit., p.175

91 Carol Migdalovitz, op. cit., p.3

92 Georgios Kostakos, op. cit., p.176

mernte pjesë në ndonjë operacion përforcues në Kosovë.⁹³ Për qeverinë pragmatike greke të asaj kohe, vendimi për mbështetjen e ndërhyrjes ushtarake ishte plotësisht i arsyeshëm sa i përkiste situatës aktuale në terren në Kosovë dhe objektivave të përgjithshme të politikës së saj të jashtme properëndimore. Por kjo politikë, ndonëse u prit mirë jashtë vendit, nuk kaloi pa pasoja dhe çmime politike brenda Greqisë. Ngaqë veproi kundër dëshirës së shumicës dërrmuese të opinionit publik grek, që ishte mobilizuar kundër intervenimit të NATO-s në Jugosllavi, qeveria e Simitis u dobësua politikisht dhe në popull forcoi imazhin e saj si forcë tepër proamerikane dhe properëndimore.

Dhënia e ndihmës nga ana e Greqisë në operacionet ushtarake të NATO-s në Jugosllavi

Në kuadër të kornizës së saj të ngushtë të veprimit, qeveria e Greqisë i përmbushi obligimet e saj konvencionale në NATO. Me të filluar operacionet ushtarake në Jugosllavi, Greqia i mbajti të hapura portet e saj dhe linjat e lëndëve djegëse, ndërsa një gjuajtës grek, që patrullonte në Adriatik, ishte në dispozicion të NATO-s.⁹⁴ Baza ajrore Aktion u ishte ofruar aleatëve për fluturimet e AWACS gjatë tërë fushatës ushtarake. Për më tepër, Greqia lejoi fluturimet turke me ndihma humanitare që të kalonin nëpër hapësirën e saj ajrore, por nuk i lejoi aeroplanët luftarakë dhe ata furnizues ta bënin këtë. Rruga Selanik-Shkup-Prishtinë u bë rruga kryesore tokësore e furnizimit për trupat e NATO-s. Selanikut po ashtu iu dha një rol shtesë si port kryesor për aterrimin e forcave të NATO-s. Si kundërshtpërbllim, aleanca zgjodhi portin maqedonas grek si qendër kryesore për pushimin dhe çlodhjen e ushtarëve, në përpjekje për t'i qetësuar shqetësimet e qeverisë greke lidhur me ndikimin e tmerrshëm të operacioneve ushtarake në ekonominë greke.⁹⁵ Edhe pse Greqia vetvetiu nuk mori pjesë në fushatën ushtarake, ajo ndërmori veprime për frenimin e konfliktit në shtetet fqinje (Shqipëri dhe IRJM) kryesisht duke menaxhuar fluksin e refugjatëve.⁹⁶ Në këtë kontekst, trupat greke morën pjesë në operacionin e NATO-s, *Strehimi i Aleatëve*, që kishte mandat të ndihmonte pranimin e refugjatëve në Shqipëri.⁹⁷ Në përgjithësi, përfshirja e Greqisë në luftën e Kosovës pasqyron një veprim drejtpeshues ndërmjet trysnive kontradiktore që buronin nga vendimet e aleatëve të NATO-s dhe pikëpamjeve të opinionit publik grek.

93 Po aty., f.167

94 Karen Donfried: "Kosova: Reagimet Ndërkombëtare ndaj Sulmeve Ajrore të NATO-s", **Raporti i CRS për Kongresin**, 21 prill 1999, f.4

95 Georgios Kostakos, op. cit., f.170

96 Po aty., f.174-17

97 Karen Donfried, op. cit.

Ndihma humanitare dhe ndihma që iu dha refugjatëve nga Greqia

Duke u paraqitur si aktor paqësor rajonal, Greqia mori rolin kryesor në ndihmën humanitare gjatë luftës së Kosovës. Greqia tregoi interes të posaçëm për ofrimin e ndihmës humanitare, një përpjekje që po ashtu ishte në pajtim me thirrjen e shoqërisë greke për lehtësimin e vuajtjeve të njerëzve në luftën e Kosovës. Përpjekjet humanitare të Greqisë kishin për qëllim të ndihmonin të dyja palët që ishin në konflikt. Autoritetet jugosllave rezervuan një trajtim të favorshëm për agjencitë humanitare greke, nuk i panë ato me dyshim dhe e falënderuan Greqinë për qëndrimin ndaj luftës.⁹⁸ Kjo bëri të mundur që OJQ-ve greke t'i kryenin detyrat e tyre humanitare pa u penguar. Kështu, një grup mjekësor grek ishte OJQ-ja e parë e huaj për ndihmë humanitare që mori leje të vepronte në Jugosllavisë më pak se një muaj pas fillimit të operacioneve të NATO-s.⁹⁹ Greqia, së bashku me Austrinë, Rusinë, Zvicrën dhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, formoi grupin *Focus*, që organizoi misionin e parë humanitar që arriti në Prishtinë gjatë luftës dhe fushatës së bombardimeve.¹⁰⁰

Asokohe, pas disa ditëve, një ndihmë humanitare prej 100 tonësh, dhuruar nga Greqia, arriti në Prishtinë dhe ishte donacioni i parë i huaj qeveritar për personat e zhvendosur në Kosovë.¹⁰¹ Ndihma e shpërndarë i jepej Jugosllavisë ose drejtpërdrejt nga agjencitë shtetërore, ose përmes OJQ-ve, si edhe Shqipërisë dhe IRJM-së, vende që pranuan pjesën më të madhe të fluksit të refugjatëve kosovarë. Shteti grek shpenzoi shumën e plotë prej 1 milion dollarësh për ndihmë brenda Jugosllavisë, të ndarë ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi, sipas proporcionit 2:1, ndërsa një shumë edhe më e madhe (1.8 milionë dollarë) u shpenzua për financimin e projekteve të udhëhequra nga OJQ-të greke. Në Shqipëri dhe në IRJM u ndanë më pak para për nismat e udhëhequra nga OJQ-të (0.8 milion dollarë), por ndihma e drejtpërdrejtë shtetërore ishte më tepër se 10 herë më shumë se kaq (gati 11 milionë), në pajtim me bashkëpunimin e ngushtë që kishte krijuar Greqia që nga fillimi i luftës me qeveritë përkatëse¹⁰². Edhe pse ndihma greke u drejtohej njerëzve që ballafaqoheshin me bombardime në shtëpi (në radhë të parë serbëve),¹⁰³ shumën e burimeve të ndara për refugjatët (në radhë të parë shqiptarë) në Shqipëri dhe IRJM është fushata më e madhe humanitare greke e të gjitha kohëve.¹⁰⁴

98 Georgios Kostakos, op. cit., f.173

99 Karen Donfried, op. cit

100 Intervista e autorëve me z. Alexandros Mallias Ambasador (ad Hon.), i cili ishte Ambasadori Grek në Shqipëri në kohën e krizës së Kosovës.

101 Ndihma humanitare greke arrin në kryeqytetin e Kosovës, Agence France-Presse, 25 prill 1999 (<http://reliefweb.int/node/46120>)

102 Nikos Ziogas: "Kontributi Humanitar Grek në Krizën e Kosovës", **Rrjeti Helenik i Burimeve** (<http://www.hri.org/MFA/thesis/spring99/humanitarian.html>)

103 Georgios Kostakos, op. cit., p168

104 Intervista e autorëve me z. Alexandros Mallias Ambasador (ad Hon.)

Sa i përket strehimit të refugjatëve në territorin e saj, Greçia fillimisht kishte ofruar strehim për 5 000 persona. Megjithatë, pas mosarritjes së marrëveshjes për numrin e caktuar të shtetit pranues në nivel evropian, ky premtim në të vërtetë nuk u jetësua kurrë.¹⁰⁵ Ndërkaq, disa qarqeve ksenofobe në vend nuk u pëlqente ideja e rritjes së pranisë së shqiptarëve në Greçi, që do t'iu shtohet shifrave edhe ashtu të mëdha të imigrantëve nga Shqipëria.¹⁰⁶ Në të vërtetë, sipas statistikave zyrtare kombëtare, në vitin 1999 nuk ishte regjistruar asnjë refugjat nga Kosova, edhe pse ekzistonte një prani e vogël e shqiptarëve të Kosovës në vend. Në vend të kësaj, së bashku me disa partnerë evropianë, Greçia zgjodhi politikën 'e qëndrimit afër shtëpisë'. Në kuadër të kësaj, Greçia drejtoi tre kampe të refugjatëve në Shqipëri: të gjithë kampin në Pogradec,¹⁰⁷ një kamp afër Tiranës, të vetmin me ndërtesa standarde të rregulluara më parë, si dhe një të vogël në zonën e Kukësit, afër pikave hyrëse të refugjatëve. Përveç këtyre nismave, Greçia ofroi aeroportin e Selanikut për transportimin ajror të disa refugjatëve të Kosovës në destinacione të jashtme.¹⁰⁸

PJESA II: Marrëdhëniet ndërmjet Athinës dhe Prishtinës

Ndryshe nga besimi i zakonshëm, marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Kosovës janë larg nga të qenit marginale. Marrëdhëniet greko-kosovare nuk kanë pasur shumë publicitet, por ato vërtetë ekzistojnë dhe përparojnë sipas interesave dhe objektivave të të dyja palëve. Në këtë pjesë ne përpiqemi të japim një pasqyrë të aspekteve kryesore të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Athinës dhe Prishtinës prej periudhës së luftës së Kosovës e deri në ditën e sotme. Pjesa pasuese do të merret në mënyrë më specifike me çështjen e shpalljes së pavarësisë nga Kosova.

Kontributi i Greqisë në burimet njerëzore dhe materiale në Kosovë

Të fillojmë me misionet ndërkombëtare, ku Greçia ka pasur prani të dukshme. Gjatë tërë kohës, UNMIK-u ka pasur grekë në përbërjen e tij. Megjithatë, kontributin më të dukshëm Greçia e ka dhënë në KFOR: duke filluar me shifrën prej 1 500 vetash, kur u vendos misioni që në atë kohë kishte rreth 40 000 pjesëtarë të personelit, kontingjenti grek në KFOR është zvogëluar me zvogëlimin e misionit në tërësi dhe aktualisht ka vetëm 245 persona, çka e bën këtë vend kontribuuesin e nëntë për nga madhësia (prej 30 kontribuuesve) në kuptimin e personelit, që vjen pas partnerëve të mëdhenj (si Gjermania, ShBA, Italia dhe Turqia), apo dhe Austria dhe Sllovenia, vende që po ashtu kërkojnë një rol të shtuar në rajon.¹⁰⁹ Në përgjithësi, sipas një burimi të

105 Georgios Kostakos, op. cit., p.173

106 Carol Migdalovitz, op. cit.

107 Joanne van Selm (ed.), *Refugjatët e Kosovës në Bashkimin Evropian*, Printer, 2000, f.218

108 Georgios Kostakos, op. cit.

109 Forca e Kosovës e NATO-s http://www.nato.int/kfor/structur/nations/placemap/kfor_placemat.pdf

besueshëm, 11.000 pjesëtarë të Forcave të Armatosura greke kanë shërbyer në KFOR në mënyrë të alternuar, duke fituar përvojë të vlefshme në terren.¹¹⁰ Prania e Greqisë në EULEX është më pak e dukshme. Me një numër prej 35 pjesëtarësh, Greqia këtu është pothuajse një kontribuuese mesatare (e 15 në 32).¹¹¹

Tabela 1: Ndarja e fondeve të PHREB sipas vendit pranues¹

Vendet PHREB	Totali i vendit (në €)	Totali për frymë banorësh (në €)
IRJM	74,840,000	36.50
Serbia	232,500,000	31.95
Mali i Zi	17,500,000	27.99
Shqipëria	49,890,000	15.62
Kosova	15,000,000	8.22
Bullgaria	54,290,000	7.37
Bosnja dhe Hercegovina	19,530,000	5.08
Rumania	70,430,000	3.22
Drejtimi/ Shpenzimet administrative (2.91%)	16,020,000	
Total:	550,000,000	11.44

Si përgjigje ndaj kushteve të posaçme që mbizotërojnë në rajonin e Ballkanit dhe në kontekst të obligimeve të Greqisë si anëtare e Komitetit për Ndihmë për Zhvillim të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH), në vitin 2002 Athina filloi një program të ndihmës së drejtpërdrejtë ekonomike.¹¹² Plani grek për Rindërtimin Ekonomik të Ballkanit (PHREB), ashtu siç u quajt, kishte për qëllim nxitjen e zhvillimit në vendet fqinje në mënyrë që të frenoheshin ndikimet negative të luftës e të mos shpërndareshin në pjesën tjetër të rajonit.¹¹³ Fillimisht i hartuar për një periudhë pesëvjeçare (2002-2006), afati kohor i PHREB më vonë u zgjat edhe për pesë vjet, deri më 2011. Dispozitat e PHREB pasqyronin interesin e posaçëm të Greqisë lidhur me stabilitetin dhe zhvillimin e IRJM-së dhe Serbisë, si elemente kryesore të sigurisë rajonale. Nivelet e larta të fondeve të PHREB për IRJM-në dhe Serbinë pasqyronin gjithashtu interesimin e madh të investitorëve grekë për këto dy vende. Megjithatë, është me rëndësi se që nga viti 2002, Kosova shënohej ndaras në listën e pranuesve dhe gjithsej 15 milionë euro të ndara për Prishtinën përbënin një

110 Intervista e autorëve me z. Alexandros Mallias Ambasador (ad Hon.)

111 Informatë për Stafin e EULEX-it (<http://www.eulex-kosovo.eu/en/info/StaffInfo.php>)

112 Po aty.

113 Për hollësi lidhur me HiPERB shih Charalambos Tsardanidis & Evangelos Karafotakis: "Diplomacia Ekonomike e Greqisë ndaj Vendeve të Ballkanit", *Perceptimet - Ditar për Çështje Ndërkombëtare*, Vëll.V / Shtator-Nëntor 2000; Μιχαήλ Χαροκόπος: "Το ελληνικό σχέδιο για την οικονομική ανασυγκρότηση των Βαλκανίων (ΕΣΟΑΒ)", *Αγορά Χωρίς Σύνορα*, Vëll.11 Nr.4 2006, f.380-398; Αστέρης Χουλιάρας: "Τα επτά παράδοξα της ελληνικής κρατικής αναπτυξιακής βοήθειας", *Αγορά Χωρίς Σύνορα*, Vëll.9 Nr.2 2003, f.91-104

donacion prej përafërsisht 8.22 euro për banor. Për fat të keq, për shkak të nivelit të ulët të absorbimit nga pranuesit, së bashku me zbatimin e papërshtatshëm nga pala greke, PHREB ishte shumë më pak i suksesshëm nga ç'kishte shpresuar në kohën kur ishte themeluar,¹¹⁴ ndërsa kriza e borxhit publik në Greqi do ta pengonte përfundimin e projektit.¹¹⁵

Komunikimi i dyanshëm qeveritar

Përveç kontributit të Greqisë me burime njerëzore dhe materiale në Kosovë, ka po ashtu komunikim ndërmjet dy palëve në nivel institucional. Edhe pse Greqia nuk e ka njohur Kosovën si shtet të pavarur, politika e saj është që t'i mbajë kanalet e komunikimit të hapura, në mënyrë që t'i përmirësojë kushtet shoqërore dhe ekonomike në vend. Prandaj, marrëdhëniet e tyre dypalëshe janë krejt të normalizuara: Athina flet me Prishtinën rregullisht, i pranon disa dokumente të lëshuara nga autoritetet kosovare dhe nuk ka shkaktuar ndonjë pengesë në komunikimin e Kosovës me institucionet ndërkombëtare dhe pranimin e saj në to.

Në këtë kuptim, edhe pse Greqia nuk i njeh zyrtarisht pasaportat kosovare, poseduesit e tyre mund të udhëtojnë në vend me vizë nacionale (jo Schengen) të lëshuar në një letër të posaçme.¹¹⁶ Edhe autoveturat me tabela të regjistrimit të Kosovës lejohet të hyjnë në Greqi, me kusht që të kenë sigurim me karton të gjelbër. Në lidhje me lëvizjen e mallrave, prej vitit 2009 e në vijim Greqia zbaton në mënyrë të njëanshme aranzhime praktike: shenja “Kosova/1244” nevojitet në dokumentet përcjellëse të mallrave dhe transporteve që hyjnë dhe që dalin; transportimi i prodhimeve greke dhe kosovare lejohet në mënyrë të dyanshme me anë të kamionëve që bartin tabela të Greqisë ose të Kosovës (me karton të gjelbër) por jo të vendeve të treta.

Rëndësia që i jep Greqia pranisë së saj në Kosovë shihet edhe nga prania e përfaqësimit diplomatik grek në kryeqytetin e Kosovës. Prej vetëm 27 misioneve nacionale diplomatike të vendosura atje, Greqia misionin e vet (të quajtur Zyrë Ndërlidhëse), së bashku me vetëm katër vende të tjera që nuk e kanë njohur.¹¹⁷ Zyra greke në Prishtinë ishte misioni i parë nacional që ishte hapur atje pothuajse në mes të luftës, me emrin *Zyra Greke për Ndihmë Humanitare*. Me vendosjen e regjimit të posaçëm administrativ të OKB-së, ajo u shndërrua në zyrë ndërlidhëse (nëntor 1999) dhe u vendos nën juridiksionin e Ambasadës Greke në Beograd, ku u akredituan zyrtarisht diplomatët e parë grekë në Prishtinë. Prej fillimit të vitit 2001, çdo shef i misionit ka pasur

114 Χαράλαμπος Τσαρδανίδης, Αστέρης Χουλιάρας: “Η άνοδος και η πτώση του Ελληνικού Σχεδίου για την Οικονομική Ανασυγκρότηση των Βαλκανίων”, *Αγορά Χωρίς Σύνορα*, Völl.11 Nr.1 2005, f.34-58

115 Σχέδιο διάσωσης του ΕΣΟΑΒ, *Voria.gr*, 21 janar 2011 (<http://www.voria.gr/index.php?module=news&func=display&sid=37812>) Apostolis Fotiadis: “Ekonomi: Kriza Greke Ndikon në Ballkan”, *ipsnews.net*, 20 mars 2010 (<http://ipsnews.net/news.asp?idnews=50734>)

116 Διμερείς σχέσεις της Ελλάδας – Κόσοβο* (<http://www1.mfa.gr/blog/dimereis-sheseis-tis-ellados/kosovo/>)

117 Kina, Rumania, Rusia dhe Sllovakia.

postin e ambasadorit dhe në vitin 2005 misioni në Prishtinë u largua nga mbikëqyrja e Ambasadës në Beograd. Që atëherë, autoritetet greke në Prishtinë njoftojnë (kjo shprehje përdoret në vend të 'akreditimit') UNMIK-un. Në të kundërtën, autoritetet greke kanë theksuar qartë që, nëse kërkohet, ato do ta akreditojnë përfaqësimin diplomatik kosovar jo si ambasadë, por si zyrë ndërlidhëse.¹¹⁸ Në fushën e kulturës, shefi i Zyrës Ndërlidhëse Greke ka marrë pozitën shtesë të Lehtësuesit të BE-së për mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë që nga shkurti 2010.¹¹⁹ Puna e ambasadorit Moschopoulos, i cili e ka mbajtur këtë post prej atëherë, vlerësohet pozitivisht nga të gjitha palët, një konsensus që nuk arrihet lehtë në këtë pjesë të botës.

Vizitat e shpeshta të nivelit të lartë ndërmjet Athinës dhe Prishtinës po ashtu tregojnë për klimën pozitive politike që ekziston ndërmjet dy palëve. Që nga përfundimi i luftës, pothuajse çdo ministër i Jashtëm grek e ka vizituar së paku një herë Prishtinën duke filluar me kryeministrin aktual, atëherë ministër i Jashtëm, George Papandreou, i cili filloi një vizitë ballkanike në janar 2003, domethënë kur Greqia mori presidencën e BE-së. Vizita e Papandreout në Ballkan dëshironte të bartte porosinë lidhur me mbështetjen e Bashkimit Europian për integrimin e rajonit në BE. Prishtina ishte ndalesa e fundit e vizitës së Papandreout; gjatë vizitës ai u takua me përfaqësuesit e komunitetit shqiptar dhe atij serb, si dhe me funksionarë të bashkësisë ndërkombëtare.¹²⁰

Po ashtu, kryeministri Costas Karamanlis vizitoi Kosovën në mars 2005.¹²¹ Kjo ishte një vizitë historike, meqë deri më tani mbetet e vetmja vizitë e një kryeministri grek në Kosovë. Përkushtimi i vazhdueshëm grek për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së statusit të Kosovës u demonstrua nga ministri i Jashtëm Petros Molyviatis, i cili po ashtu vizitoi Prishtinën në dhjetor 2005 si drejtues i trojkës jozyrtare të Procesit të Bashkëpunimit BE-Europa Juglindore (SEEC).¹²² Më pak se tre muaj më vonë, ministrja e Jashtme e sapoemëruar atëherë, Dora Bakoyanni, vizitoi Prishtinën menjëherë pas fillimit të bisedimeve për statusin përfundimtar të Kosovës në Vjenë.¹²³ Bakoyanni

118 Κύρια Αδάμ: "Κι άλλο βήμα προς αναγνώριση Κοσόβου", *Ελευθεροτυπία*, 19 qershor 2008 (http://archive.enet.gr/online/online_text/c=110,dt=19.06.2008,id=26051928)

119 RADIO KiM: "Dimitris Moschopoulos - Ne do të konsultohemi me Kishën Ortodokse Serbe për t'i përcaktuar prioritetet dhe mënyrat për mbrojtjen e trashëgimisë fetare në Kosovë" - 20 shkurt 2010 (<http://www.eparhija-prizren.com/en/media/radio-kim-dimitris-moschopoulos-we-will-consult-serbian-orthodox-church-determine-priorities-a>)

120 Ελένη Μπουκασούρη: "Επίσκεψη Γιώργου Παπανδρέου στην Πρίστινα", *Αθηναϊκό Πρακτορείο Ειδήσεων*, 15 janar 2003 (<http://www.papandreou.gr/papandreou/content/Document.aspx?d=6&rd=7739474&f=1355&rf=1290529066&m=3005&rm=22480569&l=2>)

121 "Περιοδεία - σφήνα Καραμανλή σε Βελιγράδι, Ζάγκρεμπ, Πρίστινα", *Ελευθεροτυπία*, 2 mars 2005 (http://archive.enet.gr/online/online_text/c=110,dt=02.03.2005,id=1872616)

122 "Trojka e BE-së vizitoi Prishtinën dhe Beogradin për të ardhmen e Kosovës", *Agjencia e Lajmeve e Athinës*, 9 dhjetor 2005 (<http://www.greekembassy.org/embassy/content/en/Article.aspx?office=10&folder=24&article=16395>)

123 Κύρια Αδάμ: "Η Αθήνα μπροστά σ' ένα νέο κράτος: το Κόσοβο", *Ελευθεροτυπία*, 7 mars 2006 (http://archive.enet.gr/online/online_text/c=110,dt=07.03.2006,id=31178072)

u kthye në Prishtinë më shkurt 2009, kur si kryesuese në detyrë e Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Europë vizitoi misionin e organizatës në Kosovë.¹²⁴

Në vitin tjetër, në korrik 2010, disa ditë pas nxjerrjes së vendimit nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me Kosovën, ministri i Jashtëm grek Dimitris Droutsas, me dëshirën e mirë të homologëve të tij europianë, vizitoi Beogradin dhe Prishtinën në përpjekje për t'i kthyer të dyja palët përsëri në tryezën e bisedimeve.¹²⁵ Ministri i tanishëm i Jashtëm grek Stavros Lambrinidis po ashtu ka qenë rishtazi në Prishtinë, ku u takua me përfaqësuesit e komuniteteve vendase, inkurajoi dialogun me Beogradin dhe rikonfirmoi përkushtimin e Greqisë për mbështetjen e gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor në kursin e tij të integritetit europian.¹²⁶ Ndonëse të gjitha vizitat e sipërpërmendura nuk kishin statusin e këmbimeve bilaterale zyrtare, realizimi i tyre forcoi bashkëpunimin ndërmjet dy palëve dhe tregoi edhe një herë interesimin e Greqisë për të luajtur një rol pozitiv në zhvillimet në Kosovë. Diçka që nuk është për t'u çuditur: të gjitha vizitat zyrtare greke në Prishtinë u paraprinë nga vizitat në Beograd. Në lidhje me vizitat e kosovarëve në Greqi, Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Kosovës, u bë zyrtarja më e lartë kosovare që vizitoi Athinën në qershor 2011. Në atë që shtypi kosovar e karakterizoi si vizitë zyrtare,¹²⁷ Edita Tahiri u pranua nga Ministria greke e Punëve të Jashtme. Më vonë, Edita Tahiri pati disa takime të tjera me afaristët dhe akademikët grekë.¹²⁸ Më parë, në prill 2011, Hajredin Kuçi, ministri kosovar i Drejtësisë vizitoi Athinën me rastin e forumit të Bankës Botërore në Greqi. Gjatë takimit të tij me sekretarin e përgjithshëm të MPJ greke, ambasadorin Zeppos, Hajredin Kuçi kërkoi zvogëlimin e tarifës për sigurimin e automjeteve, që duhet ta paguajnë kosovarët kur vizitojnë Greqinë. Ai po ashtu diskutoi për investimet greke në Kosovë dhe për bashkëpunimin dypalësh në arsim, por sidomos për mundësinë e bursave greke për studentët kosovarë në Greqi.¹²⁹ Një vizitor tjetër i rëndësishëm nga Kosova, edhe pse jo funksionar shtetëror, ishte Veton Surroi, i cili mbajti një ligjëratë në Ministrinë greke të Punëve të Jashtme si mysafir i Fondacionit Helen për Politikë Europiane & të Jashtme (ELIAMEP) në nëntor 2010.

124 Επίσκεψη Ντ. Μπακογιάννη στο Κόσοβο – Δελτίο Ειδήσεων ΝΑ Ευρώπης (http://web.ana-mpa.gr/balkans/article.php?doc_id=595372)

125 Επίσκεψη Δρούτσα στην Πρίστινα, *Voria.gr*, 31 korrik 2010 (<http://www.voria.gr/index.php?module=news&func=display&sid=23501>); Παρουσίαση βασικών αξόνων εξωτερικής πολιτικής από την πολιτική ηγεσία ΥΠΕΕ στους διπλωματικούς συντάκτες – Αθήνα, 15 shtator 2010 (http://www.2mfa.gr/www.mfa.gr/Articles/el-GR/150910_AH2157.htm)

126 “Επαφές Λαμπρινίδη στο Κοσσυφοπέδιο” *Καθημερινή*, 9 shtator 2011 (http://news.kathimerini.gr/4dcgi/w_articles.politics_1_09/09/2011_455411)

127 M-Magazine: “Edita Tahiri, zyrtarisht në Greqi”, *M-M@G*, 2 qershor 2011 (<http://www.m-magazine.org/index.php/en/news/kosovo/352-edita-tahiri-officially-in-greece.html>)

128 Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri takohet me zyrtarë qeveritarë grekë– Athinë, 3 qershor 2011 (<http://www.kryeministri-ks.net/index.php?page=2,9,2071>).

129 “Kuçi kërkon njohjen e Kosovës nga Greqia”, *Zëri i Popullit*, 12 prill 2011, (<http://www.zeri-popullit.com/index.php/kosove/6374.html>); “Kuçi në Greqi me kërkesa konkrete”, *Ekonomisti.info*, 12 prill 2011, (<http://www.ekonomisti.info/artikulli/1/0/8615/kuci-ne-greqi-me-kerkesa-konkrete/>)

Në përgjithësi, komunikimi institucional ndërmjet Athinës dhe Prishtinës pasqyron objektivat kryesore të politikës së jashtme të secilës palë. Për Greqinë, vizitat e shpeshta, krijimi i kanaleve zyrtare të komunikimit dhe nismat e ndryshme pasqyrojnë dëshirën e saj për krijimin e imazhit si aktor i rëndësishëm rajonal, për të mbajtur ekuilibër të drejtë në marrëdhëniet e saj si me Beogradin, ashtu edhe me Prishtinën, si dhe për të kontribuar në stabilitetin e fqinjëve të saj të afërt përmes zgjidhjeve paqësore dhe të pranueshme reciprokisht. Kosova, nga ana tjetër, mirëpret faktin që Greqia nuk i kontribuon izolimit të saj, përkundër politikës greke të mosnjohjes.¹³⁰

Marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Greqisë dhe Kosovës

Greqia jo vetëm që i ka mbajtur hapur kanalet tregtare me Kosovën, por, për më tepër, është njëri prej partnerëve të saj më të rëndësishëm tregtarë.¹³¹ Që para luftës, Greqia importonte pjesën më të madhe të prodhimeve bujqësore kosovare që kishin për qëllim tregjet jo jugosllave.¹³² Në periudhën pas luftës, Kosova eksporton kryesisht mbeturina të metaleve në vendet fqinje, prej të cilave Greqia, përkrah IRJM-së dhe Italisë, përvetëson pjesën më të madhe.¹³³ Sipas statistikave zyrtare, në periudhën 2003-2008, në mesin e shteteve të BE-së, Greqia ka pranuar pjesën e tretë më të madhe të eksporteve të Kosovës. Përndryshe, në periudhën e njëjtë, nga shtetet e BE-së Greqia ka qenë eksportuesi i dytë më i madh i mallrave në Kosovë.¹³⁴

Me kalimin e kohës, marrëdhëniet tregtare ndërmjet Greqisë dhe Kosovës janë rritur në mënyrë të konsiderueshme. Arsye e mundshme mund të jetë që Greqia (së bashku me Shqipërinë deri në një pikë) e ka marrë me sukses pjesën tregtare me Kosovën nga Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina, pasi, për arsye politike, transaksionet e tyre ekonomike u zvogëluan (madje u ndërprejnë krejt për një periudhë kohore).¹³⁵ Një rritje e konsiderueshme u shënuar në vitin 2007, kur eksportet në Greqi u rritën përafërsisht me 118%, ndërsa importet nga Greqia u rritën me 71% krahasuar me një vit më parë.¹³⁶ Kjo ngritje e shpejtë ndodhi pjesërisht për shkak të futjes së

130 Muhamet Brajshori: "Kosova ndërton lidhjet me Greqinë për ekonominë, BE", *Southeast European Times*, 10 shtator 2011 (http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2011/09/10/feature-01)

131 Për marrëdhënie ekonomike ndërmjet Greqisë dhe Kosovës shih informatat dhe analizën përkatëse në "Ecuritë ekonomike dhe ambienti për biznes në Republikën e Kosovës", *Oda Ekonomike e Kosovës*, 2008, mund të gjendet në (http://www.oek-kcc.org/publikimet/publikime_te_tjera/816); "Vlera e eksportit Kosvar në Greqi nënçmuese", *Koha Ditore*, 27 gusht 2011, (<http://www.kohaditore.com/index.php?page=1.3.67438>)

132 Will Bartlett: "Integrimi rajonal dhe marrëveshjet për tregti të lirë në Ballkan: mundësitë, pengesat dhe çështjet e politikave", *Springer Science + Business Media*, 14 tetor 2008, f.38

133 *Politika Tregtare e Kosovës*, Republika e Kosovës – Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, gusht 2009, f.9

134 Po aty, f.12

135 Po aty.

136 Myrvete Badivuku-Pantina & Muje Gjonbalaj: "Këmbimet Tregtare të Kosovës me Vendet e Rajonit të Ballkanit", *Analele Științifice ale Universității „Alexandru Ioan Cuza” din Iași*, Număr special, Știin e Economice 2010, f.8

standardeve europiane në legjislacionin kosovar lidhur me nënproduktet e naftës, që pati si rezultat zëvendësimin e IRJM-së (deri atëherë furnizuesi kryesor i Kosovës me këto nënprodukte) me Greqinë.¹³⁷

Është me interes të theksohet se IRJM është një faktor kufizues i rëndësishëm në marrëdhënien tregtare greko-kosovare. Lidhja rrugore Prishtinë-Shkup-Selanik mbetet rruga më e mirë që lidh Kosovën me jashtë. IRJM ka bërë marrëveshje tregtare me shtetet anëtare të BE-së dhe me vendet ish-jugosllave dhe kjo e shndërron vendin në një platformë të rëndësishme për kompanitë greke që synojnë tregun kosovar.¹³⁸ Përveç kësaj, ekzistojnë disa kompani në pronësi greke në IRJM, që mes të tjerash kanë orientim të qartë eksportues në Kosovë.¹³⁹

Investimi i huaj direkt është një dimension tjetër i rëndësishëm i marrëdhënieve ekonomike dypalëshe. Megjithatë, krahasuar me rrjedhën tregtare, investimet greke në Kosovë kanë luajtur rol më pak të rëndësishëm për nxitjen e lidhjeve ekonomike dypalëshe. Përkundër pranisë së dukshme të ndërmarrjeve greke gjetkë në rajon, afaristët grekë nuk treguan shumë interes për Kosovën. Kështu, tri vizita të investitorëve grekë në Kosovë janë organizuar nga shoqatat afariste greke dhe nën ombrellën e MPJ-së së Greqisë; ata u pritën ngrohtësisht nga bota politike dhe afariste e Kosovës.¹⁴⁰ Sipas të dhënave të vitit 2004, në Kosovë kishte 12 firma të interesave greke ose të interesave të përziera, çka e bën Greqinë investitorin e shtatë më të madh atje.¹⁴¹

Pa dyshim, kriza e borxhit publik në Greqi, që ndikon tërthorazi në tërë rajonin, ka ndikim të dukshëm edhe në Kosovë. Recesioni në ekonominë nacionale në mënyrë të pashmangshme e ka zvogëluar kërkesën e grekëve për mallra nga Kosova dhe qarkullimin e ndërmarrjeve të tyre.¹⁴² Kjo prirje tashmë pasqyrohet në statistika: vëllimi tregtar në vitin 2010 u rrit në 63.5 milionë euro (nga 66.4 milionë më 2009). Krahasuar me vitin 2009, eksportet greke (kryesisht nafta dhe nënproduktet e saj) kanë rënë me 4.6%. Importet nga Kosova po ashtu janë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme me 37.1% (në vitin 2009 ishin dyfishuar, krahasuar me vitin 2008). Sipas Autoritetit Statistikor Grek, prirja në rënie e eksporteve greke vazhdoi gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 (-9.8%). Investimet e huaja greke tashmë janë në

137 Po aty, f.7-8

138 Christos Nikas: "Efektet e Marrëveshjes së Përkohshme mbi marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Greqisë dhe IRJM-së", Evangelos Kofos, Vlas Vlasidis, *Athens-Skopje: An Uneasy Symbiosis (1995-2002)*, ELIAMEP, 2005, f.114

139 Po aty., f.109

140 "Kosova fton kompanitë greke të investojnë", *Nisma Ekonomike për Kosovën – ECIKS*, 8 prill 2009 (http://www.eciks.org/english/lajme.php?action=total_news&main_id=894)

141 "Κάλεσμα για ελληνικές επενδύσεις στο Κόσοβο", *Pathfinder News*, 5 dhjetor 2007 (<http://news.pathfinder.gr/greece/news/445508.html>)

142 Tomasz Dąbrowski, Marta Szpala: "Ndikimi i Krizës Greke në Ballkanin Perëndimor", *Central European Weekly* – Ośrodek Studiów w Schodnich im. Marka Karpią, Qendra për Studime Lindore, numri 17 (72), 12 maj 2010, f.2

zvogëlim e sipër dhe ekziston frika nga rreziqet e mëdha për investime në periudhën e pasigurisë dhe sidomos për arsye se bankat greke ofrojnë më pak hua në përpjekjet për ta mbajtur likuiditetin në shtëpi.¹⁴³

Kosova në mediat greke dhe në opinionin publik

Pas përfundimit të luftës, si edhe në vendet e tjera, Kosova nuk është më titujt kryesorë të lajmeve në mediat greke. Në to, informatat për Kosovën paraqiten vetëm kur ndodhin zhvillime të rëndësishme. Po ashtu, opinionin publik grek është në masë të madhe i përfshirë dhe indiferent ndaj çështjeve kryesore rreth Kosovës. Përmendja e herëpashershme e Kosovës shpesh priret të prodhojë sërish imazhe negative për të protektoratit i pasuksesshëm ndërkombëtar ose si shtet me lidhje të forta me krimin e organizuar. Në lidhje me të parën, raportet kanë prirjen të theksojnë gjendjen e vështirë ekonomike të Kosovës, paaftësinë e saj të ofrojë mallra dhe shërbime themelore sociale (p.sh. rrymë), tensionet ndëretnike, nevojën për mbrojtje ndërkombëtare të pacaktuar, mungesën e njohjeve ndërkombëtare dhe paaftësinë për të shtrirë kontrollin në Veriun e banuar me shumicë serbe.¹⁴⁴ Në përmendjen e mafies përfshihen lidhjet e pretenduara të udhëheqjes me krimin e organizuar, lulëzimi i trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabanda dhe shkalla e lartë e korrupsionit.¹⁴⁵

Në këtë kontekst, problemi nuk lidhet vetëm me keqinformimin apo raportimin e rrejshëm për Kosovën. Përkundrazi, duke u përqendruar në disa prej karakteristikave më problematike të shtetësisë dhe të qeverisjes së re të Kosovës, është bërë edhe gazetari e mirë hetuese greke dhe kërkim cilësor;¹⁴⁶ në përgjithësi, në ditët e sotme raportimi është më i kufizuar, por është më cilësor se gjatë kohës së luftës. Problemi është që analiza dhe raportimi i kufizuar nga Kosova, i drejtuar nga përqendrimi në ngjarjet e rëndësishme dhe rrëfimet sensacionale, nuk arrijnë ta informojnë publikun grek lidhur me zhvillimet pozitive dhe karakteristikat e tjera interesante në Kosovë. Në masë të madhe, shumë pak dihet ose raportohet në Greqi për shoqërinë, kulturën, identitetin dhe historinë kosovare. Kosova mbetet në masë të madhe një

143 Svetlana Jovanovska: "Kriza greke shkakton shqetësim tek fqinjët ballkanik", *EU Observer*, 17 shkurt 2010 (<http://euobserver.com/9/29490>)

144 Αργύρης Ντινόπουλος: "Κόσοβο, μετά τον πόλεμο τι", *NET*, 2007 (<http://www.youtube.com/watch?v=dYidOrrB4M>); Σταύρος Τζίμας: "«Το Κόσοβο μπορεί να επιβιώσει»: Ένα χρόνο από την ανακήρυξη της ανεξαρτησίας ο πρόεδρος του νέου κράτους κ. Φαντμίρ Σέιντιού εμφανίζεται αισιόδοξος", *Καθημερινή*, 22 shkurt 2009 (http://news.kathimerini.gr/4dcgi/_w_articles_world_1_22/02/2009_304503).

145 "Ο Χασίμ Θάτσι «αρχηγός της κοσσοβάρινης μαφίας»!", *Το Βήμα*, 15 dhjetor 2010 (<http://www.tovima.gr/world/article/?aid=373209>); "Διαφθορά στο Κόσοβο", *Οι Νέοι Φάκελοι*, ΣΚΑΪ (<http://folders.skai.gr/main/theme?id=30&locale=el>); Κόσοβο (2007) (<http://www.youtube.com/watch?v=dYidOrrB4M&feature=related>)

146 Për shembull shih "Διαφθορά στο Κόσοβο", *Οι Νέοι Φάκελοι*, ΣΚΑΪ (<http://folders.skai.gr/main/theme?id=30&locale=el>); Κόσοβο (2007) (<http://www.youtube.com/watch?v=dYidOrrB4M&feature=related>)

vend i panjohur, për të cilin grekët dinë shumë pak dhe, si rezultat, nëse kanë ndonjë mendim, ai formohet përmes stereotipave të së kaluarës, këndvështrimeve të luftës, të ngarkuara emocionalisht, ose raportimeve negative bashkëkohore.

Këtu duhet të përmenden dy karakteristika. Njëra lidhet me faktin se mungesa e raportimit dhe njohuritë e kufizuara nuk ndodhin vetëm në rastin e Kosovës. Grekët në përgjithësi kanë njohuri të kufizuara, interesim të marginalizuar dhe marrin pak njoftime lidhur me zhvillimet të fqinjët e tyre ballkanike. Me përjashtim të dukshëm të mediave të Selanikut, që në përgjithësi janë më të interesuara për çështjet e Ballkanit, në lajmet në Greqi mbizotërojnë zhvillimet në Europën Perëndimore, në Amerikën Veriore dhe gjetiu. Që nga fillimi i krizës ekonomike greke, raportimi që nuk ka të bëjë me Perëndimin është bërë edhe më i kufizuar. Është e natyrshme që në kontekstin e një ekspozimi të tillë të kufizuar ndaj Ballkanit, vendeve të vogla dhe më pak të njohura, si Kosova, Mali i zi dhe Bosnja e Hercegovina, t'u kushtohet më pak vëmendje nga mediat greke.

Karakteristika e dytë ka të bëjë me tregun e rehatshëm, që është ende i ngarkuar emocionalisht dhe ku vijnë shumë njoftime për Ballkanin. Këtu bëjnë pjesë qarqet e orientuara nga feja dhe ato nacionaliste, që priren të ofrojnë më shumë lajme dhe analiza për Ballkanin, edhe pse në mënyrë të njëanshme dhe stereotipike, që riprodhojnë imazhet 'bardhë e zi' të viteve nëntëdhjetë.¹⁴⁷ Megjithatë, këto janë medie dhe shkrime të pakta, të cilat nuk mund të konsiderohen në mënyrë kuptimplote si rrjedhë e përgjithshme ose përgjithësisht me ndikim.

Shkëmbimet e shoqërisë civile

Kontaktet dhe shkëmbimet e shoqërisë civile, me përjashtim të atyre që janë zhvilluar në kuptimin e ndihmës humanitare dhe të bashkëpunimit, kanë qenë të kufizuara. Kjo mund të shpjegohet me gjendjen e komplikuar të statusit të Kosovës dhe, për rrjedhojë, me natyrën e ndërlikuar të kanaleve zyrtare të komunikimit. Po ashtu, është edhe produkt i mungesës së njohjes që kanë dy shoqëritë për njëra-tjetrën dhe i sistemit të posaçëm të shoqërisë greke ndaj konflikteve jugosllave në vitet nëntëdhjetë. Përjashtim nga rregulla e mësipërme është Fondacioni grek për Politikë Europiane & të Jashtme (ELIAMEP), ndoshta instituti më me ndikim në Greqi. ELIAMEP ishte njëri prej instituteve të para në Europë që zgjeroi bazën e njohurive të tij për Kosovën pas shkatërrimit të Federatës Jugosllave. Po ashtu, ishte nga të parët që zhvilloi programe dhe veprime lidhur me problemin e Kosovës, madje edhe para përfundimit të luftës në Bosnjë dhe shumë më përpara se institutet e tjera

147 "Πογκρόμ κατά Σέρβων στο Κοσσυφοπέδιο", *Ελεύθερος Κόσμος*, 13 shtator 2010 (http://elkosmos.gr/index.php?option=com_content&view=article&id=5389:2010-09-13-08-28-18&catid=97:2008-10-17-07-33-49&Itemid=284)

europiane të përqendroheshin në Kosovë. Ndërkaq, në vitin 1995, ELIAMEP filloi një projekt kërkimor që përqendrohej në parandalimin e konfliktit në Kosovë. Në projekt përfshihej një vizitë kërkimore në terren në Kosovë e ekspertëve grekë për çështje të Ballkanit dhe zgjidhje të konfliktit (si ambasadori Evangelos Kofos dhe profesorët Thanos Veremis dhe Alexis Heraclides). Po ashtu përfshihej një varg analizash që orientoreshin drejt politikave, si dhe takimet e ekspertëve, në të cilat morën pjesë disa krijues të opinionit dhe studiues të Ballkanit (si Veton Surroi, Predrag Simić, Shkelzen Maliqi, Marina Blagojević, Gramoz Pashko). Në përfundimet e projektit bënte pjesë një grup i rekomandimeve gjithëpërfshirëse dhe të reja për mënyrën e shmangies së konfliktit në Kosovë.¹⁴⁸ Konkluzionet u prezantuan në disa forume ndërmjet viteve 1996 dhe 1998 dhe u publikuan në një vëllim të redaktuar nga Thanos Veremis dhe Evangelos Kofos.¹⁴⁹ ELIAMEP vazhdoi përpjekjet për të kontribuar në dialogun dhe në zgjidhjen e problemit të Kosovës edhe pasi filloi konflikti fatal. Një shembull i tillë ishte konferenca “Zhvillimet e fundit në rajonin e Kosovës: strategjitë dhe opsionet për zgjidhje paqësore”, që bashkoi përfaqësuesit e komunitetit serb dhe atij shqiptar dhe u mbajt në Athinë në janar të vitit 1999.¹⁵⁰ Më 1999, Fondacioni botoi edhe një libër, që ishte rezultat i analizës së konfliktit në Kosovë dhe i përpjekjeve për zgjidhjen e tij.¹⁵¹

Pas përfundimit të luftës së Kosovës, ELIAMEP vazhdoi me aktivitete që kishin për qëllim lehtësimin e dialogut ndërmjet palëve në konflikt në Kosovë, madje edhe atëherë kur përpjekje të tilla dukeshin të kota. Një nismë e tillë u realizua në kontekstin e seminareve të përvitshme në ishullin Halki, pas trazirave të vitit 2004 në Kosovë.¹⁵² Kur u intensifikuan bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës, ELIAMEP doli me një propozim të shtjelluar imtësisht dhe ‘nga kutia’, lidhur me trashëgiminë e pasur ortodokse të Kosovës. Propozimi parashikonte formimin e Komunitetit të Manastireve Ortodokse Serbe (KMOS), si status të posaçëm vetëqeverisës për manastiret historike në Kosovë. KMOS do të udhëhiqej nga një organ i zgjedhur i murgjve, nën autoritetin shpirtëror të Patriarkatit Serb dhe sipas një karte të pranuar nga autoriteti i ardhshëm qeverisës i Kosovës dhe do të garantohej nga bashkësia ndërkombëtare.¹⁵³ Beogradi dhe BE-ja shprehën rezerva lidhur me propozimin e ELIAMEP, por më vonë pati pohime se diplomatët serbë ishin penduar që nuk e kishin miratuar propozimin e fondacionit.¹⁵⁴ Kontaktet dhe këmbimet e ELIAMEP me Kosovën vazhdojnë dhe nuk janë pakësuar, çka kontribuon kështu për rritjen e mirëkuptimit ndërmjet shoqërisë

148 Thanos Veremis, *Zgjidhjet e Propozuara nga Instituti Grek për Rebusin e Kosovës*, Dokumenti i Gjallë Nr. 7/2010, ELIAMEP, prill 2010, f.4-5, 9-10

149 Thanos Veremis & Evangelos Kofos, op.cit.

150 Thanos Veremis, op.cit.

151 Thanos Veremis & Dimitrios Triantaphyllou, op.cit.

152 “Ndizet shpresa në Egje: Vazhdojnë bisedimet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës”, *The Economist*, 24 qershor 2004 (<http://www.economist.com/node/2792630>)

153 “Krijimi i një Komuniteti të Manastireve Serbe Ortodokse (KMSO) në Kosovë, si pjesë përbërëse e zgjidhjes gjithëpërfshirëse të statusit të ardhshëm”, *dokument jozyrtar i ELIAMEP*, 1 nëntor 2005 (http://www.kosovo.net/news/archive/2005/December_25/files/1135470181_uoxl9qp67q4_Kofos-Couloumbis%20SOMC%20in%20Kosovo%20%20proposal%20_2_.pdf)

154 Alexandros Mallias: “Kosova pas Hagës”, Teza e *ELIAMEP* 6/2010, nëntor 2010 (<http://www.eliamep.gr/en/eliamepnews/eliamep-thesis-62010-kosovo-after-the-hague-scribd-version/>)

greke dhe asaj kosovare.¹⁵⁵

PJESA III: Qëndrimi i Greqisë ndaj pavarësisë së Kosovës

Greqia është në mesin e pesë shteteve anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Është interesant të analizohet qëndrimi zyrtar i qeverisë greke lidhur me këtë çështje, historiku i tij si edhe implikimet praktike të tij, të cilat nuk janë domosdoshmërisht aq të dëmshme për marrëdhëniet Athinë-Prishtinë sa do të priste njeriu fillimisht. Para se ta analizojmë qëndrimin zyrtar grek dhe historikun e tij, shkurtimisht do t'i përvijojmë shkollat kryesore të mendimit lidhur me çështjen që mund të gjendet në fushën publike në Greqi.

Pavarësia e Kosovës: debati në Greqi

Pavarësia e Kosovës nuk është temë që diskutohet shumë në Greqi. Publikisht diskutohet kryesisht në rrethin e ngushtë të akademikëve, të krijuesve të politikave dhe të biznesit dhe të krijuesve të opinionit në media.¹⁵⁶ Qëndrimi kundër pavarësisë nuk shprehet nga grupet specifike sociale, ideologjike ose profesionale, por nga një spektër i gjerë heterogjen, që shpesh shfrytëzon argumente të ndryshme për të arritur në përfundime të njëjta. Argumentet e atyre që janë skeptikë për pavarësinë e Kosovës bëjnë pjesë në përgjithësi në tri kategori të mëdha:

1. *Kundërshtimi i hapur i së drejtës ndërkombëtare*, që aktualisht është grupi i argumenteve që shfrytëzohet më së shpeshti.¹⁵⁷ Theksi është vënë në shkeljen e aspekteve të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare, zbatimi i standardeve të dyfishta të sistemit ndërkombëtar nga aktorët e fuqishëm, që çon në minimin e rolit të Kombeve të Bashkuara. Shqetësime të caktuara janë ngritur për shkak të frikës se kjo praktikë do të hapë kutinë e Pandorës dhe komunitetit ndërkombëtar do t'i duhet të ballafaqohet me një varg të pafund pretendimesh separatiste sipas modelit të Kosovës. Në pajtim me këtë, në debatet publike përmendet shpesh ndikimi negativ për problemin e Qipros, nëse edhe separatistët e tjerë ndjekin shembullin e Kosovës.

2. *Keqtrajtimi i pakicave*, kryesisht atyre serbe.¹⁵⁸ Argumentet në këtë kategori zakonisht theksojnë se regjimi i ri politik që është vendosur në vend

155 Shih, për shembull, raportet e medieve për vizitën e akademikëve dhe krijuesve grekë të opinionit në Kosovë të organizuar nga Klubi për Politikë të Jashtme dhe ELIAMEP në prill 2010: "[Κόσοβο-Σεοβία: Επίσκεψη αντιπροσωπείας του ELIAMEP](http://www.express.gr/news/ellada/296035oz_20100427296035.php3)", *ΕΞΠΡΕΣ*, 27 prill 2010 (http://www.express.gr/news/ellada/296035oz_20100427296035.php3)

156 Për debatet interesante, shih punimet në fusnotën 1.

157 Për një shembull karakteristik, shih punën e një profesori të shquar grek të së drejtës ndërkombëtare: Στέλιος Περγράκης, *Κόσοβο: ανατρέποντας τη διεθνή δικαιοταξία: αυτοδιάθεση και απόσχισις εθνότητων στον 21ο αιώνα*, Ι. Σιδέρης, 2008

158 Shih, për shembull, Αργύρης Ντινόπουλος: "[Κόσοβο: ο Χριστός ξανασταυρώνεται](http://www.youtube.com/watch?v=CAVkWvI-Hmk)", *ΑΝΤ1*, 2006 (<http://www.youtube.com/watch?v=CAVkWvI-Hmk>).

të strukturave qeveritare të Beogradit nuk ofron siguri dhe rehati për pakicat, sidomos për serbët. Politikat e reja diskriminuese dhe pasiguria, kësaj radhe të drejtuara kundër serbëve, kanë zëvendësuar politikat e ngjashme të së kaluarës. Kështu, pavarësia nuk sjell ndryshim të dukshëm në vend.

3. *Krijimi i parajsës së krimit të organizuar*.¹⁵⁹ Sipas këtij këndvështrimi, institucionet e dobëta të Kosovës jo vetëm që nuk mund t'i luftojnë rrjetet mafioze që po lulëzojnë në juridiksionin e tyre, por në të vërtetë krimi i organizuar është shumë i lidhur me sistemin politik të Kosovës; ky realitet pengon aktivitetet e paligjshme në Kosovë. Kështu, pavarësia nuk sjell stabilitet në rajon; në të vërtetë, ajo e krijon një shtet të ri që, në rastin më të mirë, nuk mund t'i luftojë rrjetet kriminale dhe, në rastin më të keq, i mban gjallë ato.

Në fund është grupi i katërt dhe mjaft i popullarizuar i krijuesve të opinionit, i cili ka qasje që mund të quhet pragmatike ose që bazohet në interesin nacional. Ithtarët e kësaj qasjeje nuk e mbështesin apo refuzojnë *a priori* pavarësinë. Çështja më e rëndësishme për ta është se si do t'i ndiqte më së miri Greqia interesat e saj nacionale lidhur me këtë çështje, e çliruar nga elementet historike ose thjeshtë sentimentale.¹⁶⁰ Sipas mendimi të tyre, Greqia duhet të vendosë nëse do ta njohë Kosovën apo jo duke u bazuar vetëm në interesat nacionale dhe jo në perceptimet për miq ose armiq të përhershëm. Analistët në këtë shkollë të mendimit theksojnë gjithashtu se marrëdhëniet me Serbinë nuk kanë qenë gjithmonë të këndshme, duke kujtuar se Beogradi e ka njohur IRJM-në me emrin e saj kushtetues dhe, së fundi, është përpjekur të krijojë 'partneritet strategjik në Ballkan' me Turqinë.

159 Për punën që përqendrohet në çështjen e krimit të organizuar në Kosovë, shih Μαίρη Μπόση: "Το οργανωμένο έγκλημα στα Βαλκάνια: η περίπτωση του Κοσσυφοπεδίου" in Σωτήρης Ντάλης (ed.), op. cit. p. 105-110; Ελευθέριος Καραγιάννης: "Η Ευρωπαϊκή πορεία του Κοσσυφοπεδίου", *Διπλωματικό Περίσκοπιο*, 2 Μαρτίου 2011 (http://www.diplomatikoperiskopio.com/index.php?option=com_content&view=article&id=746:2011-03-01-22-23-01&catid=35:2008-05-31-14-16-15&Itemid=59).

160 Për një shembull karakteristik, shih Σταύρος Τζίμας: "Η Ελλάδα και το Κόσοβο", *Καθημερινή*, 30 prill 2010 (http://news.kathimerini.gr/4dcgi/w_articles_columns_2_30/04/2010_399391).

Qëndrimi zyrtar i Greqisë

Së pari është e dobishme të citohet në njëfarë mase qëndrimi zyrtar i qeverisë greke.

“Greqia nuk e ka njohur shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Ne besojmë se çështje të këtij lloji duhet të zgjidhen përmes diplomacisë dhe konsensusit. Stabiliteti i rajonit më të gjerë mbetet themeli i politikës sonë.

Në të njëjtën kohë, ne po shikojmë përpara. Politika greke është e inspiruar nga vullneti ynë i sinqertë për të ndërtuar një mjedis paqes dhe prosperiteti për të gjithë popujt e rajonit, ku do të respektohen të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Përmirësimi i standardit të jetesës, mbrojtja e pakicave dhe respektimi i trashëgimisë kulturore dhe fetare janë prioritetet e larta. Ne i japim rëndësi rritjes ekonomike paralelisht me stabilitetin. Ne mbështesin plotësisht procesin e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, që do të lehtësohet nga BE-ja, në pajtim me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së të datës 9 shtator 2010, që është marrë pas Mendimit përkatës Këshillëdhënës – të nxjerrë më 22 korrik 2010 – nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë”.¹⁶¹

Citati në faqen e internetit të Ministrisë greke të Punëve të Jashtme tregon qartë karakteristikat kryesore të politikës zyrtare greke për pavarësinë e Kosovës. Greqia nuk e përjashton njohjen e pavarësisë së Kosovës (shih kohën e tashme të thjeshtë, që është përdorur: “Greqia nuk e njeh ...”), por e kushtëzon atë me zgjidhjen e arritur me marrëveshje të pranuar nga të dyja palët. Dy tipare kryesore janë identifikuar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës: një marrëveshje lidhur me të e të gjitha palëve të përfshira (“konsensus”) dhe që duhet të jetë rezultat i dialogut politik (“diplomacia”). Stabiliteti dhe përparimi përmenden vazhdimisht dhe prerazi në citat si qëllim themelor. Kjo përmendje e posaçme e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, pakicave dhe trashëgimisë kulturore tregon se Greqia është posaçërisht e shqetësuar për këto çështje të ndjeshme.

Një karakteristikë tjetër standarde e deklaratave zyrtare greke, edhe pse mungon në citatin e mësipërm, është formulimi i qëllimeve kryesore të politikave të Greqisë në Ballkan. Diplomacia greke vazhdimisht përsërit se zgjidhja përfundimtare e arritur me marrëveshje duhet të jetë në pajtim me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe që, pavarësisht nga rezultati, e ardhmja e tërë rajonit është në BE.¹⁶² Greqia e shih Europën si projekt të madh të paqes, prandaj përkrah rrugën e shpejtë për integrimin e tërë Ballkanit Perëndimor, natyrisht përfshirë Kosovën. Fakti që Greqia është duke

161 Marrëdhëniet bilaterale të Greqisë – Kosova*, Republika Helene – Ministria e Punëve të Jashtme (<http://www1.mfa.gr/en/blog/greece-bilateral-relations/kosovo/>)

162 Συνέντευξη Τύπου ΑΝΥΠΙΕΞ, κ. Δ. Δρούτσας, μετά το ΣΓΥ και το ΣΕΥ (Βρυξέλλες, 26.07.10), Republika Helene – Ministria e Punëve të Jashtme (http://www2.mfa.gr/www.mfa.gr/Articles/el-GR/260710_F1023.htm)

punuar për perspektivën europiane të tërë rajonit vlerësohet nga krijuesit kosovarë të politikave.¹⁶³

Në këtë kontekst, Greqia ka filluar një nismë të quajtur 'Agjenda 2014', duke u përpjekur të rikonfirmojë përkushtimin e BE-së ndaj integritit europian të Ballkanit

Perëndimor dhe premtimin e dhënë në Selanik më 2001.¹⁶⁴ Sipas kësaj nisme, të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të bëhen anëtare të BE-së ose, së paku, të hyjnë pakthyesëm në etapën e fundit të kursit të tyre të anëtarësimit deri më 2014, një datë simbolike, meqë shënon përvjetorin e njëqindtë të atentatit ndaj trashëgimitarit të fronit austriak dhe shkëndijën e Luftës së Parë Botërore. Në fushatën e saj për përkrahjen e 'Agjendës 2014', Ministria greke e Punëve të Jashtme lidh zgjidhjen e suksesshme të problemeve që kanë të bëjnë me sigurinë në rajon me integrimin e tij europian.¹⁶⁵ Një fjali e përhershme në njoftimet zyrtare greke është se qëndrimi grek për pavarësinë e Kosovës është i vendosur dhe i mirënjohur. Sipas deklaratave të Ministrisë, diplomacia greke nuk e ka shqyrtuar korrigjimin e këtij qëndrimi as pas rezolutave të Parlamentit Europian, që u bënë thirrje shteteve anëtare të BE-së ta njohin pavarësinë e Kosovës, as pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për Kosovën.¹⁶⁶

Interpretimi i qëndrimit grek

Zyrtarët grekë herë pas here kanë dhënë argumentimin e tyre zyrtar në bazë të të cilit është marrë vendimi për mosnjohjen e Kosovës së pavarur. Argumentet, shpesh të ndërlidhura, mund të ndahen në ato që mbrojnë respektimin e së drejtës ndërkombëtare dhe ato që shprehin shqetësime lidhur me shkaktimin e precedentit për veprime të tjera të njëanshme dhe implikimet e mundshme që mund të kenë ato në stabilitetin global.

Argumenti i mëparshëm thekson nevojën e të vepruarit në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Shprehja zakonisht përdoret për të kërkuar respektimin e integritetit territorial të shteteve dhe, pa dyshim, i mbetet besnike kornizës së KB-së dhe rezolutave të aprovuara nga organet e saj. Çështja është se një rajon i shkatërruar nga lufta nuk mund të ecë drejt paqes dhe stabilitetit përderisa nuk arrihet një zgjidhje e

163 "Greqia nuk ndryshon qëndrimin ndaj Kosovës", *Bota Sot*, 8 shtator 2011 (<http://www.botasot.info/def.php?category=3&id=135659>).

164 Ατζέντα 2014, Republika Helene – Ministria e Punëve të Jashtme (http://www1.mfa.gr/images/docs/periferiaki_politiki/agenda_2014_gr.pdf)

165 Ενημέρωση των διπλωματικών συντακτών από τον Εκπρόσωπο του ΥΠΕΞ, κ. Γρηγόρη Δελαβέκουρα, Republika Helene – Ministria e Punëve të Jashtme (http://www2.mfa.gr/www.mfa.gr/Articles/el-GR/020910_AH1807.htm)

166 "Greqia e paprekur nga rezoluta e PE", *B92*, 6 shkurt 2009 (http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2009&mm=02&dd=06&nav_id=56965); "Δ. Δρούτσας: Δε θα αφήσουμε την Τουρκία να μας παρασύρει σε ανεξέλεγκτες καταστάσεις", *Αγγελιοφόρος*, 26 korrik 2010 (<http://www.agelioforos.gr/default.asp?pid=7&ct=1&artid=52076>)

bazuar në parimet e pranuar ndërkombëtarisht dhe jo në zgjedhjet e njëanshme të kontestueshme që çojnë drejt bllokimeve të vazhdueshme dhe kushteve të brishta të sigurisë. Lartësimi i së drejtës ndërkombëtare është në pajtim me qëndrimin që mban Greqia për problemet e veta (për shembull Egjeu) dhe pasqyron imazhin e vendit si mbrojtës i status quo-së dhe fuqi jorishikuese që nga fillimi i viteve nëntëdhjetë.¹⁶⁷

Duke u bazuar në argumentin e mësipërm, Greqia ka paralajmëruar se njohja e shpalljes së njëanshme të pavarësisë të Kosovës do të ndikojë në krijimin e precedentit juridik. Ky precedent do të kalojë në mënyrë të pashmangshme në politikën ndërkombëtare, si dhe do të fillojë efektin domino për disa zona të konfliktit anembanë globit, ku entitetet që dëshirojnë të shpëputen do të përpiqen ta zbatojnë modelin e Kosovës në rrugën e tyre drejt pavarësisë, që do të kishte efekte shumë të dëmshme për sigurinë dhe stabilitetin global.¹⁶⁸ Në fund të fundit paralajmërimi për precedent është argumenti kryesor i vendeve të tjera mosnjohëse, natyrisht atyre të BE-së.

Për më tepër, grekët kanë arsyet e veta që brengosen për krijimin e mundshëm të një precedenti të tillë për shkak të problemit të Qipros. Njohjen ndërkombëtare të shtetit të vetëshpallur të qipriotëve turq e ka bërë vetëm Turqia, por prapëseprapë çdo mundësi që njohja e shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga ana e Kosovës do të jetë precedent për Qipron u shkakton dyshime dhe shqetësime grekëve.¹⁶⁹ Disa analistë grekë paralajmërojnë se çdo lidhje e Kosovës me problemin e qipriotëve turq është e dëmshme për qëndrimet greke.¹⁷⁰ Dhe zyrtarë grekë tërheqin qartazi një linjë dalluese ndërmjet rastit të Kosovës dhe të Qipros Veriore të vetëshpallur, duke cituar referencën qartë të ngjashme të bërë në mendimin këshillëdhënës të GJND-së për Kosovën në korrik 2010;¹⁷¹ Republika e Qipros madje është parë si “përfutuese indirekte” e mendimit këshillëdhënës të GJND-së për Kosovën.¹⁷²

Megjithatë, frika nga precedenti përmes rastit të Kosovës është e përhapur dhe ka prirjen ta lidhë vendosmërisht diplomacinë greke me grupin mosnjohës; ashtu siç thotë proverbi ‘më mirë të jemi të sigurt se sa të ndiejmë keqardhje’, sidomos “për arsye se në politikë çdo gjë mund të lidhet me çdo gjë”.¹⁷³ Interesante është se opinionistët në Kosovë gjithnjë e më tepër kanë filluar të kuptojnë se frika nga vendosja e precedentit

167 Άγγελος Αθανασόπουλος: “Το μακροχρόνιο πρόβλημα”, *Το Βήμα*, 6 mars 2008 (<http://www.tovima.gr/opinions/article/?aid=230330&wordsinarticle=>)

168 Ιωάννα Παπαδημητροπούλου: “Το Κόσοβο ανοίγει την πόρτα για αποσχιστικό ντόμινο”, *Εθνος*, 7 dhjetor 2007 (<http://www.ethnos.gr/article.asp?catid=22769&subid=2&pubid=162404>)

169 Evgeny Postnikov & Brandon M. Boylan, “Bashkimi European dhe Politika e Njohjes së Kosovës: Separatizmi i Brendshëm dhe Fleksibiliteti Institucional”, *Konferenca Dyvjeçare e Asociacionit të Studimeve të Bashkimit European*, 3-5 mars 2011, f.8

170 Shih, për shembull, Σταύρος Τζιμάς: op. cit.

171 Qëndrimi grek për Kosovën: Ministri Ndërrues i Jashtëm Grek Dimitris Droustas shprehë mendimin e vet lidhur me qëndrimin e Athinës për Kosovën, Radio *Athina* 98.4, 10 gusht 2010 (<http://www.kosovocompromise.com/cms/item/topic/en.html?view=story&id=2959§ionId=2>); për shtjellimin e hollësishëm të mendimit të GJND-së lidhur me shpalljen e pavarësisë nga Kosova dhe rëndësinë e kësaj për rastin e Qipros, shih Alexandros Mallias, op.cit.

172 Alexandros Mallias, op.cit. f.3.

173 Intervista e autorëve me burimin nga Ministria Helene e Punëve të Jashtme

për Qipron përmes pavarësisë së Kosovës është forca kryesore shtytëse prapa qëndrimit grek. Në të vërtetë, në një raport të Klubit Kosovar për Politikë të Jashtme, pas vendimit të GjND-së, kërkohet nga qeveria e Prishtinës që të merret me frikën dhe shqetësimet e qeverisë greke duke argumentuar, mes të tjerash, dhe deklaruar zyrtarisht që rasti i Kosovës është ndryshe nga ai i Qipros, i cili ka të bëjë me sulm nga shteti i tretë.¹⁷⁴

Në fund, disa analistë, sidomos jashtë Greqisë, priren ta sqarojnë qëndrimin e Greqisë duke iu referuar lidhjeve të posaçme me Serbinë.¹⁷⁵ Sipas këtij argumenti, Greqia rreshtohet në anën e Serbisë lidhur me çështjen e Kosovës për shkak të lidhjeve ekonomike dhe politike të të dy vendeve, një marrëdhënie që Greqia nuk do të donte ta prishte duke e njohur Kosovën. Natyrisht, Greqia e konsideron Serbinë si partnere dhe elementin kryesor në sistemin e sigurisë në Ballkan dhe përpiket të mbajë raporte të mira me Beogradin. Por theksimi i tepër i kësaj marrëdhënieje nga disa analistë ndërkombëtarë më tepër pasqyron situatën e trazuar të viteve nëntëdhjetë. Politika e jashtme greke i vështron sot Ballkanin dhe problemin e Kosovës në mënyrë shumë më pragmatike dhe qëndrimi i saj ndaj pavarësisë së Kosovës është i lidhur me shqetësimet për precedentin që mund të shkaktohet dhe me pasojat e tij për politikën ndërkombëtare.

Veprimi balancues i Greqisë

Siç u sqarua më sipër Greqia, vazhdon me politikën e qartë të mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës, e cila në sytë e politikëbërësve është në pajtim me qasjen e saj parimore për problemet e Ballkanit dhe politikën botërore në tërësi; për më tepër, kjo politikë nuk mund të konsiderohet vetëm si qëndrim proserb ose vetëm pasqyrim i marrëdhënieve të mira ndërmjet Athinës dhe Beogradit. Megjithatë, përkundër politikës së qartë mosnjohëse, Greqia po respektuar një veprim të balancuar me kujdes, që krijon mundësi për zhvillimin e marrëdhënieve me Kosovën, si dhe zbatimin e plotë të politikave ndërkombëtare, sidomos të BE-së, për problemin e Kosovës.

Në ditën e shpalljes së pavarësisë nga Kosova (por për një kohë edhe pas kësaj)¹⁷⁶, udhëheqja greke nuk dha ndonjë deklaratë të prerë dhe kategorike që të mohonte njohjen e shtetit të saposhpallur. Në vend të kësaj, pa kaluar shumë kohë nga shpallja e pavarësisë, ministria e atëhershme e Jashtme, Bakoyanni, tha: “Greqia do t’i marrë vendimet e saj në një fazë të ardhshme, pasi t’i ketë ekzaminuar të gjitha zhvillimet me hollësi; të gjitha dimensionet dhe pasojat që kanë këto zhvillime për sigurinë rajonale

174 “*Athina – sa afër e sa larg*”, *Klubi për Politikë të Jashtme*, gusht 2011, mund të gjendet në (<http://www.foreignpolicyclub.org/pdf/301011016181813.pdf>)

175 Evgeny Postnikov & Brandon M. Boylan, op. cit.

176 “Greqia: Nuk ngutet ta njohë Kosovën”, *B92*, 15 mars 2008 (http://www.b92.net/eng/news/region-article.php?yyyy=2008&mm=03&dd=15&nav_id=48474)

dhe interesat e Greqisë”.¹⁷⁷ Në vend që të tregonte se njohja e Kosovës ishte e sigurt në atë kohë, kjo qasje me sa dukej ishte më tepër një përpjekje e kujdesshme për të mos bërë lëvizje të nxituara.¹⁷⁸ Në fund të fundit, nuk duhet të harrojmë se shumica e partnerëve të Greqisë në BE e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe Athina nuk do të dëshironte që të izolohej sërish në Europë për shkak të politikës së saj për Ballkanin.

Me kalimin e kohës, u formua një grup jozyrtar i shteteve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën dhe çdo trysnia e mundshme ndaj tyre u pakësua, ngaqë në tryezë u diskutuan shqetësime më të ngutshme.¹⁷⁹ Kjo e bëri më të lehta zgjedhjen politike për grekët dhe mënjanoi barrën e njohjes, meqë Greçia nuk shihet si vendi që shpreh vendosmëri më të madhe kundër pavarësisë së Kosovës nga pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin atë.

Përkundër kësaj politike të mosnjohjes, Greçia ka zgjedhur të ketë marrëdhënie konstruktive me Prishtinën. E kemi parë më sipër (pjesa ‘Komunikimet e dyanshme qeveritare’) se si Athina ka ruajtur kanalet zyrtare të komunikimit me Prishtinën, ka pranuar dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Kosovës, ka lehtësuar komunikimin dhe transportin e qytetarëve ndërmjet Kosovës dhe Greqisë dhe ka përkrahur tregtinë dhe investimet ndërmjet dy palëve. Përveç kësaj, Greçia është posaçërisht aktive në dhënien e ndihmës ndaj Kosovës përmes Zyrës së saj Ndërlidhëse në Prishtinë.¹⁸⁰

Po ashtu, kjo qasje konstruktive mund të shihet në qëndrimet e Greqisë ndaj anëtarësimit të Kosovës në disa organizata ndërkombëtare. Sipas analistëve, qëndrimi i Greqisë në votimin përkatës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore ka kontribuar në aplikimin e suksesshëm të Kosovës për anëtarësim.¹⁸¹ Edhe pse ende nuk ka ndonjë konfirmim zyrtar lidhur me këtë, mediat raportojnë që Greçia do të mbështesë hyrjen e Kosovës në Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.¹⁸² Këto gjëra nuk kanë kaluar pa u vënë re nga krijuesit kosovarë të politikave dhe ata të opinionit, të cilët duket se e çmojnë qasjen pragmatike të Greqisë lidhur me këtë çështje.¹⁸³ Siç ka tërhequr vëmendjen Klubi Kosovar për Politikë të Jashtme, Greçia “ka qëndrimin më konstruktiv ndaj Kosovës” ndër vendet mosnjohëse të BE-së.¹⁸⁴

177 Deklaratat e MJ znj. Bakoyannis pas Këshillit të BE-së për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie me Jashtë (GAERC, Bruksel), Republika Helene – Ministria për Punë të Jashtme (http://www2.mfa.gr/www.mfa.gr/Articles/en-US/190208_alp_1300.htm)

178 Intervista e autorëve me burimin e Ministrisë Helene të Punëve të Jashtme

179 “Kosova / BE: Lehtësohet presioni mbi pesë vendet që janë kundër pavarësisë”, *Analiza Analitike Globale Strategjike e Oksfordit*, 4 janar 2010.

180 Klubi për Politikë të Jashtme, op.cit.

181 Neil MacDonald: “Kosova tregon se ka vota të mjaftueshme për t’iu bashkuar FMN-së”, *Financial Times*, 6 maj 2009 (<http://www.ft.com/intl/cms/s/0/db5f737a-39d6-11de-b82d-00144feabd0c.html#axzz1Xh8ik696>)

182 Artan M. Haraqija: “Greçia, pro anëtarësimit të Kosovës në BERZH”, *Zëri.info*, 3 shtator 2011 (<http://www.zeri.info/artikulli/2/8/33298/greçia-pro-anetaresimit-te-kosoves-ne-berzh/>)

183 Po aty.; Klubi për Politikë të Jashtme, op.cit.; Muhamet Brajshori: “Kosova ndërton lidhjet me Greçinë për ekonomi, BE”, *Southeast European Times*, 10 shtator 2011 (http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2011/09/10/feature-01)

184 Klubi për Politikë të Jashtme, op. cit., f.3.

Qëndrimi i Greqisë ndaj rastit të Kosovës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) dëshmon gjithashtu për politikën e saj ndaj Kosovës. Greqia ka votuar për rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së, e cila përkrahte nismën serbe për të kërkuar mendimin këshillëdhënës të GJND-së. Por gjatë procedurës gjyqësore, Athina as nuk dorëzoi ndonjë deklaratë me shkrim, as nuk paraqiti qëndrimin e saj me gojë gjatë seancave publike të shqyrtimit. Përkundrazi, të katër vendet tjera mosnjohëse të BE-së ishin bashkë me 42 vendet e tjera që merrnin pjesë në procedurën gjyqësore dhe e refuzonin fuqishëm pavarësinë e Kosovës.

Të gjitha faktet e mësipërme tregojnë se, përkundër mosnjohjes, Greqia ka një qasje të posaçme ndaj pavarësisë së Kosovës, që shndërrohet në komunikim të këndshëm të dyanshëm, në atmosferë miqësore. Arsyeja për një qëndrim të tillë është se, përkundër rezervave të konsiderueshme greke ndaj pavarësisë, ajo nuk dëshiron ta izolojë Kosovën apo të devijojë nga zgjedhjet themelore të politikës së partnerëve të saj perëndimorë. Si rezultat, partnerët e BE-së pranojnë potencialin konstruktiv dhe të ndërmjetëm të Greqisë.¹⁸⁵

Vetë kosovarët nuk preken nga politika e Greqisë dhe, ndonëse dëshirojnë të njihen nga Athina, nuk duket që ata të ushtrojnë trysni.¹⁸⁶ Prishtina merr parasysh shqetësimet greke dhe mirëpret rolin konstruktiv të qeverisë greke.¹⁸⁷ Pas vizitës së fundit të ministrit të ri të Jashtëm grek Stavros Lamprinidis në Prishtinë, kryeministri kosovar Hashim Thaçi e bëri të qartë qëndrimin e qeverisë së tij si vijon: marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Greqisë "...do të përkrahen dhe do të jenë marrëdhënie ndërmjet dy vendeve mike. Kërkesa jonë për njohje natyrisht ekziston gjithmonë, por kjo është zgjedhje që duhet ta bëjë Athina si shtet sovran dhe e mbështet këtë vendim që është në pajtim me interesat e shtetit dhe të popullit grek. Po ashtu, dëshiroj ta falënderoj edhe një herë ministrin e Jashtëm grek për mbështetjen e plotë, që ka sjellë një frymë uniteti brenda BE-së në lidhje me perspektivën europiane të Kosovës".¹⁸⁸

Mirëkuptimi i interesave dhe i ndjeshmërisë nacionale të vendit tjetër është reciprok. Për shembull, Greqia nuk ka shprehur pakënaqësi kur Kosova njohu dhe vendosi marrëdhënie zyrtare diplomatike me IRJM-në me emrin e saj kushtetues.¹⁸⁹ Përveç

185 Konferenca për shtyp e Ministrit Ndërrues Grek për Punë të Jashtme D. Droutsas, Bruksel, 26 korrik 2010 (http://www2.mfa.gr/www.mfa.gr/Articles/en-US/27072010_ALK1305.htm)

186 Muhamet Brajshori, op. cit.

187 Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri takon zyrtarët qeveritarë grekë, op. cit.

188 "Greqia nuk ndryshon qëndrimin ndaj Kosovës", *Bota Sot*, 8 shtator 2011 (<http://www.botasot.info/def.php?category=3&id=135659>).

189 Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, shih "Komunikata e përbashkët për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë", e nënshkruar në tetor 2009 (<http://www.mfa-ks.net/repository/docs/shqip-226.pdf>); për rritjen e marrëdhënieve ekonomike Kosovë-IRJM, shih Fatos Musliu & Pandeli Pani: "Marrëdhënie diplomatike mes Maqedonisë dhe Kosovës", *Deutsche Welle*, tetor 2009 (<http://www.dw-world.de/dw/article/0,4803300,00.html>); "Rritet këmbimi tregtar midis Maqedonisë dhe Kosovës", *Lajm Maqedonia*, tetor 2011 (<http://lajmpress.com/lajme/maqedoni/11199.html>); Marrëdhëniet ekonomike Kosovë-Maqedoni kanë shënuar zhvillim pozitiv (<http://mem.rks-gov.net/?page=1,42,395>)

kësaj, Greqia nuk ka lejuar që, marrëdhëniet nganjëherë të trazuara me Shqipërinë dhe mosmarrëveshjet ndërmjet Athinës dhe Tiranës, të përkeqësojnë marrëdhëniet e saj me Kosovën. Greqia ka mbetur kontribuuese konsekuente e mirëqenies politike dhe materiale të Kosovës, madje edhe në kohën kur opinioni publik grek përkrahte në masë të madhe Serbinë ose kur, në të kaluarën, marrëdhëniet me Shqipërinë ishin të tendosura. Nënkuptohej që nëse marrëdhëniet ndërmjet Athinës dhe Tiranës përmirësohen edhe më shumë, mund pritet ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndërmjet Athinës dhe Prishtinës.

Në përgjithësi, siç u tregua edhe në këtë punim, marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Kosovës shkojnë shumë përtej politikës së njohjes. Marrëdhëniet u zhvilluan, u rritën dhe u poqën përkundër mungesës së njohjes. Të dyja palët kanë shumë mundësi që t'i intensifikojnë edhe më tepër kontaktet dhe bashkëpunimin e tyre dhe Athina të vazhdojë politikën e saj të mosizolimit të Kosovës. Për këtë të fundit mundësia e shfrytëzimit të udhëkryqit kryesor tregtar dhe transportues të Selanikut ka rëndësi shumë të madhe. Përveç kësaj, politika greke, si brenda vetë Kosovës ashtu edhe në organizatat ndërkombëtare, kontribuon për stabilitetin e saj. Për më tepër, Greqia luan rolin e avokatit kryesor të Ballkanit në BE; sidomos në epokën e lodhjes nga zgjerimi, Greqia ndoshta është kampioni më i flaktë i anëtarësimit të shpejtë të Ballkanit Perëndimor në BE, një proces ku bën pjesë edhe Kosova. *Marrëveshja e përkohshme* ndërmjet Greqisë dhe Kosovës mund të shihet si hap i suksesshëm në situatat komplekse dhe të vështira për tejkalimin e mosmarrëveshjeve lidhur me problemet kryesor të Ballkanit. Në të vërtetë, qasja e Greqisë mund t'u japë shteteve të tjera ide të dobishme për mënyrën se si një vend që nuk e ka njohur Kosovën prapëseprapë mund të mbajë qëndrim bashkëpunues dhe konstruktiv ndaj saj.

Qiproja

Qiproja

Punim lidhur me qëndrimin për Kosovën

DR. GIORGOS KENTAS, profesor asistent për politikat ndërkombëtare, Universiteti i Nikozisë, Qipro.

Hyrje

Ky punim shqyrton qëndrimin e Qipros ndaj Kosovës.¹⁹⁰ Qiproja nuk ka as marrëdhënie zyrtare as jozyrtare me Republikën e Kosovës. Është njëri prej pesë shteteve anëtare të BE-së që nuk e njeh Kosovën, por është shteti i vetëm anëtar i Unionit që nuk kontribuon në forcën e EULEX-it në Kosovë, në misionin e BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë (2008/124/CFSP).¹⁹¹ Qëndrimi i Qipros për Kosovën është aq i prerë sa nuk njeh as dokumentet e Kosovës (p.sh. dokumentet e udhëtimit).¹⁹² Ky qëndrim bazohet në disa karakteristika që duhet të shqyrtohen plotësisht.

Shpjegimi i arsyeshëm i qëndrimit të Qipros ndaj Kosovës bazohet në faktorët historikë, politikë, kulturorë dhe ekonomikë. Marrëdhëniet e Qipros me Ballkanin datojnë që nga Lufta e parë Ballkanike (1912-1913).¹⁹³ Megjithatë, takimi i parë i Qipros si shtet i pavarur me Ballkanin lidhet me krijimin e Lëvizjes së të Painkuadruarve më 1961. Kryetari i parë i Qipros, kryepeshkopi Makarios III dhe kryetari i Jugosllavisë, Josip Broz Tito, ishin ndër themeluesit e Lëvizjes.¹⁹⁴ Gjatë luftës së ftohtë, Qiproja dhe Jugosllavia krijuan një marrëdhënie të fortë dhe konsideronin njëra-tjetrën si aleatë të afërt. Në vitet gjashtëdhjetë, kur Republika e Qipros u mor me disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, që ndonjëherë kërcënonin ekzistencën e saj, Jugosllavia ishte mbështetëse e përkushtuar e kauzës së Qipros për mbijetesë.¹⁹⁵ Pas pushtimit ushtarak turk më

190 Analiza përqendrohet në qëndrimin e Republikës së Qipros. Janë marrë parasysh po ashtu edhe qëndrimet e aktorëve të tjerë qipriotë.

191 G.Crevi, EULEX Kosovë, në G. Grevi et al., *Politika Europiane për Siguri dhe Mbrojtje* (Lisbonë: Instituti i BE-së për Studime të Sigurisë, 2009), faqe 353-368.

192 Sot Qiproja eksporton vetëm një produkt në Kosovë, megjithatë nuk importon asnjë prodhim prej saj; shih Republika e Qipros, *Statistikat tregtare brenda dhe jashtë BE-së sipas prodhimeve dhe vendeve* (Nikozia: Shërbimi Statistikor i Qipros, 2011).

193 Qipriotët grekë e lidhnin Luftën Ballkanike me përpjekjen e tyre për çlirim dhe e kanë konsideruar veten pjesë të luftës greke për liri. Shih P. Papapoliviou, *Qiproja dhe luftërat ballkanike* (Nikozi: Qendra Kërkimore e Qipros, 1997), në gjuhën greke.

194 Kur hyri në BE më 2004, Qiproja tërhoqi anëtarësimin nga Lëvizja e të Painkuadruarve, por merr pjesë në takimet e saj si mysafire.

195 Në tetor 1964, kryetari Tito i Jugosllavisë arriti në Qipro për një vizitë prej gjashtë orësh me kryetarin Makarios. Kjo vizitë nënvizoi përkrahjen e Jugosllavisë për përpjekjet e Qipros për pavarësi; shih The Resister-Guard, 'Tito në Qipro', 18 tetor 1964.

1974, Jugosllavia ishte njëra prej vendeve të para që i erdhi në ndihmë Republikës së Qipros. Deri në shpërbërjen e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në fillim të viteve nëntëdhjetë, marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet dy vendeve ishin në nivel shumë të mirë.

Kriza e Ballkanit, sidoqoftë, nxori në pah ndikimin e fshehtë të marrëdhënieve ndërmjet Qipros dhe Jugosllavisë. Nëse e shikojmë këtë marrëdhënie nga pozita e favorshme¹⁹⁶ e marrëdhënieve ndërkombëtare (MN), forma dhe shkalla e saj bazohej në interesin e përbashkët, rrethanat e luftës së ftohte dhe lidhjet personale ndërmjet liderëve historikë të këtyre vendeve.

Ndarja, konflikti etnik dhe lufta në Jugosllavi, sidoqoftë, zbuluan një element të rrënjësor thellë kulturor-fetar të marrëdhënieve të tyre. Që nga fazat e hershme të konfliktit në (ish) Jugosllavi më 1991 e deri kur u bë shkatërrimi i fundit i Republikës Federative të Jugosllavisë më 2008, Republika e Qipros ishte mbështetëse e përkushtuar e kauzës serbe. Megjithatë, kjo njëanshmëri nuk e pengoi Nikozinë të pranonte gjendjen e re të krijuar në rajon dhe të vazhdonte marrëdhëniet e mira me shtetet që u krijuan.

Qëndrimi i qeverisë së Qipros lidhur me gjendjen e re të krijuar në Ballkan bazohej rreptësisht në kritere politike. Nikozia i pranoi të gjitha shtetet e reja, përveç Kosovës. Vendimi për mosnjohjen e Kosovës bazohet në një interpretim të caktuar të së drejtës ndërkombëtare.¹⁹⁷ Nikozia po ashtu është e shqetësuar lidhur me implikimet e mundshme të rastit të Kosovës në zgjidhjen përfundimtare të problemit të Qipros.

Në anën tjetër, populli i Qipros e sheh çështjen e Kosovës nga aspekti kulturor dhe fetar. Pjesa dërmuese e qipriotëve grekë i mirëkuptojnë serbët, sepse i konsiderojnë ata viktimat të ndërhyrjes së huaj dhe të diskriminimit fetar. Mes popujve të krishterë ortodoksë ekziston ndjenja e besimit të përbashkët. Pjesa dërmuese e qipriotëve turq i mirëkuptojnë popujt myslimanë në rajon. Duke menduar në mënyrë të njëjtë ideologjike si qipriotët grekë, ata mendojnë se myslimanët janë viktimat të diskriminimit dhe shtypjes së krishterë. Edhe pse feja kurrë nuk ka qenë element i rëndësishëm i konfliktit në Qipro, kur është fjala për konfliktet ndërkombëtare këndvështrimet e qipriotëve grekë dhe turq krijohen nga faktorët etno-kulturorë dhe fetarë.¹⁹⁸

196 I referohem fushës akademike të marrëdhënieve ndërkombëtare, që kryesisht merret me marrëdhëniet ndërmjet shteteve.

197 Kjo çështje është trajtuar në pjesët vijuese.

198 Megjithatë, ky qëndrim nuk pasqyrohet në diskursin politik të udhëheqjeve të dy komuniteteve. Këta të fundit prirën t'i politizojnë ose t'i mbrojnë implikimet e konfliktit ndërkombëtar për rritjen e konfliktit të Qipros. Nga aspekti shoqëror, kulturor ose politik, as komuniteti qipriot grek, as komuniteti qipriot turk nuk është homogjen. Ashtu si ndodh edhe në të gjitha komunitetet politike, disa këndvështrime mbizotërojnë mbi të tjerat.

Faktorët historikë, politikë dhe kulturorë-fetarë plotësohen nga ata ekonomikë. Marrëdhënia e fuqishme ekonomike ndërmjet Serbisë dhe Qipros mund të thjeshtohen në lidhjet e fuqishme historike dhe politike ndërmjet dy vendeve, si dhe në interesat që janë lënë në duart e ndërmarrësve të caktuar qipriotë dhe serbë.¹⁹⁹ Qiproja ka marrëdhënie të mira ekonomike me të gjitha shtetet e Ballkanit, por pjesa më e madhe e transaksioneve ekonomike ndërmjet Qipros dhe Ballkanit bëhet me Serbinë. Ky aspekt i marrëdhënieve ndërmjet Qipros dhe Serbisë, megjithatë, është i mjaftueshëm por jo i domosdoshëm për shtjellimin e qëndrimit të Nikozisë ndaj Prishtinës. Për më tepër, lidhjet historike dhe kulturore-fetare ndërmjet dy vendeve mund të jenë thelbësore dhe nuk mund të lihen aq lehtë pas dore, por kur të adresohen faktorët relevantë politikë, qëndrimi i Qipros ndaj Kosovës do të ndryshojë pavarësisht nga çdo gjë tjetër.²⁰⁰

Duke e pasur parasysh këtë “realitet”, kjo gazetë gjurmon zhvillimin historik të qëndrimit të Qipros ndaj Kosovës gjatë dy dekadave të kaluara (1991-2011). Në pjesën e parë jepen vërejte të shkurta lidhur me reagimin e Qipros ndaj luftës në Ballkan në fillim të viteve nëntëdhjetë. Pjesa e dytë merret me reagimin e Qipros ndaj luftës në Kosovë më 1999. Pjesa e tretë shqyrton reagimin e Qipros ndaj shpalljes së pavarësisë nga ana e Kosovës në shkurt 2008 dhe bën krahasimin e këndvështrimeve të Republikës së Qipros, qipriotëve grekë, qipriotëve turq dhe Turqisë. Në fund, pjesa e katërt shqyrton mundësinë e ndryshimit të qëndrimit në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Kosovës.

1. Reagimi ndaj luftës në Ballkan

Shpërthimi i luftës në Ballkan në fillim të viteve nëntëdhjetë dhe kriza humanitare që pasoi, shkaktuan një valë keqardhjeje për viktimat. Përvoja e hidhur e luftës së vitit 1974 ishte relativisht e freskët në mendjet dhe zemrat e qipriotëve, të cilët ndjenë se duhet të vepronin. Qeveria e Qipros, si dhe Kisha e Qipros,²⁰¹ dërguan ndihmë të konsiderueshme humanitare në Ballkan. Ndihma iu drejtohej ekskluzivisht serbëve, jo për arsyes se viktimat e tjera të luftës lireshin pas dore, por për shkak se ekzistonte

199 Për analiza të mëtejshme të kësaj marrëdhënieje, shih Asociacioni i Biznesit Qipro Serbia (<http://www.cyprus-serbia.org.cy/>), e shikuar për herë të fundit në shtator 2011).

200 Kjo çështje është diskutuar me diplomatët qipriotë dhe serbë. Pikëpamja dominuese është që, nëse Prishtina dhe Beogradi arrijnë një zgjidhje të statusit të Kosovës të pranuar nga të dyja palët, Qiproja nuk do të ketë kurrfarë problemi për t'i normalizuar marrëdhëniet e saj me Kosovën. Një diplomat qipriot është shprehur se normalizimi i marrëdhënieve Qipro-Kosovë varet nga normalizimi i marrëdhënieve Serbi-Kosovë. Megjithatë, një diplomat serb ka debatuar dhe ka thënë se Kosova gjithmonë do të jetë burim pasigurie politike për Nikozinë, sepse paraqet model për konfliktin e Qipros. Intervista të bëra në mars 2008 dhe shtator 2011. Po ashtu, shih intervistat me G. Macris (SHBA), V. Maystrenko (Rusi), P. Millet (MB) dhe M. Jelic (Serbi) për Kosovën në revistën *Apopsi* (prill 2008), që mund ta gjeni në faqen <http://www.apopsi.com.cy/date/2008/4> (në gjuhën greke, por po ashtu të përkthyer në gjuhën angleze).

201 Kisha Ortodokse e Qipros ka luajtur një rol të rëndësishëm. Ky institucion ka ekzistuar para krijimit të shtetit të Qipros dhe funksionon i pavarur nga institucionet politike. Roli kryesor i kishës është kritikuar nga disa që pohojnë se ajo nxitë nacionalizëm dhe urrejtje.

një ndjenjë ngutjeje që të ndihmoheshin njerëzit me fe dhe kulturë të njëjtë, të cilët përpiqeshin për lirinë e tyre. Nuk ka kurrfarë dyshimi që kontributi i Qipros për lehtësimin e krizës humanitare në Ballkan ishte i njëanshëm.²⁰²

Në lidhje me politikën e luftës në Ballkan, qeveria e Qipros dukej skeptike për ndërmjetësimin e palës së tretë. Mendimi që mbizotëronte tek elitat politike dhe opinionin i gjerë ishte që intervenimi i palës së tretë kishte për qëllim përkrahjen e interesave të NATO-s në rajon.²⁰³ Të pushtuar me problemin e Qipros, shqetësimi kryesor i qipriotëve grekë ishte gracka e një procesi të ngjashëm me Dejtonin për zgjidhjen e problemit të tyre politik. Ndërmjetësuesit, në anën tjetër, i shihnin gjërat ndryshe. Për shembull, Richard Holbrook, një figurë udhëheqëse në atë kohë, pohonte se Qiproja është shembull i keq që duhet të merret parasysh gjatë menaxhimit të konfliktit në Ballkan. “Duhet të parandalojmë që Bosnja,” shkruante ai, “të bëhet Qipro apo Kore.”²⁰⁴

Rezultati i luftës në periudhën pas Dejtonit nuk ndikoi në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Jugosllavisë. Shteti i suksesshëm i Jugosllavisë (domethënë Republika Federative e Jugosllavisë) konsiderohej aleat i afërt dhe shtet miqësor. Megjithatë, politika e jashtme e Republikës së Qipros po kalonte nëpër një ndryshim të rëndësishëm. Disa muaj para nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit (nëntor 1995), BE-ja ia bëri një premtim të rëndësishëm Qipros: ajo po e merrte parasysh Republikën e Qipros për anëtarësim të ardhshëm në Union. Prej atëherë dhe deri sa u arrit anëtarësimi, Nikozia e kishte hyrjen në BE prioritet kryesor të politikës së jashtme. Një implikim themelor për anëtarësim të ardhshëm në Union ishte obligimi i Republikës së Qipros që të bënte përafrimin e politikës së saj të jashtme me politikën e përbashkët të BE-së për punët e jashtme dhe sigurinë. Gjatë negociatave për anëtarësim, neutraliteti nuk ishte alternativë për Qipron.

Më 1998, kur filluan bisedimet për anëtarësim, u dukën shenjat e para të përshtatjes së politikës së jashtme me qëndrimet e BE-së. Ndërmjet viteve 1998-2002 (domethënë gjatë bisedimeve për anëtarësim), Qipros iu desh ta përshtaste politikën e jashtme në pajtim me politikën e jashtme të BE-së. Në mes tjerash, ajo iu bashkua qëndrimeve të përbashkëta të Unionit për një mori çështjesh, duke përfshirë Kosovën dhe ish-Republikën e Jugosllavisë.²⁰⁵ Megjithatë, ashtu si dhe në rastin e të gjitha shteteve

202 Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë befasi, pasi Qiproja mund të ketë respektuar praktikën që zbatohet në marrëdhëniet ndërkombëtare e që respektohet rregullisht nga të gjitha shtetet.

203 Ky shqetësim bazohet në faktorët historikë. Shumë qipriotë grekë mendojnë se NATO-ja ka luajtur rol në përgatitjen e grusht shtetit më 1974 në Qipro. Gjatë viteve nëntëdhjetë, qipriotët grekë kanë menduar se, kur është në pyetje Qiproja, NATO-ja mbështet interesin e Turqisë për shkak të rolit shumë të rëndësishëm të kësaj të fundit në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

204 R. Holbrooke, *Të përfundosh një luftë* (New York: Random House), faqe 226. Megjithatë, kritikët e z. Holbrooke mund të kenë të drejtë. Në të njëjtin libër ai ka sugjeruar se metoda që u shfrytëzua në Bosnjë mundet të shfrytëzohet edhe në rastet e tjera, siç është Qiproja; shih po aty, faqe 232.

205 Shih, për shembull, Komisioni Europian, ‘Raporti i rregullt për Qipron’ përparimi i bërë drejt anëtarësimit’, Bruksel, tetor 1999, faqe 42. Në raportet e rregullta që pasuan pas këtij, ekzistojnë referenca të

kandidate, europeanizimi i politikës së jashtme dhe të sigurisë të Qipros kishte fushëveprim të kufizuar, çka nënkuptonte se nuk i rregullonte interesat nacionale të Qipros në nivel të plotë. Qeveria e Qipros mbajti disa këndvështrime dhe qëndrime politike që konsiderohen jetike për interesin e saj kombëtar.

2. Reagimi ndaj luftës në Kosovë

Faza e re e konfliktit në Kosovë (1998-1999) nuk ishte në vëmendje të opinionit të gjerë në Qipro para shkurtit 1999. Por, ndërsa gjendja në terren po përkeqësohej në mënyrë dramatike dhe mundësia e ndërhyrjes së NATO-s po rritej, si elitat politike ashtu edhe opinionin i gjerë u alarmuan. Nuk duhet quajtur befasi që pjesa më e madhe e grekëve qipriotë morën anën e serbëve.²⁰⁶ Në debatin publik, çështjet humanitare dhe faktorët e tjerë që kishin të bënin me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe ato politike të komuniteteve etnike në Kosovë u ngritën në mënyrë sporadike. Diskutimet politike në Qipro përqendroheshin në përdorimin e forcës nga NATO-ja dhe në implikimet që kishte kjo në të drejtën ndërkombëtare dhe në sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë.

Një ditë pas fillimit të fushatës ajrore të NATO-s (25 mars 1999), Dhoma e Përfaqësuesve e Qipros e përshkroi përdorimin e forcës kundër Jugosllavisë si “një provokim të papranueshëm të rendit ndërkombëtar dhe të Kartës së KB-së.”²⁰⁷ Partitë parlamentare²⁰⁸ nxorën një deklaratë të cilën e lexoi kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, z. Spyros Kyprianou (ish-president i Republikës). Në deklaratë thuhej se “asnjë rezolutë e Këshillit të Sigurimit nuk e autorizon NATO-n ose çdo vend të përdorë forcën ushtarake kundër Jugosllavisë... bombardimet nuk do ta zgjidhin problemin e Kosovës... [ato më tepër do të] krijojnë kushte jostabiliteti dhe pasigurie në rajonin e ndjeshëm të Ballkanit.”²⁰⁹ Të gjitha partitë politike dënuan sulmet ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë dhe kërkuan zgjidhje paqësore të konfliktit.

Presidenti i Qipros, zoti Glafcos Clerides, mori qëndrim të qartë lidhur me këtë çështje. Duke folur në Universitetin e Athinës dy ditë pas fillimit të fushatës së NATO-s (26 mars 1999), ai theksoi se “Kosova duhet të mbetet brenda kufijve të Jugosllavisë.”²¹⁰ Ai përkrahu një rol më aktiv të Këshillit të Sigurimit dhe shprehu mendimin që Kosova

206 konsiderueshme për qëndrimin e Qipros ndaj Jugosllavisë dhe Kosovës në pajtim me qëndrimet e BE-së. Ndërmjet marsit dhe qershorit 1999, në Nikozi u organizuan disa demonstrata dhe protesta para Ambasadës së ShBA-ve kundër ndërhyrjes së NATO-s. Këto ngjarje u organizuan nga shoqatat e studentëve, sindikatat e punëtorëve, partitë politike dhe lëvizjet e tjera.

207 Agjencia e Lajmeve e Qipros (CNA), 25 mars 1999.

208 Partia Demokratike e krahut të djathtë (DISI), e mbështetur nga 34.5% e elektoratit, kishte 20 vende; Partia Përparimtare e Popullit Punues e krahut të majtë (AKEL) kishte 33% dhe 19 vende; Partia Demokratike e Qendrës së Djathtë (DIKO) kishte 16.5% dhe 10 vende; Partia Social Demokratike (EDEK) kishte 8.1% dhe 5 vende; dhe Lëvizja Liberale e Demokratëve kishte 3.7% dhe 2 vende.

209 CNA, 25 mars 1999.

210 CNA, 25 mars 1999.

mund “të marrë një autonomi të caktuar”, sidoqoftë pa ndikuar në sovranitetin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë.²¹¹

Gjatë fushatës ajrore të NATO-së kundër Jugosllavisë dhe pas saj, u ngritën dy çështje kryesore. Së pari, nëse veprimet e NATO-s ofronin një mënyrë të re të menaxhimit të konfliktit dhe, së dyti, nëse Kosova paraqiste precedent për zgjidhjen e konfliktit. Po të analizohen diskutimet publike në Qipro, vihet re se kishte shumë spekulime fatkeqe në lidhje me rastin e Kosovës.²¹² Megjithatë, duke dhënë mend pas kuvendit, njeriu mund të argumentojë që rastisja historike e konfliktit në Kosovë më 1999 ka krijuar një liri veprimi për të ushtruar trysni në komunitetin e qipriotëve grekë që të hyjnë në një raund të ri bisedimesh ndërmjet komuniteteve. Në anën tjetër, vetëm zhvillimet në Kosovë nuk kanë mjaftuar për krijimin e kushteve për një raund të ri bisedimesh.²¹³ Edhe nëse Kosova ka pasur ndikim në rritjen e problemit të Qipros nga viti 1999 deri kur është bërë dorëzimi i një plani përfundimtar për zgjidhje gjithëpërfshirëse të këtij problemi më 2004, ai duhet të ketë qenë ndikim marginal, nëse krahasohet me ndikimin që ka pasur në problemin e Qipros përfundimi i bisedimeve për anëtarësim në BE dhe oferta bërë Turqisë për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE. Megjithatë, rasti i Kosovës vazhdon “të endet” në konfliktin e Qipros.

Pavarësisht nga ndonjë faktor politik, lufta në Kosovë shkaktoi ndjenjë pasigurie në Qipro. Elitat e Qipros dhe opinioni i gjerë kryesisht bënin ShBA-të përgjegjëse për përdorimin e pajustifikuar të forcës kundër Jugosllavisë. Ky akt konsiderohej mospërfillje e së drejtës ndërkombëtare dhe e ligjit të luftës. Fërkimi në ishull ishte i tillë sa pikërisht në ditën kur përfundoi lufta në Kosovë (11 qershor 1999), konfrontimi politik ndërmjet partive politike dhe Ambasadës së ShBA-ve arriti pikën kritike. AKEL i krahut të majtë, që mbështetej nga 33% e elektoratit dhe DIKO e qendrës së djathtë, që mbështetej nga 16.5% e elektoratit, nuk i pranuan ftesat për ngjarjet e sponsorizuara nga Ambasada e ShBA-ve dhe në vend të kësaj demonstruan kundër bombardimeve të Jugosllavisë para Ambasadës.²¹⁴ Ambasada e ShBA-ve nxori një deklaratë që, mes të tjerash, thoshte se “anëtarët e AKEL dhe DIKO nuk i kanë pranuar ftesat për ngjarjet e sponsorizuara nga Ambasada në javët e fundit... Ne kemi përshtypjen se anëtarët e AKEL dhe DIKO kanë ardhur te Ambasada kohëve të fundit vetëm për të demonstruar kundër përpjekjeve të NATO-s për të ndalur veprimet

211 Po aty.

212 Lidhur me këtë çështje mund të përmenden dhjetëra artikuj që u botuan në gazetatat lokale, por nuk e gijkojmë të domosdoshme për qëllime të këtij punimi.

213 Raundi i ri i bisedimeve filloi në dhjetor 1999 në Nju-Jork. Në të njëjtën kohë, BE-ja shpalli Turqinë shtet kandidat dhe premtoi që, nëse nuk arrihet asnjë zgjidhje deri sa të përfundojnë bisedimet për anëtarësimin e Qipros, vendimi për anëtarësim do të merrej pa këtë parakusht, por BE-ja do t'i merrte parasysht të gjithë faktorët e tjerë relevantë. Shih Këshillin Europian në Helsinki, 10 dhe 11 dhjetor 1999, Konkluzionet e Presidencës.

214 CAN, 11 qershor 1999. EDEK, partia e katërt më e madhe në Qipro, po ashtu u shpreh kundër rolit të ShBA-ve në luftën në Kosovë.

kriminale të regjimit në Kosovë.”²¹⁵ Si përgjigje ndaj kësaj deklarate, zëdhënësi parlamentar i AKEL, z. Andresa Christou, tha se “nuk ka mundësi që marrëdhëniet me misionet e huaja të mos ndikohen kur disa prej këtyre vendeve bombardojnë një vend që është mik i popullit të Qipros.”²¹⁶

Ky incident, në të cilin kishte shkëmbime verbale dhe të shkruara ndërmjet Ambasadës së ShBA-ve në Nikozi dhe partive politike të Qipros, nënvizon mjedisin politik dhe emocional në të cilin diskutohej çështja e Kosovës në Qipro. Dikur situata u qetësua, por kjo nuk mjaftoi që të mos merreshin parasysh faktorët politikë që përforcojnë qëndrimin e Qipros ndaj Kosovës.

3. Reagimi ndaj shpalljes së pavarësisë nga ana e Kosovës

Shpallja e pavarësisë nga ana e Kosovës u bë më 17 shkurt 2008. Në të njëjtën ditë, qipriotët dolën në zgjedhje për të votuar për presidentin e ri të Republikës.²¹⁷ Reagimi i parë i Republikës së Qipros ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës erdhi një ditë më vonë përmes një deklarate të shkruar nga Ministria e Punëve të Jashtme. Në deklaratë shkruhej se “shpallja e njëanshme e pavarësisë nga shumica në Kosovë... përbën shkelje të integritetit dhe sovranitetit të Serbisë.”²¹⁸ Qiproja e konsideronte shpalljen si “veprim të shkëputjes që del jashtë kornizës së ligjshmërisë ndërkombëtare dhe për këtë arsye është ligjërisht e pavlefshme, shkel Kartën e OKB-së, Aktin Përfundimtar të Helsinkit dhe Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, që konfirmon respektimin e shteteve anëtare të KB-ve ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Serbisë.”²¹⁹ Në deklaratë propozohej që statusi përfundimtar i Kosovës duhej të arrihej në kuadër të dialogut dhe bisedimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Deklarata përfundonte duke thënë se çdo marrëveshje duhej të miratohej nga Këshilli i Sigurimit.

Megjithatë, ky qëndrim nuk doli në shesh vetëm më 2008. Kundërshtimi i Qipros ndaj shpalljes së njëanshme të pavarësisë ishte shprehur haptas në disa raste në të kaluarën. Për shembull, në prill 2007, gjatë një konference me presidentin sllovak, i cili ishte për një vizitë zyrtare në Qipro, presidenti Papadopoulos sugjeroi që zgjidhja e konfliktit në Kosovë duhet “të arrihet në kuadër të marrëveshjes më të mirë të mundshme”,

215 Po aty.

216 Po aty.

217 Ish ministri i jashtëm Kasoulides i DISI dhe kryetari i Dhomës, Chritofias (sekretari i përgjithshëm i AKEL) siguruan shumicën e votave dhe kaluan në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Kryetari në detyrë, Papadopoulos, u eliminua në raundin e dytë. Një javë më vonë (24 shkurt 2008), z. Christofias u zgjodh president i Republikës së Qipros.

218 Republika e Qipros, ‘Ministria e Punëve të Jashtme: Shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës, ligjërisht e pavlefshme’, 18 shkurt 2008.

219 Po aty.

duke shtuar se “është i nevojshëm një vendim i ri i Këshillit të Sigurimit.”²²⁰ Zoti Papadopoulos kundërshtoi mundësinë e shpalljes së njëanshme të pavarësisë.

Në nivel të BE-së, këndvështrimi zyrtar i Qipros mbi statusin e ardhshëm të Kosovës u theksua nga ministrja e Jashtme Kozakou-Marcoullis në kuadër të Këshillit për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme të BE-së, që u mbajt në Bruksel në nëntor 2007. Në bazë të informatave për bllokimin përfundimtar në bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës dhe në mes të thashethemeve për shpalljen e shpejtë të njëanshme të pavarësisë nga shumica në Kosovë, zonja Kozakou-Marcoullis bëri deklaratën në vijim:

Qiproja mbështet zgjidhjen e problemit që do të dalë nga bisedimet. Ky është qëndrimi ynë për të gjitha çështjet ndërkombëtare. Në mënyrë që zgjidhja të ketë shanse për sukses, ajo duhet të jetë rezultat i bisedimeve dhe jo imponim apo veprim i njëanshëm. Ky është qëndrimi që do ta mbështesim sot së bashku me qëndrimin që çdo zgjidhje duhet të miratohet nga Këshilli i Sigurimit i KB. Sipas nesh, çdo veprim jashtë KB dhe jashtë Këshillit të Sigurimit i minon themelet e organizatës ndërkombëtare dhe do të jetë një zhvillim shumë i rrezikshëm dhe një precedent shumë i rrezikshëm.²²¹

Zonja Kozakou-Marcoullis po ashtu theksoi se, lidhur me çështjen e Kosovës, Qiproja mbante “një qëndrim parimor.” Në veçanti, ajo theksoi:

Nuk është qëndrim në favor të ndonjë vendi. Qëndrimi ynë është i vjetër dhe është qëndrim parimor. Ne do të kemi qëndrim të njëjtë për çdo situatë të ngjashme. Për ne është me rëndësi që të respektohet dhe të mbështetet e drejta ndërkombëtare dhe pikërisht të drejtën ndërkombëtare dhe vendimet e KB-së kemi mbështetur gjatë viteve. Prandaj, nuk mund t’i minojmë këto parime dhe të drejtën ndërkombëtare, që ka mbështetur shtetësinë tonë dhe përpjekjet tona për zgjidhjen e problemit të Qipros.²²²

Gjendja e përkohshme në Kosovë, ashtu siç thuhej në Rezolutën 1244 të KSKB, ishte e pranueshme për Qipron. Në kuadër të kësaj, Qiproja mbështeti misionet e KB-së dhe të BE-së në Kosovë, si dhe misionet e organizatave të tjera rajonale atje. Ajo po ashtu mbështeste drejtimin e ndihmës humanitare të BE-së për Kosovën. Diplomatat e Qipros mbajtën takime me përfaqësuesit politikë dhe administrativë të administratës së përkohshme të Kosovës dhe mbështetën bisedimet që kishin për qëllim përcaktimin e statusit përfundimtar të kësaj krahine. Megjithatë, shpallja e njëanshme e pavarësisë shënoi një pikë kthese në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Kosovës. Prej shkurtit 2007, nuk ka as marrëdhënie zyrtare e as jozyrtare ndërmjet

220 Republika e Qipros, ‘Zyra për Shtyp dhe Informim’, 20 prill 2007.

221 Republika e Qipros, ‘Zyra për Shtyp dhe Informim’, 20 prill 2007

222 Po aty.

Prishtinës dhe Nikozisë.²²³

Kur shqyrtohet me kujdes, qëndrimi i Qipros lidhur me Kosovën ka së paku katër nuanca të shprehjes. Së pari, duket që Qiproja ka qëndrim proserb për Kosovën. Kjo veçori e qëndrimit të Qipros është shfaqur në disa raste. Për shembull, gjatë një vizite zyrtare të kryeministrit të Serbisë, Mirko Cvetkoviç, në Qipro, zoti Demitris Christofias tha:

Është me rëndësi të nënvizoj edhe një herë që Republika e Qipros nuk e njeh dhe nuk do ta njohë Kosovën, një qëndrim parimor që është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Zgjidhja duhet të jetë rezultat i konsultimeve reciproke dypalëshe, të cilat do të çojnë në një zgjidhje të pajtueshme që do të respektojë integritetin territorial të Serbisë dhe do të miratohet nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. Ne e mirëpresim dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, për të cilin më informoi gjerësisht kryeministri.²²⁴

Z. Christofias shprehu “mirënjohjen e thellë të popullit të Qipros për qëndrimin e prerë parimor të Serbisë mbi problemin e Qipros... dhe për kontributin pozitiv të vendit (të Serbisë)... ndaj forcës paqeruajtëse në Qipro.”²²⁵ Përveç çështjes së Kosovës dhe problemit të Qipros, këto dy vende kanë interes të përbashkët në fusha të tjera, si në ekonomi, turizëm dhe në industrinë ndërtimore. Ky interes i përbashkët u theksua gjatë vizitës së z. Cvetkoviç në Qipro, në qershor 2011. Së fundi, por jo më e parëndësishme, Nikozia mbështet kërkesën e Serbisë për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me BE-në. Gjatë një vizite në Serbi, në dhjetor 2010, ministri Kyprianou tha:

Bashkimi Europian nuk ka qëndrim të përbashkët për çështjen e Kosovës dhe njohja e pavarësisë së saj nuk është kusht që duhet t'i vihet Serbisë në asnjë fazë. Qiproja nuk e ka ndryshuar qëndrimin e vet lidhur me shpalljen e njëanshme të pavarësisë, e cila paraqet akt të paligjshëm. Ne mbështesim plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë dhe i ftojmë të gjithë ta respektojnë të drejtën ndërkombëtare.²²⁶

Së dyti, Qiproja mbron një interpretim të caktuar të së drejtës ndërkombëtare, që e konsideron shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës si të pavlefshme. Ky

223 Në mars 2010, ish ministri i Jashtëm i Qipros, z. Kasoulides, u takua në Strasbourg me ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, z. Hyseni, në cilësinë e tij si shef i grupit të punës të Parlamentit Europian për Punë të Jashtme, jo në cilësinë e tij si anëtar qipriot i Parlamentit Europian.

224 Republika e Qipros, ‘Zyra për Informim dhe Shtyp’, 7 qershor 2011.

225 Po aty.

226 Republika e Qipros, Ministria e Punëve të Jashtme, 3 dhjetor 2010. Në qershor 2011, z. Christofias tha se “Republika e Qipros i mbështet vendosmërisht përpjekjet e Serbisë për të hyrë në BE” dhe ka shprehur shpresën e tij që, pas arrestimit të Ratko Mladiçit, “nuk do të ketë ndonjë arsytim të ri për vonimin e fillimit të bisedimeve të Serbisë për anëtarësim në BE.” (Republika e Qipros, Zyra për Shtyp dhe Informim, 7 qershor 2011).

qëndrim është shprehur qartë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND)²²⁷ dhe është përsëritur në disa raste nga zyrtarët e Qipros. Në vitin 2010, gjatë një vizite në Serbi, z. Kyprianou theksoi se “Qiproja mban qëndrim parimor në favor të respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të Serbisë, ku përfshihen krahina e Kosovës dhe e Metohisë.”²²⁸ Për më tepër, z. Kyprianou theksoi se “qeveria e Qipros e konsideron shpalljen e njëanshme të pavarësisë nga Kosova si të paligjshme.”²²⁹ Në një deklaratë më të vonshme, z. Kyprianou tha se Qiproja “mbështet qëndrimet parimore, siç është respektimi i së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e sovranitetit dhe të integritetit territorial.”²³⁰

Edhe pas nxjerrjes së Mendimit Këshillëdhënës të GJND-së, Qiproja përsëriti “qëndrimin e saj parimor lidhur me çështjen e Kosovës dhe rikonfirmoi qëndrimin e palëkundur për respektimin e sovranitetit dhe të integritetit territorial të Serbisë.”²³¹ Republika e Qipros “u bëri thirrje të dy palëve, Republikës së Serbisë dhe ‘Kosovës nën Rezolutën 1244/99 të KSKB’, që të rifillojnë dialogun për gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja palët për çështjen e Kosovës, duke e mundësuar në këtë mënyrë sundimin e stabilitetit dhe të paqes në rajon.”²³²

Së treti, duke mbajtur këtë qëndrim për Kosovën, Nikozia përpiqet ta përvetësojë çdo shtrirje që mund të ketë ky rast për problemin e Qipros. Qeveria e Qipros ka theksuar haptazi se “çështja e Kosovës... është e rëndësishme për Qipron”.²³³ Nikozia ishte e lumtur të kuptojë që Mendimi Këshillëdhënës i GJND-së dallon çështjen e Qipros dhe atë të Kosovës.²³⁴ Sipas një diplomati të Qipros, i cili foli në kushte anonimiteti, vetëm Mendimi i GJND-së nuk mjafton për lehtësimin e shqetësimeve të Qipros për implikimet e mundshme të rastit të Kosovës për problemin e Qipros. Shtetet udhëheqëse të BE-së, siç janë Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, mund të theksojnë që Kosova është rast unik, por kjo nuk i lehtëson shqetësimet e Nikozisë.²³⁵ Qeveria e Qipros merret çdo ditë me incidentet ku përfshihen përpjekjet e Turqisë dhe të “Republikës Turke

227 Qiproja ishte njëri prej 35 shteteve që dorëzuan deklaratë me shkrim në GJND dhe njëra prej 14 shteteve që ka dorëzuar komente me shkrim për deklaratat e vendeve të tjera.

228 Republika e Qipros, Ministria e Punëve të Jashtme, 3 dhjetor 2010.

229 Po aty.

230 Republika e Qipros, Zyra për Shtyp dhe Informim, 25 qershor 2011. Ju lutemi, mbani parasysh që z. Kyprianou ka dorëzuar detyrën në korrik 2011 dhe është zëvendësuar nga znj. Erato Kozakou-Marcoullis (e cila në të vërtetë ishte pararendëse e tij në atë detyrë).

231 Deklaratë e Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me Mendimin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e njëanshme të pavarësisë nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, 22 korrik 2010.

232 Po aty.

233 Republika e Qipros, ‘Ministria e Punëve të Jashtme’, 3 dhjetor 2010.

234 Deklarata e Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me Mendimin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e njëanshme të pavarësisë nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, 22 korrik 2010.

235 .Për shembull, në korrik 2010, ministri i Jashtëm gjerman, z. Westerwelle, theksoi që “Kosova ishte rast individual, me kushte specifike historike dhe që nuk është bërë asnjë precedent.” (Zyra e Jashtme Federale Gjermane, 23 korrik 2010).

të ipros Veriore" ("TRNC") për të normalizuar status quo-në në Qipro.²³⁶ Së katërti, pavarësisht nga qëndrimi për Kosovën, Qiproja bën çdo përpjekje që të duket si shtet anëtar i arsyeshëm dhe konstruktiv i BE-së. Në të vërtetë, përpiket të mbajë një ekuilibër të përsosur ndërmjet qëndrimit të saj nacional për statusin ndërkombëtar të Kosovës dhe qëndrimit të Unionit për të ndihmuar Kosovës të gjejë rrugën e saj përmes pasigurisë së vazhdueshme historike. BE-ja nuk ka qëndrim të përbashkët për Kosovën dhe kjo ju jep shteteve anëtare të BE-së një lloj lirie veprimi për të shprehur këndvështrime të ndryshme për çështjet relevante që kanë të bëjnë me të ardhmen e saj. Si shtet anëtar i BE-së, Qiproja ka marrë qëndrim të qartë kundër njohjes së Kosovës. Megjithatë, në të njëjtën kohë mbështet përpjekjet e ndërmarra nga BE-ja për të ndihmuar Kosovës që të krijojë institucionet e saj. Në aspekte praktike, Qiproja ka abstenuar në votimin e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX-Kosovë) dhe nuk kontribuon në forcën e BE-së atje,²³⁷ edhe pse merr pjesë në të gjitha takimet dhe vendimet e BE-së që kanë të bëjnë me këtë mision dhe miraton buxhetin e tij.²³⁸

Qëndrimi i prerë politik i Qipros kundër njohjes ndërkombëtare të Kosovës ndërmjetësohet disi nga qasja pajtuese ndaj popullsisë së Kosovës.²³⁹ Për shembull, gjatë një takimi me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Jashtëm të Shqipërisë, z. Ilir Meta, i cili e vizitoi Qipron në gusht 2010, ministri i Jashtëm Kyprianou theksoi se "Qiproja ...mbështet politikën e BE-së për ta ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe institucional të Kosovës."²⁴⁰ Qiproja duket të jetë e kujdesshme që të mos jap përshtypje të gabuar lidhur me qëndrimin e saj politik për Kosovën. Është e vetëdijshme që disa shtete, si Shqipëria, që janë mbështetëse të përkushtuara të pavarësisë së Kosovës, mund të shohin ngjashmëri ndërmjet gjendjes në Kosovë dhe asaj në Qipro. Ky fakt ka mjaft ndikim, sidomos kur Nikozia merret me çështjen e Kosovës në nivel të BE-së dhe në nivel ndërkombëtar.

Këto katër nuanca të shprehjes, sidoqoftë, janë të ndërlidhura dhe është mjaft vështirë të bëhet dallimi ndërmjet tyre. Me fjalë të tjera, qëndrimi i Qipros për Kosovën ka shumë aspekte. Përveç ndjenjës së konsekuencës dhe vazhdimësisë për çështjen e

236 Këto përpjekje janë të gjithëpranishme që nga viti 1974. Në vitet e fundit, megjithatë, ato janë bërë më intensive. Pas vitit 2004, kur një plan i KB-së për zgjidhjen gjithëpërfshirëse të çështjes së Qipros u miratua nga turqit e Qipros dhe u refuzua nga grekët e Qipros, u shfaq një valë mirëkuptimi për këta të parët. Një numër i shteteve dhe i organizatave ndërkombëtare bënë thirrje që të përfundonte izolimi i komunitetit turk. Qeveria e Qipros mendon se i ashtuquajtimi izolim i komunitetit të turqve të Qipros është rezultat i okupimit ushtarak nga Turqia të afërsisht 36% të territorit të Qipros, si dhe përpjekjeve të saj për ndarje në Qipro.

237 Qiproja është shteti i vetëm anëtar i BE-së që nuk kontribuon në forcën e Unionit në Kosovë.

238 Një diplomat qipriot, i cili foli në kushte anonimiteti, tha se Qiproja është gati të kontribuojë në çfarëdo misionin të BE-së në Kosovë, sa kohë që vendimet merren në pajtim me Rezolutën 1244 të KSKB. Aktualisht, Qiproja parapëlqen të mos marrë pjesë në forcën e BE-së atje. Sidoqoftë, në shtator 2011, Qiproja dha pëlqimin për miratimin e buxhetit të EULEX-it në Kosovë.

239 Qiproja nuk dëshiron që vendet e tjera ta kuptojnë qëndrimin e saj politik si qëndrim kundër Kosovës, por si 'qëndrim parimor', domethënë si qëndrim që është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

240 Republika e Qipros, Ministria e Punëve të Jashtme, 6 gusht 2010.

Kosovës, është tepër e vështirë të tregohet një renditje hierarkike e shqetësimeve të Nikozisë. Kur mendon për një çast, duket se shqetësimet lidhur me implikimet e rastit të Kosovës për problemin e Qipros vijnë të parat.

Këto shqetësime nganjëherë zmadhohen nga veprimet dhe deklaratat që bëhen nga Turqia dhe udhëheqja e turqve të Qipros, si dhe nga këndvështrimet e komentuesve dhe analistëve, të cilët sugjerojnë që Qiproja po shkon drejt një zgjidhjeje si të Kosovës. Sa për fillim, Ankaraja e njohu Kosovën më 18 shkurt 2008 dhe Zyrën e saj Koordinuese në Prishtinë e ngriti në ambasadë. Nga ana e saj, Kosova hapi ambasadë në Turqi, njëri prej vendeve të para ku hapi një të tillë. Që nga viti 1999, Turqia ka një *task force* në Kosovë, që përbërë prej përafërsisht 550 vetash personel ushtarak në kuadër të KFOR-it. Ajo po ashtu kontribuon në EULEX-Kosovë me 36 policë. Ankaraja ka interes të posaçëm në Kosovë. Vlerësohet se 1% e popullsisë atje janë turq. Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) është parti turke në Kosovë, që promovon kulturën dhe interesat turke. Disa organizata të tjera turke veprojnë në Kosovë. Interesimi dhe përfshirja e Ankarasë në Kosovë, po ashtu, perceptohet si pjesë përbërëse e një agjende për Qipron.

Turqia është shteti i vetëm anëtar i KB-së që njeh “TRNC”-në. Edhe pse Këshilli i Sigurimit i KB-së e ka shpallur të pavlefshme shpalljen e pavarësisë nga “TRNC”-ja (Rezoluta 541/1983 e KSKB), Turqia dhe udhëheqja e turqve të Qipros bëjnë përpjekje të mëdha të krijojnë marrëdhënie zyrtare dhe jozyrtare me shtetet, organizatat ndërkombëtare dhe regjimet. Edhe pasi Mendimi i GjND-së konstatoi se “Këshilli i Sigurimit caktoi kushte specifike që kanë të bëjnë me statusin e përhershëm të Qipros”²⁴¹, që e dallon qartë rastin e Kosovës nga rasti i Qipros, disa ende shohin një shkallë pajtueshmërie ndërmjet dy rasteve. Sipas Ker-Lindsay, “në Turqi dhe në Qipron Veriore ekzistonte një spekulim i konsiderueshëm që mendimi (i GjND-së) do të mund ta hapte rrugën për njohjen e TRNC-së.”²⁴² Spekulumet të tilla paraqiten shpesh në gazetatat turke dhe të turqve të Qipros. Në një intervistë me Grupin Ndërkombëtar të Krizës, Osman Ertuğ, anëtar i Partisë së Unitetit Kombëtar (UBM) dhe ish anëtar i ekipit të bisedimeve, pyetej nëse Kosova është “më shumë apo më pak e pavarur se ne [“TRNC”]”.²⁴³

Një ditë pasi Kosova shpalli pavarësinë e saj, udhëheqësi i turqve të Qipros, Mehmet Ali Talat, “përsëriti pavarësinë e Kosovës në emër të popullit turk të Qipros, duke shtuar që vullneti i popullit të Kosovës duhet të respektohet dhe duhet t’i ndihmohet shtetit të ri.”²⁴⁴ Edhe pse udhëheqja e turqve të Qipros miratoi shpalljen e pavarësisë së Kosovës, “TRNC”-ja nuk vendosi marrëdhënie zyrtare me Prishtinën dhe nuk bëri deklaratë të qartë për njohjen e saj. Për këtë kishte disa kritika nga politikanët e

241 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, ‘Sipas të drejtës ndërkombëtare për shpalljen e njëanshme të pavarësisë në lidhje me Kosovën’, 22 korrik 2010 (Lista e përgjithshme nr. 141), paragrafi 114.

242 J. Ker-Lindsay, ‘Pas së gjithash, nuk është edhe aq rast *‘sui generis’*: vlerësimi i mendimit të GjND-së për Kosovën’, Nationalities Papers, 2001, 39(1), faqe 6.

243 Grupi Ndërkombëtar i Krizës, ‘Qipro: Ribashkim apo ndarje?’ *Raporti i Europës nr. 201, 30 shtator 2009*.

244 Agjencia Anatolia Pres, 18 shkurt 2008.

turqve të Qipros dhe gazetarët, të cilët e panë këtë si humbje të një rasti historik për komunitetin e tyre.

Duke pasur parasysh ndarjen dy këndvështrimet, ato të grekëve të Qipros dhe turqve të Qipros për Kosovën, po të ribashkohej Qiproja tani, do të ishte vështirë arritja e një qëndrimi të përbashkët për Kosovën. Ka mundësi që kjo të jetë një çështje e grindjes ndërmjet dy komuniteteve në Qipro, ndoshta deri në kohën kur Beogradi dhe Prishtina të gjejnë një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët lidhur me konfliktin e tyre.

4. Ndryshimi i qëndrimit në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Kosovës

Ka pak të ngjarë që në të ardhmen e afërme të ndodhë ndonjë ndryshim i qëndrimit në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Kosovës. Ndryshimi i politikës do të bazohet në rezultatin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Aktualisht, gjendja në Kosovë është mjaft e paqëndrueshme dhe vëzhguesit parashikojnë që ajo të mbetet e tillë edhe gjatë muajve të ardhshëm.²⁴⁵ Vëmendja ndërkombëtare në Kosovë edhe një herë është zhvendosur në menaxhimin e konfliktit, në vend të zgjidhjes së tij.²⁴⁶ Në këtë kontekst, Qiproja ka mundësi ta mbajë qëndrimin e saj fillestar për Kosovën, domethënë nuk ka shpresë për njohje.

Në nivel të BE-së, Qiproja do të vazhdojë ta mbështesë EULEX-in në Kosovë në kontekstin e Rezolutës 1244, megjithatë pa dhënë ndonjë kontribut për forcën e BE-së atje. Kontributi i saj do të kufizohen në nivelin teknik dhe financiar. Perspektiva e bisedimeve për anëtarësim ndërmjet BE-së dhe Serbisë mund të sjellë një moment të ri. Kërkesa e Kosovës për anëtarësim në BE, po ashtu, mund të nxjerrë një perspektivë të re. Por, siç tregon rasti i Qipros, BE-ja nuk është në gjendje të kontribuojë për zgjidhjen e konflikteve të komplikuar që përfshijnë si çështjet për të cilat vendosin shtetet, ashtu edhe ato për të cilat vendosin etnitë. Vlerësimet e mëparshme për kapacitetin e BE-së për transformimin e strukturës nxitëse të palëve ka dëshmuar se është mjaft optimiste, por joreale.²⁴⁷ Në thelb, faktori BE nuk duket të jetë katalizator për ndryshimin e qëndrimit në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Kosovës.

245 Grupi Ndërkombëtar i Krizës, 'Kosova veriore: sovran i dyfishtë në praktikë', *Raporti i Europës* nr. 211, 14 mars 2011.

246 Avineri pohonte se, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pak a shumë kjo çështje është konsideruar si e zgjidhur. Megjithatë, mikropolitika dhe konflikti etnik në Kosovë e bën të vështirë të thuhet se Kosova është çështje e zgjidhur. Duket se në Kosovë asgjë nuk është e kryer, deri sa të kryhet. Shih S. Avineri, 'Çka mund të na mësojnë Qiproja, Bosnja dhe Kosova', *Haaretz*, 4 korrik 2008.

247 T. Diez, M. Albert, S. Stetter, 'Bashkimi European dhe konfliktet kufitare: Fuqia transformuese e integritetit' *Organizata ndërkombëtare*, 2006, 60(2), faqe 563-593; T. Diez, M. Albert, S. Stetter. *Bashkimi European dhe konfliktet kufitare: Fuqia transformuese e integritetit dhe asociimit* (Kembrixh: Shtypi i Universitetit të Kembrixhit, 2008).

Po ashtu, në nivel jozyrtar, ndryshimi i perceptimeve për statusin e Kosovës vështirë se mund të ndodhë në një të ardhme të afërt. Me sa duket, dy komunitetet në Qipro do të mbajnë qëndrimet e mëparshme. Turqit e Qipros do të vazhdojnë ta mbështesin kauzën e Kosovës, ndërsa grekët e Qipros kauzën e Serbisë, ashtu siç është paraqitur në pjesët e mëparshme të këtij punimi. Lidhur me grekët e Qipros, duhet të merret parasysh edhe një faktor tjetër. Tërthorazi, qëndrimi i tyre për Kosovën lidhet jo pak me situatën politike në Qipro. Shpallja e pavarësisë së “TRNC-së” më 1983 i ka bërë grekët e Qipros më të ndjeshëm ndaj çështjeve të sovranitetit nacional, integritetit territorial dhe pavarësisë nacionale. Këto çështje duket se është ngulitur thellë në kulturën politike të shumicës së grekëve të Qipros.²⁴⁸ Kur këta faktorë bashkohen me qëndrimin proserb, bëhet tepër e vështirë të pritët ndonjë ndryshim në qëndrim. E kundërta është e vërtetë. Ndjeshmëria e grekëve të Qipros ndaj së drejtës ndërkombëtare dhe qëndrimi i tyre proserb paraqesin pengesë për marrëdhëniet e tjera ndërmjet Qipros dhe Kosovës në fushat jopolitike, siç është Akademia dhe shkëmbimet universitare, bashkëpunimi i shoqërisë civile etj.

Përfundimisht, sektori ekonomik nuk duket se mund të jetë forcë e mundshme shtytëse për ndryshimin e qëndrimit në marrëdhëniet Qipro-Kosovë. Disa ndërmarrës qipriotë kanë shprehur interes për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Qipros dhe Serbisë dhe pak prej tyre, nëse do të ketë ndonjë, do të rrezikojnë të bashkëpunojë me Kosovën. Përveç animit të fuqishëm ndaj Serbisë, ndërmarrësit qipriotë duhet të marrin parasysh kufizimet institucionale që rrjedhin nga marrëdhëniet politike ndërmjet Qipros dhe Kosovës. Aktualisht, marrëdhëniet ndërkombëtare ndërmjet Qipros dhe Kosovës janë shumë të pakta.²⁴⁹

Me pak fjalë, ka një numër pengesash politike, institucionale dhe kulturore që japin pak shpresë për ndryshimin e qëndrimit në marrëdhëniet ndërmjet Qipros dhe Kosovës në të ardhmen e afërt.

248 Megjithatë, këtë çështje nuk e shikojnë njësoj të gjithë grekët e Qipros. Për shembull, shih C. Constantinou dhe Y. Papadakis, ‘Shteti (-et) qipriote *në vend*: Kontakti ndëretnik dhe diskursi i njohjes’, *Global Society*, 2001, 15(2), faqe 125-148.

249 Sipas Shërbimit Statistikor të Qipros, ndërmjet vitit 2009 dhe 2011, Qiproja ka eksportuar vetëm një artikull në Kosovë, domethënë “pjesë artificiale të trupit O/T HDS.” Nuk importon asnjë artikull nga Kosova.

Serbia

Fundi i mitit të Kosovës

Nëntor 2011

Historiku

Gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, Beogradi dështoi në përpjekjet për ta shndërruar Kosovën në një rajon të mbizotëruar nga serbët, së pari përmes nacionalizimit dhe kolonizimit dhe pastaj duke dëbuar popullsinë e saj shqiptare për në Turqi. Miti i Kosovës u ringjall në fillim të viteve 1980²⁵⁰ dhe me të u manipulua në mënyrë të shkathtë me qëllim që të arrihej homogjenizimi i popullit serb. Miti i Kosovës po ashtu u përdor për të nxitur nacionalizmin serb dhe për të ngritur çështjen e kombit serb në Jugosllavi duke pasur si synim zgjerimin e shtetit serb në drejtimin veriperëndimor. Në këtë kontekst, përpjekjet e Serbisë për t'i drejtuar refugjatët nga Kroacia dhe nga Bosnja dhe Hercegovina në Kosovë dështuan ashtu sikurse kishin dështuar përpjekjet e tjera që ishin bërë para këtyre. Të shqetësuar lidhur me përparimin dhe zgjerimin biologjik të popullit shqiptar dhe duke u frikësuar nga shpërthimi demografik, nacionalistët serbë filluan të kërkonin zgjidhje të tjera për Kosovën, posaçërisht marrjen e saj.

Ndërhyrja e NATO-s ia prishi planet Beogradit për zgjidhjen e çështjes së Kosovës duke dëbuar popullsinë e saj shqiptare. Sidoqoftë, përkundër disfatës *de facto* të tij në Kosovë, regjimi i Beogradit vazhdoi të ndiqte strategjinë e tij të vjetër në rrethana të reja. Kjo strategji ka dy degë që përbëhen nga a) mospranimi dhe minimi i misionit ndërkombëtar dhe b) puna për ndarjen e Kosovës në entitete. Në pajtim me pararendësit e tyre, autoritetet demokratike nuk kanë treguar gatishmëri të arrijnë mirëkuptim me shqiptarët, në mënyrë që ta gjejnë një mënyrë të jetuari për të dy popujt.

Nacionalistët serbë, të cilët e konsiderojnë ndarjen e Kosovës si zgjidhje përfundimtare për këtë çështje, dolën me një propozim në këtë drejtim në pranverë të këtij viti. Dobrica Qosiç ishte i pari që e sugjeroi këtë ide publikisht, duke thënë se 'zgjidhja e përhershme për çështjen e Kosmetit [Kosovës dhe Metohisë] [është] ndarja e Kosovës dhe e Metohisë dhe demarkacioni territorial ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë' (në vend që të bëhet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë) është në pajtim me përkufizimin e Qosiçit për luftërat jugosllave si 'rirregullim i Ballkanit'. Qosiçi argumenton se Serbia duhet të pajtohet që të ketë një 'Kosovë të tretë', domethënë ta

250 ¹. Miti i Kosovës mbetet i ngulitur në vetëdijen e popullit serb si ngjarje kryesore e tërë historisë së tij. Miti ka luajtur një rol të rëndësishëm për krijimin e shtetit modern serb. Që nga përfundimi i luftërave ballkanike më 1913, kulti i Shën Vitus (që daton nga shekulli 19) është respektuar si ditë e 'betejës kalorësiake dhe e fitores kundër së ligës', që rezulton me simbolizimin e hakmarrjes së përgjakshme dhe të pamëshirshme mbi çdo gjë turke në veçanti dhe myslimane në përgjithësi. Dita e Shën Vitus është bërë zyrtarisht festë kombëtare kishtarë më 1913, domethënë pas 'fitores së qartë ndaj turqve'.

ndajë atë me shqiptarët, meqë nuk është në gjendje ta çlirojë atë përsëri. Sipas Qosiçit, Serbia duhet të marrë pjesët e populluara nga serbët dhe ato ku gjenden manastiret dhe shqiptarëve të mbajnë pjesët që janë bërë të tyre. Përndryshe, paralajmëron ai, 'do të hyjmë në luftë të përhershme me shqiptarët, të cilën nuk mund ta fitojmë'.

Refuzimi i planit të Ahtisaarit

Para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Beogradi nuk tregoi gatishmëri për bisedime serioze me Prishtinën. Madje edhe mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës nuk e bindi Beogradin të ndryshonte qëndrim. Beogradi nuk tregoi se kishte ndërmend ta pranonte realitetin e ri dhe statusin e ri ndërkombëtar të Kosovës. Përkundrazi, sillej sikur të mos kishte ndodhur asnjë ndryshim.

Meqë data për marrjen e statusit të kandidatit për anëtarësim në BE po afrohet, elitat serbe besojnë se është çasti i fundit që ta përmbyllin punën e tyre 'të papërfunduar' në Kosovë. Që nga pranvera e kaluar, disa politikanë e kanë mbështetur hapur ndarjen dhe për herë të parë e kanë propozuar atë zyrtarisht si opsion.²⁵¹

Përpjekjet e bëra verës për të imponuar ndarjen e Kosovës duke organizuar 'revolucionin e trungjeve' (duke i bllokuar rrugët me trungje), me mbështetjen e Beogradit, dështuan. Ato e diskredituan koalicionin udhëheqës serb në sytë e bashkësisë ndërkombëtare në kohën kur nga Serbia pritej të bëheshin përpjekje shtesë për të paraqitur imazhin më pozitiv të mundshëm në BE para vendimit për statusin e kandidatit për anëtarësim. Në njërën anë kjo ndihmoi për të krijuar përshtypjen se elita serbe në të vërtetë nuk e dëshironte anëtarësimin në BE. Në anën tjetër, u bë e qartë se Beogradi ende e konsideronte statusin e Kosovës si çështje të hapur.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për marrjen e vendkalimeve kufitare në Jarinjë dhe në Bërnjak, që ta konsolidonte në këtë mënyrë shtetësinë e Kosovës, u mbështet në heshtje nga bashkësia ndërkombëtare. Qëndrimi i vendosur i BE-së dhe i KFOR-it lidhur me 'revolucionin e trungjeve' në Kosovën veriore tregoi paaftësinë e elitave serbe për t'i peshuar opsionet e tyre dhe për të vendosur objektivat reale për të ardhmen e Serbisë. Prodhimi i vazhdueshëm i nacionalizmit përmes mitit të Kosovës po pengon mobilizimin demokratik të Serbisë për kthimin e domosdoshëm drejt së ardhmes europiane. Nuk ka dyshim që Serbia mund të përparojë vetëm nëse bëhet më e vetëdijshme për realitetin e ri dhe për interesat e përbashkëta.

251 Duke treguar gjithmonë pretendime territoriale ndaj Kosovës veriore, Serbia shpresonte ta arrinte këtë përmes disa strategjive, përfshirë okupimin e Kosovës pas vitit 1999 dhe mbajtjen e status quo-së. Llogariste që bashkësia ndërkombëtare do ta pranonte gjendjen de facto në terren.

Idetë e gabuara të Serbisë për bashkësinë ndërkombëtare

Vizita e kancelares gjermane Angela Merkel më 23 gusht 2012 i dha fund strategjisë së kalkulimit të Beogradit, që për tre vjet radhazi pas shpalljes së pavarësisë po nxiste iluzionin në veri të Kosovës se bashkësia ndërkombëtare, në një çast të favorshëm, do ta pranonte status quo-në atje si zgjidhje të përhershme. Kancelarja gjermane kërkoi nga Beogradi haptazi që t'i shpërbënte strukturat paralele në Kosovën veriore, në mënyrë që ajo pjesë të përfshihet ligjërisht dhe institucionalisht në sistemin shoqëror-politik të Kosovës. Duke bërë këtë, ajo vetëm deklaroi publikisht atë që aktorët ndërkombëtarë e kishin kërkuar gjatë gjithë kohës nga zyrtarët serbë. Megjithatë, as gjesti i qartë i Merkelit nuk ishte i mjaftueshëm për të ndikuar në mënyrë të dukshme në politikën e Serbisë ndaj Kosovës dhe në modelin si mediat serbe e bëjnë mbulimin e Kosovës dhe nga Kosova.

Përkundrazi, përkundër çdo gjëje, vazhduan përpjekjet për të bërë diçka në Kosovë. Propozimet për 'autonomi substanciale' për veriun e Kosovën, për një 'Plan Ahtisaari plus', për dialog politik me Kosovën dhe ngjashëm, filluan të bëheshin publike me një shpeshtësi dhe transparencë gjithnjë më të madhe, duke treguar ekzistencën e një plani të mundshëm: në rast se nuk ka ndarje të Kosovës, veriut të saj duhet 't'i sigurohet statusi' i një subjekti specifik (sipas modelit të Republikës Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë). Megjithatë, opsioni i ndarjes së mundshme mbeti në qarkullim përmes një vargu artikujsh nëpër gazeta dhe rekrutimit të analistëve të huaj që ishin të predispozuar ndaj 'argumenteve serbe'.

Ndarja e Kosovës – opSION i vjetër i Beogradit

'Caktimi i kufijve me shqiptarët', 'marrëveshje historike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve', 'korrigjim i kufijve' – të gjitha këto janë vetëm eufemizma për ndarjen e veriut të Kosovës dhe përfshirjen e tij në Serbi. Për pothuajse gjysmë shekulli, kjo ka qenë strategjia e Beogradit. Deri së fundi, plani nuk është paraqitur kurrë si linjë zyrtare e Beogradit. Ai është diskutuar publikisht nga autori i tij, akademiku Dobrica Qosiç, nga anëtarët e rrethit të tij të ngushtë (Aleksandar Despiq, më 1997) dhe nga një numër analistësh dhe komentuesish vendas dhe të huaj.

Sidoqoftë, ideja u bë zyrtare në gjysmën e parë të këtij viti nga zëvendëskryeministri dhe kryetari i Partisë Socialiste të Serbisë (PSS) Ivica Daçiç.²⁵² Kësaj i parapriu intervista e Qosiçit në gazetën ditore *Politika*, e cila e botoi atë tri ditë radhazi. Qosiçi pohoi se politika shtetërore e Serbisë për Kosovën kishte qenë e gabuar 'që nga (Nikolla) Pashiçi e deri te (Boris) Tadiçi' dhe kujtoi se kjo çështje ishte diskutuar dhe për të ishte shkruar për katër dekada me radhë (pa ndonjë dobi). Ai propozoi një

252 Buletini i Komitetit të Helsinkit, nr. 80.

‘ndarje demokratike, të drejtë, me kompromis dhe të përhershme të kufijve ‘si mënyrë të vetme për kalimin e armiqësive shekullore ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve’.²⁵³

Qosiçi nuk e humbi edhe këtë rast për të përmendur se ndarjen ai e kishte diskutuar disa herë me Sllobodan Millosheviçin. Dhe shtoi madje se që më 1991 i kishte bërë të ditur Millosheviçit ‘një propozim të ShBA-ve për ndarjen e Kosovës, sipas të cilit Serbia do të kishte një të tretën e Kosovës dhe Metohisë’²⁵⁴, por Millosheviçi as atëherë nuk hoqi dorë nga ‘iluzionet serbe’. Me siguri që përmendja e Shteteve të Bashkuara në lidhje me idenë e ndarjes së Kosovës është bërë për t’i dhënë pak më shumë peshe çështjes.

Është fakt se mendimet e disa ekspertëve dhe analistëve të ShBA-ve, kryesisht të grumbulluar rreth Institutit konservator Cato të ShBA-ve²⁵⁵ botohen shpesh në mediat serbe. Për shembull, analisti i institutit, Ted Carpenter, botoi një artikull në *The National Interest* me titull “Rreziqet e refuzimit të ndarjes në Ballkan”, ku i referohet ‘përzgjedhjes së mrekullueshme’ lidhur me pranimin e shkëputjeve dhe ndarjeve. Ai pohon se një elitë relativisht e vogël europiane dhe amerikane reagoi kur ‘fuqitë e NATO-s ndihmuan shpërbërjen e Jugosllavisë në fillim të viteve nëntëdhjetë. Madje edhe më pak shprehën shqetësim lidhur me shkëputjen e Kosovës me forcë nga Serbia’.²⁵⁶ Carpenter çuditet me preken e disave që ‘marrin parasysh një strategji të re për Ballkanin, ku përfshihet një përshtatje modeste territoriale për Kosovën dhe një vendim për braktisjen e projektit të krijimit të kombit në Bosnjë, çka është e qartë që ka dështuar’.²⁵⁷ Duke u paraqitur në programin televiziv *Ćirilica të Happy TV*, Steven Meyer, të cilin mediat e Beogradit e ftojnë shpesh për të paraqitur këndvështrimin e tij, rishtazi theksoi pothuajse po të njëjtën gjë në lidhje me krizën rajonale.²⁵⁸

Një fejtון mbi strategjinë ruse të politikës së jashtme të ish-kryeministrit dhe ministrit të Jashtëm Yevgeny Primakov, botuar me vijim nga *Politika* gjatë shtatorit, prek çështjen e Kosovës (pa e përmendur rolin e Viktor Chernomyrdin në arritjen e Marrëveshjes së Kumanovës më 1999). Primakov këmbëngul se pavarësia e Kosovës është ‘problem i politikës së jashtme, që ka ndërlikime negative për marrëdhëniet ndërmjet Rusisë dhe ShBA-ve’.²⁵⁹ Sipas tij, problemi mund të zvogëlohet kur të përfundojë kërkimi për zgjidhje dhe kur të kuptohet se ‘demarkacioni territorial është zgjidhja e vetme’.²⁶⁰ Gazeta ditore *Blic* është njëra prej mediseve më me ndikim në Beograd që ende beson se ndarja e Kosovës është opSION dhe për këtë përpiqet të gjejë të intervistuar që e mbështetin këtë tezë. Gazeta ditore (përfshirë disa të tjera) intervistoi profesorin e

253 *Politika*, 29 maj 201

254 Po aty.

255 Këndvështrimet e tyre më së shpeshti transmetohen në *The Washington Times* dhe në mediat e tjera.

256 *Politika*, 5 tetor 2011.

257 Po aty.

258 Programi *Ćirilica*, i prezantuar nga Milomir Mariq, 3 tetor 2011.

259 *Politika*, 24 shtator 2011.

260 Po aty.

London School of Economics, James-Kerr Lindsay, gjatë vizitës së tij në Beograd dhe botoi intervistën me titull “Ende ka gjasë për ndarjen e Kosovës, nëse ekziston një plan i mirë”. Nëse Serbia detyrohet të pranojë pavarësinë e Kosovës, argumenton Lindsay, atëherë Prishtina duhet të pranojë se veriu i Kosovës është pjesë e Serbisë.²⁶¹

Qëndrimi i qeverisë

Qeveria në Beograd po përpiket ta portretizojë veten si dikush që nuk ka ndikim tek udhëheqësit e rebelimit serb dhe të ‘revolucionit të trungjeve’ në Kosovën veriore dhe, si pasojë, as në gjendjen e atjeshme në tërësi. Kjo është e saktë vetëm pjesërisht dhe mund të themi që kjo mund të vlejë vetëm për strukturat më radikale në Veri. Këto struktura janë më afër Partisë Demokratike të Serbisë (DSS) dhe Partisë Radikale Serbe (SRS) dhe që të dyja këto parti kanë ushtruar trysni të madhe në kampin ekzistues dhe të brishtë proeuropian. Nuk duhet harruar që ishte pikërisht Beogradi ai që i krijoi dhe i mbajti strukturat paralele (pavarësisht sa qeveri janë ndërruar ndërkohë) dhe si pasojë bart përgjegjësi për to.

Ndikimi i Qeverisë dhe i presidentit Boris Tadić në këto struktura pasqyrohet në disa nivele. I pari ka të bëjë me mënyrën e financimit të tyre. Kjo është e qartë nëse merren parasysh lidhjet e qarta ndërmjet institucioneve serbe me veriun e Kosovës, nga ato civile deri tek ato të sigurisë. Për më tepër, disa prej lëvizjeve të Beogradit gjatë vitit të kaluar tregojnë se skenari i realizuar verën e kaluar, nuk ishte i rastësishëm.

Po ashtu, në zgjedhjet e dhjetorit 2010 në Kosovë (dhe në zgjedhjet vendore më 2009, para kësaj), qeveria serbe, udhëheqësit e Partisë Demokratike (DS) dhe analistët e afërt me ta u dërguan një porosi dykuptimshme serbëve në pjesën jugore dhe qendrore të Kosovës, duke thënë se ata duhej të dilnin në zgjedhje dhe të merrnin pjesë në punën e institucioneve të Kosovës. Në të njëjtën kohë, serbët në veri të Kosovës morën porosi krejt ndryshe, pra t’i bojkotonin zgjedhjet sepse gjendja atje ishte krejt ndryshe.

Për pasojë, serbët që jetonin në jug të lumit Ibër po integrohen ngadalë në institucionet e Kosovës dhe kjo ka pasur si rezultat përmirësimin e shpejtë të gjendjes së tyre (ekonomike dhe të sigurisë). Në anën tjetër, veriu i Kosovës nuk është i sigurt as për vetë serbët. Nuk ka liri të shprehjes dhe tubimit. Çdo kundërshtar atje i nënshtrohet rrezikut të kërcënimit në një mënyrë ose tjetër. Për shembull, gjatë zgjedhjeve të dhjetorit, në Kosovën veriore është regjistruar një numër incidentesh që kishin në shënjestër persona që i nxitnin njerëzit të votojnë. Kështu, pothuajse dy vjet më parë, një zyrtar i lartë i Partisë së Pavarur Liberale dhe deputet i Kuvendit të Kosovës, që jeton në qytetin verior të Mitrovicës, ishte viktimë e sulmit me granatë dore.

²⁶¹ *Blic*, 3 tetor 2011.

Plani i mundshëm për Kosovën

Përballë realitetit të ri dhe papërkulshmërisë së bashkësisë ndërkombëtare (së paku deri tani), Beogradi ka filluar të flasë për krijimin e një autonomie të posaçme territoriale për veriun e Kosovës. Në fund të fundit, si edhe në rastin e Republikës Serbe, Beogradi llogarit që në referendum të përfshihet edhe veriu i Kosovës në Serbi. Në këtë aspekt, Republika Serbe dhe veriu i Kosovës janë të lidhura ngushtë. Republika Serbe, që sillet si shtet brenda shtetit, shërben si model për Kosovën. Si Republika Serbe ashtu edhe Kosova varen nga 'strategjia e pritjes', që të vijë një çast i volitshëm. Shpresohet që situata ndërkombëtare do të ndryshojë dhe kjo do të bëhet në mënyrë paqësore. Ky qëndrim i matur është i favorshëm për paqëndrueshmërinë e përhershme në rajon.

Edhe pse në një masë më të vogël, mediat e Beogradit njoftojnë se ka gjithnjë e më shumë propozime për pranimin e realiteti, duke theksuar gjetjen e një zgjidhjeje për veriun e Kosovës. Më së shpeshti sugjerohet që kjo të bëhet në formën e një 'Plani Ahtisaari plus', çka nënkupton garantimin e autonomisë territoriale për komunat në pjesën e Kosovës, të cilat kufizohen me Serbinë afër Rashkës dhe Novi Pazarit. Në këtë kontekst është përmendur po ashtu edhe mundësia e mbajtjes së një konference ndërkombëtare për Kosovën. Nisma e parë (gjysmë) zyrtare në këtë aspekt mund të ndërmerret nga kryetari i Këshillit Politik të DS, Dragoljub Miqunović.

Kërkesat për 'pranimin e realitetit' lidhur me Kosovën po dëgjohen gjithnjë e më shumë në publik, edhe pse ato janë të pakta. Në mesin e partive politike, Partia Liberale Demokratike (LDP) ka qëndrimin më të qartë lidhur me këtë çështje, duke përkrahur pranimin e Planit të Ahtisaarit, që Serbia e ka refuzuar në tërësi gjatë bisedimeve në Vjenë më 2006. Lëvizja e Ripërtëritjes Serbe (SPO) dhe udhëheqësi i saj Vuk Drashkoviç kanë mendim të njëjtë. Drashkoviçi pohon se duhet të pranohet pjesa e Planit të Ahtisaarit që nuk ka të bëjë me statusin, çka do t'u mundësonte komunave serbe të krijonin lidhje ndërmjet vetes dhe me Serbinë në bazë të interesit të tyre, me 'autonomi rajonale shtesë të paraparë për komunat serbe në veri të lumit Ibër'. 'Plani i Ahtisaarit,' thotë Drashkoviç, 'është kryesisht kopje e planit të mëparshëm Z-4 për serbët në Kroaci dhe kombinim i zgjidhjeve të mira që zbatohen për konfliktet e ngjashme ndërshtetërore dhe ndërshoqërore në Europë.' Ai thotë se komunat serbe në veri të Ibrit do të gëzonin autonomi të njëjtë me atë që i është dhënë Tirolit Jugor.²⁶²

Disa nëpunës të lartë publikë të mëparshëm (ambasadorë) dhe tani analistë të pavarur (Ognjen Pribiçević dhe Predrag Simić) po ashtu përkrahin një qasje më racionale si zgjidhje të përhershme për krizën që po zgjat me muaj të tërë tani në Kosovën veriore. Gazetari i *Politikës* dhe komentuesi më me ndikim i mediave, Boshko Jakshiq, po ashtu i takon këtij rrethi.

262 *Politika*, 27 shtator 2011.

Përveç insistimit për 'zgjidhje paqësore' përmes 'dialogut', qëndrimi i DS në pushtet nuk është i qartë. Jo zyrtarisht, brenda vetë qeverisë ka mosmarrëveshje lidhur me atë se çka duhet të bëhet, duke treguar që disa anëtarë të koalicionit në pushtet nuk janë plotësisht në një mendje me këtë. Zëvendëskryeministri dhe udhëheqësi i SPS, Ivica Daçiç, është posaçërisht i njohur për qëndrimin e tij radikal. Është dëshmuar se kryetarja e Parlamentit dhe kolegja e partisë së Daçiçit, Slavica Gjukiç-Dejanoviç, mendon se është e nevojshme të sqarohet qëndrimi i Daçiçit lidhur me ndarjen, duke thënë se 'ai nuk është për ndarje, por për vizatimin e linjës së kufirit'. Ajo theksoi se 'linja e kufirit nënkupton praninë e institucioneve serbe në vendet ku dominon popullsia serbe'.²⁶³

Vladimir Todoriç, drejtor i Qendrës së Politikës së Re, një organizatë joqeveritare e afërt me DS, thotë se nuk duhet përjashtuar mundësia që qeveria do të ndryshojë edhe retorikën, edhe sjelljen e saj. Ai thotë se Beogradi ka qenë për një kohë të gjatë tepër optimist se ShBA-të do të ndryshojnë mendimin lidhur me ndarjen në fjalë, çka sqaron arsyen pse 'ne nuk e kemi ngritur çështjen e statusit të posaçëm për Veriun në një kohë më të përshtatshme'. Ai pohon se 'koha e paktë që ka mbetur' duhet të shfrytëzohet për 'të formuluar një propozim brenda fushës së të mundshmes për të mundësuar autonominë më të gjerë për serbët në Veri, ndërsa duhet të ruhet niveli aktual i decentralizimit në Jug'.²⁶⁴

Qendra e Politikës së Re ka shpallur gjithashtu një platformë për bisedimet Serbi-Kosovë, në të cilën përfshihen elementet e një marrëveshjeje.²⁶⁵ Sipas propozimit, autonomia funksionale e Kosovës nuk do të bazohet në Kushtetutën e Kosovës, por në një marrëveshje të arritur nga Serbia, Kosova dhe BE-ja si garantuese (me miratimin e KB-së, duke u bazuar në një rezolutë të re). 'Sovraniteti i Serbisë do të njihet në mënyrë deklarative nga Marrëveshja, e cila do ta parashikonte "delegimin" e pushtetit sovran të Serbisë Kosovës e që, në aspektin juridik, do të nënkuptonte që Kushtetuta e Serbisë mbetet burim i sovranitetit, çka mund të jetë shumë e rëndësishme nëse Marrëveshja shkelet nga ana e Kosovës në rastin e komunitetit serb,' thuhet në platformë.

Po ashtu, komunave serbe do t'u jepej një institucion i përbashkët për bashkërendimin e aktivitetit të tyre dhe do të shërbente si pikë kontaktuese për komunikimin e tyre me Beogradin. Kuvendi i komunave serbe, i quajtur Kuvendi Ndërkomunal, nuk do të mundej të nxirrte ligje, por do të mund të miratonte vendime në kuadër të 'kompetencave të përbashkëta të transferuara'. Komunitet serbe do të çmilitarizoheshin, 'përveç policisë së Kosovës, që duhet të mbetet nën kompetencat e EULEX-it'. Zbatimi i marrëveshjes do të mbikëqyrej nga një organ i përbërë nga përfaqësuesit e Serbisë, të Kosovës dhe të BE-së. Serbët e Kosovës do të kishin mbështetje nga bashkësia

263 *Danas*, 10 tetor 2011.

264 *Politika*, 30 shtator 2011.

265 <http://www.cnp.rs/articles/view/22>.

ndërkombëtare (ndërsa mbrojtja nga Serbia nuk do të vihej në pikëpyetje deri në shkallën që është ende e mundshme). Ata duhet të kenë të drejtë në shtetësi të dyfishtë, pa diskriminim lidhur me vizat. Sipas propozimit, do të ishte e mundur që disa vende të kenë konsullatë në qendrën administrative të komunitetit serb.

Zëvendëskryetari i DS, Dragan Gjilas, shkoi më larg kur e distancoi veten nga politika e ndjekur deri tani. Duke u paraqitur në programin *Utisak nedelje* të TV B92, ai tha se në të kaluarën Serbia kishte harxhuar shumë mundim, përpjekje dhe kohë në territore dhe se tani ishte koha që të kujdesej për popullin.²⁶⁶

Megjithatë, në vend që të kërkojë dalje nga rruga pa krye pas marrjes së sinjaleve të qarta nga KFOR-i, BE-ja dhe ShBA-të se nuk do të ketë kthim prapa, në një raport për aktivitetet e saj lidhur me stabilizimin e gjendjes në Kosovë, qeveria serbe erdhi në përfundimin se misionet ndërkombëtare në Kosovë kishin vënë veton në shërbim të Prishtinës. Raporti do t'i dorëzohet Parlamentit në fund të tetorit. Qeveria tha se interesat e serbëve të Kosovës vazhdonin të përkraheshin dhe të mbroheshin me të gjitha mjetet që ishin në dispozicion, duke pasur parasysh kontekstin politik dhe të sigurisë së përkufizuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB dhe me Marrëveshjen Ushtarake e Teknike të Kumanovës.

Ç'mund të bëjë Beogradit

Radikalizimi i situatës në Kosovë varet kryesisht nga rezultati i zgjedhjeve që po afrohen. Fushata tashmë është duke u zhvilluar dhe, me sa duket, Kosova është tema e vetme që është ngritur deri tani. Blloku kundër Europës po e shfrytëzon Kosovën, aty ku mund të përdorë më shumë ndikim se qeveria, si armë me të cilën mund ta mundë kundërshtarin në zgjedhje. Megjithatë, Kosova nuk është prioritet i qytetarëve serbë. Sipas sondazheve të opinionit publik, kjo çështje renditet e teta në mesin e shqetësimeve të tyre, pas problemeve të tyre ekonomike, të sigurisë, atyre shëndetësore dhe problemeve të tjera.

Rryma proeuropiane në qeveri dhe ata që kanë të bëjnë me aspektet teknike të integritit europian i vazhdojnë përpjekjet e tyre në atë drejtim sikur zhvillimet aktuale në veri të Kosovës nuk kanë të bëjnë me Serbinë dhe me statusin e saj të kandidatit. Tani, njerëzit në qeveri janë më të moderuar në deklaratimet dhe në sjelljen e tyre se ç'ishin në fillim të krizës. Kryetari Tadiç i bën lajka segmentit nationalist të popullsisë, ndonëse nuk ka nevojë ta bëjë këtë.

Përfaqësuesit e qeverisë po përpiqen të shkaktojnë shqetësime mes diplomatëve të huaj duke parashikuar një operacion të ri 'Stuhia', një katastrofë humanitare dhe

266 Programi Utisak nedelje, TV B92, 2 tetor 2011.

një valë refugjatësh nga Kosova. Kjo ka ndodhur edhe përpara. Por pyetja shtrohet nëse një rezultat i tillë do të ishte i mundur pa nxitje strategjike nga Beogradi. Askush nuk e merr parasysh faktin se ka struktura të mëdha kriminale që funksionojnë në Kosovën veriore. Kur të vijë koha që ato të tërhiqen, ka mundësi të shkaktohet eksod serb. Gazeta javore *NIN*, duke cituar burime anonime, ka raportuar se huliganët ishin infiltruar në Veri nga Serbia.

WikiLeaks rishtazi publikoi një informacion të vitit 2008 nga Ambasada e ShBA-ve në Budapest, ku citohet ministri i Jashtëm serb Vuk Jeremiç duke i thënë një zyrtari të ShBA-ve: 'Pavarësia në Kosovë nënkupton luftë në Ballkan... dhe lufta në Ballkan nënkupton refugjatë në Hungari dhe në zonat etnike hungareze në Serbi'.

Milorad Dodik, kampion i bllokut antieuropian, së bashku me Jeremiçin, po merr pjesë aktive në përpjekjet për t'u marrë me çështjen e Kosovës. Taktikat e tij përmbledhen në thënien se serbët dëshirojnë qartazi 't'i krijojnë të drejtat e tyre', në mënyrë që në një të ardhme të jenë në gjendje të sillen si shqiptarët. 'Duhet të jemi të durueshëm dhe ta paguajmë çmimin e kohës në të cilën jemi duke jetuar. Në përputhje me rrethanat, aktualisht duhet të jetojmë për (Republikën) Serbe dhe të vazhdojmë me ndërtimin e saj. Pra, gjëja kryesore është RS. Nuk do t'ia japim askujt më asnjë pjesë të saj.' (Raporti i Komitetit të Helsinkit, f. 556, *Večernje novosti*, 28 korrik 2010). Kur shpërtheu kriza e fundit në Kosovë, Dodik paraqiti propozimin që Serbia dhe Republika Serbe duhet ta krijojnë një union sipas modelit të Unionit Shtetëror të Serbisë dhe të Malit të zi. Megjithatë, në lidhje me krizën, Dodik tha se popullit në Kosovë duhet t'i thuhet qartë që shteti do të rezervojë shuma të konsiderueshme për komunitetin serb që mbetet atje dhe do t'u jepte tokë në Serbi ose në Republikën Serbe atyre që dëshironin të imigronin. Ai mendon se kjo është zgjidhja e vetme dhe se shqiptarëve nuk duhet t'u jepet më rast që të flasin për shoqëri shumetnike.

BE dhe ShBA janë të vendosura për Kosovën

Kriza në veri të Kosovës ka ngulitur qëndrimin e BE-së dhe të ShBA-ve se nuk do të ketë kufij të rinj në Ballkan.

Këtë ia bëri të qartë presidentit Tadiç jo vetëm Angela Merkel, por, sipas të gjitha të dhënave, edhe sekretarja amerikane e Shtetit, Hillary Clinton, gjatë takimit të Asamblesë së Përgjithshme të KB. Clinton tha se takimi i saj me Tadiçin ishte i zbrazët dhe se ai nuk kishte thënë asgjë të re që do ta ndryshonte mendimin e saj se Beogradi po vazhdon ta luajë kartën e ndarjes së Kosovës.²⁶⁷

Politikanët e tjerë europianë, të cilët e kanë vizituar Beogradin rishtazi, e kanë bërë gjithnjë e më të qartë se nuk do të ketë ndarje. Për shembull, sekretari austriak i

267 Danas, 30 shtator 2011

Shtetit, Wolfgang Walden, i cili mori pjesë në Samitin Ekonomik në Beograd, tha qartë se pavarësia e Kosovës ishte realitet. Sipas mendimit të tij, ndarja nuk është opsion. Ai beson se duhet të gjendet një formulë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës veriore sa më parë që të jetë e mundur.²⁶⁸

Raporti i Progresit 2011 për Serbinë ishte më i qartë dhe theksonte se, në mënyrë që të marrë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, Serbia duhet t'i shpërbëjë institucionet paralele në veri të Kosovës dhe ta rivendosë dialogun me Prishtinën deri me 9 dhjetor. Kjo përfundimisht iu dha fund iluzioneve të Beogradit që ndarja e Kosovës është opsion.

Qëndrimi i Rusisë

Gjatë fazave të hershme të krizës në vendkalimet kufitare në Bërnjak dhe në Jarinjë gjatë verës së kaluar, Moska tregoi përmbajtje të dukshme. Sidoqoftë, më vonë, ambasadori rus në Beograd, Alexander Konuzin, filloi të ndërhynte haptazi e duke bërë të ditur se Rusia nuk do të hiqte dorë nga ambicia e saj për të luajtur rol kryesor në rajon. Në Forumin e parë të Sigurisë në Beograd, Konuzin i qortoi me inat të pranishmit, të cilët nuk po i mbronin interesat e vendit të tyre në Kosovë. Në një çast, ai bërtiti me zemërim: “A nuk ka serbë në këtë sallë?” Po ashtu, ai tha se në Serbi kishte njerëz që ishin të gatshëm t’ia shisnin objektet ekonomike çdokujt tjetër përveç Rusisë, edhe pse ishin në dijeni që objektet do të shkatërroheshin si rezultat i kësaj.

Pas këtij skandali, në tërë Beogradin u shfaqën afishe ku shkruhej: ‘Alexander Konuzin, ambasador i serbëve në Serbi’. Afishet ishin vepër e ‘Srpski narodni pokret 1389’ në mbështetje të ambasadorit rus, sepse, sipas organizatës, ai ishte ‘nën kritika dhe sulme të vazhdueshme’ pas Forumit të Sigurisë në Beograd.²⁶⁹

Konuzin shkaktoi incidentin, i cili ishte dënuar si skandal diplomatik, me mbështetjen e Moskës. Për incidentit njoftuan po ashtu edhe gazetatat ruse, duke thënë se kjo mund të ndikonte në aleancën e Beogradit me Moskën. *Zëri i Rusisë* nuk mendonte që Konuzin kishte bërë ndonjë gjë për të fituar emrin ‘ngatërrestar’ nga media dhe theksoi se ishte skandaloze që një forum i tillë u mbajt në prani të Presidentit serb. Duke folur në tubimin elektoral të Partisë Përparimtare Serbe (SNS) në Nish, Konuzin tha: ‘Partia Përparimtare Serbe²⁷⁰ është bërë treguesi kryesor për gjendjen shpirtërore të qytetarëve të Serbisë. Kjo ju krijon mundësinë të bëni plane të karakterit gjithëkombëtar, si dhe të merrni përgjegjësi për besimin dhe shpresat që kanë njerëzit në këtë parti.’²⁷¹ Ndërhyrja e Konuzinit në çështjet e politikës së brendshme të Serbisë nxiti reagimin e ashpër të qeverisë.

268 *Blic*, 4 tetor 2011.

269 *Alo*, 22 shtator 2011.

270 Partia Përparimtare Serbe është fuqishëm proruse dhe mbështetë ‘edhe Rusinë, edhe BE-në’.

271 http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2011&mm=10&dd=30&nav_category=11&nav_id=553594

Në përgjithësi, në kontekstin e marrëdhënieve të komplikuar dhe të pasigurta me ShBA-të (sidomos kur Putini njoftoi se do të kandidonte përsëri për president), Moska ka treguar, me anë të gjestit të pahijshëm dhe despotik të Konuzinit, se ajo dëshiron të mbetet aktore në Ballkan përmes Serbisë, Republikës Serbe dhe Kosovës veriore, si dhe dëshiron tërthorazi të forcojë pozitën e saj në forumet ndërkombëtare, sidomos në KB dhe në Këshillin e Sigurimit mbi fuqinë e kontrollit të saj në Ballkan. Për rrjedhojë, nga Rusia mund të pritet që të vazhdojë me 'mbrojtjen' e interesave të Serbisë në organet ndërkombëtare, përderisa kjo u përshtatet interesave të saj strategjike në marrëdhëniet me BE-në dhe me ShBA-të.

Përfundime dhe rekomandime

Politika e Beogradit për Kosovën përfundimisht është mundur dhe madje është ndalur çdo mundësi për ndarjen e Kosovës. Me sa duket, Beogradi ka llogaritur që bashkësia ndërkombëtare dhe KFOR-i do ta pranojnë faktin e kryer. Duke pasur këtë qëllim parasysh, Beogradi është shtirur se po zhvillon dialog me Prishtinën dhe në këtë mënyrë e ka shtyrë zgjidhjen e çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me pavarësinë e Kosovës. Duke e radikalizuar çështjen e Kosovës, Serbia ka minuar pozitën e saj përballë BE-së. Kjo ka shkaktuar turbullimin e skenës së brendshme, që tashmë është shumë e ndikuar nga fushata zgjedhore.

Meqë opsioni i ndarjes është përjashtuar, Beogradi do të mund ta zgjidhte lehtë çështjen e Kosovës, para së gjithash duke vepruar në pajtueshmëri me kushtet e vëna në Raportin e Progresit 2011 për Serbinë. Po ashtu, gjithnjë e më shumë po përmendet zgjidhja e statusit të Kosovës veriore sipas një 'Plani Ahtisaari plus', që parasheh një autonomi të gjerë për komunitetet lokale, përfshirë financimin transparent nga Serbia.

Autoritetet e Beogradit po ashtu duhet t'u dërgojnë serbëve në veri të Kosovës sinjale të tjera, posaçërisht që të kthehen drejt Prishtinës dhe institucioneve të Kosovës dhe të merren së bashku me problemet e tyre. Ndonëse Beogradi do të mund të jepte ndihmë, ai nuk duhet të jetë aktor që bën lëvizje vendimtare dhe tërheqë popullsinë vendase në konflikt më të gjerë si me shqiptarët e Kosovës, ashtu dhe me bashkësinë ndërkombëtare. Modeli i autonomisë për serbët e Kosovës duhet të ketë mekanizma që janë krijuar për ta parandaluar ndërhyrjen e Serbisë në sovranitetin e Kosovës duke i shfrytëzuar serbët e Kosovës ashtu siç po ndodhë në Republikën Serbe. Çdo ngjashmëri ndërmjet veriut të Kosovës dhe Republikës Serbe do ta bënte Kosovën jo funksionale si shtet.

Nëse Serbia lë jashtë territorin e Kosovës veriore kur të organizojë zgjedhjet e ardhshme (në pranverë 2012), kjo do të jetë shenjë e qartë se e ka pranuar realitetin dhe është pajtuar me zhdukjen graduale të institucioneve dhe strukturave paralele në atë pjesë të Kosovës.

Serbët e Kosovës veriore duhet të bëhen partnerë dhe të bisedojnë me autoritetet e Kosovës dhe me bashkësinë ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, serbët atje duhet të vendosin për të ardhmen e tyre, pozitën dhe jetën e tyre brenda atij sistemi. Aktualisht, serbët në Kosovën veriore janë peng i politikës së Beogradit. Për këtë arsye, ajo pjesë e Kosovës është po ashtu e pasigurt edhe për vetë serbët. Nuk ka liri të shprehjes. Gjithkush që nuk pajtohet, bëhet objekt kërcënimi nga pala serbe. Shpërbërja e institucioneve paralele në Kosovë meriton mbështetje të fuqishme. Nuk duhet të pritet që Serbia ta bëjë gjithë këtë përnjëherë. Qasja graduale do të ishte shumë më efektive. Shpërbërja e këtyre strukturave nuk do të jetë e thjeshtë duke pasur parasysh lidhjen e tyre të ngushtë me kriminelët që praktikisht qeverisin zonën. Ata nuk do të heqin dorë vullnetarisht nga përfitimet që mbledhin nga paligjshmëria, kontrabanda dhe korrupsioni.

Shembujt e decentralizimit të modeluar në bazë të karakterit etnik, që nuk janë gjithmonë domosdoshmërisht të këqij, duhet të merren parasysh po ashtu në kontekstin specifik të ish-Jugosllavisë. Së pari, këto autonomi nuk janë pasojë e marrëveshjes, por rezultat i konfliktit dhe paraqesin pjesë të presë së luftës. Së dyti, pavarësisht nga të gjitha nismat rajonale që merren, Beogradi ende ka ndikim të madh në vendet fqinje, domethënë në stabilitetin e tyre të brendshëm, duke shfrytëzuar serbët vendas. Ekziston përshtypja që autonomia territoriale do t'i përmbushte aspiratat serbe vetëm për një kohë të shkurtër. Kjo po shkakton dyshime dhe shqetësime mes fqinjëve në lidhje me decentralizimin etnik. Së treti, Serbia nuk pranon t'u japë autonomi territoriale komuniteteve pakicë në territorin e saj. Për shembull, asnjë qeveri serbe nuk i ka plotësuar kërkesat e hungarezëve të Vojvodinës për autonomi territoriale, ndonëse këto kërkesa janë paraqitur që 15 vjet më parë. Kërkesat për autonomi territoriale në Serbi po rriten: shqiptarët duan e këtë në Serbinë jugore dhe boshnjakët në Sanxhak.

Në mënyrë që të sigurojë statusin e vendit kandidat (nëse është vërtet e interesuar për të), qeveria serbe do të duhet të përpaket t'i përmirësojë dëmet e shkaktuara nga radikalizimi i pamatur i gjendjes në Kosovën veriore dhe të tregojë gatishmëri për vazhdim konstruktiv të dialogut me Prishtinën. Ajo do të duhet ta bëjë këtë deri në dhjetor, para se vendet anëtare të BE-së të votojnë për propozimin e Komisionit për kandidimin e Serbisë. Qeveria dhe presidenti serb duhet të shkëputen nga 'revolucionarët e trungjeve'. Një qëndrim i vendosur i qeverisë²⁷² në këtë aspekt do të ndihmonte në zbutjen e tensioneve dhe në qetësimin e zemërimit të qytetarëve serbë, të cilët ka kohë që e kanë kuptuar se Kosova nuk mund të kthehet brenda kufijve të Serbisë. Serbët në Kosovë, përfshirë ata që jetojnë në Veri, nuk kanë besim në politikën e Beogradit dhe janë shumë më realistë lidhur me situatën. Po del që populli i zakonshëm, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi, ka dëshmuar se është shumë më realist dhe më racional se vetë qeveria.

272 Marrja e kufirit nga autoritetet e Kosovës do të mund të shfrytëzohej nga Serbia në dobi të saj. *Beogradi do të mund t'i thoshte popullit se Kosova veriore nuk mund të mbrohet më ngase nuk mund të luftohet me 'tërë botën'.*

Bosnja dhe Hercegovina



Gjendja aktuale e marrëdhënieve ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës dhe mundësia për zhvillimin e tyre

DENISA SARAJLIQ MAGLIQ: Nisma për politikë të jashtme e BH; Sarajevë Janar 2012

Hyrje

Ndërlikimi i marrëdhënieve ndërmjet Bosnjës dhe Hercegovinës (B&H) dhe Kosovës rrjedh nga trashëgimia e tyre e përbashkët, roli i fuqishëm i Serbisë dhe përpjekjet e tyre të vazhdueshme për të ushtruar ndikim në dy vendet, lidhja e së ardhmes së Republikës Serbe me pavarësinë e Kosovës dhe aspiratat europiane të dy vendeve, që deri më tani nuk kanë qenë të suksesshme në përmirësimin e marrëdhënieve reciproke. Sa herë që përmenden marrëdhëniet me Kosovën, aktivizohet reciprociteti dhe ngjashmëria me Republikën Serbe dhe fryma e ndarjes së Republikës Serbe vazhdon të përvijohet mbi B&H dhe, për rrjedhojë, edhe në marrëdhëniet e saj me Kosovën. Serbët e Republikës Serbe e konsiderojnë pavarësinë e Kosovës si padrejtësi për të gjithë serbët në rajon dhe shpesh nënkuptohet se duhet të kërkohej kompensim përmes autonomisë më të gjerë për Republikën Serbe. Megjithëse i pajustifikuar, ky argument përpiket t'i lidhë fatet e dy vendeve dhe lë shumë pak hapësirë për pragmatizëm. Për këto arsye, për dallim nga vendet e tjera që nuk e kanë njohur Kosovën, Bosnja dhe Hercegovina bart barrën e rreziqeve shumë të mëdha nëse bën hapa shumë të vegjël për përmirësimin e marrëdhënieve për ndonjë arsye pragmatike. Për B&H, Kosova nuk është çështje 'e politikës së jashtme'; ajo trajtohet si çështje për debate të brendshme, që e bën pothuajse të pamundur çfarëdo lloj racionalizimi për Kosovën. Së bashku me mungesën e pragmatizmit, mungesa e konsensusit të brendshëm për çështjen e njohjes së Kosovës ka mundësi ta bëjë B&H vendin e fundit në Europë që do ta njohë Kosovën, vetëm pasi Serbia të merrte një vendim të tillë.

Megjithatë, duke e pasur parasysh mungesën e përparimit deri më tani, mund të thuhet që B&H po bën edhe më pak se Serbia për t'i lehtësuar marrëdhëniet me Kosovën lidhur me disa çështje praktike. Në këtë aspekt, Beogradi ka marrë disa hapa gjatë vitit të kaluar për njohjen e dokumenteve të Kosovës, si: vulave doganore, targave të regjistrimit, diplomave, etj. Sidoqoftë, B&H ka ndërmarrë vetëm hapa modeste në këtë aspekt dhe vetëm pas vonësive të gjata dhe presionit të fuqishëm nga BE-ja. Njëra prej arsyeve për këtë është fakti që, si Serbia, ashtu edhe Kosova janë angazhuara përmes një procesi të strukturuar që lehtëson dialogun në bisedimet e ndërmjetësuar nga

BE-ja. B&H dhe Kosova nuk kanë ndonjë mënyrë të tillë të komunikimit lidhur me çështjet e hapura dhe për këtë arsye çdo diskutim për përmirësimin e marrëdhënieve me Kosovën është *ad hoc*, reagues dhe pa ndonjë agjendë të qartë. Fakti që B&H nuk kanë pasur qeveri në nivel shteti, ka pothuajse pesëmbëdhjetë muaj, prej zgjedhjeve të tetorit 2010, që vetëm e acaron situatën dhe BE-ja nuk ka pasur një homologe që mund t'ia drejtonte çështjen e marrëdhënieve me Kosovën. Kjo është arsyeja pse mund të pritet më shumë presion nga BE-ja sapo të formohet qeveria e re në B&H. Pra, nëse zhvillohet ndonjë dialog, ai mund të ndodhë vetëm nën ombrellën e BE-së.

Mungesa e konsensusit të brendshëm

Në shumicën e vendeve të tjera që nuk e njohin Kosovën, duket se ekziston një konsensus i brendshëm politik lidhur me këtë çështje. Megjithatë, Kosova është njëra prej çështjeve më të diskutueshme për të cilën palët e ndryshme në B&H nuk pajtohen. Ky fakt e bën të pamundur zhvillimin e një dialogu racional për Kosovën, pasi ai do të jetë gjithmonë pasqyrim i mosmarrëveshjeve të brendshme dhe i debateve të vazhdueshme për të ardhmen e vetë B&H. E çara ndërmjet dy palëve kundërshtuese është aq e thellë sa jo vetëm që është e paimaginueshme të flitet për njohje në të ardhmen e afërt, por madje as për ndërmarrjen e disa hapave pragmatike që do të rivendosnin lidhjet praktike dhe do të mundësonin bashkëpunimin minimal. Në këtë kuptim, mund të thuhet që B&H është madje edhe më larg se Serbia në normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

Marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe B&H janë lënë në hije nga krahasimet e nënkuptuara që bëhen ndërmjet dy vendeve dhe do të vazhdojnë të mbeten kështu. Në njërin anë ka njerëz që pohojnë se pavarësia e Kosovës është e justifikuar për shkak të vetëvendosjes pas shkeljes së të drejtave të njeriut dhe mungesës së ndonjë mundësie tjetër për zgjidhjen e marrëdhënieve me Serbinë – çka lë të kuptohet krahasimi se pavarësia është kërkuar për shkak të arsyeve të njëjta si edhe në rastin e B&H. Në anën tjetër, serbët e Bosnjës kundërshtojnë pavarësinë dhe bëjnë krahasim duke mbështetur shkëputjen e Republikës Serbe (RS) duke u bazuar në 'vullnetin e popullit', çka do të testohet me referendum.

Një vendim me rëndësi të tillë, siç do të ishte rasti i njohjes së Kosovës, kërkon konsensus të tre anëtarëve të Presidencës së B&H (boshnjak, kroat dhe serb). Deri më tani, të gjithë anëtarët e Presidencës pajtohen që kjo çështje nuk do të jetë në agjendën e tyre në të ardhmen e afërt duke pasur parasysh mungesën e dukshme të konsensusit për këtë çështje. Sidoqoftë, kjo nuk i ka penguar anëtarët aktualë dhe ata të mëparshëm të Presidencës së B&H që të shfaqin mendimet e tyre personale në publik. Në të dy rastet, ata që e mbështesin dhe ata që e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës i bazojnë mendimet e tyre në arsye emocionale, në vend të së drejtës ndërkombëtare ose të vendimeve të organizatave ndërkombëtare.

Më 26 shtator 2008, ndërsa po merrte pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, Kryesuesi i atëhershëm i Presidencës së B&H, Haris Silajxhiç, i tha *Zërit të Amerikës* se e mbështeste pavarësinë e Kosovës dhe e kundërshtonte kërkesën e Serbisë që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të jepte mendim lidhur me ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës. I zëshëm në lidhje me çështjen e pavarësisë së Kosovës është edhe anëtari kroat i Presidencës së B&H, Zhelko Komshiq, i cili refuzon çdo krahasim me B&H për arsye se “...për dallim nga Kosova, Republika Serbe nuk ishte rezultat i historisë ose i një procesi të gjatë historik. Ajo u krijua si rezultat i luftës dhe kurrë nuk ka gëzuar status të shtetit, ndërsa Kosova ishte krahinë autonome e ish Jugosllavisë dhe kishte qeverinë, parlamentin, gjyqësorin dhe policinë e vet, ashtu siç kishin të gjitha republikat federative”. Ai shkaktoi reagime të fuqishme te politikanët në Serbi dhe në Kroaci kur, pas deklaratave për të ardhmen e B&H nga kryetari i Kroacisë dhe ai i Serbisë në takimin e tyre të përbashkët, Komshiq tha se ai “mbështetë integritetin e Kroacisë dhe të Serbisë pa Kosovën”. Autoritetet serbe reaguan duke dërguar një notë proteste në Ministrinë e Punëve të Jashtme të B&H. Më pas, Komshiq pranoi publikisht se është e qartë që njohja e Kosovës nuk do të jetë në agjendën e Presidencës së B&H në të ardhmen e afërt, por një qëndrimi i tillë duhet të shqyrtohen herët a vonë duke marrë parasysh harmonizimin e politikës së jashtme të B&H me atë të BE-së.

Anëtari aktual boshnjak i Presidencës, Bakir Izetbegović, nuk e fsheh mbështetjen e tij për pavarësinë e Kosovës, por nuk është mbrojtësi i saj i hapur. Ai është takuar herë pas here me zyrtarët kosovarë në sfond të ngjarjeve ndërkombëtare, por për shkak të mosnjohjes zyrtare të Kosovës si shtet, këto takime nuk kanë qenë në plan të parë.

Në anën tjetër, kundërshtari më i zëshëm i njohjes së Kosovës është Kryetari i Republikës Serbe, Milorad Dodik. Në disa raste ai ka thënë se B&H kurrë nuk do ta njohë Kosovën, sepse anëtari serb i Presidencës së B&H do të shfrytëzojë veton. Ai e arsyeton një qëndrim të tillë duke deklaruar se fati i të gjithë serbëve është i ndërlidhur, pavarësisht në cilën pjesë të Ballkanit jetojnë dhe po ashtu i sheh ata si viktimë të kompleteve të huaja. Pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) mbi ligjshmërinë e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës nga Serbia, në shkurt 2008, Dodik tha se kjo nxiste veprime për më shumë autonomi në Republikën Serbe. Dodik pohon se shpallja e pavarësisë së Kosovës është “...udhëzim për betejën tonë për status (juridik) dhe të ardhmen e Republikës Serbe. ...ne dëshirojmë t'i përcaktojmë të drejtat tona qartazi, në mënyrë që të jemi në gjendje të veprojmë në ndonjë situatë të ardhshme ashtu si po veprojnë shqiptarët tani.”

Më 22 shkurt 2008, vetëm disa ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Kuvendi Nacional i Republikës Serbe miratoi një deklaratë për mosnjohjen e Kosovës. Në deklaratë thuhej se shpallja e pavarësisë së Kosovës është “akt i papranueshëm i ndarjes së integritetit territorial të një shteti sovran dhe të njohur ndërkombëtarisht”, si dhe u bënte thirrje të gjithë përfaqësuesve në institucionet e RS dhe të B&H që të

bënin gjithçka për të parandaluar njohjen e Kosovës. Ajo po ashtu dënonte synimin e shumë shteteve për njohjen e Kosovës, duke pasur parasysh që njohjet paraqesin zbatimin e një parimi të ri të vetëvendosjes, çka mund ta ndiqte edhe RS. Në këtë mënyrë, deklarata e Kuvendit Nacional nënkupton të drejtën e RS që të mbajë referendum për shkëputje nga B&H. Bashkësia ndërkombëtare në B&H reagoi fuqishëm ndaj deklaratës dhe u bëri thirrje autoriteteve në RS t'i respektonin parimet e Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit, e cila mbron dhe garanton integritetin e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Prej atëherë, Dodik ka vazhduar ta mbështesë ndarjen e Kosovës, me ç'rast pjesa e saj veriore do të mbetet në juridiksionin e Serbisë. Ai e sheh këtë si zgjidhje që mund të garantojë stabilitet në të ardhmen, meqë "ndarjet gjithmonë kanë sjellë stabilitet në të kaluarën". Duke u bazuar në këtë, Dodik rekomandon që Serbia t'i kthehet vetvetes e jo Europës. Dodik është takuar në disa raste me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës duke i mbështetur ata gjatë konfrontimit të tyre të hapur me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe duke nxitur frikën e tyre nga komplotet e huaja. Përmes ngjarjeve të tilla publike, Dodik krijon një iluzion që RS qëndron në mënyrë më të vendosur pas serbëve të Kosovës se Serbia, edhe pse RS nuk ka luajtur kurrfarë roli që ka të bëjë me të ardhmen e Kosovës apo të popullsisë së saj pakicë. Pas një takimi të tillë në Banja Luka, Sllavisha Ristiç, udhëheqësi i Zubin Potokut (komunë me shumicë serbe në Kosovë) tha se ata marrin mbështetje më të madhe politike nga zyrtarët e RS se sa nga autoritetet serbe. Ai deklaroi se Banja Luka është "më afër nesh për shkak të mbështetjes së tyre të hapur për kërkesat tona dhe të qëndrimit tonë për rolin e bashkësisë ndërkombëtare". Mirëpo, përkundër retorikës së fuqishme në të kaluarën, deklaratat e fundit të Dodik janë dëshmi për faktin se ai e pranon pavarësinë e Kosovës si fakt të pakthyeshëm dhe që aspiratat për integritimin e saj të sërishëm në Serbi janë të kota. Sidoqoftë, të gjitha partitë politike në RS pajtohen njëzëri që B&H nuk duhet ta njohë Kosovën.

Po ashtu, ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të imponuar shkëputjen e Republikës Serbe si kompensim territorial në bisedimet për statusin e Kosovës. Madje edhe disa analistë politikë u angazhuan në përpjekjen për t'i rivizatuat kufijtë, në mënyrë që të krijojnë një zgjidhje të re për Kosovën me çmimin e integritetit territorial të B&H. Këto propozime u paraqitën nga pikëpamja e kërcënimit të perceptuar për përhapjen e krizës jashtë kufijve të Kosovës dhe aty përfshihej edhe frika nga konflikti më i gjerë rajonal. Një frikë e tillë u nxit edhe më shumë nga deklaratat e zyrtarëve serbë, siç ishte rasti me Vojislav Koshtunicën, i cili ishte kryeministër në atë kohë, i cili deklaroi se Republika Serbe dhe Kosova ishin prioritetet kryesore të Serbisë, duke lënë të kuptohej kompensimi territorial me B&H, kur të shkëputej Kosova.

Mirëpo, kjo është çështja e vetme në të cilën bashkësia ndërkombëtare mbeti e vendosur dhe e bashkuar dhe nuk pranoi kërcënimet. Ata haptas mbështetën mbrojtjen e integritetit të B&H sipas Marrëveshjes së Dejtonit dhe refuzuan çdo krahasim ndërmjet Kosovës dhe B&H. Ambasadat e ShBA-ve në Zagreb, Beograd dhe Sarajevë vazhdimisht kanë refuzuar ndonjë krahasim ndërmjet Kosovës dhe B&H. Ato kundërshtuan fuqishëm mbajtjen e referendumit në RS pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe vazhdimisht kanë theksuar që Marrëveshja Paqësore e Dejtonit është zgjidhja e vetme për të ardhmen e B&H dhe kjo çështje nuk duhet të hapet. Një qëndrim të ngjashëm mbajtën edhe Përfaqësuesit e Lartë të Bashkësisë Ndërkombëtare në B&H (PL), si Miroslav Lajçak në kohën e shpalljes së pavarësisë, ashtu edhe PL aktual, Valentin Inzko.

Qëndrimi për Kosovën në arenën ndërkombëtare

Kosova është edhe një çështje tjetër e zënkës ndërmjet partive kundërshtare në B&H, që nuk duhet të nënvlerësohet në lidhje me përpjekjet e ardhme për përafrimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. B&H ka qenë në prag të krizës së rëndë politike që nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2006 dhe madje edhe çështjet me ndjeshmëri më të vogël janë shfrytëzuar për nxitjen e tensioneve, edhe ashtu të larta, ndërmjet partive kryesore politike. Përkundër faktit që numri i përgjithshëm i votave në mesin e partive kryesore politike ndryshoi pas zgjedhjeve të përgjithshme më 2010, qëndrimet mbeten pak a shumë të njëjta. Gjashtë partive të mëdha politike iu deshën katërmbëdhjetë muaj të arrinin një marrëveshje koalicioni për formimin e qeverisë, ndërsa të gjitha çështjet e pazgjidhura që kishin ndodhur në periudhën paraprake u bënë edhe më të dukshme, përfshirë çështjen e njohjes së Kosovës, që mbeti çështje e zënkave të mëdha. Në këtë mënyrë, zyrtarët e B&H iu kundërvunë njëri-tjetrit lidhur me çështjen e njohjes së Kosovës, madje edhe në forumet ndërkombëtare, duke e zgjeruar më tej mungesën e konsensusit të brendshëm për këtë çështje të njohur.

Kur u ftuan të merrnin pjesë në Konferencën e Pestë të Kryetarëve të Parlamenteve nga Ballkani Perëndimor, që u mbajt në Budapest më 12 nëntor 2011, kryetarët e Dhomës së Përfaqësuesve dhe të Dhomës së Popullit të Parlamentit të B&H e nxorën këtë debat jashtë kufijve të B&H. Ognjen Tadiç, kryetar i Dhomës së Popullit, i dërgoi një letër organizuesit të konferencës, kryetarit të Parlamentit hungarez László Kövér, në të cilën refuzoi pjesëmarrjen në konferencë për shkak të pranisë së njoftuar të përfaqësuesve të Kosovës. Tadiç kërkoi po ashtu që përfaqësuesit e dy entiteteve të B&H të ftoheshin si të barabartë me Kosovën, e cila, sipas mendimit të tij, është entitet i Serbisë dhe jo shtet i pavarur. Kjo nxiti dërgimin e një varg letrash kryetarit të Parlamentit hungarez, në të cilat kryetarët e dy dhomave të Parlamentit të B&H shprehën secili mendimet e tyre për trajtimin e Kosovës në ngjarjet ndërkombëtare, nganjëherë duke përdorur gjuhë shumë diplomatike. Në veçanti, ky incident tregoi

shkallën në të cilën përfaqësuesit e Republikës Serbe kundërshtojnë çdo përpjekje që ata t'i afrohen diskutimit për marrëdhëniet me Kosovën. Jo vetëm që e kundërshtojnë përmirësimin zyrtar të marrëdhënieve, por e shfrytëzojnë atë për arsye simbolike, për ta treguar haptas mbështetjen për Serbinë në arenën ndërkombëtare. Cilado nga dy arsyet që mund të mbizotërojnë në ngjarje të caktuara, mbetet fakt që përfaqësuesit e Republikës Serbe nuk do ta ndryshonin qëndrimin e tyre para se këtë ta bënte Serbia. Në fund, kompromisi për çështjen e Kosovës do të konsiderohej si shenjë dobësie për serbët e RS në marrëdhëniet politike/etnike brenda B&H dhe kjo është arsyeja pse është edhe më e pritshme që ata do të mbajnë qëndrim të vendosur për një kohë të gjatë.

Autoritetet e B&H u gjendën në pozitë disi të mundimshme për Kosovën kur B&H u bë anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Mirëpo, në këtë rast, dukej se integritetit të përfaqësimit të B&H në OKB iu dha përparësi mbi ndarjet e brendshme për Kosovën. I dobishëm ishte po ashtu fakti që Presidenca e B&H i mori vendimet për Kosovën nën ombrellën e Rezolutës 1244 të OKB-së, pa pasur në këtë mënyrë as njohje të nënkuptuar të statusit të saj. Gjatë mandatit të B&H në Këshillin e Sigurimit, tetë herë janë diskutuar raportet e rregullta tremujore për Kosovën dhe në dy raste është debatuar për Kosovën në seanca të posaçme. Presidenca e B&H ishte në gjendje të arrinte konsensus për qëndrime lidhur me këto debate në tetë prej dhjetë rasteve. Edhe pse anëtari serb i Presidencës ishte kundër qëndrimit të posaçëm në disa raste, megjithatë Presidenca e B&H ishte në gjendje të merrte vendim, meqë ai nuk përbënte interes jetik nacional, kështu që ambasadori i B&H në OKB mori udhëzime të qarta për votim. Sidoqoftë, edhe pse Presidenca e B&H gjeti rrugën për të arritur kompromis, me qëllim që të mbrojë besueshmërinë e rolit të B&H në KS të OKB-së, zyrtarët serbë u përpoqën ta kundërshtonin një qasje të tillë. Në një rast, ministri i Jashtëm serb, Vuk Jeremiç, udhëtoi në Banja Luka që të kërkonte nga Milorad Dodik mbështetjen e B&H për përpjekjen për një rezolutë të dorëzuar nga Serbia, në të cilën dënohej dhuna në Kosovë. Siç u përmend më herët, përgjegjësinë e qartë për marrjen e vendimeve për politikën e jashtme e ka Presidenca e B&H dhe duke qenë se Dodik është kryetar i njërit prej entiteteve të B&H, ai nuk luan rol zyrtar në hartimin e politikës së jashtme. Pra, Jeremiçi jo vetëm që u përpoq t'i anashkalonte institucionet zyrtare të B&H, që janë përgjegjëse për politikën e jashtme, por po ashtu kërkoi nga zyrtarët e RS t'i vinin interesat e Serbisë para interesave të B&H, çka solli reagime të fuqishme publike mes zyrtarëve të B&H dhe shkaktoi edhe një krizë të vogël të brendshme. Kjo ishte dëshmi e përpjekjeve të vazhdueshme të Serbisë për përhapjen e krizës në rajon dhe jashtë kufijve të saj. Duke vepruar kështu, zyrtarët serbë mbështesin një lidhje imagjinare ndërmjet të ardhmes së Kosovës dhe të ardhmes së Republikës Serbe dhe, si pasojë, edhe të së ardhmes së B&H.

Njohja e dokumenteve të Kosovës

Në gusht 2008, ministri i Jashtëm i B&H, Sven Alkalaj, tha se, sipas ligjit të B&H, pasaportat e Kosovës nuk mund të konsiderohen të ligjshme për shkak të faktit që B&H nuk e njeh Kosovën si shtet. Kjo nxiti një debat të gjatë politik dhe juridik lidhur me mënyrën për lejimin e personave që kanë pasaporta të Kosovës që të udhëtojnë nëpër territorin e B&H. Vetëm dy vjet më vonë, Ministria e Punëve të Jashtme e B&H (MPJ), nën tryshninë kryesisht të BE-së, i dërgoi një letër Presidencës së B&H, ku propozoi zgjidhjen që zbatohet në vendet e tjera që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por që e kishin tejkaluar problemin e udhëtimit të shtetasve kosovarë. Në letërën e saj, MPJ i propozoi Presidencës së B&H që të zbatonte një zgjidhje që do të përcaktohej sipas vendimit të Komisionit Europian EC 333/2002. Sipas kësaj zgjidhjeje, vizat e B&H mund të jepen në një dokument të posaçëm të udhëtimit, në mënyrë që të bëhet e mundur lëvizja e lirë e njerëzve. Sidoqoftë, një anëtar serb i Presidencës së B&H, Nebojsa Radmanović, e refuzoi këtë propozim me arsyetimin e mosnjohjes së Kosovës. Kompromisi i vetëm që u ofrua ishte mundësimi i procedurave të posaçme që do të ndihmonin përfaqësuesit e Kosovës që merrnin pjesë në nisma të caktuara rajonale, për shembull në takimet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal me bazë në Sarajevë.

Duke u bazuar në këtë, Këshilli i Ministrave mori një vendim më 8 maj 2010, në të cilin i dha MPJ-së miratimin që t'u jepte viza në dokumente të posaçme të udhëtimit atyre shtetasve të Kosovës për të cilët kishte vendosur se 'ishin me interes të posaçëm për B&H'. Në pajtim me atë vendim, MPJ u dërgoi udhëzimet e saj të gjitha misioneve diplomatike – konsullore të B&H (MDK) që t'u jepnin viza shtetasve të Kosovës në një formular të posaçëm që u dërgohej atyre. Sidoqoftë, në udhëzimet e dërguara për misionet diplomatike-konsullore, MPJ theksoi se Këshilli i Ministrave ishte përgjegjës për vendosjen e kritereve për përcaktimin e personave me 'interesi të posaçëm për B&H'. Edhe pse kompetenca në këtë rast është e diskutueshme, vendimi për çdo kërkesë individuale për vizë për një shtetas të Kosovës së pari duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Si rezultat, shtetasve që kanë pasaporta të Kosovës mund t'u jepet rasti të udhëtojnë përmes territorit të B&H vetëm kur konsiderohen që janë 'me rëndësi të posaçme' për shtetin e B&H. Këto raste shqyrtohen në mënyrë individuale, zakonisht për arsye të trajtimit mjekësor ose të pjesëmarrjes në ngjarje rajonale të organizuara në B&H. Shumica e rasteve për të cilat nevojitet vendimi i KM miratohen, por sidoqoftë procedura është e gjatë, e rëndë dhe shumë njerëz thjesht nuk bëjnë përpjekje të aplikojnë.

Si reagim ndaj zbatimit të kësaj procedure, përfaqësuesit boshnjakë në institucionet e Kosovës i kanë dërguar një letër Presidencës së B&H, ku kërkojnë që të zgjidhet çështja e njohjes së pasaportave të Kosovës. Në letër sqarohej se studentët nga Kosova nuk lejohen të studiojnë në Sarajevë ngaqë nuk mund të regjistrohen në universitet për

shkak të faktit që dokumentet e tyre nuk pranohen dhe këtu përfshihen edhe studentët e Kosovës me origjinë boshnjake. Aty po ashtu përmendet fakti se procedura që zbatohet tani pengon udhëtimin e lirë që, mes të tjerash, prek shumë familje shqiptare dhe boshnjake që jetojnë në dyja vendet. Në fund, në letër theksohet se vende si Greqia dhe Sllovakia, që nuk e njohin Kosovën, kanë ndërmarrë hapa për të lejuar udhëtimin e lirë për personat që kanë pasaporta të Kosovës. Meqë Presidenca e B&H nuk iu përgjigj kësaj letre, ajo iu dërgua po ashtu Përfaqësuesit të Lartë të Bashkësisë Ndërkombëtare, Valentin Inzko, i cili e njoftoi për këtë Nikolla Shpiriq, Kryesuesin e KM në atë kohë, si dhe ministrin e Jashtëm Sven Alkalaj. Përfaqësuesi i Lartë u përpoq të shfrytëzonte ndikimin e tij politik në mënyrë që të tërhiqte vëmendjen e autoriteteve të B&H lidhur me çështjen e njohjes së pasaportave të Kosovës dhe t'i informonte për praktikat që shfrytëzoheshin në këtë rast në vendet e BE-së, përfshirë ato që nuk e njohin Kosovën.

Befasues është fakti që madje edhe autoritetet serbe kanë bërë më shumë lëshime kur është fjala për udhëtimin me dokumente të Kosovës, pas një marrëveshjeje kur u zhvilluan bisedime mes Serbisë dhe të Kosovës në Bruksel në korrik 2011. Më 22 dhjetor, qeveria e Serbisë miratoi një deklaratë për lirinë e lëvizjes duke e përkufizuar kontrollin mbi kalimet në linjën administrative të Kosovës. Deklarata parashikon që personat që kanë dokumente identifikimi të lëshuara nga institucionet e përkohshme të Kosovës mund ta kalojnë kufirin pasi t'iu jepen dokumente hyrëse dhe dalje. Në akt, po ashtu, përfshihet një pikë në të cilën thuhet që targat e Kosovës duhet të hiqen në vendkalime kufitare dhe të zëvendësohen me targa të përkohshme.

Po ashtu, nëse B&H do ta zbatonte linjën e BE-së ashtu siç do të duhej të ndodhte bazuar në dispozitat e Marrëveshjes së saj për Stabilizim dhe Asocim me BE-në, që kërkojnë harmonizim në këtë fushë, ajo do të duhej të fillonte të kërkonte zgjidhje për udhëtimin e lirë për shtetasit e Kosovës. Më 14 dhjetor 2010, Këshilli European mbështeti liberalizimin e ardhshëm të vizave për Kosovën dhe Komisioni European ka paraqitur disa kushte për fillimin e dialogut për vizat me Kosovën, që duhet të fillojë më 2012. Këshilli tërhoqi vëmendjen se fillimi i dialogut për liberalizimin e vizave me Kosovën bëhej “pa i paragjykuar qëndrimet e shteteve anëtare për statusin e Kosovës”, duke iu referuar pesë shteteve të BE-së që nuk e njohin atë.

Imigrimi nga Kosova

Në mungesë të konsensusit të brendshëm për të ardhmen e Kosovës, politikanët në B&H patën qëndrime të ndryshme lidhur me konfliktin e Kosovës, por ishin pothuajse njëloj të kujdesshëm që të mos bënin deklaratat të fuqishme që do ta nënkuptonin ndonjë krahasim ndërmjet dy vendeve. Përveç çështjes së imigrimit të refugjatëve në B&H, konflikti në Kosovë nuk pati ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në Bosnjë dhe

Hercegovinë. Gjatë konfliktit, B&H kishte pranuar një numër të konsiderueshëm refugjatësh nga Kosova dhe në fund të vitit 1998 përafërsisht 10.000 njerëz kishin kërkuar strehim në B&H. Edhe pse shumë prej tyre e kishin shfrytëzuar B&H si vend transit dhe ndërkohë kishin kërkuar azil në vendet e treta, atje mbetet një numër i konsiderueshëm i azilkërkuesve nga Kosova; sipas disa vlerësimeve, më 2011 ishin deri në 4.000 syresh (një numër i konsiderueshëm ka ardhur në vitet e fundit). Çështja e statusit të atyre personave është që, sipas legjislacionit të B&H, ata mund të kërkojnë strehim të përkohshëm deri në tre vjet dhe pas kësaj kohe statusi i tyre duhet të rishikohet. Disa janë përpjekur ta përtërijnë statusin e tyre 'të strehimit të përkohshëm' deri tri herë radhazi, ndërsa shumica janë këshilluar që të kërkojnë azil në mënyrë që të qëndrojnë përgjithmonë. Megjithatë, vendimi për dhënien e azilit bëhet duke u bazuar në vlerësimin e gjendjes së sigurisë në Kosovë, e cila tani është përmirësuar në mënyrë të diskutueshme, kështu që shumica e kërkesave për azil në të vërtetë refuzohen. Kjo i lë disa qindra azilkërkues në një situatë që nuk merr zgjidhje dhe kjo është arsyeja përse ata ankohen në Gjykatën e B&H, ku vijnë procedura të gjata gjyqësore dhe nuk janë në gjendje ta legalizojnë statusin e tyre. Shumë prej tyre janë ende të vendosur në 'qendra kolektive' e në kushte të mjerueshme jetese.

Në Kosovë jeton një pakicë e vogël boshnjake që, sipas disa vlerësimeve, shkon në rreth 4.000 persona, çka është një numër i vogël në krahasim me numrin prej 17.000 personash që jetonin atje para luftës. Shoqatat e pakicës boshnjake, që llobojnë për njohjen e Kosovës, paralajmërojnë për imigrim masiv të popullsisë së tyre nga Kosova dhe pohojnë se ky imigrim nuk do të ishte aq i madh sikur B&H ta njihte Kosovën. Përfaqësuesit boshnjakë nga Kosova i kanë akuzuar përfaqësuesit politikë boshnjakë nga B&H se ata tregojnë vetëm mbështetje deklarative, ndërsa çështjet pragmatike, siç është udhëtimi me dokumente të Kosovës, mbeten të pazgjidhura. Pakica boshnjake në Kosovë po ashtu ankohet për pamundësinë e shfrytëzimit të librave në gjuhën boshnjake dhe të institucioneve arsimore në B&H, çka e vështirëson mësimdhënien e gjuhës boshnjake në shkollat në Kosovë.

Në gusht 2009, udhëheqësi i Bashkësisë Islame në B&H, Reis-ul-Ulema Mustafa Ceriq ishte për një vizitë treditore në Kosovë. Vizita ishte planifikuar në mënyrë të tillë që të dërgonte një mesazh politik, si dhe ishte simbol i bashkëpunimit ndërmjet dy komuniteteve myslimane. Ceriq u takua me Kryetarin e atëhershëm të Kosovës, Fatmir Sejdiu, mbajti fjalim gjatë faljes të së premtes dhe vizitoi monumentet kulturore dhe fetare të vendit, përfshirë memorialin për Adem Jasharin, udhëheqës i kohës së luftës në Kosovë, të cilit forcat serbe ia kishin vrarë tërë familjen më 1998. Vizita e Ceriqit i provokoi dhe i zemëroi serbët si në Serbi ashtu edhe në RS. Millorad Dodik e quajti vizitën e Ceriqit në Kosovë 'të papërshtatshme', duke pohuar se meqë B&H nuk e njihte Kosovën zyrtarisht, asnjë vizitë në atë nivel, madje edhe nëse nuk e përfaqëson shtetin, nuk konsiderohej e përshtatshme. Dodik akuzoi Ceriqin se është "ideolog i

rëndësishëm i politikës islame, i cili nuk ndërhyt vetëm në çështjet e brendshme të Bosnjës dhe Hercegovinës, por të të gjithë rajonit”.

Humbjet tregtare

Sipas Odës Ekonomike të B&H, tregtia totale ndërmjet B&H dhe Kosovës është rreth 80 milionë euro dhe shumica janë eksporte nga B&H në Kosovë. Kështu, Kosova është një partner i rëndësishëm tregtar për B&H dhe nga të paktat vende me të cilat B&H ka bilanc tregtar pozitiv. Kjo prirje madje është rritur dhe në gjysmën e parë të vitit 2011 vlera totale e eksporteve në Kosovë ishte mbi 35 milionë euro. Eksportet kryesore në Kosovë janë hekuri, substancat kimike, barërat dhe mishi. Sidoqoftë, më 20 korrik 2011, qeveria e Kosovës mori një vendim të njëanshëm duke zbatuar një taksë doganore prej 10% për mallrat e importuara nga B&H. Ky akt shkaktoi reagim të Odës Ekonomike të B&H dhe të asaj të Serbisë, që i dërguan një letër të përbashkët Sekretariatit të CEFTA-s, në të cilën ankoheshin për shkeljen e rregullave në zonën e tregtisë së lirë. Zbatimi i taksës doganore shkaktoi rënie të menjëhershme të tregtisë mes dy vendeve dhe shumë kompani të B&H që eksportonin në Kosovë thanë se nuk do të ishin më konkurreuese më në tregun e Kosovës. Mes kompanive që eksportojnë në Kosovë janë ‘Hemija patenting’ nga Lukavaci, që furnizon impiantet termike të Kosovës me substanca kimike dhe acide; ‘Obrrt komerc’ nga Gradaçaci, që eksporton prodhime karpentierie; ‘Fininvest’ nga Dërvari, etj. Humbja totale e shkaktuar gjatë këtyre tre muajve, në kohën që zbatohet ky vendim, vlerësohet të jetë disa milionë euro dhe tregtia pësoi rënie për 7-8% në atë periudhë.

Qeveria e Kosovës e tërhoqi vendimin e saj vetëm pasi Ministria për Tregti të Jashtme dhe Marrëdhënie Ekonomike e B&H i informoi ata se pranonte vulën e Zyrës Doganore të Kosovës. Vendimi u shfuqizua më 22 shtator, pasi autoritetet e Kosovës dhe të Beogradit u pajtuan për dizajnin e vulës doganore në Bruksel, më 2 shtator. Sidoqoftë, ka pasur vonesa të mëtejshme në zbatimin e tërheqjes së vendimit, sepse Ministria për Tregti me Jashtë e B&H i drejtoi një letër UNMIK-ut, ndërsa qeveria e Kosovës nuk e pranonte atë, nëse nuk i drejtohej ministrisë kompetente në qeverinë e Kosovës. Ndërkohë, kompanitë e B&H humbën shumë kontrata, sepse gjatë tre muajve, deri sa vendimi për taksën doganore ishte në fuqi, kompanitë nga Kroacia, Bullgaria dhe Maqedonia morën një pjesë të tregut të tyre.

Është interesant të përmendet fakti që shumë prej kompanive nga B&H që eksportojnë në Kosovë, gjenden në Republikën Serbe. Sipas zonjës Dragica Ristiq, drejtoreshë ekzekutive e Odës Ekonomike të RS, tregu i Kosovës ka “rëndësi të madhe për ne. Ne jemi ekonomi e vogël dhe eksportet janë shumë të rëndësishme për ne. Nëse e humbim pozitën tonë në treg, do të shfaqen kompani të reja dhe do të jetë më vështirë t’i fitojmë përsëri ato tregje”. Një kompani që gjendet në RS, ‘Swisslion Tools Industry’

nga Trebinja, u përpoq t'i tejkalonte problemet që ndodhën për shkak të faktit që dogana e B&H nuk e pranonte vulën doganore të Kosovës duke eksportuar përmes një kompanie me seli në Podgoricë, Mal të Zi. Menaxheri i kësaj kompanie tha se eksportet ishin shumë më të lehta para 'se të përfshihej politika' dhe shprehu dëshirën të vazhdonte të punonte 'normalisht' ashtu si më parë, sepse ai po ashtu e konsideron Kosovën treg të rëndësishëm.

Çështja e mosnjohjes së dokumentit tregtar të Kosovës u diskutua edhe në Parlamentin e B&H dhe disa deputetë të Parlamentit kërkuan që Këshilli i Ministrave ta zgjidhte problemin sa më shpejt, në mënyrë që të mbroheshin eksportuesit nga B&H. Disa analiza shkaktuan shqetësime lidhur me faktin që ish-kryeministria e Kroacisë, Jadranka Kosor, kryesoi një delegacion të madh tregtar në Kosovë në kulmin e krizës së eksportit nga B&H.

Përfundim

Pavarësisht nga qëndrimi i tyre personal ose zyrtar, emocional ose racional për Kosovën, mund të thuhet që politikanët dhe vendimmarrësit në B&H pajtohen për dy fakte: pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme, por ata nuk do të jenë në gjendje të arrijnë konsensus në të ardhmen e afërt për njohjen e saj. Ajo që nevojitet tani është pragmatizmi që do të hynte në mes të këtyre dy fakteve – pranimi të realitetit në terren, pa njohje të plotë në horizont. Ky do të ishte rekomandimi i parë dhe kryesor për çdo aktor të jashtëm; pra, të kërkohen zgjidhje për përmirësimin e marrëdhënieve që do t'i lehtësonin gjërat praktike të jetës së përditshme për popullin e Kosovës, ekonominë e saj, bizneset, botën shkencore, shoqërinë civile etj.

Fakti i tretë që mund të pranohet, por ende nuk është përmendur në mënyrë të mjaftueshme, është se nuk ka krahasime ndërmjet statusit të Kosovës dhe të ardhmes së B&H. Sa më shumë të theksohet ky fakt, aq më shumë do të zbuten tensionet brenda B&H. Përderisa bëhen krahasime, madje edhe në mënyrë të nënkuptuar, por megjithatë të diskutueshme, ato do të shërbejnë si arsye për kërkesat për më shumë autonomi e madje edhe për shkëputjen e Republikës Serbe. Deri më tani, bashkësia ndërkombëtare ka qenë e vendosur dhe e bashkuar lidhur me këtë çështje, por ata duhet të jenë më të zëshëm, sidomos në kontekstin e integriteteve në BE. Pikërisht korniza për integrim në BE nuk duhet të lejojë hapësirë për rivizatimin e ri të kufijve, çka mund të jetë e vështirë përderisa ka zëra kundërshtues brenda vetë BE-së për statusin e Kosovës dhe të ardhmen e saj në BE.

Megjithatë, të gjithë aktorët ndërkombëtarë duhet të jenë të bashkuar lidhur me çështjen e ndërhyrjes së nënkuptuar ose të qartë të Serbisë në marrëdhëniet brenda B&H, në këtë rast për çështjet që kanë të bëjnë me statusin e Kosovës. Nga disa

prej shembujve të paraqitur këtu del qartë se zyrtarët serbë priren ta kanalizojnë pakënaqësinë e tyre për politika të caktuara lidhur me Kosovën përmes politikanëve të RS, në mënyrë që të kompensojnë lëshimet që bëjnë në dialogun me BE-në. Duke pasur parasysh faktin që BE-ja në B&H është më tepër e përqendruar në udhërrëfyesin e BE-së për vetë Bosnjën, marrëdhëniet me Kosovën janë disi të shkëputura nga ai proces. Nëse BE-ja do ta shtonte tryshinë ndaj B&H që të ndjekë hapin e Serbisë në përmirësimin e marrëdhënieve me Kosovën, kjo do t'i lente më pak hapësirë Serbisë ta shfrente frustrimin e saj përmes RS. Në mungesë të një tryshnie të tillë, Serbia do të jetë në gjendje të vazhdojë të kërkojë mënyra alternative për të mbështetur këndvështrimet e veta nën pushtetin e RS.

Efektet e politikës së ngarkuar emocionalisht për Kosovën do të zvogëloheshin duke rritur dukshmërinë dhe efektet e lidhjeve ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, mediave, artit, botës shkencore, bizneseve, etj. Kjo mund të arrihet përmes një llojllojshmërie perspektivash për Kosovën, në mënyrë që të nxitet debati publik lidhur me çështjet dhe jo të ketë reagim ndaj kontekstit, krahasimeve ligjore ose trashëgimisë historike. Kjo politikë do të kishte kufizimet e saj, por mund të tregojë rrugën për modelimin e paragjytimeve dhe do t'u japë perspektivën e së ardhmes marrëdhënieve me Kosovën, në vend të trashëgimive të së kaluarës. Siç është përshkruar në shembuj të ndryshëm të paraqitur në këtë punim, pavarësisht sa praktike/teknike/burokratike mund të jetë njëra nga çështjet, ajo gjithmonë shikohet përmes prizmit të separatizmit. Për këtë arsye, nuk ka pasur pothuajse fare dialog substancial publik për Kosovën dhe ka pak mundësi që një dialog i tillë të lindë brenda B&H. Por, në mënyrë që të jetë në gjendje të krijojë kushte të favorshme për mbajtjen e dialogut racional, BE-ja duhet të ofrojë një kornizë ku mund të dëgjoheshin dhe të diskutoheshin argumentet. Për të qenë në gjendje të kenë medie mbështetëse dhe të angazhuara që e zhveshin dialogun publik nga emocionet e panevojshme, krijuesit kryesorë të opinionit duhet të përfshihen në thelbin e çështjeve kryesore që ngarkojnë marrëdhëniet ndërmjet B&H dhe Kosovës në nivel praktik.

Prandaj, aspektet praktike të marrëdhënieve me Kosovën duhet të vendosen në kornizën e integriteteve në BE dhe hapat e menjëhershme do të ishin gjetja e zgjidhjeve për pranimin e dokumenteve të udhëtimit, të tabelave të regjistrimit dhe të marrëveshjeve të tjera që mundësojnë udhëtimin e lirë, lëvizjen e mallrave dhe përmirësimin e marrëdhënieve tregtare. Procedurat aktuale për dhënien e vizave për shtetasit e Kosovës nuk janë të vështira vetëm për ata që u nevojiten, por edhe për Këshillin e Ministrave të B&H, të cilëve iu duhet kohë dhe përpjekje ta rishikojnë, shqyrtojnë dhe ta miratojnë çdo rast individual veç e veç.

Në fund, ky debat duhet të vendoset në kontekstin se lehtësimi i marrëdhënieve me Kosovën nuk bëhet me çmimin e serbëve nga RS ose Serbia. Nëse qeveria e re e

B&H do të kërkonte ndonjë lloj *rivendosjeje të marrëdhënieve* me Serbinë në kuadër të politikës së saj të jashtme të përtërirë, që më tepër do të përqendrohej në rajon, atëherë Serbia do të duhej të luante rolin e saj për t'u dhënë ndihmë zyrtarëve të B&H për uljen e tensioneve në Kosovë dhe në vend. Zyrtarët serbë duhet të kenë rolin e tyre në zhveshjen e portretizimit të marrëdhënieve me Kosovën si viktimizim të serbëve. Prandaj, marrëdhëniet më të thella me Kosovën duhet të vendosen nën ombrellën e politikës së jashtme të ridizajnuar të B&H, në të cilën bashkëpunimi rajonal do të jetë elementi kryesor.

Bogرافیتہ

Qipro

Giorgos Kentas (Ph.D. Vrije Universiteit Brussel, 2009) është Asistent Profesor i Politikës Ndërkombëtare në Universitetin e Nikozisë dhe Hulumtues në Qendrën për Çështje Evropiane dhe Ndërkombëtare. Ai ka marrë titullin Bachelor në shkencat politike në Universitetin e Qipros dhe titullin Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Kentit. Ai është i interesuar të zhvillojë hulumtime në fushën e filozofisë së shkencës, të teorisë së politikës ndërkombëtare, të dhunës së organizuar në politikën botërore, të Politikës Evropiane dhe të Konfliktit të Qipros. Së fundi ka përfunduar një libër për aspektet e sigurisë të problemit të Qipros. Më 2010 ka qenë bashkautor i një libri për bisedimet lidhur me zgjidhjen gjithëpërfshirëse të problemit të Qipros.

Greqia

Ioannis Armakolas është ligjërues në Departamentin për Studime Ballkanike, Sllave dhe Orientale, në Universitetin e Maqedonisë, dhe anëtar i 'Stavros Costopoulos' dhe udhëheqës i Ekipit për Ballkanin Perëndimor në Fondacionin Helen për Politikë Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP). Ai është po ashtu Redaktor Drejtues i revistës Studimet për Evropën Juglindore dhe Detin e Zi të botuar nga Routledge Press, Mbretëria e Bashkuar. Ai ka doktoruar në Universitetin e Kembrixhit, ka magjistruar në Universitetin e Kentit dhe ka kryer shkallën e parë në Universitetin Panteion, në Athinë. Më parë ka qenë anëtar i ESRC në Departamentin për Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare –Universiteti i Oksfordit, hulumtues në Kolegjin Nuffield –Universiteti i Oksfordit, Drejtor për Hulumtime për EKEM-CSIS në projektin 'Task Forca SHBA-Greqi: Të transformuarit e Ballkanit', anëtar i Tip O'Neill në Nismën për Zgjidhjen e Konfliktit dhe Karakterin Etnik në Irlandën e Veriut. Ai ka përvojë të gjerë pune si konsulent në projektet e qeverisjes të USAID dhe DFID në Bosnjë dhe Kosovë dhe ka qenë udhëheqës rajonal për Evropën Juglindore për Oxford Analytica.

Apostolis Karabairis është hulumtues i ri në ekipin për Ballkanin Perëndimor në Fondacionin Helen për Politikë Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP). Ai ka kualifikim akademik në studimet e lëmit (Bachelor në Studimet Ballkanike, Sllave dhe Orientale, Universiteti i Maqedonisë dhe Master në Studimet e Evropës Juglindore, Universiteti i Athinës) dhe ka kryer hulumtime në terren në Bosnjë dhe Hercegovinë. Më parë ka punuar në Qendrën Helene për Studime Evropiane (EKEM) dhe në Fondacionin Kokkalis në Athinë dhe ka kryer praktikën në Asociacionin e Zyrtarëve të Zgjedhur në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Sarajevë.

Rumania

Oana Popescu është Drejtoreshë e Qendrës për Parandalimin e Konfliktit dhe për Paralajmërim të Hershëm në Bukuresht, njërit prej instituteve më prestigjioze për politika në Rumani, i specializuar për çështje të transformimit të konfliktit, të tranzicioneve, të sigurisë dhe ato euroatlantike, duke u përqendruar në mënyrë të posaçme në fqinjësinë BE/NATO. Ajo është po ashtu themeluese e Global Focus, një OJQ e cila zhvillon programe që kanë për qëllim t'i forcojnë lidhjet e Rumanisë me shtetet që shfaqen.

Oana është po ashtu analiste për politika të jashtme dhe analiste politike si edhe është komentuese/kontribuuese e rregullt për magazinën e Politikës së Jashtme, ditoren Rumania dhe Adevarul (gazetë cilësore me qarkullimin më të madh në vend). Në karrierën e saj të mëparshme ajo ka pasur pozitë në shërbimin civil, në media, jo-fitimprurëse dhe në biznes. Ajo ka shërbyer si Këshilltare për Çështje të Jashtme e Kryetarit të Senatit rumun, por ka qenë po ashtu Drejtoreshë e Programit në Institutin Aspen në Rumani, Redaktore e Jashtme e njëres prej gazetave kryesore në vend, Cotidianul dhe është pronare e zyrës këshilluese Marrëdhëniet dhe Komunikimet Qeveritare, Mindset Media, LLC.

Në të gjitha pozitat e numëruara më sipër, Oana Popescu ka marrë pjesë në ngjarje kryesore ndërkombëtare në nivelet më të larta dhe ka qenë afër proceseve vendimmarrëse. Ajo është shpesh mysafire e programeve biseduese në televizion dhe në radio. Më parë, si gazetarë, ajo ishte korrespondente në Shtetet e Bashkuara dhe në Afganistan. Ajo ka intervistuar personalitete të shquara botërore si Henry Kissinger, Madeleine Albright, Bob Woodward ose Francis Fukuyama.

Znj. Popescu ishte bursiste e Fulbright në Universitetin e Yale, ku ka studiuar Demokratizimin dhe Rindërtimin pas Konfliktit, dhe ka punuar si Asistente e Mësimdhënies e ish-këshilltarit të Sekretarit të Përgjithshëm të KB Charles Hill dhe e historianit të shquar Paul Kennedy. Ajo ka kryer hulumtime për Këshillin Evropian mbi Marrëdhëniet me Jashtë dhe për Institutin Suedez Hulumtues dhe Trajnues për Hulumtime lidhur me Administrimin (Crismart). Ajo është autore e disa libra të lidhura për temat që sillen prej menaxhimit të krizës deri te reformat në kujdesin shëndetësor dhe zhvillimet në Evropën Lindore. Aktualisht interesimi i saj kryesor është rindërtimi pas konfliktit dhe stabilizimi në Ballkan dhe në Lindjen e Mesme.

George-Vadim Tiugea është lindur më 27 mars 1979 në Targu Neamt, Qarkun Neamt, në verilindje të Rumanisë. Ai ka diplomuar në Shkenca Politike në gjuhën angleze në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Bukureshtit më 2001 dhe ka diplomë Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare prej vitit 2003 të marrë

në universitetin e njëjtë, me punime që kanë të bëjnë me konfliktet etnike. Më 2002 ai e ka kryer praktikën në zyrën e Kryetarit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Prej vitit 2003 ai ka punuar si hulumtues i shkencave politike në Institutin Shoqëror Demokratik Ovidiu Sincai, ku aktualisht është duke e bashkërenduar Departamentin për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Prej vitit 2004 ai ka punuar edhe si asistent i projektit në Shkollën Evropiane Ovidiu Sincai, një shkollë për politikanë të rinj e mbështetur nga Këshilli i Evropës në vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore. Nga vitit 2009 ai është po ashtu bashkëpunëtor i jashtëm i Parlamentit Evropian. Po ashtu ka qenë redaktor ose autor i disa punimeve dhe artikujve të specializuar siç janë: “Konceptet e Ngjashmërisë, Komunitetit Etnik dhe Kombi në Evropë” në Rishikimin e Shkollës Evropiane të Ovidiu Sincai– 2005, “Drejt një Strategjie të Përbashkët të Sigurisë të Evropës Juglindore” (2005) në faqen e internetit www.dcafyounghfaces.net, Strategjia Rajonale e Sigurisë nga perspektiva e Shoqërisë Civile (ed., 2006), një projekt i Asociacionit të Traktatit të Atlantikut me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, “Strukturat Kryesore të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore dhe Perspektivat e tyre” (2007) në faqen e internetit www.dcafyounghfaces.net, “Evropa Lindore – Trashëgimia Kulturore dhe Historike, Perspektivat e Tashme. Këndvështrimi Rumun” (2007) në *Neprikosnovenny Zapas: debaty o politike i culture (Moskë)*.

Slovakia

Eliska Slavikova ka punuar si hulumtuese e lartë e EUROPEUM Institutit për Politika Evropiane dhe konsulente në politikën zhvillimore dhe publike. Në periudhën prej vitit 2009 deri më 2011 ajo ishte në Kosovë. Më 2008 ishte hulumtuese në Asociacionit Sllovak për Politikë të Jashtme dhe në periudhën 2002-2007 ajo udhëhoqi Programin e Demokratizimit dhe të Drejtave të Njeriut në OJQ-në slloake për zhvillim, Asociacioni Njerëzit në Rrezik. Ajo mori diplomën Master në Universitetin Comenius në Bratislavë në linguistikën slloake dhe gjermane, duke vazhduar me diplomën Master në Studimet Ndërkombëtare Territoriale në Fakultetin e Shkencave Shoqërore në Universitetin Charles, në Pragë. Ajo ka kryer hulumtime për politikën e Ballkanit Perëndimor në Shkollën e Londrës për Ekonomi dhe për Shkenca Politike si Studiuose e British Chevening.

Spanja

Jordi Vaquer i Fanés është Drejtor i CIDOB, Qendra për Çështje Ndërkombëtare e Barcelonës. Ai është po ashtu reporter për çështje ndërkombëtare në El País, në gazetën kryesore ditore të Spanjës. Ai ka diplomën Master në Çështje Evropiane të marrë në Kolegjin e Evropës në Bruges, Belgjikë, dhe ka doktoruar në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Shkollën e Londrës për Ekonomi dhe Shkenca Politike. Ndërmjet periudhës 1999 dhe 2007 ai ka punuar në Departamentin e Presidencës në

Qeverinë e Katalonjës, ku u bë Udhëheqës i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Ai bashkëpunimin përreth Detit Baltik, Detit të Zi, Detit Kaspik dhe Detit Mesdhe të financuar nga Programi i Shtatë Kornizë për Hulumtime i Komisionit Evropian. Ai ka punuar si mësues me korrespondencë në Shkollën e Londrës për Ekonomi dhe Shkenca Politike (London School of Economics and Political Science) dhe në Institutin e Barcelonës për Studime Ndërkombëtare. Dr. Vaquer është kontribuues i rregullt i disa medieve si ekspert për marrëdhënie ndërkombëtare.

Bosnia and Herzegovina

Denisa Sarajlić Maglić është emëruar në pozitën e zëvendësministres për çështje civile në B dhe H në shkurt të vitit 2012. Ajo ka diplomuar në shkencat politike në Universitetin e Wolverhampton në Britaninë e Madhe, pastaj ka marrë diplomën Master në studimet për diplomaci në Universitetin e Westminster në Britaninë e Madhe. Aktualisht është candidate për doktoraturë në fushën e politikës së jashtme të BE-së në Universitetin Bath në Britani të Madhe. Prej vitit 2010 deri në emërimin në pozitën e zëvendësministres për çështje civile e ka kryer punën e drejtoreshës të Nismës së B dhe H për Politikë të Jashtme, ndërsa gjashtë vjetët e kaluara ka qenë drejtoreshë e Departamentit Politik të Projektit për Llogaridhënie në Qeverisje (GAP). Në periudhën prej vitit 2003 deri më 2004 ka punuar si këshilltare politike në Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë, ndërsa para kësaj ka qenë këshilltare e ministrit të punëve të jashtme të B dhe H dhe zëvendësdrejtoreshë e Departamentit për votim jashtë vendit në misionin e OSBE-së në B dhe H.

Denisa Sarajlić Maglić ka publikuar një varg analizash dhe tekstesh në temën e integritimit evropian, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të politikës së jashtme, pastaj të rolit të bashkësisë ndërkombëtare në B dhe H. Ka kryer shumë hulumtime dhe projekte hulumtuese dhe është autore e një varg studimesh të publikuara në B dhe H dhe jashtë vendit.

Serbia

Sonja Biserko, njëra prej aktivisteve më të njohura për të drejta civile dhe njerëzore në Serbi. Ajo e ka kryesuar Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi që nga viti 1994. Ajo është anëtare themeluese e Lëvizjes Evropiane në Jugosllavi, Qendrës për Veprim Kundër Luftës në Forumin e Beogradit për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Aktiviteti i saj për të drejtat e njeriut është shpërblyer disa herë. Ajo është shpërblyer nga Komiteti i Juristëve për të Drejtat e Njeriut nga Nju Jorku, SHBA, është propozuar në projektin “1,000 Gra” për çmimin Nobel të Paqes, është shpërblyer me Çmimin Wimar

2009, me Çmimin Eitinger 2010 nga Universiteti i Osllos dhe më 2010 është shpallur Qytetare Nderi e Sarajevës. Në aspektin profesional, ajo ka shërbyer në programe të shumta për të drejtat e njeriut, përfshirë, Helsinki Watch, Komitetin e Juristëve për të Drejtat e Njeriut, Qendrën e KB për të Drejtat e Njeriut, misionin e Mazowieckit dhe Tribunalin e Hagës. Gjatë vitit 2001 ajo ishte anëtare e lartë e USIP dhe ka punuar në projektin “Nacionalizmi Serb”. Znj. Biserko ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në përpjekjet e shoqërisë civile për rrëzimin e Millosheviqit nga pushteti gjatë vitit 2000. Përveç kësaj, ajo ka shërbyer për disa vite në Ministrinë Federale për Punë të Jashtme, RFJ, prej ku ka dhënë dorëheqje më 1991, kur filloi shpërbërja e Jugosllavisë.

Znj. Biserko është autore e disa artikujve dhe publikimeve, përfshirë Serbia në Orient, Srebrenica: Nga Mohimi deri te Pranimi, Millosheviqi kundër Jugosllavisë, Dubrovnik: Lufta për Paqe, dhe i shkruan rregullisht rreshtat e parë të kryeartikujve që bëhen nga magazina e Komitetit, Karta e Helsinkit.

Znj. Biserko ka diplomuar në ekonomi në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Beogradit më 1970.



"Kosova Thërret" sjell bashkë shtatë analiza mbi marrëdhënien e Kosovës me BE dhe shtetet e rajonit të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e saj: Spanja, Sllovakia, Rumania, Greqia, Qipro, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Këto analiza ishin mandatuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), Projekti "Kosovo Talks EU" që mbështetet nga Këshilli Britanik, dhe Ministria e Kosovës për Punë të Jashtme, si dhe nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe Klubi i Politikave të Jashtme.

©Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur dhe British Council
Prill 2012